



HAPËSIRA MOSPËRPUTHJESH  
Etnografi hapësire dhe vendi në fshatin Dhërmi/Drimades,  
Shqipëria e Jugut

Nataša Gregorič Bon



Botimet Morava





Nataša Gregorič Bon

Hapësira mospërputhjesh  
Etnografi hapësire dhe vendi në  
fshatin Dhërmi/Drimades,  
Shqipëria e Jugut

Recensuese

Ingrid Slavec Gradišnik  
Jasna Čapo Žmegač

Përktheu

Anila Zaimi

Përkujdesja grafike

Mojca Repič Veber

Shtëpia Botuese

Morava

Për botuesin

Kryeradaktori

Shtypur nga

Morava

Tirazhi

200

Botimi i librit është mbështetur nga Agjencia Publike për Veprimtari  
Shkencore e Republikës së Sllovenisë

Fotografia në ballinë: Fshati Dhërmi/Drimades (foto: Daniela Vávrová)

GREGORIČ BON, Nataša, Hapësira mospërputhjesh. Etnografi hapësire dhe  
vendi në fshatin Dhërmi/Drimades, Shqipëria e Jugut / Nataša Gregorič  
Bon. Tiranë: Shtëpia Botuese Morava.

ISBN: 978-9928-169-84-6





NATAŠA GREGORIČ BON

HAPËSIRA MOSPËRPUTHJESH  
ETNOGRAFI HAPËSIRE DHE VENDI NË FSHATIN DHËRMI/DRIMADES,  
SHQIPËRIA E JUGUT

Tiranë 2015





*Në kujtim të Thoma Kunit dhe Niko Belit*





## TREGUESI I LËNDËS

|                                    |     |
|------------------------------------|-----|
| FALËNDERIME .....                  | 6   |
| PARA LEXIMIT... ..                 | 9   |
| HYRJE .....                        | 21  |
| 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ ..... | 37  |
| 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH .....    | 92  |
| 3. DETI DHE MALET .....            | 156 |
| 4. BISEDIME PËR MBETURINAT .....   | 179 |
| PËRFUNDIM .....                    | 203 |
| SHTOJCA .....                      | 212 |
| BIBLIOGRAFIA .....                 | 214 |





## FALËNDERIME

Libri lindi me ndihmën e shumë njerëzve dhe institucioneve me të cilat pata rastin të bashkëpunojta gjatë viteve të realizimit të tij. Është kënaqësi për mua t'u shpreh atyre në këto faqe mirënjohjen time për ndihmën, komentet dhe këshillat e dhëna me shumë zemërgjerësi, dhe së fundi për pyetjet dhe sugjerimet kuptimplote për gjurmime të mëtejshme.

Meritat më të madha i kanë fshatarët e Dhërmiut/Drimadesit, që më hapën dyert e jetës së tyre të përditshme, më ofruan ndihmë të gjithanshme dhe miqësi. Ia vlen të përmenden në mënyrë të veçantë banorët e lagjes qendrore të fshatit që gjetën kohë të bisedonin dhe të ndanin me mua shumë histori të jetës së tyre, duke më krijuar një ndjenjë familjariteti dhe duke më bërë të ndihem si në shtëpi. Le të përmend këtu familjen e tashmë të ndjerit Thoma Kumi që më priti ngrohtësisht në mesin e saj që në ditët e para të punës në terren në fshat. Falënderoj bashkëshorten e tij Anthula për mësimin e greqishtes në orët e mbrëmjes. Gjithashtu i jam mirënjohëse tashmë të ndjerit Niko Beli dhe bashkëshortes së tij Bula për kujdesin e tyre prindëror. Falënderoj dhe pjesëtarët e tjerë të soia/fisit Belej, veçanërisht Amalinë, sot e martuar Konomi, që më prezantoi me shumë të afërm të saj që jetojnë ende në fshat dhe më tregoi shumicën e kishave dhe kapelave në fshat. Enea Kumi i jam shumë mirënjohëse për ndihmën që më dha me përkthimet dhe për durimin e treguar në përgjigjet e pyetjeve të mia të pafundme. Falënderime edhe familjes së Ciko Iliadit, Marko Gjipopulit, Cica Tores dhe Hektoras Belit, Elsës dhe Lefter Kumi, Foto dhe Katerina Bixhilit, Kozma Papasavit, Petro Dhimës, Katina Çulës, Doksijes dhe vajzave të saja, Athinës, familjes Lavdoshi si dhe shumë të tjerëve emrat e të cilëve këtu nuk përmenden.

Falënderoj edhe fshatarët e Palasës ku kreu një pjesë të kërkimeve në terren. Veçanërisht soi/fiseve Verei, Niklei, Milei dhe Babei për mirësjelljen e tyre dhe për bisedat. Falënderime të sinqerta Juliana Verit për ndihmën dhe durimin e saj në përkthimin e dialekteve lokale si dhe për mësimin e tyre.

Me ndihmën e Julianës kapërceva shumë vështirësi, sidomos në fillim të kërkimeve në terren. Së bashku me motrat dhe babanë më mirëpritën shumë herë në shtëpinë e saj në Vlorë dhe Palasë. I jam mirënjohëse edhe Nevila Koçollari Furxhiut dhe bashkëshortit të saj Taqi





## FALËNDERIME

Furxhiut që më prezantuan fshatin dhe zonën përreth dhe më ofruan ndihmë të gjithanshme, sa herë që pata nevojë. Edhe pse shumë histori dhe falënderime nuk u përmendën, shpresoj se shumë njerëz mikpritës do ta njohin veten e tyre në këtë tekst si dhe mirënjohjen time për ta. Faleminderit shumë/Euharisto para poli!

Kërkimet trembëdhjetëmuajore në terren në fshatrat Dhërmi/Drimades dhe Palasë u realizuan mes viteve 2004 dhe 2005 në kuadrin e trajnimit të studiuësve të rinj për doktoraturën dhe u mbështet financiarisht nga Agjencia për Veprimtari Kërkuese dhe Ministria e Arsimit të Lartë, Shkencës dhe Teknologjisë. Monografia mbështetet në ripërpunimin e tezës së doktoraturës që e kam shkruar nën drejtimin e Borut Telban-it dhe Duška Knezević Hočevar-it të Universitetit në Nova Gorica dhe Sarah Green-it nga Universiteti i Manchester-it. Të tre më drejtuan me kujdes gjatë shkrimit të saj. Faleminderit Sarës për të gjitha komentet dhe këshillat mbi raportet që i dërgoja çdo muaj me postë elektronike gjatë kohës së punës në terren. Me qasjen e saj pedagogjike ka bërë gjithmonë komente konstruktive dhe pyetje domethënëse rreth projekt-idesë së doktoraturës. Vërejtjet dhe kritikak e mprehta të Borut-it më kanë ndihmuar për përsosjen e argumentimit. Duška ka ditur t'i dëgjojë me vëmendje mendimet e mia, nganjëherë të pa rregulluara, duke i sistemuar ato me mjeshtëri në kontekstin e duhur dhe duke më ndihmuar të gjej thelbin e tyre. I falënderoj të tre udhëheqësit shkencorë të tezës së doktoraturës për ndihmën e tyre të pakursyer dhe altruiste, kritikak dhe komentet me vlerë.

Përkthimi i librit është mbështetur financiarisht nga Agjencia Publike për Veprimtari Shkencore e Republikës së Sllovenisë së cilës i jam shumë mirënjohëse. Falënderime të përzemërta edhe Anila Zaimit për përkthimin mjeshtëror dhe sugjerimet domethënëse dhe shpjegimet e hollësishme të veçorive gramatikore të shqipes. Falënderoj edhe Kristaq Jorgjin, Kristina Toplak-un dhe Gerti Gurin që më ndihmuar të gjej shtëpinë botuese për botimin e kësaj monografije, si dhe redaktorin e shtëpisë botuese Morava, Artan Selenicën dhe djalin e tij Elindin për punën e tyre.

Falënderoj edhe shumë studiuës të tjerë që më ndihmuar me këshillat e tyre për literaturën dhe burimet e tjera dhe për informacionet e shumta dhe komentet që më ofruan. Shumë faleminderit: Margaritis Gjokës, Kristaq Jorgjit, Enkeleida Tahirit, Juli Vullnetarit, Stephanie Schwandner Sievers-it, Gilles de Rapper-it, Konstandinos Tsitseliki-t, Nathalie Clayer-it, Robert Pichler-it, Ingrid Slavec Gradišnik dhe Jasna Čapo Žmegač. I jam veçanërisht mirënjohëse Marjeta Šašel Kos-it nga Instituti i Arkeologjisë për ndihmën e saj të pakursyer në sqarimin e disa çështjeve që kanë të





## FALËNDERIME

bëjnë me periudhën antike. Falënderime të përzemërta Urška Jereb-it për ndihmën dhe pajisjen me literaturë juridike dhe së fundi falënderoj vëllain tim Janez Gregorič-in për ndihmën që më dha në përpunimin e hartave gjeografike dhe të skicave.

Ky libër nuk do të ishte realizuar pa mbështetjen e ngrohtë të prindërve të mi, të motrës sime dhe familjes së saj dhe vëllait. Falënderoj edhe vjehrrën dhe vjehrrin, jeta e të cilit u ndal para se të shihte rezultatet e kësaj vepre. Falënderime të sinqerta bashkëshortit tim, Jur-it, për mbështetjen intelektuale dhe emocionale, ndihmën, ndjeshmërinë dhe mirëkuptimin e treguar gjatë kohës së mungesës sime shumëmuajore dhe qëndrimit larg për kërkimet në terren dhe shkrimin e librit.







## PARA LEXIMIT...

Ky libër është përkthimi i monografisë në gjuhën sllovene me të njëjtin titull dhe bazohet në të dhënat etnografike të grumbulluara gjatë kërkimeve antropologjike në terren për trembëdhjetë muaj (shtator 2004, dhjetor 2004 – dhjetor 2005) në Dhërmi/Drimades, në bashkinë e Himarës/Himara në Shqipërinë e Jugut. Në përkthim të gjitha të dhënat, përfshirë ato nga terreni, ato zyrtare dhe të dhënat bibliografike janë të njëjta me ato të origjinalit. Këtu bëjnë pjesë edhe të dhëna të tilla siç janë censusi i popullatës, të dhënat e tabelave, grafikëve dhe skicave të lagjeve, të dhënat gjenealogjike etj. që i referohen vitit të punës në terren.

Përsa i përket tejskrimit, fjalët në greqishten lokale janë të shkruara pjerrtas. Në tejskrimin e fjalëve në greqishten lokale jam mbështetur në shqiptimin e greqishtes moderne, siç shkruhet në fjalorin e xhepit të gjuhës greke të Oxford-it (2002).

|    |   |    |      |    |   |    |      |
|----|---|----|------|----|---|----|------|
| Aα | a | Ηη | i, e | Nν | n | Ττ | t    |
| Bβ | v | Θθ | th   | Ξξ | x | Υυ | i, e |
| Γγ | g | Ιι | i, e | Οο | o | Φφ | f    |
| Δδ | d | Κκ | c, k | Ππ | p | Χχ | h    |
| Εε | e | Λλ | l    | Ρρ | r | Ψψ | ps   |
| Ζζ | z | Μμ | m    | Σς | s | Ωω | o    |





### Dyshkronjëshat

|    |    |    |    |    |           |
|----|----|----|----|----|-----------|
| αι | αι | ου | ου | ντ | nd ose d  |
| αυ | av | γκ | g  | ευ | ef ose ev |
| ει | ei | μπ | b  | οι | i ose oi  |

### Pseudonimet

Për të respektuar anonimitetin e bashkëbiseduesve i kam ndryshuar emrat e tyre si dhe disa të dhëna të tregimeve nga jeta e tyre që për këtë vepër nuk janë të rëndësishme.





## PARATHËNIE

Antropologët janë gjithnjë e më të vetëdijshëm se përmbajtja e prezantimeve etnografike nuk është vetëm shkrim »mbi« proceset shoqërore të ndërtimit të vendit, ajo gjithashtu merr pjesë aktive në procesin e këtij ndërtimi. (Gupta dhe Ferguson 2001[1997]: 23)

Gupta dhe Ferguson në veprën *Kultura, forca dhe vendi* (2001) vënë në dukje se zgjedhja e lokalitetit të terrenit antropologjik cakton dhe krijon mënyrën e paraqitjes etnografike dhe orienton përzgjedhjen e qasjes teorike, të nevojshme për analizën e të dhënave etnografike. Për këtë, në vend të hyrjes, po e nis tekstin me parathënien me të cilën jam munduar t'ia përshkruaj lexuesit një pjesë të përvojës sime të punës në terren në Shqipërinë e Jugut, për t'ia afruar atij fshatarët dhe fshatin.

### Vizita paraprake

9 shtator 2004. Ishte ditë vjeshte me diell kur me Entelën u nisëm drejt fshatrave të bashkisë së Himarës (emri zyrtar shqiptar) ose Himara (në greqishten lokale) në Bregdetin jugor shqiptar. Entelën e njoha nëpërmjet Sanilës, pedagoge në Universitetin Teknik »Ismail Qemali« në Vlorë, ku gjatë kërkimeve të mia në Dhërmi (emri zyrtar shqiptar) ose Drimades (në greqishten lokale) isha bashkëpunëtoresh shkencore. Disa ditë para nisjes për në Himarë/Himara, Sanila më prezantoi me një ish studenten e saj që sapo ishte diplomuar në anglisht dhe psikologji. Vendimi i Entelës për të më shoqëruar gjatë vizitës në fshatin e Himarës që disi i jashtëzakonshëm, pasi nëpër fshatra shumicës së vajzave të pamartuara, më të mëdhaja se 18 vjeçe, nuk u lejohet të rrinë në shoqërinë e një të »huaji« ose të »huaje«. Pyetjes sime përse është kështu, njerëzit që pyeta iu përgjigjën disi njësoj. Shumica e tyre i shpjegoi arsyet për këtë me bindjen e përgjithshme se burrat kanë rol kryesor në jetën publike, kurse gratë në jetën private. Kuptohet që këto rregulla janë më tepër një ideal tipik, pasi jeta e përditshme, ashtu si në këtë rast, dikton shpesh sjellje të tjera. Ndryshe nga të rinjtë, të rejat konsiderohen naive dhe të paafta për të gjykuar në »mënyrë të përgjegjshme« mbi përshtatshmërinë e partnerëve të tyre. Kështu vajzat e pamartuara sipas zakoneve »konservative« në mbrëmje (në dimër pas orës 20:00 dhe në verë pas orës 22:00) nuk duhet të shoqërohen





## PARATHËNIE

me djem të rinj. Për arsye sigurie dhe të pikëpamjeve »konservative« ishte disi e pazakontë që babai i lejoj Entelës të më shoqëronte në vizitën time paraprake në fshatin e rivierës shqiptare.

Kushëriri ende i pamartuar i Entelës na çoi në Himarë/Himaro me një Mercedes-Benz pothuajse të ri, një nga markat e makinave që shihet më shpesh në rrugët e Shqipërisë. Vendimi për t'u kujdesur për transportin tonë kishte një numër arsyesh. Vendimtar ishte shqetësimi për sigurinë e nderit të kushëririt, gjë që lidhet me nderin e familjes. Nëse Entela do të mpleksej papritur me ndonjë mashkull nga Himara/Himara, kjo do të ishte krejtësisht e pandershme për fisin.

Gjatë udhëtimit për në Himarë/Himaria, Entela dhe kushëriri i saj vendosën të më çonin në një shëtitje të shkurtër nëpër fshatrat bregdetare të bashkisë së Himarës/Himara deri në qytetin e Himarës, ku kishim të rezervuar një dhomë private në qendër. Njësoj si shumica e shoferëve në Shqipëri, edhe kushëriri i Entelës e ngiste shumë shpejt makinën nëpër rrugën me kthesa, relativisht të re, në luginën e Dukatit, përmes qafës së Llogarasë duke vazhduar drejt Himarës/Himara. Lugina Dukatit, nëpër të cilën kalon lumi Shushica, ka qenë dikur për banorët e zonës së Himarës/Himara deri në shekullin e 19 një nga zonat më të pasura, ku gratë fshatare nga fshatrat përreth Himarës/Himara shkëmbenin kripë, ullinj dhe agrume me drithëra, fruta stine dhe perime. Për shkak të shkallës së lartë të erozionit (Dedej 2002: 12) dhe tokës jopjellore, gjatë kohës së urisë dhe mungesave të tjera fshataret ishin të detyruara të shkonin përtej qafës së malit për të këmbyer ushqimet. Sot fshati Dukat ndahet në pjesën e re dhe të vjetër; pjesa e vjetër gjendet pranë lumit, kurse e reja shtrihet përgjatë rrugës. Për shkak të afërsisë me lumin lugina e Dukatit është relativisht pjellore, me fusha të gjera të mbjella me drithëra dhe misër që janë tashmë të korrura. Në lindje lugina rrethohet e gjitha nga Malet e Vetëtimës ose malet Acroceraunia, që me sa duket e ruajnë nga erërat dhe stuhitë që vijnë nga përtej malit. Në perëndim rrethohet nga shkurre të gjelbërta, prapa të cilave fshihet deti Jon me kaltërsinë e tij të pafundme. Karakteristikat gjeomorfologjike, afërsia me qytetin e Vlorës dhe izolimi relativ nga deti janë disa nga arsyet që lugina ka qenë e zhvilluar mirë për mijëra vite të tëra.

Pas kalimit të shpejtë përmes Dukatit, rruga fillon të ngjitet nëpër kthesat e forta që dredhojnë përmes malit të Çikës. Pas disa kilometrash rruga bëhet edhe më shumë me kthesa dhe më e ngushtë, në lindje rrethohet nga pemë gjethore të larta dhe në perëndim nga malet në gjyrrë kafe të hirtë. Afërsisht në lartësinë 800 metra mbi lartësinë e detit shpaloset pamja mbi krahinën malore të mbuluar me bredha të drejtë e të





## PARATHËNIE

gjelbërt dhe pisha me damarë, majat e të cilave duken si të mprehura nga era. Pas qafës së Llogarasë nxituam nëpër rrugën e ngushtë dhe të pjerrët të ndërtuar gjatë Luftës së Parë Botërore, kur zona e Himarës/Himara së sotme u pushtua nga italianët dhe të burgosurit e tyre e zgjeruan rrugën malore prej guri. Më vonë, në kohën e komunizmit u asfaltua nga brigadat e punëtorëve dhe në vitin 2000 u rinovua sërish.

Për shkak të mjedisit të këndshëm dhe klimës së përshtatshme malore, pushteti komunist donte të ndërtonte një sanatorium për të sëmurët me probleme në mushkëri në vitin 1970 në Llogara. Për shkak të kullotave të shumta që shtrihen në malin e Çikës dhe që u mundësuan njerëzve mbijetesën para dhe pas periudhës së komunizmit, pas vitit 2000 ky kalim malor u shndërrua në një vend të vogël turistik. Sot Llogaraja është tepër e njohur për mishin e qingjit; në majën e qafës së Llogarasë ka shumë restorante që përveç mishit të freskët ofrojnë çdo ditë edhe produkte qumështi, veçanërisht djath deleje, qumësht dhe kos.

Si e sapoardhur, për mendimin e Entelës dhe të kushëririt të saj, nuk duhej të lija pa provuar specialitetet «kulinare» që ofronte Llogaraja. Por nga që nuk ha mish pile dhe mish të kuq, nuk munda ta ndaja me ta kënaqësinë kulinare të drekës, ose bukës (që përveç kuptimit të vaktit, do të thotë edhe bukë). Siç konstatova më vonë, buka është pjesë e pandashme e drekës, kurse pjata kryesore është mishi i qingjit me pilaf. Me kënaqësi të madhe shijova një porcion të madh sallate jeshile, perime në skarë dhe ajkë të bërë në shtëpi, që ofrohej si pjatë shtesë. Pas vaktit u kthyem në makinën e zezë të shndritshme, me të cilën kushëririn i Entelës na zbriti teposhtë qafës së malit. Pemët e errëta halore filluan të rralloheshin gradualisht dhe përmes kurorës së tyre vezullonte dielli. I shoqëruar nga era e nxehtë na mbështolli me rrezet e tij që në përfundim shkëlqenin në sipërfaqen e detit Jon. Pamja e mrekullueshme e kaltërsisë vezulluese të detit në këmbët e malit dhe majat e mprehta të hirta dhe të bardha të maleve në lindje, më mahnitën. Kuptova ndjesinë që kishte përshkuar përshkrimet e shumë udhëtarëve nëpër këto vende. Pouqueville (1825), Lear (1988 [1851]) dhe Leake (1967) e përshkruan me frymëzim pamjen e Bregut ose ndryshe të bregdetit të Shqipërisë së Jugut dhe këto përshkrime njihen ende sot nga disa banorë të krahinës së Himarës/Himara.

## Dhërmi/Drimades

11 shtator 2004. Ishte një mesditë e ngrohtë e premtjeje, kur shkuam me një taksì në Dhërmi/Drimades. Meqë me Entelën u akomodua në një motel





## PARATHËNIE

familjar në qytetin e Himarës/Himara, morëm një taksi për t'i vizituar të shtatë fshatrat e bashkisë. Në Dhërmi/Drimades shoferi na ndaloi në njërin prej bareve anës rrugës. Meqë ishte koha e përgatitjes së drekës, fshati ishte pothuajse i zbrazur. Në kohën që po kërkonim qendrën e fshatit takuam një grua plakë që, e kërrusur dhe e mbështetur në një shkop, po ecte përmes fshatit. Entela më pyeti a ta ndalonim dhe të bisedonim me të. Meqë atëherë shqipja ime ishte shumë modeste, e mori fjalën Entela duke e përshëndetur: »Mirëdita, zonjë. A mund t'ju ndalojmë vetëm për një çast?« Gruaja, e veshur me të zeza dhe e mbuluar me një shami të zezë, e ngriti ngadalë vështrimin e saj në fillim drejt Entelës dhe më pas te unë. Në vend të përgjigjes pyeti menjëherë: »Nga jeni?« Entela iu përgjigj se jam e huaj, nga Sllovenia, kurse ajo vetë nga Vlora. I shpjegoi plakës se më interesonin zakonet dhe traditat e banorëve vendas si dhe mënyra e jetesës së tyre. Plaka u përgjigj me dyshim se nuk i di këto gjëra dhe na drejtoi në shkollën e fshatit, ku gjenden mësuesit që i njohin përgjigjet e pyetjeve tona. Edhe pse Entela u mundua ta bindte se nuk na interesonin njohuritë e mësuesve, plaka këmbënguli se ajo është e vjetër për t'i ditur përgjigjet. Entela m'i përktheu fjalët e saj dhe shtoi: »Mjerisht mezi flet shqip... Mendoj se flet vetëm greqisht si shumica e banorëve në Himarë.« Pastaj Entela propozoi ta linim të qetë dhe të niseshim drejt shkollës. Kur donte ta falënderonte për kohën që na dedikoi, Entela më pyeti nëse mund t'i bënte edhe një pyetje, gjë që e pranova me shumë interes. Më pas vijoi pyetja: »Jeni shqiptare apo greke?« Gruaja u përgjigj shkurt dhe qartë: »Vorioepirote«, na përshëndeti dhe u largua. Entela e përktheu pyetjen dhe përgjigjen: »Tha se është greke«. Kur e kujtova se përgjigjia e plakës që vorioepirote, shtoi disi e inatosur se kjo ishte e njëjta gjë si të jesh grek.

### Njohja me hapësirën e fshatit

4 janar 2005. Të lodhur nga ngjarjet e përditshme me Marien, përkthyesen time të re, u kthyem në banesën time në Dhërmi/Drimades që e kisha marrë me qira te një çift i vjetër. Ishte një prej atyre mbrëmjeve të ftohta, me shi dhe erë të janarit, që i kaloja në shoqërinë e Maries, studente për anglisht në Universitetin e Vlorës. Entela, që më kishte shoqëruar gjatë shtatorit, më vonë u punësua në Vlorë dhe m'u desh të gjeja një përkthyes tjetër në javët e para të punës në terren. Maria jetonte dhe punonte në Vlorë. Meqë i ati është nga Dhërmi/Drimadesi, afër Palasës, ku ashtu si në Dhërmi/Drimades shumica e banorëve flet në greqishten lokale, Maria e kuptonte dhe fliste në këtë dialekt. Edhe pse në fillim babai i saj nuk u pajtua me faktin që ajo t'i kalonte pushimet dimërore me mua në fshat (mes 25. 12.





## PARATHËNIE

2004 dhe 10. 1. 2005) dhe të më ndihmonte me përkthimet dhe mësimin e të folmeve lokale, më në fund e pranoi planin e punës sonë.

Të lagura dhe të nervozuara nga bashkëbisedimi i vështirë me mësuesin e fshatit Andrea dhe gruan e tij, bashkë me Marien u kthyem në banesë. Meqë kishte ikur rryma elektike, banesa ishte e ftohtë dhe në errësirë. Pa thënë asnjë fjalë u futëm nëpër shtretër që ishin të vetmet vende të ngrohta në banesë. Kur Maria u shtri, ndeza një qiri që e mbuloi dhomën me një dritë të çuditshme, bezdisëse dhe shqetësuese duke shkallëzuar brenda meje të njëjtën gjendje shpirtërore.



Në mendimet e mia u ktheva në vizitën e mëngjesit të Lefterisë dhe burrit të saj. Meqë në fshat nuk njihnim njeri, e vizituam Lefterinë pa marrëveshje paraprake, gjë që s'është në përputhje me zakonet e fshatit. Vendasit në përgjithësi nuk janë të mësuar me vizitat e papritura të të huajve, sidomos të dy studenteve të reja të antropologjisë dhe anglishtes që sipas tyre bëjnë shpesh pyetje të pazakonta dhe »të dyshimta«. Ashtu si shumica e shtëpive të fshatit, të reja dhe të vjetra, edhe shtëpia e tyre rrethohej nga një mur rrethues një metër e gjysmë i lartë që rrethonte shtëpinë dhe kopshtin si dhe i mbronte ata nga vizitorët e bezdisshëm. Trokitëm në derën e hekurt dhe të lartë ngjyrë blu përmes së cilës dukej kopshti. Kur e hapi derën, Lefteria nuk mundi t'a fshihte befasinë e saj për vizitën e papritur. Për shkak të njohurive të mia të pakta të greqishtes lokale, e mori fjalën Maria. Na prezantoi dhe e pyeti, nëse kishte kohë për një bisedë të shkurtër. Me gjithë shikimin e dyshimtë, Lefteria na ftoi brenda sipas traditës së mikpritjes. Mikpritja është një pjesë e rëndësishme e zakoneve dhe e praktikave të përditshme të fshatit, që sot nuk respektohen si dikur.

Na ftoi në ambjentin e ditës së shtëpisë, pjesërisht të rinovuar, që dikur kishte qenë pronë e babait të saj. Meqë nuk kishte pasur pasardhës meshkuj, ai ia kishte lënë shtëpinë asaj si vajza më e madhe e fëmijëve. Pas tridhjetë e gjastë vitesh jetese në Tiranë, ishte kthyer në fshatin e lindjes dhe bashkë me burrin kishin rinovuar shtëpinë. Lefteria na uli në një divan shumëngjyrësh që pata rastin t'a shihja në shumë shtëpi, si në fshatra ashtu dhe në vende të tjera të Shqipërisë. Ishte blerë në kohën e komunizmit dhe për këtë ishte i prodhuar sipas standardeve të njejta për të gjithë Shqipërinë. Lefteria u ul me ngadalë në shtratin pranë divanit. E drejtoi shpinën, i kryqëzoi pak këmbët e mbështetura përtokë, i vendosi duart mbi fund, buzëqeshi dhe na dha të kuptojmë se ishte gati për pyetjet. Në një greqishte elegante që ishte më afër të folmes së





## PARATHËNIE

Athinës sesa asaj të Dhërmu/Drimadesit, Maria i shpjegoi asaj arsyeën e interesimit tim për zakonet, traditat dhe jetën e përditshme të njerëzve në fshat. Pas këtyre sqarimeve e pyeti Lefterinë, nëse na lejonte ta shkruanim bashkëbisedimin tonë në fletoren e punës në terren. Lefteria pranoi. Pikërisht kur ajo po shpjegonte arsyet e martesave endogame në fshat, në dhomë hyri burri i saj. Nga shprehja e zyrtë e fytyrës së tij, ishte e qartë se ai nuk ishte shumë entuziast për vizitën tonë. Sapo hyri ai, Lefteria u ngrit dhe e ftoi të ulej në kolltukun pranë divanit përballë derës hyrëse. Kur ai u ul, nxitoi në kuzhinë, që gjendej në të njëjtin ambient, dhe pas pak minutash u kthye me tabaka në dorë. Na qerasi me karamela, me fruta tradicionale të përgatitura me shurup të ëmbël, të quajtur ndryshe gliko dhe nga një gotë ujë. Ky lloj shërbimi quhet kersama (qerasje) dhe është karakteristikë për zonën e Evropës Juglindore. Kerasmën e përgatit zonja e shtëpisë, e cila ofron llokume (xhelatinë turke), gliko, kafe, ujë ose ndonjë pije tjetër, raki rrushi ose tsipouro, të gjitha këto në një tabaka të shtruar me tantellë. E gjithë kjo më shkaktonte gjithmonë konfuzion, pasi nuk dija se ç'farë të merrja më parë nga tabakaja. Marija më mësoi se në fillim merret karamelja, pastaj ëmbëlsirat dhe në fund gota e ujit. Pasi na qerasi, Lefteria u ul përsëri dhe i shpjegoi shkurt burrit motivin e vizitës sonë. Ai pohoi me kokë dhe na dha të kuptojmë se mund të vazhdonim bisedën. Meqë doja të bisedoja edhe me të, iu luta Maries ta pyeste se si e kalojnë ditën vendasit dhe vendasat. Burri i Lefterisë shpjegoi shkurt se gjatë javës shumë burra e kalojnë kohën nëpër kafene, ku debatojnë për tema të ndryshme, luajnë letra dhe nganjëherë këndojnë. Gratë dhe vejushat qëndrojnë në shtëpi dhe bëjnë punët e shtëpisë, gatujnë dhe kujdesen për kopshtin. Të dielën shkojnë të gjithë në meshë, pasi janë shumë fetarë, përfundoi ai. Më dukej se po bezdisej gjithnjë e më shumë nga përmbajtja e pyetjeve të mia, prandaj në vazhdim doja t'i bëja pyetje më të thjeshta në lidhje me ushqimin e tyre. Doja të dija diçka më shumë mbi ushqimin karakteristik të kësaj zone. Ai u ngrit rrëmbimthi dhe sqaroi se nuk kishte kohë për pyetje të tilla, pasi kishte punë të tjera për të bërë. Gjatë rrugës për në derë mëmërishte me bezdi se edhe Enver Hoxha i kishte pyetur se ç'farë hanin dhe pinin, dhe pastaj i kishte dërguar të gjithë në Spaç. Për fat Lefteria nuk dukej e bezdisur, të paktën kështu m'u duk mua. Me mirësjellje na lejoi të vazhdonim bisedën që pas pak minutash u shndërrua në një bisedë të lirë mbi ushqimin, recetat, piten me peshk e të tjera. Pas një ore bisede u ndamë. Ishte pasdite. Meqë ishte kohë dreke, vendosëm të ktheheshim në banesën tonë. Gjatë rrugës takuam dy gra të veshura me të zeza dhe të mbuluara me shami të zeza të shkurtra të lidhura në kokë rreth flokëve të kapura prapa.







## PARATHËNIE

Në shpinë po mbartnin shkarpa për zjarr të lidhura rreth shpatullave dhe belit. Kur na panë që po vinim drejt tyre, i përkulën kokat dhe duke mbuluar gojën me dorë filluan t'i pëshpërisnin njëra-tjetrës. E kuptuam se ishin të informuara për ardhjen tonë në fshat dhe se ashtu si shumica e fshatarëve kjo gjë u dukej e pazakontë. Kur kaluam fare pranë tyre i përshëndetëm dhe i pyetëm nëse mund të ndaleshin pak. Maria na prezantoi, u shpjegoi qëllimin e vizitës tonë dhe i pyeti se a mund të bisedonim kur të kishin kohë. Fytyrat e tyre ishin të rrudhura nga era dhe nga puna shumëvjeçare në kooperativën bujqësore dhe dukeshin më të vjetra se ç'ishin. Më vonë më thanë se ishin 65 vjeçare, por nga pamja e jashtme krijonin përshtypjen se ishin 70 vjeçare. Kërkesën tonë e refuzuan dhe shpjeguan se nuk u interesonte politika. Edhe pse Maria ua sqaroi se edhe neve nuk na interesonte politika, por zakonet e vendasve, jeta e përditshme dhe kuzhina »tradicionale« e tyre, dëgjuam përsëri të njëjtën përgjigje që i ngjante fjalisë së burrit të Lefterisë: »Edhe Enver Hoxha na thoshte se nuk i interesonte politika, dhe na pyeste se si jetonim, çfarë hanim dhe pinim. Pastaj na çoi të tërëve në burg!« Me këtë shpjegim u ndanë prej nesh dhe vazhduan rrugën e tyre, kurse ne të dyja u kthyem në banesë. Poqëm peshkun që na dhuroi një vendase e sjellshme në vizitën që i bëmë një ditë më parë pasdite. »Nuk mund të jenë të gjitha ditët njësoj«, menduam me shpresën se mbrëmja në shoqërinë e mësuesit të fshatit dhe gruas së tij do të kalonte më këndshëm. Mësuesin Andrea dhe gruan e tij i kisha njohur që në shtator kur vizitova fshatin me Entelën. Atë mbrëmje na ftuan në një lokal në bregun e fshatit për të pirë dhe biseduar.

Kishte filluar të binte mbrëmja kur Andrea dhe gruaja e tij u ndalën me mercedes blu te banesa jonë dhe duke i rënë borisë pa durim na dhanë shenjë se ishte koha për të dalë. Unë dhe Maria veshëm xhupat shpejt e shpejt dhe nxituam drejt automobilit. Ende pa mbyllur dyert, automobili u lëshua me shpejtësi nëpër rrugën e ngushtë të fshatit drejt bregut. Bregu gjendet pothuajse një kilometër larg fshatit që shtrihet lart në kodër nga ku duket një pamje e bukur. Shpejtësia e Andreas nëpër rrugën rrëshqitëse dhe me gropa të fshatit na çoi menjëherë në bregun e detit.

Megjithë erën dhe pikat e shiut e ndjeva veten shumë mirë në përqaftimin e aromës së detit dhe shpërthimit të dallgëve që përplaseshin me vrull te shkëmbinjtë. Kur zbritëm nga makina na u afrua një qen stani lozonjar që ruante me besnikëri pronën e pronarit të tij, Beharit. Ky qe shpërngulur përafërsisht para tridhjetë vjetësh në Dhërmi/Drimades dhe në kohën e komunizmit kishte punuar në kooperativën bujqësore të fshatit. Pas rënies së komunizmit ishte bërë pronar i një restoranti në bregdet dhe më vonë i një moteli familjar.





## PARATHËNIE

Me përjashtim të familjes së Beharit, atë mbrëmje restoranti ishte pothuajse i zbrazur Ndërkohë që Behari nxitoi drejt banakut, djali i tij Romano, emrin e të cilit mbante restoranti, po shikonte televizor. Gruaja e Beharit dhe dy vajzat e mëdhaja po përgatishnin darkën në kuzhinë. Andrea na uli në një tavolinë të vogël katrore dhe porositi për të pirë. »Për mua uzo dhe për këtë kafe,« bërtiti në shqip dhe duke qëndruar drejt tregoi me gisht drejt gjoksit të tij dhe pastaj nga koka e gruas. Gjatë porosities nxorri nga xhepi kutinë e duhanit dhe duke ndezur cigaren na pyeti në greqishte lokale se çfarë do të pinim. »Çaj«, u përgjigjëm njëherazi. Kur Andrea porositi çajin, përsëri në shqip, e mbështeti xhaketën, i vuri duart kryq mbi tavolinë, u drejtua nga unë dhe Maria, u ndal pak dhe filloi të fliste në greqisht: »Pas një jave do të shkojmë me gruan në Athinë për të vizituar fëmijët.« U ndal përsëri, thithi cigaren dhe vazhdoi se në Athinë kanë ndërmend të qëndrojnë disa javë, pasi ka edhe disa punë për të bërë. Përsëri u ndal, thithi cigaren dhe pyeti, nëse gjatë mungesës së tij në shkollë, mund të zëvendësoja orët e tij të historisë me orët e anglishtes. Kur Maria ma përktheu pyetjen u ndjeva tepër e lehtësuar, pasi nga serioziteti i tij prita lajm të keq. E pranova ofertën dhe i shpjegova se të mësuarit anglisht nxënësve shqip- dhe grekëfolës do të ishte për mua një rast i mrekullueshëm për konsolidimin e shqipes. Andrea tha se mësimdhënia ime do të ishte më tepër një provë gjatë mungesës së tij, gjë që do të thoshte se pas kthimit nga Athina do të gjykonte, nëse do të vazhdoja të jepja anglisht apo jo. Gjatë bisedës mbi mënyrën tim të të dhënurit mësim, gruaja e Andreas rrinte heshtur. Foli vetëm kur mbaroi biseda jonë. Me një shprehje të zymtë në fytyrë u kthye nga Maria dhe e pyeti se ku ishim njohur para se të vinim në fshat. Maria e pa me habi dhe iu përgjigj se na kishte prezantuar në Vlorë një mikeshë e përbashkët, Sanila, pedagoge në universitetin e atjeshëm. Nga atje u nisëm me autobus për në Dhërm/ Drimades. Gruaja e Andreas e vështroi me dyshim të shoqin që pohoi disi i nervozuar: »Të gjitha i di! Sot fola me rektorin e Universitetit të Vlorës, i cili më tha se është në dijeni për ju!« Meqë nuk po kuptoja asgjë shikoja me kureshtje drejt Maries. Goja e saj po hapej gjithnjë e më shumë dhe shprehja e fytyrës po bëhej gjithnjë e më e indinjuar. Nuk kishte arritur ende të komentonte dyshimin e tyre, kur gruaja e Andreas e pyeti: »A nuk u takuat në Llogara ku ajo (duke bërë me shenjë nga unë) po të priste, ndërkohë që ty të prunë me makinë të zezë?« Maria u nervozua keq dhe në një vërshim fjalësh filloi ta përshkruajë përsëri takimin tonë. Kur ajo mbaroi, Andrea dhe gruaja e tij po e shikonin me fytyrë të ngrysur. Andrea vazhdoi: »Mirë ju kanë zgjedhur ju të dyjave! Ai që ka bërë përzgjedhjen, ka bërë punë të mirë!« Edhe pse Maria ma përktheu të tërë bisedën më





## PARATHËNIE

vonë kur u kthyem në banesë, nga shprehjet e fytyrave, zërit të lartë dhe lëvizjes së duarve e kuptova që atje se bëhej fjalë për një keqkuptim që mund të mbaronte me zënie.

Në atë çast hyri nga dera këshilltari i fshatit, Kosta, që Andrea e përshëndeti me gëzim. Ende pa u ulur në karrigen e ofruar nga Andrea, ky i fundit i porositi këshilltarit një uzo te Behari, që ishte ende prapa banakut. »Uzo për shefin!«, e urdhëroi Andrea Beharin. Ende nuk e kisha njohur këshilltarin e fshatit, por iu gëzova ardhjes së tij, sepse e ndërpreu situatën e vështirë që ishte krijuar. Biseda jonë mori fund, por nuk e kishim të qartë se ku synonin akuzat e Andreas dhe të gruas së tij.

### Zgjedhja e temës

10 mars 2006. Për akuza dhe dyshime të tilla kisha lexuar në monografi të shumta (Herzfeld 1991: 47–49, pjesërisht edhe Ballinger 2003: 6 dhe pjesërisht Green 2005: 35–36, edhe në dorëshkrim) që para se të nisesh përnjëpunë të terrenit, por në momentet e dyshimit të asaj mbrëmjeje nuk më ndihmuan aspak.

Në kohën e diktaturës dhe ndoshta edhe në vitet e mbretërisë së Zogut (1928–1939) fjala spiun ishte në rend të ditës jo vetëm në Dhërmi/Drimades, por në mbarë Shqipërinë dhe në vende të tjera të botës. Në fakt fjalën spiun e kisha dëgjuar mjaft shpesh edhe gjatë qëndrimit tim në fshat. Vendasit e Dhërmiut/Drimadesit e përdornin jo vetëm kur flisnin për të panjohur, por edhe kur përmendnin bashkëfshatarët që për arsye të ndryshme i konsideronin të padëshirueshëm dhe antipatik. Gjithsesi përmbajtja e disa dyshimeve m'u duk kuptimplote, p.sh. dyshimi i mësuesit dhe gruas së tij, kur thanë se takimi im me Marien nuk kishte qenë i rastësishëm, por i planifikuar. Shpesh e pyesja veten përse Andrea kishte zgjedhur si vend takimi pikërisht Llogaranë dhe jo Vlorën si qytet më i afërt. Përse unë »isha atje« kur Marien e sollën me mercedesin e zi. Në fillim të këto pyetje nuk gjeta ndonjë kuptim të veçantë.

Vetëm më vonë, kur dëgjoja se si e përshkruanin vendasit krahinën, e kuptova se për shumicën e tyre Llogaraja ishte më shumë se një qafë mali. Sipas mendimit të shumë vendasve, Llogaraja konsiderohet si kufi »natyror« dhe në rrëfimet e tyre ka karakterizuar shpesh dallimet shoqërore mes »nesh« dhe »të tjerëve«, dallime këto që në përvojat e veçanta socialo-kulturore rikrijohen dhe transformohen parreshtur. Prandaj në imagjinatën dhe bisedat e shumë vendasve është njëri prej vendeve ku spikat më shumë dallimet mes pikëpamjeve të ndryshme shoqërore.





## PARATHËNIE

Gjatë qëndrimit në Dhërmi/Drimades pata rastin të dëgjoja pikëpamje të shumta, të ndryshme dhe mospërputhëse për hapësirën e fshatit. Disa prej tyre kanë çuar në mosmarrëveshje për tokën, të tjerat në çështjet konfliktuale të depozitimit të mbeturinave dhe të ndërtimit të lokalizimit dhe përkatësisë. Pikërisht këto mospërputhje dhe mosmarrëveshje mbi kuptimet e hapësirës dhe vendit caktuan titullin e monografisë: Hapësira mospërputhësh.





## HYRJE

Thjesht emri i dyfishtë Dhërmi/Drimades zbulon paqartësitë e para që ndërthuren në hapësirën e këtij fshati. Zyrtarisht, emri shqiptar Dhërmi përdoret më së shumti nga banorët dhe punëtorët sezonalë që çdo ditë flasin kryesisht në dialektin jugor (toskë) dhe atë verior (gegë). Shumë prej tyre janë transferuar në këtë fshat nga zona të tjera të Shqipërisë në kohën e komunizmit (1945-1990), veçanërisht pas rënies së tij. Emri lokal Drimades, në kundërshtim me emrin zyrtar, përdoret kryesisht në bisedat e përditshme të fshatarëve, që sipas tyre e “kanë prejardhjen” nga fshati. Këta përdorin kryesisht greqishten lokale dhe pjesërisht edhe dialektin jugor shqiptar (toskë).

Vendasit, emigrantët, imigrantët, punëtorët sezonal, historiografët, demografët, gjeografët, politikanët dhe të tjerë i japin fshatit dhe banorëve të tij kuptime të ndryshme. Këto janë të lidhura mes tyre dhe në proceset e ndërtimit dhe të rindërtimit lokal, rajonal dhe nacional (shoqërore, politike dhe historike) të hapësirave dhe vendeve ndryshojnë parreshtur. Për këtë arsye, proceset e pandërprera dhe të paqëndrueshme të ndërtimit të hapësirave dhe vendeve në Dhërmi/Drimades janë premisë themelore e kësaj trajtесе.

Shumica e banorëve të Dhërmiut/Drimadesit udhëtojnë nëpër fshatra dhe qytete në Shqipëri, Greqi dhe anembanë Evropës. Kur udhëtojnë nëpër vende dhe ndërmjet tyre, fshatarët e Dhërmiut/Drimadesit rikonfigurojnë dhe ripërcaktojnë vazhdimisht vendin që ata zënë në fshatin e tyre si dhe pozitën dhe kuptimin që ka fshati për ta. Në bazë të këtyre proceseve shpesh lindin paqartësi që çojnë në diskutime dhe konflikte mbi përkatësinë dhe vendin që zënë fshatarët dhe fshati vetë. Për shkak të ndryshimeve shoqërore (p.sh. shpërnguljet dhe rënia e numrit të popullatës), politike (p.sh. demokracia) dhe ndryshimeve ekonomike (p.sh. liberalizimi i tregut), individë të shumtë nga Dhërmiu/Drimades e vendosin fshatin e tyre në hartën gjeopolitike që përfshin Greqinë ose Bashkimin Evropian në njërin anë dhe Shqipërinë dhe Ballkanin në anën tjetër.

Kështu sot, si dhe gjatë mijëvjeçarëve të fundit, në territorin e sotëm të bashkisë së Himarës/Himara kanë ndodhur shpërngulje dhe udhëtime. Erozioni i konsiderueshëm i terrenit, mungesa e tokës pjellore,





## HYRJE

ndryshimet ekonomike, shoqërore dhe politike kanë qenë dhe mbeten arsyet themelore të shpërnguljeve.

Njëndërdallimet erralla ndërmjet mënyrave të sotme dhe të dikurshme të udhëtimit është se sot janë në përdorim mjete udhëtimi moderne, udhëtimet janë të rregulluara me pasaporta dhe viza dhe zhvillohen nëpër kufij gjeopolitikë. Nga një anë udhëtimet dhe shpërnguljet sjellin lidhje të shumta mes njerëzve dhe vendeve, në anën tjetër ndarjet administrative dhe politike të njerëzve dhe vendeve (p.sh. caktimi i kufijve në periudhën osmane mes shek. 15 dhe 19, lindja e shteteve kombëtare në shek. 19, marrëveshja e Schengenit mes anëtarëve të plotë të Bashkimit Evropian në shek. 21, ose dukuritë e rajonalizmit bashkëkohor të promovuara nga Bashkimi Evropian) sjellin shumë dallime dhe demarkacione.

Qëllimi i këtij punimi është prezantimi i proceseve të krijimit, përforcimit dhe rindërtimit të kuptimeve të hapësirës dhe të vendit në zonën e Himarës/Himara, veçanërisht në atë të Dhërmiut/Drimadesit. Këto procese nxjerrin në pah dinamikën kulturore, sociopolitike dhe historike të rindërtimit të hapësirave dhe vendeve që janë gjithmonë në proces krijimi. Ndërkohë që në njërin anë kuptimet e hapësirave shkaktojnë dallime dhe kontradikta, në anën tjetër krijohen nga kontaktet dhe ngjashmëritë në proceset kombëtare dhe lokale dhe ato të gjera shoqërore, me të cilat vendasit në Dhërmi/Drimades caktojnë përkatësinë dhe lokalizmin e tyre.

## NDËRTIMI I HAPËSIRAVE DHE VENDEVE

Janë lokalitetet e veçanta ato që përbëjnë thelbin e hapësirave dhe jo “vendi” në vetvete. (Heidegger 1997: 332)

Studimet e para (perëndimore)<sup>1</sup> të koncepteve hapësinore u shfaqën në shkencat shoqërore dhe humaniste në fund të shekullit 19 dhe në fillim të shekullit 20, kur evolucionistët dhe funksionalistët, si p.sh. Morgan (1881), Mauss in Beuchat (1979 [1904]), Durkheim (1976 [1915]) dhe funksionalistët strukturalistë më të hershëm p.sh. Evans-Pritchard (1940), trajtuan marrëdhëniet interaktive mes njerëzve dhe ambjentit të tyre të ngushtë. Studimet e tyre mbi hapësirën dhe shoqërinë bazoheshin në qasjet pozitivistë dhe lidheshin me funksionalizmin.

Më vonë, pas vitit 1970, gjeografët socialë (Tuan 1974, 1977; Relph 1976), gjeografët biheivorist (Lowenthal 1961; Brookfield 1969; Harvey 1973; Gould in White 1974; Gold 1980) si dhe disa arkeologë “të rinj”

<sup>1</sup> Grekët e lashtë, romakët, civilizimi indian dhe kinezët zhvilluan konceptualizime të ndryshme për hapësirën që në mijëvjeçarin e kaluar.





## HYRJE

(Ingold 1993; Tilley 1994) i trajtuan në mënyrë kritike autorët pozitivistë. Këta, në kundërshtim me pozitivistët dhe funksionalistët strukturalist, hapësirën dhe shoqërinë nuk i shihnin si entitete të ndara dhe autonome, por i konceptonin si të ndërthurura dhe të lidhura mes tyre në mënyrë të ndërsjellë.

Mendimtari neomarksist Henry Lefebvre (1991 [1974]) e analizoi hapësirën në lidhje të drejtpërdrejtë me shoqërinë. Hapësirën e përkufizonte si të krijuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandarë nga forcat e saja produktive ose të punës që e krijojnë atë.

Në një nga veprat e tij me ndikim, *Prodhimi i hapësirës* (1991 [1974]), e përkufizon hapësirën si rrjet marrëdhëniesh reciproke mes praktikave hapësinore (perceptimi i hapësirës), riprodhimit të hapësirës (konceptimi i hapësirës) dhe prezantimit të hapësirës (të përjetuarit e hapësirës). Hapësira është në krijim të vazhdueshëm dhe përfaqësues, thotë autori. Kështu që nuk duhet ta kuptojmë si një "hapësirë në vetvete", gjithashtu kuptimi i hapësirës nuk mund të përmbajë në vetvete hapësirën (1991:299). Hapësira është një proces shoqëror dhe kulturor. Mes hapësirës dhe shoqërisë ekziston një marrëdhënie dialektike që i bashkon ato në një proces të vazhdueshëm, të rastësishëm dhe të pakthyesëm. Në vend që të studiojmë se ç'është faktikisht hapësira shoqërore, është më me vend të hulumtojmë mospajtimet dhe kundërshtimet që vijnë nga mënyra e konceptimit të hapësirave. Gjithashtu është me vend të trajtohet se si hapësirave u caktohen kuptime të shumëllojshme shoqërore dhe kulturore. Marrëdhëniet shoqërore kanë kuptime të ndryshme, të cilat nëpërmjet konflikteve shoqërore përcaktojnë hapësirat. Këto lloj konfliktesh shpesh herë krijojnë hapësira kontradiktore, pasi prezantimet e hapësirave asnjëherë nuk përputhen tërësisht. Kontradiktat hapësinore janë për rrjedhojë të pashmangshme: çojnë në konflikte ose zgjidhen me "organizimin e arsyesëm të prodhimit dhe me administrimin racional të shoqërisë si tërësi" (1991: 422). Lefebvre nuk e dallonte kuptimin e hapësirës nga ai i vendit. Sipas mendimit të tij çdo lloj dallimi mes kuptimit të hapësirës dhe vendit është çorientues. Dallimi do t'i kufizonte kuptimet e termave të përdorura për hapësirën në një bashkësi lokale të caktuar.

Në kundërshtim me Lefebvre, i cili në studimin e procesit të ndërtimit shoqëror të hapësirës dhe të dinamikës së forcave e shikonte shoqërinë si entitet ose strukturë themelore, Michel Foucault (1975, 1980) e vuri theksin te kuptimi i dinamikës së forcës. Atë e interesonte mënyra e rishpërndarjes së forcës dhe kontrollit në hapësirë. Në studimin e kuptimit të hapësirës Foucault-in e interesonin taktikat hapësinore me të cilat një grup i veçantë njerëzish ushtron forcën e tij dhe mbikëqyr një grup tjetër.





## HYRJE

Ndërkohë që Foucault analizonte taktikat hapësinore të forcës politike, Michel de Certeau merrej me rezistencën individuale ndaj formave hapësinore të forcës shoqërore. Në punimin e tij *Praktika e jetës së përditshme* de Certeau hulumtoi kuptimin e "taktikave" që i përdor një individ, i cili në një farë mënyre e gjen veten të ngjuar në rrjetën "e disiplinës" (de Certeau 1984: xiv-xv). De Certeau e përkufizoi hapësirën si "të përbërë nga një kryqëzim elementesh të lëvizshme. Është tërësi lëvizjesh, që lindin dhe zhvillohen në të" (1984: 117). Hapësirën dhe vendin i hulumtoi nëpërmjet aktiviteteve hapësinore siç janë ecja, rrëfimi i historive, kujtimet, shkrimet dhe leximet (1984: 91-115, 194-195). E gjitha kjo përfshin lëvizjen, e cila i konfiguron parreshtur vendet në hapësira dhe hapësirat në vende (1984: 118). Hapësira dhe vendi janë gjithmonë në marrëdhënie reciproke, edhe pse mes tyre ka dallim kuptimi. Hapësira (espace) është efekt operacionesh, që e përkufizojnë, e caktojnë, e vendosin në kohë dhe i mundësojnë hapësirës funksionimin në një tërësi polivalente programesh kontradiktore dhe afërsish indirekte." Në kundërshtim me hapësirën dinamike, vendi (lieu) është statik. De Certeau mendon se vendi është "një rregullsi e çfarëdo lloji, ku elementet janë të vendosura në marrëdhënie bashkëjetese reciproke" (1984: 117). Vendi është një "konfigurim momental pozicionesh" (po aty).

Tim Ingold (1993, 2000) iu qas studimeve të ndërtimit të hapësirave nga pikëpamja e "banimit" (*dwelling*). Në përkufizimin e banimit u mbështet te kuptimi etimologjik që i jepte këtij termi Heidegger (Ingold 2000: 185). "Të ndërtosh" ose gjermanisht *bauen*, rrjedh nga anglishtja e vjetër *buon*, që në gjermanishten e epërme do të thotë "banoj" (po aty). Kuptimi i banimit i referohet jetës së individit në botë. "Unë banoj, ti banon," pra do të thotë të njëjtën gjë si "unë jam, ti je" (po aty). Kuptimi themelor i banimit është përpunimi dhe ndërtimi. Banim do të thotë se "në kontekste marrëdhëniesh të caktuara njerëzit në lidhjen e tyre praktike me mjedisin rrethues ndërtojnë forma, të cilat janë si imagjinare ashtu dhe faktike dhe njëkohësisht burojnë nga rrjedha e përfshirjes së tyre në veprimtari" (2000: 186). Individu me praktikën e veta jetësore ndërton botën, pjesë e së cilës është edhe vetë. Ingold mendon se njerëzit janë si "organizma-persona" të vendosur në një botë të populluar me qenie të ndryshme, si njerëzore ashtu dhe jonjerëzore (2000: 5). Kështu marrëdhëniet shoqërore mes njerëzve janë nënvarg marrëdhëniesh ekologjike. Në njërin prej kontributeve të mësipërme "Marrëdhëniet shoqërore, ekologjia njerëzore dhe zhvillimi kulturor" (1996), Ingold e ka përcaktuar mjedisin si ndërtim kulturor duke e përkufizuar njëkohësisht si "hyrje" dhe "përfundim", që nuk përfshin "shpjegim" apo "debat". Dituria mbi mjedisin (potencial produktiv







## HYRJE

i proceseve komplekse) krijohet parreshtur, paralelisht me lëvizjet e individëve nëpër botë (2000: 230). Njohim diçka atëherë *kur shkojmë dhe jo para se të shkojmë atje*" (po aty, në origjinal, me shkronja të pjerrëta).

Duke u nisur nga përkufizimet e sipërpërmendura, në proceset e marrëdhënieve shoqërore hapësira dhe vendi prodhohen dhe krijohen vazhdimisht në perceptimet, në të kuptuarit dhe të jetuarit e hapësirës (Lefebvre 1991), ose me rishpërndarjen e forcës, e cila përshkon të gjitha shtresat shoqërore (Foucault 1975, 1980), ose me praktikatat e përditshme dhe veprimet hapësinore të aktivistëve të shoqërisë, që jo vetëm e zbatojnë por dhe e përvetësojnë kulturën sipas mënyrës së tyre (de Certeau 1984) dhe së fundi me vendbanimin, ku njohuritë për mjedisin janë të njëjta me lëvizjen nëpër botë (Ingold 2000).<sup>2</sup>

Disi më ndryshe nga studiuesit e lartpërmendur, Gupta dhe Ferguson (2001) i kanë vendosur studimet e rindërtimit dhe prodhimit hapësinor në botën moderne të kapitalizmit të vonshëm, në shpërnguljet e shumta dhe rrymat kulturore transnacionale. Atyre u interesonin mënyrat me të cilat format kulturore mbizotëruese, të mbledhura dhe të përdorura në fushën e marrëdhënieve të pushteteve që lidhin një bashkësi lokale të caktuar me pjesën tjetër të botës (Gupta dhe Ferguson 2001: 5). Në studimin e rëndësishëm të vendit dhe forcave ata e vënë theksin te "proceset politike komplekse dhe nganjëherë ironike, në të cilat format kulturore janë të imponuara, të imagjinuara, të përpunuara dhe të riformuara" (po aty).

Në botimin *Kultura, forca dhe vendi* (2001) Gupta dhe Ferguson i trajtojnë në mënyrë kritike marrëdhëniet mes hapësirës dhe forcës, të ndërlidhura në mënyrë të ndërsjellë mes tyre. Në hyrjen e këtij botimi ata trajtojnë proceset dhe praktikatat e ndërtimit të vendit, duke theksuar reciprocitetin mes ambjentit lokal dhe strukturave dhe proceseve rajonale më të gjera. Njerëzit dhe vendet nuk janë entitete të mbyllura dhe homogjene, lokalizmi i tyre nuk mund të përkufizohet si rrënosje në një vend të caktuar. Lokalizëm do të thotë thjesht se "dikush është i vendosur në një vend të caktuar dhe që kuptimi i këtij vendi është i ndryshëm dhe në kundërshtim me kuptimet e vendeve të tjera" (Gupta dhe Ferguson 2001: 13). Gjatë proceseve të ndërtimit të vendit, lokalizmit dhe identitetit krijohet një marrëdhënie e ndërsjellë. Proceset e këtij ndërtimi janë gjithmonë konfliktual dhe të paqëndrueshëm. Krahas këtyre proceseve Gupta (2001: 17) hedh dritë edhe mbi marrëdhëniet mes vendeve të

<sup>2</sup> Shumë studiues të tjerë, përveç atyre që u përmendën, e përkufizojnë hapësirën si proces ndërtimi të papërfunduar. Vetë procesin e trajtojnë nga këndvështrime të ndryshme, p.sh. njohja (Hirsch dhe O'Hanlon 1995), ndjenjat dhe perceptimet (Feld dhe Basso 1996), identiteti dhe lokalizmi (Lovell 1998), kujtesa dhe historia (Stewart dhe Strathern 2003).





## HYRJE

veçanta, kuptimi i të cilëve është gjithmonë në zhvendosje, varësisht nga organizimi politik dhe ekonomik i hapësirës në një sistem më të gjerë global.

Sipas mendimit të tij veprimtarët socialë jo vetëm që vënë në jetë “format kulturore mbizotëruese” të imponuara (2001: 5), por i ripërvetësojnë dhe i riinterpretojnë ato. Nga kjo rrjedh që kuptimet e vendit dhe të identitetit kanë një ndërtim shoqëror dhe janë në proces të vazhdueshëm krijimi. Pavarësisht faktit se autorët e përmendur e dallojnë kuptimin e hapësirës nga ai i vendit, në studimet e tyre i trajtojnë ato si procese të lidhura dhe të gërshetuara. Dallimi mes kuptimeve të tyre nuk është krejtësisht i qartë. Prandaj ky studim nuk trajton dallimet mes tyre, por përqëndrohet te marrëdhëniet mes tyre, ashtu siç del në pah dhe nga jeta e përditshme e fshatarëve të Dhërmiut/Drimadesit. Vendasit e Dhërmiut/ Drimadesit në bisedat e tyre të përditshme i emërtojnë hapësirën dhe vendin në mënyra të ndryshme.

Prandaj dhe unë i trajtoj si të ndryshëm, por njëkohësisht edhe të lidhur mes tyre. Konceptin e vendit (*topos/vendi*) e përdor atëherë kur trajtoj ndërveprimet sociale, përvojat dhe praktikat, kurse koncepti i hapësirës (*horos/hapësirë*) është më abstrakt dhe tregon një konceptualizim më të gjerë shoqëror dhe politik të dimensionit jetësor të individëve.

## DHËRMIU/DRIMADES NË BASHKINË E HIMARËS/HIMARA

Por, çfarë kanë të bëjnë proceset dinamike të ndërtimit dhe rikonfigurimit të hapësirës dhe vendit me fshatin Dhërmi/Drimades? Akoma më shumë, çfarë kanë të përbashkët rrymat kulturore transnacionale të shpërnguljeve me fshatin e vogël në jug të Shqipërisë? Përgjigjen e gjejmë pjesërisht te përcaktimi si vorioepirote që një grua plakë i bëri vetes. Kur Entela, shoqëruesja ime, e pyeti a është shqiptare apo greke, ajo e përcaktoi identitetin e kësaj gruaje në bazë të shtetësisë. Në kundërshtim me këtë, plaka shprehu përkatësinë e saj lokaliste apo etnike<sup>3</sup> duke e vendosur atë në Epirin Verior.

3 Në greqishten moderne termi etnicitet rrjedh nga fjala ethnos, që faktikisht përfshin një fushë të gjerë kuptimesh për kombësinë dhe nacionalizmin (Herzfeld 2005:113, shiko dhe Green 2005:266 shn. 12). Kuptime të përafërta për fjalën etnicitet vlejné edhe për banorët e Dhërmiut/Drimadesit, të cilët në jetën e përditshme bisedojné kryesisht në të folmen lokale greke dhe pjesërisht në dialektin shqiptar jugor. Për t’iu shmangur lidhjes semantike të fjalës etnicitet me kombësi apo nacionalizëm, të cilat nuk përputhen me kuptimin e etnicitetit për të cilin kanë diskutuar Barth (1970 [1969], Eriksen (1993), Coen A. P. (1994), Knežević Hočevar (1999), Šumi (2000) etj., në vazhdim fjalën etnicitet në përgjithësi nuk do ta përdor.





## HYRJE

Një shembull i vogël si ky, është ilustrim i faktit që identiteti i një individi është i kushtëzuar jo vetëm nga përkatësia gjuhësore, fetare dhe farefisnore, por edhe nga ajo territoriale. Siç tërheqin vëmendjen Gupta dhe Ferguson (2001: 13), identiteti është një vijë ndarëse e lëvizshme dhe e paqëndrueshme mes “nesh” dhe të “tjerëve”, i cili ngërthen gjithmonë në vetvete ndërtimin e vendit. Meqë është gjithmonë në proces krijimi, në këtë punim i jap përparësi termit *identifikim* apo formim identiteti, pasi e kuptoj atë si proces të pakthyeshem, dinamik dhe në kontinuitet, dhe jo të përcaktuar si një “gjendje” statike dhe politike.

“Ku fillon dhe mbaron saktësisht Epiri i Veriut, është një nga pyetjet djegëse, që provokojnë konflikte përsa i përket vendosjes së vijave në hartë” (Green 2005: 15). Ndërsa për disa Epiri i Veriut shtrihet nëpër kufirin greko-shqiptar, për të tjerët përfshin edhe territorin e Shqipërisë së Jugut, ku jeton një popullatë grekëfolëse që i përket kishës së krishtere ortodokse. Për të tjerë, sidomos për ata që e deklarojnë veten si shqiptarë, Epiri i Veriut as që ekziston. Krahina e gjerë gjeografike-historike Epiri i Veriut, pavarësisht nga kufiri shqiptaro-grek, përfshin Shqipërinë e sotme Jugore dhe Epirin në Greqi. Pas krijimit të shtetit të pavarur të Shqipërisë në vitin 1913 Epiri i Veriut u nda mes Shqipërisë së Jugut dhe Greqisë. Sipas mendimit publik mbizotërues në Greqi, popullata grekëfolëse dhe ortodoksë që jetojnë në Shqipërinë e Jugut emërtohen si epirotë veriorë (Vorioepirotës) (Triandafyllidou dhe Veikou 2002:191), kurse sipas mendimit publik në Shqipëri, këta shpesh quhen grekë apo *greku*, ose me përbuzje *kaurë* (të pabesë), *kaur i dërrit* (derra të pabesë ose derra grekë).

Me qindra vjet banorët e Epirit të Veriut për shkak të tregtisë, kullotjes dhe rekrutimit në shërbimin ushtarak, kanë udhëtuar rreth e rrotull këtij territori (Winnifrieth 2000; Vullnetari 2007). Në fillim të shek. 19 territori i sotëm i Shqipërisë së Jugut dhe Epirit në Greqi i përkiste të ashtuquajturit vilajet me qendër në Janinë. Për shkak të tatimeve, administrata osmane i ndau jomuslimanët në njësi të veçanta administrative dhe organizative (milete), në të cilat jetonin bashkë njerëz të besimeve të ndryshme, pavarësisht nga vendi i banimit, gjuha dhe ngjyra e lëkurës (Glenny 2000: 71, 91-93, 112, 115; Mazower 2000: 59-60; Duijzings 2002:60; Green 2005: 147). Pas vitit 1913 mënyrën osmane të organizimit të njerëzve dhe vendeve e zëvendësoi ndasia kombëtare, që i klasifikonte njerëzit dhe vendet sipas gjuhës dhe territorit. Mospërputhja e ndarjes osmane dhe kombëtare e njerëzve dhe vendeve shkaktoi tensione të shumta shoqërore-politike dhe konflikte territoriale, të cilat prej asaj kohe përsëriten, zhduken, rishfaqen dhe ngërthehen në mënyrë të vazhdueshme (de Rapper dhe Sintès 2006; Green 2005: 148-149).





## HYRJE

Nëpër fshatra dhe qytete, ku jetonte popullata grekëfolëse, u shfaqën prirje politike të provokuara nga partia pro greke. Në përputhje me kërkesat e popullatës grekëfolëse, në vitin 1914 partia pro greke, e cila kishte një ndikim të madh në Shqipërinë e Jugut, shpalli qeverinë autonome të Epirit të Veriut me qendër në Gjirokastrë. Kjo qeveri u rrëzua pak para fillimit të luftës së parë botërore (Winnifrih 2002: 130). Prirjet për një autonomi të re të Epirit të Veriut u ringjallën përsëri pas luftës. Në shkurt të vitit 1922 Parlamenti i Republikës së Shqipërisë ratifikoi *Deklaratën e të drejtave të minoritetit grek*, të paraqitur nga Fan Noli. Deklarata ia njihte të drejtat e pakicave popullatës grekëfolëse në fshatrat e Gjirokastrës dhe Delvinës, ndërkohë që në fshatrat e zonës së Himarës/Himara kësaj popullate i njohu të drejta të veçanta, si p.sh. të drejtën e mësimin në gjuhën greke nëpër shkolla (Clayer 2003).

Shumica e banorëve të Dhërmiut/Drimadesit mendojnë se deri në fund të luftës së dytë botërore (1945) kufiri mes Shqipërisë dhe Greqisë ishte i parëndësishëm, pasi banorët e Shqipërisë së Jugut dhe të Epirit të Greqisë e kalonin atë pa pengesa. Të njëjtin mendim shprehën edhe bashkëbiseduesit e Greenit (2005: 57) në Pogonian në Epirin grek. Green në punimin e saj përmend se deri në fund të luftës së dytë botërore shumë banorë të Pogonianit e konsideronin Gjirokastrën apo Argyrokastron si qendrën kryesore tregtare që ishte ekonomikisht më e zhvilluar se Pogoniani. Për pjesën më të madhe të banorëve të Pogonianit, Gjirokastra ishte një nga qendrat blerëse më të rëndësishme pasi nga pozita gjeografike ishte më afër se Janina (Green 2005: 57).

Kufiri shtetëror mes Shqipërisë dhe Greqisë, nëpër të cilin dikur njerëzit kishin udhëtuar dhe tregtuar pa pengesa dhe që sot banorët e Dhërmiut/Drimadesit e quajnë rrugë ose *to dromo*, në kohën e komunizmit (1945-1990) u bë rreptësisht i padepërtueshëm. Nën autokracinë e Enver Hoxhës statusi i veçantë i banorëve të Palasës, Dhërmiut/Drimadesit dhe Himarës/Himara u hoq me shpjegimin zyrtar se numri i banorëve grekëfolës në territoret e vendeve të përmendura është tepër i vogël (Kondis dhe Manda 1994: 21). Zonat e Gjirokastrës, Sarandës dhe Delvinës, për t'u mbikqyruar më lehtë, u ndanë në të ashtuquajturat njësi territoriale apo "zona minoritare" (Kondis dhe Manda 1994: 21; de Rapper dhe Sintës 2006: 12).

Me gjithë kufizimin dhe kontrollimin e udhëtimeve dhe shpërnguljeve brenda Shqipërisë, Hoxha me qëllimin që t'i bashkonte dhe homogjenizonte të gjithë shtetasit e Republikës së Shqipërisë, shumë grekfolës i shpërnguli në veri apo në Shqipërinë e Mesme (Kondis dhe Manda 1994: 21, shiko edhe Green 2005: 227). Përveç shpërnguljes së disa





## HYRJE

banorëve nga jugu në veri apo në drejtimin e kundërt, Hoxha ndryshoi dhe shumë emra grekë njerëzish dhe vendesh në shqiptarë dhe e ndaloi rreptësisht përdorimin e gjuhës greke jashtë zonave minoritare (Kondisi dhe Manda 1994: 21; Claytor 2003).

Gjatë diktaturës komuniste aspiratat irredentiste të partisë politike pro greke në Shqipërinë e Jugut u fashitën. Pas shpalljes së demokracisë, hapjes së kufirit shtetëror shqiptar dhe emigrimit masiv, këto lloj prirjesh u rishfaqën (Hatziprokopiu 2003 1033-1059; Mai dhe Schwandner-Sievers 2003: 939-949; Papailias 2003: 1059-1079). Sot, për shkak të ndryshimeve ekonomike (p.sh. kapitalizmi), politike (p.sh. demokracia, formimi i shteteve të reja kombëtare dhe Bashkimit Evropian), shoqërore dhe kulturore (p.sh. individualizmi), këto lloj prirjesh shfaqen disi në mënyrë tjetër. Sot në Dhërmi/Drimades dhe në komunën e Himarës/Himara, nga pikëpamja e pjesës dërrmuese të popullatës lokale që deklarohen si vendas (*horiane*) apo “nga” vendi (*apo ton topo*), këto prirje shfaqen në kërkesat e tyre për vendosjen e lokalizmit. Pra, me përjashtim të disa banorëve të moshuar në fshat, siç ishte plaka që takuam me Entelën, termi epirot verior përdoret rrallë në gjuhën e përditshme të fshatarëve. Për shkak të emigrimit masiv të shqiptarëve në Greqi dhe në vende të tjera, në mediat moderne greke janë shfaqur përfytyrime të stereotipizuara ndaj Shqipërisë, të një vendi të “prapambetur”, ku jetojnë njerëz “të prapambetur”, të ashtuquajturit *Vorioepirotë*, të cilët sot i identifikojnë me shqiptarët (Vullnetari 2007: 51; Green 2005: 229).

Ky emigrim masiv është më i dukshëm në zonën e Gjirokastrës, Sarandës, Delvinës dhe të Himarës/Himara, ku jeton një popullatë grekëfolëse. Për ta pasur nën kontroll dhe për ta rregulluar emigrimin masiv nga Shqipëria dhe nga vendet e tjera post-komuniste (p.sh. shtetet e ish Bashkimit Sovjetik), politika greke vuri në zbatim ligjin për emigrantët (Ligji 1975/1991) Triandafyllidou dhe Veikou 2002: 198); sipas këtij ligji emigrantët me origjinë greke, ose banorët grekëfolës të Shqipërisë apo *Vorioepirotët* dhe grekët e Pontit<sup>4</sup> përcaktohen si homogjenë, apo *omogeneis*. Bazuar në urdhëresën e Parlamentit të Republikës së Greqisë “statusi i origjinës greke caktohet në bazë të rrënjëve kulturore (“kujtesa e përbashkët historike” dhe/apo lidhjet me shtetin amtar dhe kulturën e origjinës”), trashëgimisë greke (të cilën grekëfolësit shqiptarë duhet ta

4 Glytsos (1995), Triandafyllidou dhe Veikou i përcaktojnë grekët e Pontit si “grekë etnikë”, të cilët në fillim të shek. 20 u shpërngulën nga territori i Perandorisë Osmane (veçanërisht nga bregu jugor i detit të Zi) në shtetet e ish Bashkimit Sovjetik, ose që u larguan nga Greqia për arsye politike në vitet 1930-1940 (2002: 191).

5 Dekreti nr. 2756/1983, u miratua nga Parlamenti i Republikës së Greqisë dhe nga Gjykata Supreme e Republikës së Greqisë (Triandafyllidou dhe Veikou 2002: 204).





## HYRJE

provojnë me vendlindjen e njërit prej prindërve apo gjyshërve; vendlindja duhet të jetë në territorin e Epirit të Veriut), në bazë të gjuhës dhe besimit (po aty). Dekreti i Ministrisë së Brendshme të Greqisë vendos që shqiptarët grekë pas marrjes së statusit të origjinës greke mund të bëjnë kërkesë për Letërnjoftimin e posaçëm të Homogjenit, apo i ashtuquajtur *Eidiko Deltio Tautotitas Omogeneis* (Tsitselikis 2003: 7; Kondis dhe Manda 1994: 20-21). Këto letërnjoftime u japin banorëve grekëfolës në Shqipëri dhe Greqi shtetësi të dyfishtë, shqiptare dhe greke. Përveç kësaj, bartësit e këtij letërnjoftimi kanë të drejtë ta kalojnë "lirshëm" kufirin shqiptarogrek, të jetojnë dhe punojnë në Greqi, të përfitojnë sigurimin social dhe shëndetësor si dhe të arsimohen falas.

Ndërkohë që politika për emigracionin në Greqi origjinën greke e njeh në bazë të gjuhës, besimit fetar dhe vendlindjes së njërit prej prindërve apo gjyshërve, politika për minoritetin në Shqipëri e njeh origjinën greke në bazë të gjuhës, besimit fetar dhe si rrjedhojë edhe të vendlindjes së personit në njërin prej zonave minoritare (Gjirokastra, Saranda dhe Delvina). Meqë personat që mendojnë se e kanë origjinën nga Himara/Himara, zyrtarisht nuk jetojnë në zonat e njohura si minoritare, atyre në bazë të ligjit për minoritetet të Republikës së Shqipërisë nuk u takon statusi zyrtar i minoritetit grek.

Me miratimin e Ligjit për tokën nr. 7501 të vitit 1991, të cilin një vit më vonë filloi ta vinte në zbatim koalicioni i atëhershëm në qeveri (*Partia Demokratike e Shqipërisë me prirje të djathta*), kërkesat për njohjen e statutit të minoritetit grek në zonën e Himarës/Himara filluan të shkallëzoheshin. Ligji mbi dekollektivizimin e pasurisë mbi tokën vendos që tokat që dikur në kohën e komunizmit iu morën pronarëve të tyre dhe iu dhanë në administrim kooperativave bujqësore, duhet t'u ndahen anëtarëve të kooperativës në pjesë të barabarta. Kjo do të thotë, që në përputhje me këtë ligj, çdo ish-anëtar i kooperativës duhet të marrë një pjesë toke dhe se madhësia e saj varet prej sipërfaqes së përgjithshme të tokës në një vend të caktuar, që dikur ka qenë pjesë e kësaj kooperative. Vlera e pronësisë para komunizmit u zhvlerësua. Edhe pse elita politike këmbëngul se kjo mënyrë ndarjeje e tokës është një prej më korrekteve, shumë prej banorëve si në Jug ashtu dhe në Veri të Shqipërisë e kundërshtojnë zbatimin e këtij ligji. Mes kundërshtarëve të këtij ligji janë edhe banorët e atyre vendeve që mes shek. 13 dhe shek. 15 për shkak të relievit të vështirë (p.sh. fshatrat malorë në veri të Mirëditës), apo për shkak të marrëdhënieve tregtare me vendet përtej detit (p.sh. Himara/Himara), arritën që t'i shmangeshin pushtetit osman dhe të ruanin vetëadministrimin lokal. Në këto zona tokat ishin në duart e pronarëve të vegjël, pasardhësit e të cilëve sot e





## HYRJE

kundërshtojnë dekollektivizimin dhe kërkojnë kthimin e tokave që dikur ishin pronë e prindërve dhe gjyshërve të tyre (Bollano dhe tj. 2006: 217-241).

Sipas të dhënave të regjistrimit zyrtar të popullatës në vitin 2005, në fshatin Dhërmi/Drimades janë regjistruar 1800 banorë, edhe pse pothuajse gjysma e tyre jeton në mërgim në Greqi apo diku tjetër (shumica në Itali dhe SHBA). Për shkak të shpërnguljeve masive, përveç disa familjeve të reja, sot në fshat jetojnë kryesisht fshatarë të shtyrë në moshë (të lindur para vitit 1950). Përveç tyre në fshat po rritet gjithnjë e më shumë numri i familjeve të ardhura dhe të punëtorëve sezonalë nga zona të tjera të Shqipërisë. Këta janë shpërngulur në Dhërmi/Drimades pas vitit 1990. Ndërkohë që gjatë vitit fshati është pothuajse i abandonuar, në verë është plot me turistë që mbushin hotelet e vogla, motelet dhe dhomat në zonën bregdetare të fshatit. Mes tyre janë dhe fshatarë tashmë me banim diku tjetër, prindërit e të cilëve janë me origjinë nga Dhërmiu/Drimades, të cilët kthehen në fshat me pushime. Në pesë vitet e fundit është rritur numri i turistëve nga Vlora, nga kryeqyteti - Tirana, nga Kosova dhe nga shtete të tjera evropiane (p.sh. Sllovenia, Çekia, Italia, Greqia, Franca etj.).

## PROCESI DINAMIKE TË NDËRTIMIT TË DHËRMIUT/DRIMADESIT DHE HIMARËS/HIMARA

Për shkak të shpërnguljeve të vazhdueshme, lidhjeve dhe ndarjes së njerëzve dhe vendeve janë krijuar dhe formësuar pozita të ndryshme të Dhërmiut/Drimadesit dhe të një territori më gjerë. Në këtë proces dinamik të ndërtimit të Dhërmiut/Drimadesit janë afirmuar (khs. Green 2005) pozita ("ku") të ndryshme të fshatit dhe zonës së Himarës/Himara. Pozita e tyre përcaktohet në raport me njerëz dhe vende të tjera, nëpër të cilët udhëtojnë apo shpërngulen.

Nën qeverisjen osmane si dhe më vonë me krijimin e shtetit kombëtar shqiptar, njerëzit shpërnguleshin dhe udhëtonin si fillim nëpër vilajetin e Janinës dhe më vonë nëpër territorin e Shqipërisë dhe Epirit në Greqi. Nëse para komunizmit kufiri shtetëror nuk përbënte një pengesë konkrete në mënyrën e udhëtimit dhe të shpërnguljes, pas vitit 1945 banorët e Shqipërisë e konceptonin atë si pengesë. Sidomos për njerëzit që, ashtu si dhe sot, jetonin në zonën e kufirit shtetëror, telat me gjemba që mbyllnin dhe "mbronin" kufirin shtetëror sinjalizonin pakalueshmërinë e tij. Gjithsesi, shpërnguljet e njerëzve ndër vite kanë vazhduar. Nëse më parë këto lëvizje zhvilloheshin përtej kufirit, gjatë periudhës së komunizmit ishin të kufizuara brenda territorit të shtetit shqiptar, pra ndryshoi vetëm drejtimi i tyre, i cili nuk kalonte përtej kufirit shtetëror.





## HYRJE

Sipas de Certeau-së (1984: 118) shpërnguljet e banorëve të Dhërmiut/ Drimadesit dhe zonës së Himarës/Himara mund t'i interpretoj si konfigurime të pandalshme nga vendi në hapësirë dhe anasjelltas. Personat me udhëtimet e tyre nga një vend në tjetrin krijojnë hartën e hapësirës; kjo deri në vitin 1945 ngërthente në vetvete vendet e të ashtuquajturit Epir i Veriut dhe më vonë, pas vitit 1945 me mbylljen e kufijve shtetërorë të Shqipërisë, me kontrollin e udhëtimeve dhe të shpërnguljeve dhe së fundi me përzierjen e banorëve grekëfolës, udhëtimet dhe shpërnguljet u drejtuan kryesisht drejt Shqipërisë së Veriut dhe të Mesme. Pas këtij ndryshimi lëvizjeje, hapësirat që hartonin fshatarët përmbanin vetëm vendet brenda kufijve shtetërorë. Me rënien e komunizmit dhe emigrimin masiv në Greqi, Itali dhe gjetkë, hapësira u zgjerua përsëri pasi shtrihej në vendet e Shqipërisë, Greqisë, Italisë, si dhe gjetkë nëpër Evropë dhe botë.

Shpërnguljet dhe udhëtimet në periudha të ndryshme historike e kanë vendosur dhe përcaktuar në pozita të ndryshme Dhërmiun/Drimadesin në hapësirën e gjerë gjeopolitike dhe shoqërore. Kur banorët vendas, politikanët e huaj dhe të vendit, historianët e huaj dhe të vendit mundohen t'i "vënë themelet" dhe të caktojnë pozitën "absolute dhe të vërtetë" të tij, ata përballen me dinamikën, lëvizshmërinë dhe ndryshueshmërinë e pozitës së këtij fshati. Përpjekjet e shumta për vendosjen e kufirit dhe caktimin e pozitës së fshatit si në Shqipëri ashtu dhe në Greqi, mund t'i konceptoj si të dështuara dhe shpeshherë si përpjekje kontradiktore të stabilitetit të një lokalizmi statik, të cilat do ta ndalnin vetëm në "dukje" procesin e rindërtimit dhe të rikrijimit të kuptimeve të hapësirës.

Zhvendosja e kuptimeve të vendeve dhe të njerëzve përfshin ambiguitetin e emrave, të lokaliteteve dhe identifikimit të personave. Vetëm emri i fshatit Dhërmi/Drimades zbulon njërin prej këtyre ambiguiteteve përsa i përket pozitës së fshatit. Nga pikëpamja e normave juridike dhe mendimit publik mbizotërues në Greqi, fshati Dhërmi/Drimades dhe bashkia e Himarës/Himara bëjnë pjesë në krahinën politike dhe historike të Epirit të Veriut, kurse nga pikëpamja e normave juridike dhe mendimit publik mbizotërues në Shqipëri bëjnë pjesë në Shqipërinë e Jugut. Kjo pozitë e paqartë e fshatit shkakton për rrjedhojë paqartësi në identifikimin e personave, pasi vorioepirot do të thotë si shqiptar ashtu dhe grek.

Po të ndjek Sarah Green-in (2005: 12), ambiguiteti përkufizohet si subjekt hegjemonist menaxhimesh të disiplinuar, ku bën pjesë p.sh. edhe qartësia. Sipas mendimit të saj ambiguiteti është sinonim konfuzioni dhe pamundësie për një përkufizim të qartë të një diçkaje apo fenomeni. Green vazhdon të shpjegojë se paqartësi të tilla mes banorëve të Pogonianit







## HYRJE

lindin në formë deklaratash pozitive të ndërtimit të së vërtetës: “Ky është Ballkan, Sarah, ç’mund të presësh tjetër?” (po aty). Ndryshe nga banorët e Pogonianit, banorët e Dhërmiut/Drimadesit nuk i shpjegojnë paqartësitë me mungesën e qartësisë dhe të konfuzionit, gjë që mund t’i njësonte me Ballkanin. Banorët e Dhërmiut/Drimadesit paqartësinë ia atribuojnë Shqipërisë dhe jo Ballkanit. Lëvizshmëria dhe papërcaktueshmëria e vendeve dhe njerëzve të veçantë në Shqipëri përshkruhen shpesh me fjalë të tilla si: “*Edo einai Alvania. Monooha pseumata. Simera lene etsi kai avrio anapoda.*” (“Kjo është Shqipëria. Thjesht gënjeshtër! Sot thonë diçka, nesër diçka krejt tjetër.”).

Në bisedat e përditshme të vendasve, Shqipëria shihet si diçka e kundërt me Bashkimin Evropian. Ky i fundit është për ta një bashkësi vendesh të Evropës Perëndimore, në të cilën vendasit e Himarës/Drimadesit rradhisin Greqinë, Italinë, Gjermaninë dhe Austrinë. Në ndryshim nga Bashkimi Evropian - që është i rregulluar dhe stabil - Shqipëria nuk është as e rregulluar dhe as stabile. Më tepër se në bisedat e përditshme të fshatarëve të Dhërmiut/Drimadesit, termi Ballkan<sup>6</sup> si sinonim konfuzioni, paqartësie dhe parregullsie shfaqet në diskursin e mediave shqiptare dhe të politikanëve. Te ky diskurs Ballkani është e kundërta e “të rregulluarës” Evropë Perëndimore dhe ka kuptim negativ (p.sh. “Ballkani i trazuar”-Todorova 1997: 45).

Sot për shkak të emigrimit masiv në Greqi dhe kthimit në fshatin e lindjes, banorët vendas të Dhërmiut/Drimadesit e përcaktojnë dhe e vendosin fshatin e tyre në hartën botërore gjeopolitike duke e riorganizuar hapësirën në të cilën jetojnë. Ata e vendosin fshatin në hartën shoqërore ku gjenden Greqia dhe Bashkimi Evropian. Hapësira e Bashkimit Evropian për ta ndryshon nga ajo e Shqipërisë, kufirin e së cilës e vendosin në veri të Himarës/Himara. Në një formim të tillë hartash vendoset parreshtur një hierarki vendesh, ku forcat dhe vendet ndërtohen në mënyrë dinamike dhe të ndërsjellë në varësi të një konteksti të rastësishëm historik, politik dhe shoqëror.

Pikërisht kjo lloj hierarkie dhe mënyra e vendosjes së saj është objekt trajtimi i këtij punimi. Shumë studiues (Herzfeld 1991; Henry 1994; De Soto 2000; Bender dhe Winer 2001; Gupta dhe Ferguson 2001; Ballinger 2003; Low dhe Lawrence-Zúñiga 2003) pohojnë se ndërtimi dinamik i hapësirave dhe vendeve ngërthen në vetvete paqëndrueshmëri dhe konflikte. Meqë presupozoj se paqëndrueshmëria dhe konfliktet janë pikërisht temat qëndrore të lidhura me Dhërmiun/Drimadesin, ky punim do të përqëndrohet në çështjen e hapësirave të mospërputhjeve.

6 Më shumë për Ballkanin dhe kuptimin e tij diskursiv shiko Norris (1999), Bjelić dhe Savić (2000), Todorova (1997, 2004); për Ballkanin si koncept hegjemonist shiko Green (2005).





## HYRJE

### HAPËSIRA MOSPËRPUTHJESH

Në vitet e fundit shumë literatura u janë përgjigjur pyetjeve mbi konfliktualitetin e hapësirave dhe vendeve: në to konfliktualiteti i hapësirave dhe i vendeve ndriçohet nga këndvështrime të ndryshme dhe ilustruhet në kontekste të ndryshme kulturore dhe shoqërore. Këtu, në formë të përmbledhur, përmenden disa shembuj.

Në punën e saj në terren në Kurandi në Australinë e Veriut, Rosita Henry (1994) u morr me studimin e hapësirave konfliktuale duke u përqëndruar te identiteti, i cili së bashku me hapësirën prodhon parreshtur dhe është konfliktual. Michael Herzfeld (1991) është marrë me trajtimin e Rethemnosit në ishullin Kreta në Greqi. Ai sqaroi se si dhe në ç'mënyrë mund të jetë konfliktuale historia materiale e një vendi. Hermine De Soto (2000) gjatë hulumtimit të debateve konfliktuale mes dy grupeve shoqërore në Gjermaninë Lindore postkomuniste, konstatoi se grupet promovonin propozime të ndryshme për rindërtimin e rajonit dhe se përballeshin në mënyra të ndryshme me problemet e mbrojtjes së mjedisit. Në përmbledhjen me titull *Peizazhe konfliktuale* (2001) Barbara Bender dhe Margo Winer bënë dallimin mes pesë teksteve të lidhura ndërmjet tyre, në të cilat linden peizazhe konfliktuale si: promovimi i turizmit dhe administrimi i pasurisë kulturore; peizazhe kundërshtimesh, përmbysjesh dhe rezistencash; forca të shumëllojshme moderniste, që i japin formë peizazhit të një vendi; marrëdhëniet ideologjike ndaj peizazhit që kërcënojnë identitetin e përbashkët; shpërnguljet dhe dëbimet. Edhe Pamela Ballinger (2003) tregoi interes për peizazhin e dëbimit dhe të përzjerjes. Në rastin e Istrës, e cila përfshin pjesë të Sllovenisë së sotme, Kroacisë dhe Italisë, ajo analizoi rrëfimet e të dëbuarve apo të të shpërngulurve nga vendi i tyre i banimit. Përveç kësaj analizoi dhe debatin politik dhe akademik që në mënyra të ndryshme përpiqet të vendosë një "të vërtetë të vetme historike". Ballinger aty thekson se e vërteta është e lëvizshme dhe është shpesh herë pjesë e debateve mbi pastërtinë dhe shumëllojshmërinë (2003: 266). Seta M. Low dhe Denis Lawrence-Zúñiga (2003), bënë dallim mes pesë konteksteve të lidhur mes tyre, që krijojnë konfliktet e hapësirës; këto janë: gjuha e qyteteve apo simbolet që përçohen nëpërmjet kuptimeve të koncentruara dhe janë aktivë në dramet e ngjarjeve politike; prodhimi i hapësirave urbane konfliktuale dhe në mospërputhje; hegjemonia shtetërore dhe kujtimi i qyteve të veçanta; qytetet turistike që, ashtu si dhe qendrat urbane, i nënshtrohen konkurrencës së ndikimeve të shumëllojshme shoqërore, ekonomike dhe politike; dhe së fundi ndërtimi strategjik i identiteteve shoqërore në vende dhe qytete të veçanta dhe në debate të ndryshme.





## HYRJE

Në hulumtimet dhe reflektimet e përmendura, pikënisje janë hapësirat konfliktuale në kontekste të ndryshme shoqërore dhe kulturore. Këto janë kryesisht vendbanime urbane, vende dhe krahina në zhvillim, shpërngulje, dislokime, dëbime apo vende dhe hapësira gjatë ndryshimeve postsocialiste apo postkoloniale. Studimet e proceseve të ndërtimit të vendit dhe hapësirës tregojnë vëmendje ndaj prezantimeve të hapësirës së dy apo më shumë grupeve shoqërore që rindërtojnë dhe ripërcaktojnë vendet që janë në lidhje të drejtëpërdrejtë me formimin e identitetit, me rishkrimin e historisë dhe rikonfigurimin e marrëdhënieve të forcave. Shumëkush i sheh grupet shoqërore si homogjene (p.sh. Henry 1994; De Soto 2000; Bender dhe Winer 2001; Low dhe Lawrence-Zúñiga 2003) dhe janë të rrallë ata (p.sh. Herzefeld 1991; Ballinger 2003) që e vënë theksin te kufizimet dhe konfliktet në grup. Në studimet mbi hapësira konfliktuale (Low dhe Lawrence-Zúñiga 2003) apo të krahinave (Bender dhe Winer 2001) shtrohet pyetja vetëm për “natyrën” konfliktuale të tyre dhe jo për “natyrën” e praktikave shoqërore dhe të marrëdhënieve që krijohen në hapësirë si dhe të bashkëveprimit në krijimin e tyre. Ekzistojnë raste (Low dhe Lawrence-Zúñiga 2003), kur konflikti paraqitet apriori në fillim, i përcaktuar dhe i palëvizshëm. Në trajtimin që i bëj ndërtimit të hapësirës dhe vendit në Dhërmi/Drimades më interesojnë veçanërisht kontekstet në të cilat ndodhin konfliktet, si dhe ato në të cilat ndërtimi dinamik i hapësirës dhe i vendit nuk shkakton konflikte. Përveç faktit që prezantohen kuptime të shumëllojshme dhe konfliktuale që politikanët, juristët, demografët (kapitulli i parë), historiografët (kapitulli i dytë), banorët vendas (kapitulli i tretë), emigrantët, imigrantët dhe së fundi turistët (kapitulli i katërt) u atribuojnë vendit dhe hapësirës, i kushtohet vëmendje edhe kuptimeve të lidhura mes tyre që fshatarët i tregojnë në rrëfimet e tyre për shpërnguljet dhe udhëtimet brenda dhe mes vendeve të ndryshme, përtej detit dhe maleve (kapitulli i tretë). Në studimin e marrëdhënieve shoqërore dhe hapësinore merren parasysh edhe proceset e ndërtimit dhe të distribuimit të hierarkisë së forcës. Për shkak të ndërtimit dhe distribuimit të hierarkisë së forcës, vende dhe hapësira të caktuara në një kontekst të dhënë socio-kulturor, historik dhe politik përkufizohen si “më të zëshëm” dhe më konfliktual, ndërkohë që të tjerët mbeten në sfond.

Në analizën e të dhënave etnografike shtrohet pyetja se si duhen studiuar proceset e ndërtimit dinamik të hapësirës dhe të vendit, kur hapësira dhe vendi nuk janë të rregulluara dhe stabile, por ndryshojnë vazhdimisht dhe janë të brishta. Këtu më ka ndihmuar metafora fraktale e formësimit të formave kulturore, siç e përkufizonte Appadurai (1996: 46).





## HYRJE

Duke kaluar nga hulumtimet e imazheve të formave dhe përmbajtjeve kulturore të lokalizuara nga lart, të orientuara drejt kufirit, tërësore dhe thelbësore, tek studimi i imazheve të formave dhe përmbajtjeve kulturore të brishta dhe komplekse ai shkruan:

Ajo që dëshiroj të propozoj është që të fillojmë t'i mendojmë konfigurimet e formave kulturore të botës së sotme në mënyrë fraktale, pa kufij euklidianë, struktura dhe rregulla. Më tej propozoj që këto forma kulturore, të cilat deri tani janë trajtuar me një matematikë të pastër (p.sh. në teorinë e shumicës) në mënyrë biologjike (në gjuhën e klasifikimit politeknik), duhet të përpiqemi t'i prezantojmë tërësisht fraktale, të mbivendosura me njëra-tjetrën. Për këtë duhet ta kombinojmë metaforën fraktale për format e kulturës (në shumës) me rrefimin politeknik të mbivendosjeve dhe ngjashmërive të tyre. (1996: 46)

Duke ndjekur metaforën fraktale të Appadurait, proceset e ndërtimit të hapësirave dhe vendeve nuk i trajtoj si procese njëdrejtimse që zhvillohen nga brenda jashtë. Këto procese i trajtoj si reciproke dhe të dyanëshme. Metodë të ngjashme përdori edhe Ballinger (2003), të cilën e interesonte procesi i rindërtimit të historisë dhe identitetit në Venecia Xhulia.

Në rastin konkret më intereson procesi kompleks dhe fraktal<sup>7</sup> i ndërtimit të hapësirës dhe vendit në Dhërmi/Drimades. Në vazhdim do të paraqes vështrime dhe prezantime të ndryshme të fshatit dhe të banorëve të tij (kapitulli i parë), duke i vendosur në një kontekst historik të historiografisë, që me debate të ngjashme por me interesa të ndryshme ndërton të kaluarën e fshatit (kapitulli i dytë), vijojnë histori personale, të cilat përshkruajnë udhëtimet dhe shpërnguljet përtej detit dhe maleve duke e konceptuar në këtë mënyrë pozitën e fshatit (kapitulli i tretë), dhe në fund do të shqyrtoj konfliktet dhe bisedimet për mbeturinat në bregdetin e Dhërmiut/Drimadesit; në këtë mënyrë këta njerëz e ndërtojnë vendin e tyre bregdetar, duke lidhur me të përkatësinë e tyre (kapitulli i katërt).

---

<sup>7</sup> Më shumë për konceptin e fraktalit në antropologji edhe te Strathen (2005 [1991]), Wagner (1991) dhe Green (2005).





1.

---

## FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

### ZONA

Dhërmiu/Drimades është një fshat në bashkinë e Himarës. Zona e bashkisë shtrihet 25 kilometra në jug të Bregdetit shqiptar, e quajnë gjithashtu *Bregu i Detit*, dmth. “zonë bregdetare”. Bashkia e Himarës/Himara bën pjesë në qarkun e Vlorës dhe është një pjesë e rëndësishme e detit Jon mes qytetit të Vlorës (qendra e prefekturës) dhe Sarandës. Kjo zonë është larg prej të dy qyteteve rreth 40 kilometra, kurse nga kufiri greko-shqiptar 60 kilometra. Në anën veriore dhe verilindore rrethohet nga *Malet e Vetëtimës*, që quhen ndryshe Acroceraunia. Në anën jugperëndimore, nëpërmjet malit Çika, hapet drejt bregdetit Jon dhe ishujve grekë Othonas dhe Korfuz. Emri Himarë/Himara përveç zonës gjeografike emërton edhe qytetin e vogël që në vitin 2000<sup>8</sup> fitoi statusin e bashkisë. Shumë prej vendasve dhe disa historiografë mendojnë se emri buron nga kohët antike<sup>9</sup>. Emri origjinal mund të jetë Heimarra apo Himarra; historianët vendas mendojnë se buron nga fjala greke *himarros*, dmth. “lum rrëke”; të tillë ka shumë dhe janë karakteristike për këtë krahinë (Koçi 2006: 14). Historiografë të tjerë

---

8 Nga viti 1992 (nga zgjedhjet e para demokratike pas komunizmit) deri në vitin 2000 zona e Himarës/Himara bënte pjesë në zonat rurale të vendit. Sipas Ligjit të vetëadministrimit të pushtetit lokal (Ligji nr. 7275 – Ligji për funksionimin dhe organizimin e pushtetit lokal) zona rurale është për nga territori njësi administrative dhe përbëhet nga shumë zona rurale dhe disa zona urbane (Albanian Association of Municipalities 2001: 5, 18). Edhe pse në zonën e Himarës/Himara nuk ka vendbanime të mëdha urbane, autoritetet lokale arritën që në vitin 2000 të fitonin statusin e bashkisë, kryesisht me argumentin se bëhet fjalë për një zonë me perspektivë turistike. Me këtë ndryshim zona e Himarës/Himara fitoi një pavarësi më të madhe nga pikëpamja administrative dhe ekonomike, në planet hapësinore dhe në proceset dekollektivizuese.

9 Gjatë punës në terren shumica e banorëve, të cilët pohuan se paraardhësit e tyre janë me origjinë nga Himara, e deklaruan veten e tyre si *horiani* (sh.), që do të thotë “vendas”. Prandaj në vazhdim i quaj “vendas”.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

mendojnë se emri ka të bëjë me himerën mitologjike, simboli që bashkon të kundërtat<sup>10</sup> (Spirou 1965).

Sipas shpjegimit të tretë emri buron nga Ymera, apo Hydra, apo Ydra, ku *hy-u* do të thotë "hyjni", kurse prapashtesa *dra* ose *dre(q)* "e keqe". *Himera*, *Hydra* apo *Ydra* mund të përkthehen "hyjni e keqe" (Bixhili 2004: 19). Sot, të gjitha këto shpjegime përshkohen nga kuptime të ndryshme lokale, rajonale apo nacionale.

Sipas regjistrimit të popullatës (INSTAT 2004) në zonën e Himarës jetojnë 11.257 banorë, 5418 prej të cilëve janë në qytetin e Himarës/Himara, të tjerët jetojnë në shtatë fshatra. Për shkak të lëvizjeve dhe shpërnguljeve të parreshtura të njerëzve, popullata e kësaj zone ka ndryshuar vazhdimisht. Në disa fshatra ka pasur dallime të shumta në numrin mes vendasve të regjistruar rregullisht dhe atyre që jetojnë faktikisht në të, gjë për të cilën vendasit, me të cilët kam biseduar gjatë vizitës sime kërkimore më 2004, janë ankuar shpeshherë në mënyrë spontane. Shumë prej tyre kanë shprehur edhe ndjenja braktisjeje, njësoj si në zona të tjera në Shqipëri dhe në Greqinë e Veriut (fshati Pogonian në Epirin e Veriut, shiko Green 2005: 7).

Edhe madhësia e zonës së Himarës/Himara gjatë historisë ka ndryshuar, numri i fshatrave luhatet nga tetë në pesëdhjetë. Mes shekujve 15 dhe 18 në këtë zonë gjendeshin rreth 50 fshatra të shpërndara nëpër fushën e Labërisë Juglindore dhe në bregdetin jugor të detit Jon. Në mesin e shekullit 18, në periudhën e perandorisë osmane, për shkak të islamizimit madhësia e zonës së Labërisë u zvogëluar shumë; mbetën vetëm 16 fshatra në bregdet ndërmjet Palasës dhe Sarandës. Njëqind vjet më vonë, rreth vitit 1830, kjo zonë u bë për nga madhësia e ngjashme me të sotmen, e cila shtrihet mes fshatrave Palasë dhe Qeparo (Sotiri 2004: 263-264; Duka 2004: 64-66; Bixhili 2004: 12; Frashëri 2005: 9-10). Tani disa prej banorëve po përpiqen që bashkia e Himarës të bashkohet me komunën e Lukovës, me të cilën do të formonte një zonë të pavarur administrative ose qark (Marko 2006: 195).

Shumica e fshatrave të kësaj zone (Palasë, Dhërmi/Drimades, Ilias/Lates, Vuno dhe Qeparo shtrihen përgjatë rrugës kryesore bregdetare, kurse dy të tjerët gjenden më larg, Piluri në shpatin e malit Çipthi dhe Kudhes në shpatin e malit Gjinvlash. Nga Vlora rruga ngjitet mbi qafën e Llogarasë dhe në një lartësi malore gati 1025 metra hapet një pamje e

<sup>10</sup> Në mitologjinë greke himera ishte një përbindësh, që nxirrte zjarr nga goja, trupi i të cilit përbëhej nga pjesë të ndryshme kafshësh. Përshkrimet e tij janë nga më të ndryshmet, që ka kokë luani, trup dhie dhe bisht kuçedre; sipas përshkrimeve të tjera ka kokë dhie, trup luani etj. Kur himera u dilte njerëzve përpara, paralajmëronte katastrofë, p.sh. stuhi, fundosje anijesh apo fatkeqësi natyrore (shpërthime vullkanesh).





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

mrekullueshme e dy fshatrave në shpatin e malit Çika. I pari është Palasa, që dikur sipas rrëfimeve të banorëve e quanin *Palesti*.

Një legjendë thotë se rreth shekujve 12, 13 sulmet e piratëve i përzunë banorët “e parë” nga vendbanimet e tyre fillestare *Meghalihora* (Vend i madh) në bregdet. Ata u vendosën më në brendësi dhe kështu u krijua fshati *Palesti*. Popullata në Palasë është rritur vazhdimisht, njerëzit janë shpërngulur në jug pranë bregut dhe kështu janë krijuar dhe fshatra të tjera.

Një ndër to është edhe Dhërmiu/Drimades që gjendet një kilometër në jug të Palasës dhe shtrihet në kodër 150 deri 200 metra mbi nivelin e detit. Në jugperëndim fshati hapet drejt plazhit me guralecë të imët, i cili bashkë me plazhet e Himarës/Himara dhe të Vunosë përbëjnë qendrën turistike kryesore gjatë muajve të verës. Përveç pensioneve, turizmi u sjell vendasve të ardhurat kryesore.

Rruga e ngushtë bregdetare nga fshati vazhdon drejt jugut, në fshatin Ilias që shtrihet pas malit Mjegullosh, 1000 kilometra larg Dhërmiut/Drimadesit. Shumica e banorëve thotë se emri buron nga emri i familjes Lates që ka themeluar fshatin. Ky fshat është i njohur edhe për legjendën e Shën Kozmait, i cili në njërin prej vizitave të tij në zonën e Himarës/Himara në vitet 1778 dhe 1779 kaloi nëpër fshat (Bixhili 2004: 160). Për shkak të thatësisë fshatarët nuk mundën t’i ofronin ujë, prandaj i ofenduar e mallkoi fshatin që të mos kishte më shumë se 39 shtëpi. Shumica e vendasve mendon se ky është shkaku pse fshati ka mbetur i vogël. Sot në të jetojnë 118 fshatarë (regjistrimi i popullatës së bashkisë së Himarës në vitin 2005). Kur vendasit numërojnë fshatrat e kapërcejnë Iliasin me arsyen se është tepër i vogël për ta merituar emrin fshat. E konsiderojnë si pjesë të fshatrave fqinjë, Dhërmiut/Drimadesit apo Vunoit.

Fshati tjetër në rrugën bregdetare është Vuno. Emrin e ka marrë nga fjala vuno (“mal”), meqë shtrihet në shpatin e malit dhe arrin deri në 300 metra mbi lartësinë e detit. Edhe Vunoja ashtu si Dhërmiu/Drimades dhe Himara/Himara e ka plazhin me guralecë të imët dhe vizitohet nga shumë turistë gjatë muajve maj deri në shtator. Një nga plazhet e quajtura Jaliskari është bërë një vend pushim i preferuar për të huajt që punojnë në Shqipëri për organizata të ndryshme joshitetore.

Nga Vunoja rruga vazhdon drejt jugut, duke kaluar nëpër Himarë/Himara, drejt fshatit Qeparo. Qeparo është fshati i fundit anës rrugës. Sipas traditës gojoje dhe historisë së shkruar (Leake 1967 [1835]: 79) emri i tij i parë ka qenë *Kiepero* ose *Kiparos*, që rrjedh nga fjala *kipos*, “vrt”. Qeparo sot ndahet në dy pjesë: pjesa më e vjetër shtrihet në kodër në një lartësi 300 deri 400 metra, kurse pjesa e re zbret deri në rripin bregdetar drejt





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

plazheve. Plazhet e Qeparoit për shkak të infrastukturës së pazhvilluar mirë dhe largësisë nga Vlora janë më pak interesante për turistët.

Dy fshatrat e fundit të kësaj zone janë Kudhës dhe Pilur. Shtrihen disa kilometra larg rrugës bregdetare. Për shkak të pozitës gjeografike nga pikëpamja sociale dhe ekonomike janë disi të izoluar. Kudhesi shtrihet në shpatet e malit Gjivalashi, nëpër të rrjedh përroi me të njëjtin emër. Sipas rrëfimeve të disa prej fshatarëve, fshati e ka marrë emrin nga vendasit e tij të parë, të cilët u tërhoqën aty në shekullin e 18 në periudhën e Perandorisë Osmane. Të ardhurit së bashku me banorët prej disa zonave të tjera të Shqipërisë së Veriut janë shpërngulur nga zona e Kurveleshit që gjendet pas Maleve të Vetëtimës. Një nga arsyet e shpërnguljes në zonën e Himarës/Himara ka qenë mosbindja e vendasve, të cilët nuk iu nënshtruan plotësisht pushtetit osman, siç ndodhi në zonat e Shqipërisë së Mesme<sup>11</sup> (Winnifriith 2002:104). Piluri shtrihet në një zonë kodrinore, në brendësi të Himarës/Himara. Emri ndoshta buron nga fjala *pile*, "majë", dhe flet për pozitën e lartë të shtrirjes së tij. Ashtu si dhe Kudhesi, edhe Piluri u krijua në periudhën e dominimit osman.

### KARAKTERISTIKAT GJEOMORFOLOGJIKE

Bregdeti jugor i Shqipërisë bën pjesë në vargmalin e Alpeve Dinarike. Shpellat shkëmbore që zgjerohen nëpërmjet bregdetit, mes Vlorës dhe Dhërmiut/Drimadesit, zbesin në fushat e ulëta me plazhe me guralecë të imët që përfshijnë një të tretën e bregdetit në zonën e Himarës/Himara. Disa vite pas rënies së komunizmit kjo u shndërrua në qendër turistike e njohur për plazhet me guralecë si ato të Jaliskarit dhe Gjipe në Dhërmi/Drimades, Jala në Vuno dhe Livadhi e Potami në qytetin e Himarës/Himara.

Duke hyrë gradualisht në thellësi të tokës, plazhet me guralecë shndërrohen në bimësi të gjelbër me plantacione të shumta ullinjsh dhe limonash. Nga bregdeti terreni ngrihet gradualisht në një lartësi prej 50 deri në 80 metra mbi nivelin e detit duke vazhduar me fushat, në të cilat shtrihen fshatrat. Relievi është i tipit karsik dhe për shkak të shkëmbinjve gëlqerorë cilësia e tokës është relativisht e keqe (Kabo 2004: 21). Tokat bujqësore janë të copëtuara dhe rendimenti i të korrave është i ulët. Kjo zonë është më e përshtatshme për rritjen e bagëtive të imta dhe prodhimin e ullirit, portokallit, verës dhe misrit, si dhe peshkimit.

<sup>11</sup> Historiografi anglez Winnifriith në historinë e Shqipërisë së Jugut ka konstatuar se në shekullin e 16 fshatrat bregdetare të Himarës së bashku me fshatrat vllehe në lindje të Voskopojës, fshati Dhrovjan në Sarandë dhe fshatrat e qytetit të Metsovës (në Greqinë e sotme) fituan të drejta të veçanta, të cilat u sollën atyre pjesërisht pavarësi dhe përjashtime nga pagimi i taksave (Winnifriith 2002: 104).







## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

Klima është mesdhetare: temperaturat mesatare të dimrit luhaten mes 10 dhe 12° C, muaji më i ftohtë është janari, kurse temperaturat mesatare gjatë verës janë mes 25 dhe 37° C, muaji më i nxehtë është gushti.

Rreshjet vjetore luhaten mes 1442 dhe 1571 mm. Reth 70% e shirave bien në periudhën e dimrit, mes janarit dhe marsit. Në muajt verorë ka vetëm 60 – 80 mm rreshje. Raportet mbi rreshjet tregojnë se zona e Himarës/Drimadesit ka rreth 90 ditë me shi në vit. Rreshjet janë me shira të rënda që mund të shkaktojnë përmytje. Kështu p.sh. në tetor të vitit 1964 brenda 24 orëve ranë 313 mm shi, kurse në shkurt të 1935 më shumë se 350 mm.

Ndërkohë që në pjesët e ulëta lulëzon njolla mezdhetare (Macchia Mediterranea), në lartësitë (600-800 m mbi n. e d.) lulëzojnë pemët. Mbizotërojnë lloje të ndryshme lisi (*Quercus valonae*, *Quercus lix*, *Ceratonia siliqua*) dhe bimë të tjera karakteristike të zonës (*Gomphocarpus ruticosus* dhe *Euphorbia dendrioder*) (Nasi etj. 2004: 22). Për shkak të ndërhyrjeve të vazhdueshme në mjedis (ndërtime taracash, djegie bari dhe teprimi i kullotjes nga bagëtitë e imta) bimësia në të gjithë zonën është e dëmtuar. Minerale kryesore janë kalçumi dhe karbonate të tjera. Relievi malor përshkohet nga lumenj dhe përranj që gjatë verës thahen dhe gjatë dimrit shfaqen përsëri. Dimrat me rreshje shkaktojnë kullimin e tokës dhe humbjen e sedimenteve. Kjo është një zonë tektonike aktive. Në bazë të raporteve mbi ligatinat dhe ekosistemet bregdetare të rajonit të mesdheut “lëvizjet tektonike dhe ndryshimet e morfologjisë së shtratit të detit ndikojnë në erozionin e shkëmbinjve duke bërë që në shkëmbinjtë gëlqerorë të bregdetit të krijohen zgavra në formë shpellash dhe kanionesh” (United Nations Development Programme Global Environment Facility 1999: 13).

Njësoj si në bregdetin jugor dhe në zonat malore të Shqipërisë së Veriut, terreni malor dhe shirat në zonën e Himarës/Himara janë arsyeja kryesore e erozionit dhe degradimit të tokës (Dedej 2002: 12). Gjatë shekujve për shkak të ndikimeve negative të përdorimit të tepruar të tokës për qëllime bujqësore dhe përdorimit të plehrave kimik<sup>12</sup> (nga viti 1970), të shpyllëzimit, të krijimit të rezervuarëve dhe digave, të gërmimit të rërës dhe zhavorrit, devijimit të lumenjve dhe rrjedhave natyrore si dhe nga zhvillimi “i pakontrolluar” i turizmit, erozioni në disa zona është përshpejtuar.

---

12 Sipas konstatimeve të raportit të hulumtimeve “Kontrolli i tokave në Shqipëri”, plehrat artificialë filluan të përdoren në Shqipëri në vitet 70 të shekullit të kaluar, pas ndërtimit të fabrikës për prodhimin e plehrave fosfatike dhe azotike (Zdruli 2004: 43).





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ DHËRMIU/DRIMADES

Dhërmium/Drimadesi shtrihet në një gjatësi prej tre kilometrash përgjatë rrugës kryesore bregdetare. Është i ndarë në tre fshatra të vogla: Kondraça, Gjilek/Gjilekates dhe Dhërmi/Drimades si qendër e fshatit (shiko shtojcën 1). Sipas rrëfimeve të banorëve qendra e fshatit (*o kendros*) u krijua në shekullin e 13, kur filloi të rritej numri i banorëve dhe njerëzit filluan të shpërnguleshin drejt jugut. Shekuj më vonë u krijua fshati Gjilek (emri zyrtar) apo Gjilekates (emri lokal). Pas tërmetit të vitit 1930, kur shumë familje humbën shtëpitë e tyre dhe u shpërngulën më afër bregdetit, lindi fshati Kondraça. Në vitin 1957, në kohën e komunizmit, në këtë zonë u krijua kooperativa e fshatit që çoi në zgjerimin e tij, gjë që vazhdoi edhe pas rënies së komunizmit. Shumë vendas nga Dhërmium/Drimades që sot jetojnë dhe punojnë në Greqi, kanë ndërtuar në Kondraç shtëpi të reja që gjatë verës i kanë si shtëpi pushimi. Me rritjen e numrit të shtëpive Kondraçi u nda në dy lagje, Kondraço dhe Kallam (emri zyrtar) dhe Kalami (emri lokal). Sipas fjalëve të vendasve emri i *Kalamit* buron nga emri i bimës së kallamit që në këtë vend rritet me shumicë.

Njëkohësisht me reformën agrare të vitit 1946 në Shqipëri u zhvillua edhe kolektivizimi i pronave tokësore; shumica e tokave private u bë shoqërore deri në vitin 1967 (de Waal 1996: 171). Sidomos pas prishjes së miqësisë me ish Bashkimin Sovjetik në vitin 1961, ideali i Hoxhës ishte krijimi i një shteti vetëmjaftues. Për këtë partia komuniste u përpoq t'a rriste prodhimin bujqësor dhe t'i zvogëlonte investimet në industri. Mes viteve 1950 dhe 1989 u ndërtuan tarrasa në toka bujqësore, u thanë kënetat, u zbatuan projekte për ujësjelljen dhe shkripëzimin e tokave të punueshme si pasojë e së cilave sipërfaqja e tokës së punueshme në këtë periudhë u dyfishua (ibid.).

Pas vitit 1958, kur Dhërmium u bë pjesë e kooperativës bujqësore, toka që dikur kishte qenë private (kopshte dhe tarrasa me plantacione ullinjsh), apo i përkiste pasardhësve (kullotat dhe pyjet) u bë pronë kolektive. Sistemi i kooperativave solli dhe të reja të tjera – sistemin e ujësjellësit, elektrifikimin, zhvillimin e infrastrukturës dhe rritjen e tokave përpunuese<sup>13</sup>. Në rrafshirat lumore anëtarët e kooperativave (vendas dhe disa prej të ardhurve nga zona të tjera të Shqipërisë) i zgjeruan tarasat me ullinj dhe citruse, të cilat ishin mbjellur pas luftës së dytë botërore

13 Në përputhje me ideologjinë komuniste të afirmimit të barazisë mes rajoneve (të paktën parimisht), sipërfaqja e tokës së punueshme u zgjerua. Zgjerimi propagandohej me parrullën "Të shkojmë në kodra e në male që t'i bëjmë ato të bukura dhe pjellore si fushat tona" (de Waal 1996: 175)





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

mes viteve 1945 dhe 1955 (Nina 2004: 132). Më vonë (pas vitit 1980), kur kooperativat shpronësuan edhe ndërtesat e banimit, kooperativa lokale përfitoi katër shtëpi anës rrugës në qendër të Dhërmiut/Drimadesit. Dy prej këtyre shtëpive përdorëshin si magazina, njëra si zyrë kryesore dhe e fundit si shtëpi kulture. Pronarët e shtëpisë që kishte qenë magazinë u shpërngulën në Tiranë, tre shtëpitë e tjera ishin zbrazur kur i morrën. Pronarët e tyre kishin vdekur dhe fëmijët e tyre kishin kërkuar transferim në Tiranë dhe Vlorë<sup>14</sup> për kushte më të mira arsimimi. Anëtarët e kooperativës në Kondraqi ndërtuan fabrikën e vajit të ullirit. Ndërtesat në qendër, anash rrugës kryesore, të cilat më parë kishin shërbyer si magazina, partia komuniste më vonë i shndërroi në dyqane. Në njërin shisnin artikuj ushqimorë, kurse në tjetrin artikuj të ndryshëm. Punëtorët shtetëror të ndërtimitarisë ndërtuan qendrën shëndetësore dhe zyrën e kryesisë së kooperativës. Në lagjen Kondraqa u vendos shkolla fillore me tre klasa dhe një kopsht<sup>15</sup> si dhe pallati për punonjësit e shtetit (punëtorët e ndërtimitarisë, mësuesit, mjekët, policët, drejtuesit e dyqaneve lokale dhe të hoteleve) dhe familjet e tyre që ishin shpërngulur në Dhërmi/Drimades pas vitit 1957.

Punonjësit e shtetit ndërtuan në bregdet *Hotel Dhërmiun*, vilën shtetërore apo *vila tou Enveri* dhe shtëpinë e pushimit të punëtorëve apo *Kampin e punëtorëve*<sup>16</sup>. Të gjitha këto ndërtesa ishin pronë e shtetit. Pas urdhërit të Hoxhës për militarizimin e krahinave të Shqipërisë, banorët vendas në bregdet dhe në kodrat përreth ngritën bunkere në formë kërpudhash, që si kudo në Shqipëri edhe sot janë pjesë e pandashme e panoramës shqiptare. Pas fundit të komunizmit dhe emigrimit masiv, të gjitha ndërtesat e përmendura si dhe shtëpitë e fshatit janë sot të abandonuara dhe të lëna pas dore.

Sot fshati drejtohet nga kryeplaku i fshatit dhe këshilli i fshatit i përbërë nga pesë anëtarë. Këta zgjidhen në zgjedhjet lokale. Deri në vitin 2006 zgjedhjet bëheshin çdo tre vjet, pas këtij viti në çdo katër vjet. Pasi këshillohet me këshillin, kryeplaku vendos për çështje të rëndësishme të fshatit, dmth. për konfliktet mbi tokën dhe konflikte të tjera si dhe ndërtimin e infrastrukturës. Sipas nevojës kryeplaku mbledh këshillin dhe

14 Në kohën e komunizmit shpërnguljet brenda vendit ishin të kontrolluar rreptësisht. Për t'u shpërngulur, njerëzit kishin nevojë për leje të veçanta nga pushteti lokal. Procedura e marrjes së këtyre lejeve quhej *pashaportizim*.

15 Pas mbarimit të tre klasave të para të fillores në Kondraqi, fëmijët e vazhdonin shkollimin e tyre në shkollën fillore Gjike Bixhili (ndërtuar në vitin 1850 me nismën e të njohurit Gjike Bixhili [shiko kapitullin Gjuhët, nëntitulli Gjuha dhe arsimi ]) në qendër të Dhërmiut/Drimadesit.

16 Për informacione të mëtejshme shiko kapitullin Bisedime për mbeturinat.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

së bashku shpallin mbledhjen për të gjithë fshatarët. Gjatë qëndrimit tim në fshat këto mbledhje zhvilloheshin në oborrin e njëres prej kishave kryesore të fshatit, *Ag. Haralamb*.

### EMRI I PAQARTË I FSHATIT

Vetë emërtimi i paqartë i fshatit Dhërmi/Drimades përvijon disa dallime shoqërore që përcaktojnë hapësirën e fshatit. Një numër i madh fshatarësh, sidomos i atyre që mendojnë se janë pasardhës të banorëve “të parë” të fshatit apo zonës së Himarës/Himara dhe se për këtë e meritojnë të quhen vendas apo *horiani*, mendojnë se emri origjinal i fshatit është Drimades dhe rrjedh nga greqishtja. Sipas mendimit të tyre emri Dhërmi është futur më vonë, në kohën e mbretit Zog (1924-1039), dhe u bë emri zyrtar në regjimin e komunizmit. Historianët dhe politikanët shqiptarë në kundërshtim me këtë pohojnë se emri Drimades hyri në përdorim me ardhjen e tregtarëve grekë në shek. e 4 p.e.s, kur fshatrat e zonës së Himarës/Himara së bashku me vende të tjera të Shqipërisë së Jugut ishin pjesë e kolonive greke (Memushaj 2003; Bixhili 2004; Frashëri 2005).

Mospërputhjet mes të dhënave historike janë pjesërisht të lidhura me përpjekjet e ndryshme të rishkrimit të historisë, që ishin karakteristike për periudhat e mëparshme. Kontestueshmëria dhe pyetjet mbi ambiguitetin e emrave të këtyre fshatrave dhe zonave si dhe interpretimet e ndryshme të ngjarjeve të së kaluarës, mbeten edhe sot të pa zgjidhura. Për shkak të prirjeve të parreshtura nacionaliste të shtetit shqiptar dhe atij grek, është e vështirë të gjykojmë se kur ka nisur të përdoret njëri apo tjetri emër.

Nëpër Dhërmi/Drimades kanë kaluar shumë udhëtarë të huaj, të cilët e shkruan emrin e fshatit në mënyra të ndryshme. Hobhous (1813) dhe bashkëudhëtari i tij i famshëm, poeti Bajron (1891), Pouqueville (1825), Leake (1967 [1835]), Lear (1851), Hammond (1967) janë nga ata shkrimtarë që e kanë përmendur Himarën/Himara apo Dhërmiun/Drimades. Emrat i shkruan në mënyra të ndryshme. Kështu p.sh. historiani anglez Leake (1967) në punimin e tij që lindi si frut i udhëtimeve të tij nëpër Epir, përmendi edhe Dhërmiun/Drimadesin me emrin *Dhrymadhes*, duke shkruajtur për të si më poshtë:

Në Korfuz u takova me kontin Giko nga Dhrymadhesi, i cili më tha se vendi është shumë piktoresk, me një përrua që rrjedh përmes tij ... (Leake 1967: 88).

Më vonë këto vende i vizitoi piktori anglez i peizazheve Eduard Lear (1812-1888), i cili në shkrimet mbi udhëtimet e tij në librin *Journal of a*





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

*Landscape Painter in Greece and Albania* botoi edhe pikturat e Dhërmiut/Drimadesit. Edhe ai e përmend atë si Dhrymadhes:

Duke qëndruar në shkëmb, nga ku dukej vendi, Anastasi qëlloi me pistoletë. Ndërsa unë u nisa për në Dhrymadhes për të ngrënë dhe pikturuar. Në fshat arrita në dhjetë e gjysmë ... Pikturova deri në mesditë. Madhështia e këtij vendi është e pashtershme (Lear 1851: 147).

Një shekull më vonë historiani anglez Hammond e shënoi Dhërmiun/Drimadesin si Dherm apo Zrimazes, kurse për fshatin shkruajti:

Nga Himara u nisa drejt fshatit grekëfolës. Nga Vunoja, nëpër Vijates deri në Zrimazes (350), poshtë të cilit kanë gjetur rrënoja romake, eca tre orë<sup>17</sup>. Natën e kalova në Zrimazes. Gjumin ma prishën disa gra që po vajtonin për një djalë të ri të vrarë për hakmarrje (Hammond 1967: 125).

Këto kujtime udhëtimesh dëshmojnë për mospërputhje në burimet historike, në bazë të të cilave mund të konkludoj se emërtimet e fshatit kanë qenë të ndryshme. Në vitet e fundit, të shoqëruara nga konfliktet për tokën mes fshatarëve dhe elitës politike, çështja e emrit bëhet gjithnjë e më e vështirë (Bollano etj. 2006). Edhe pse shkrimet e udhëtarëve të huaj kanë zbuluar "anën ekzotike", janë më të besueshme sesa shkrimet e ndryshme me motive nacionale të historianëve; udhëtarët marrin parasysh emërtimet vendase të fshatrave dhe krahinave.

Në sfondin e interpretimeve diametralisht të kundërta të emrit të fshatit, rreth shfaqjes së tij ka spekulime të ndryshme. Në përgjithësi kemi të bëjmë me shpjegime pro greke dhe pro shqiptare që kanë qëllime të ndryshme politike. Njëra nga shpjegimet pro greke, p.sh. thotë se emri buron nga fjala *drima-dhes*: sipas mendimit të vendasve në greqishten e lashtë kjo ishte pemë dushku, karakteristikë e kësaj zone. Shpjegimi tjetër pro grek pohon se emri rrjedh nga fjala *dhromos*, kjo është rruga apo udha në të cilën shtrihet fshati. Shpjegimi i tretë e lidh emrin me fjalën *drimos*,<sup>18</sup> "përrua", kurse e katërta me fjalën shqipe dhe-mih që do të thotë gërmoj tokën, gjë që mund të lidhej me ndikimin e degradimit të tokës në ekonominë lokale. Petro Marko nga Dhërmiu/Drimades ofron një shpjegim tjetër të emrit. Në romanin për fëmijë *Shpella e piratëve*, botuar në vitin 1998 në Tiranë, ka përkthyer shpërnguljen e vendasve nga Vreka te shpellat, të quajtura Qendrushe (qendër, apo qëndrim (i përkohshëm)). Në Qendrushe gjendet e *madhe dhri*. Petro Marko nuk e shpjegoi se

17 Hammond u mbështet te Philippon dhe Kirsten (1950), të cilët kishin përmendur shënimin e Lamprosit se nën Zrimazes ishin gjetur rrënojat e një varreze romake (Hammond 1967: 125).

18 Fjalë e njëjtë me fjalën drimus, që do të thotë "brejtës" apo "i mprehtë", mund të gjendet në fjalorin e Oxfordit të gjuhës greke (2002).





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

çfarë do të thotë *dhri*, por me shpjegimin u morr më vonë Foto Bixhili, gjithashtu vendas nga Dhërmiu/Drimades. Në vitin 2004 botoi punimin e tij mbi historinë e zonës së Himarës/Himara. Për përcaktimin e fjalës Bixhili u mbështet në shpjegimin e Agim Shehut, që fjalën *dhri* e përktheu si hardhi që rritet në shpatin e shpellave. (Bixhili 2004: 41). Kur Bixhili përmend Shehun, për fat të keq nuk jep të dhëna të sakta për deklaratat e tij. Bixhili përmend se fshati Dhërmi, përveç tarasave me plantacione ulliri dhe numrit të paktë të drurëve të dushkut, njihet edhe për *madhe dhri* (vreshta të mëdha) (ibid.). Te ky shpjegim ka dhe paqartësi të tjera, pasi nuk ka ndonjë shpjegim, nëse fjala *dhri* buron nga shqipja, greqishtja apo nga ndonjë gjuhë apo dialekt tjetër. Kjo fjalë nuk gjendet në fjalorët modernë (Fjalori anglisht-shqip, Ramazan Hysa 2005; Fjalori i shqipes së sotme, 1980; Fjalori i greqishtes, Oxford 1997). Fjala *drim* gjendet vetëm në fjalorin modern të shqipes, botim i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Shqipërisë; tregon dymbëdhjetë ditët e para të gushtit apo tre ditët e fundit të marsit, kur sipas bindjeve popullore moti keqësohet.

Në librin *Drimades në Himarë (Drimades tis Himaras)*, botuar në Athinë, historiani vendas Kosta Dede shpjegon se fjala *dhrimadhe* buron nga fjala *dhrimos* që në greqishten e vjetër do të thotë "pyll", kurse në greqishten moderne "park natyror" (Dede 1978: 10). Krahas shpjegimeve të lartpërmendura ka dhe të tjera, p.sh. letrare, shkencore dhe popullore. Të gjitha janë të ngjyrosura me kuptime politike dhe nacionale pro greke dhe pro shqiptare. Shumica e shpjegimeve përpiqen t'a krijojnë në mënyra të ndryshme hartën historike, kombëtare dhe shoqërore të zonës së Himarës/Himara dhe t'a vendosin atë në hartën gjeopolitike të botës. Pikërisht për këtë arsye nga pikëpamja etnografike më shumë se nga studimi i burimeve historike dhe gjuhësore të burimit të emrave të vendeve, është me rëndësi studimi i vetë mënyrave të krijimit të hartave dhe të konteksteve në të cilat ato përdoren.

## LOKALITETE TË LËVIZSHME

Në përdorimin e përditshëm të emrave Dhërmi dhe Drimades dallohet ndarja ndërmjet fshatarëve që pohojnë se paraardhësit e tyre "janë me origjinë" nga fshati, duke u vetëquajtur vendas, *horiani* apo *Drimadiotes*, dhe atyre banorëve dhe punëtorëve sezonal që janë shpërngulur në fshat nga vende të tjera të Shqipërisë në kohën e komunizmit ose pas tij. Të ardhurit në fshat përdorin emrin Dhërmi, kurse vendasit shpesh i përdorin të dy emrat. Përdorimi i emrit të vendit nuk varet vetëm nga prejardhja e folësit, por edhe nga gjuha që ai flet në një moment të caktuar. Kur një





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

vendas flet me një vendas tjetër në dialektin grek, përdor kryesisht emrin Drimades, kurse kur flet në dialekt shqiptar përdor kryesisht emrin zyrtar të fshatit Dhërmi.

### Përkufizimi i “vendasit”

Kur i pyesja për kuptimin e fjalës *horiani* (vendas), shumë fshatarë më përgjigjeshin se është një person “me origjinë nga vendi”, apo *ton topo*. Kuptimi i lokucionit ndajfoljor “nga vendi” i referohet prejardhjes së një personi nga Dhërmiu/Drimades apo nga zona e Himarës/Himara. Në bisedimet e përditshme të tyre shumë vendas emërtojnë *horiane* ata njerëz që jetojnë në fshat gjithë jetën e tyre; ata që janë me origjinë nga fshati, por që pjesën më të madhe të jetës e kanë kaluar në zona të tjera të Shqipërisë apo Greqisë dhe kohët e fundit janë kthyer në fshat; ata që janë nga fshati por jetojnë diku tjetër në Shqipëri, apo kanë emigruar (p. sh. në Greqi apo SHBA); ata që janë nga fshatrat e tjera të zonës së Himarës/Himara, ose jetojnë atje; së fundi edhe ata që janë nga ndonjë fshat tjetër i zonës së Himarës/Himara, dhe që tani jetojnë gjetkë në Shqipëri, apo kanë emigruar jashtë shtetit.

Këto lloj rradhitjesh bëhen të rëndësishme kur vendasit diskutojnë për historinë e fshatit të tyre dhe të hapësirave në të kaluarën. Kështu p.sh. 85-vjeçari Luka, lindur në Dhërmi/Drimades, ku ka kaluar pjesën më të madhe të jetës së tij, më shpjegoi se *horian-ët* “e vërtetë” dallojnë nga vendasit që janë rikthyer në fshat në vitet e fundit dhe që i quajnë *kseni* apo “të huaj”. Kur e pyeta nëse këta “të huaj” dallonin nga të ardhurit apo punëtorët sezonal që ishin shpërngulur kohët e fundit nga zona të tjera të Shqipërisë, Luka dha përgjigje negative. Me një frymë më shpjegoi se këta vendas janë *kseni* pasi e kanë harruar “fshatin” dhe “të kaluarën” e tij. Nuk i njohin ambientet “e vjetra” të fshatit, i kanë harruar emrat e lagjeve, fushave dhe kullotave të braktisura në periferi të fshatit. Ashtu si dhe vendasit e tjerë të vjetër, edhe Luka mendon se vendasit, që kanë jetuar gjetkë, në Shqipëri apo Greqi, dhe janë kthyer në fshat vitet e fundit, nuk i përkasin më fshatit. *I halase to kozmos edo* (“njerëzit e kanë humbur përkatësinë e tyre”), shpjegoi Luka dhe shtoi: “Kohë më parë njerëzit në fshat ishin më të lidhur me njëri-tjetrin. Dikur vlenin rregullat e mirësjelljes. Sot shumica e fshatarëve janë në konflikt mes tyre dhe e përgojosin njëri-tjetrin!”

Një perspektivë krejt tjetër ka 48-vjeçari Spiro dhe gruaja e tij katër vjet më e re. Të dy janë me origjinë nga fshati, por 25 vite të jetës së tyre i kanë kaluar në Vlorë dhe pesë në Athinë. Në Dhërmi/Drimades janë kthyer para disa vitesh. Urania dhe Spiro e mbajnë veten si *horiani*, kurse Luka i





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

konsideron si *kseni*. Nëse ndjek Herzfeld-in (1991: 77), do ta kisha shpjeguar rrëfimin e Uranisë dhe të Spiros si përpjekje për të krijuar imazhin e “një barazie të rreme” mes fshatarëve, e cila i zhdok dallimet mes tyre. Sa herë që i pyesja Spiron dhe Uraninë për gjëra që nuk i dinin, më drejtonin të fshatarët më të vjetër, të cilët e kishin kaluar në fshat gjithë jetën e tyre.

Nga sa më sipër, shprehja *horianos* apo “vendasi” nuk ka të njëjtin kuptim për të gjithë fshatarët, dhe kuptimi i tij varet nga kohëzgjatja e qëndrimit në fshat dhe nga dendësia e udhëtimeve dhe shpërnguljeve të tyre. Kur Luka bën dallimin mes vetes, Spiros dhe Uranisë, kuptimi i kësaj fjale përfshin edhe sjelljen, njohuritë për vendin. Në Dhërmi/Drimades kjo njohuri lidhet me mënyrat e ndryshme të ripërvijimit të së kaluarës si dhe me identifikimet e sërishtme të lokalitetit që ndërthuren parreshtur me procesin e krijimit të historisë “së vetme dhe të drejtë” të banorëve të saj.

### “VENDASIT” DHE “TË TJERËT” – DALLIMET DHE NGJASHMËRITË

Dallimet e përmendura në kategorizimin e “banorit lokal” apo “vendasit” bëhen të papërfillshme kur vetë vendasit flasin për të ardhurit dhe punëtorët sezonal, të cilët janë shpërngulur në fshat nga zona të tjera të Shqipërisë. Vendasit në bisedat e përditshme e përvijojnë qartë dallimin mes “nesh”, pra *horiani*, *Drimadiotes*, dhe “atyre” apo *kseni*, pra të ardhurit dhe të huajt. Për ta vendasit përdorin etiketa fyese, si *Turkos* apo *Alvanos*. Këto shprehin dallimet në aftësinë gjuhësore, pozitën financiare dhe sociale, si dhe në mundësitë e kalimit të “lirë” të kufirit shqiptaro-grek. Gjatë qëndrimit tim në fshat, fshatarët shpesh herë më paralajmëronin të tregohesha e kujdesshme ndaj të huajve, *kseni*, të cilët i akuzonin për vjedhje dhe mashtrim. Në paralajmërimet e tyre bënin dallim mes *ksenëve* të shumtë që ishin shpërngulur në fshat në kohën e komunizmit dhe punëtorëve sezonal (muratorë dhe punëtorë të tjerë fizikë), që kishin ardhur më vonë dhe që ishin vendosur në fshat përkohësisht.

Shumica e të ardhurve janë nga fshatrat dhe vendet rreth Labërisë (p.sh. Vranisht, Sevaster, Bolenë, Shales) në juglindje të Shqipërisë, Vlorës (Dukati, Peshkepi, Selenicë, Ballsh) dhe në fund nga fshatra të Shqipërisë Veriperëndimore; disa prej tyre kanë ardhur edhe nga vende të largëta të Veriut, nga zona e Mirëditës, afër kufirit me Malin e Zi. Mes tyre mbizotërojnë familjet e reja, pesë prej të cilave janë transferuar që në kohën e komunizmit, dyzet të tjerat kanë ardhur më vonë. Shumica e tyre janë shpërngulur në Dhërmi/Drimades për arsye ekonomike. Për shkak të emigracionit masiv të të rinjve vendas për në Greqi dhe gjetkë, në fshat u rrit nevoja për fuqi punëtore të re që do t’i ndihmonte vendasit e moshuar







## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

në punët e përditshme. Familjet e reja të shpërngulura kryejnë punë fizike nga më të ndryshmet, p.sh. në kopshtari, mirëmbajtte shtëpishë, vjelje ulliri në periudhën e dimrit, etj. Pjesëtarë të shumtë të këtyre familjeve punojnë gjithashtu për vendasit që janë pronarë apartamentesh, motelesh, restorantesh dhe baresh buzë detit. Shumica e të ardhurve në kohën e komunizmit që dikur punonin në kooperativën e fshatit, sot janë bërë pronarë dyqanesh dhe baresh. Punëtorët sezonalë që jetojnë në fshat vetëm për një periudhë kohe, janë kryesisht muratorë ose kryejnë punë të tjera fizike (mirëmbajnë kopshtet, vjelin ullin, rrush, limona, shërbejnë nëpër restorante dhe bare). Shumë prej tyre kthehen në vendlindjet e tyre ku janë të regjistruar si banorë të përhershëm. Shumica e këtyre të ardhurve identifikohen me vendin e origjinës së prindërve të tyre nga ana e babait. Gjatë punës në terren nuk dëgjova kurrë t'i quanin *fshatarë* apo *vendas*.

I pyesja shpesh të ardhurit në fshat për qëndrimin e vendasve ndaj tyre. Në fillim shumica e bashkëbiseduesve u treguan të përmbajtur, ndërsa më vonë shpesh herë ata më shprehnin ndjenjat e tyre negative që vinin nga qëndrimet fyese të fshatarëve; u thonin *njerëz të këqinj* dhe *racistë*. Shoqja ime Enkeleida, që ishte shpërngulur<sup>19</sup> në fshat në vitin 1984 me familjen e saj (burri, vajza dhe djali) nga qyteti i vogël i Mallakastrës (në verilindje të Himarës/Himara), në fillim më tha se familja e tyre nuk kishte pasur probleme kur u shpërngul në fshat. "Vendasit na pritën me ngrohtësi." Më vonë gjatë bisedës filloi të hapej dhe kur përshkruante kooperativën tha se:

Kur u shpërngulëm në fshat, nuk dija greqisht. Shpesh qaja, sepse nuk i kuptoja koleget e mia. Por me kalimin e viteve e mësova greqishten.

Më pas shtoi:

Edhe pse tashmë jetoj 25 vjet në fshat, vendasit më trajtojnë ende si *turke*. Shumë prej tyre janë racistë, njësoj si serbët në Kosovë. Gjithsesi, mund të them se vendasit që janë kthyer në fshat pas mërgimit ndryshojnë shumë nga ata që s'kanë lëvizur kurrë.

---

<sup>19</sup> Njësoj si shpërnguljet e njerëzve të tjerë brenda shtetit, edhe shpërnguljen e familjes së Enkeleidës e kishte miratuar Partia Komuniste apo e ashtuquajtura Partia e Punës së Shqipërisë. Atyre u caktuan transferimin në Dhërmi/Drimades ku punuan në një nga kooperativat më të mëdha të bregdetit. Disa vite pas komunizmit djali i Enkeleidës emigroi në Itali, ku studion për ekonomi, kurse vajza u transferua në Vlorë, ku dhe u martua. Para pesë vjetësh Enkeleida dhe burri i saj blenë një shtëpi të vjetër në qendër të fshatit, të cilën po e rinovojnë me paratë që ata fitojnë gjatë verës në kioskën me fast food anës detit. Burri i Enkeleidës gjatë vitit fiton para edhe me punët sezonale në fshat dhe jashtë tij.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

Edhe pse Enkeleida u mundua të tregohej e kujdesshme para shoqes së saj nga fshati, e cila po ndiqte bisedën tonë, i tregoi hapur ndjenjat e saja ndaj vendasve. Edhe më vonë, kur fola me të ardhur<sup>20</sup> të tjerë në kohën e komunizmit dhe më pas, mësova se ata dyshonin për “ndjenjën e të qenurit grekë” të vendasve dhe u atribuonin atyre një qëndrim racist ndaj të ardhurve nga zona të tjera të Shqipërisë, gjë që kohët e fundit është gjithnjë e në rritje.

Shumë nga të shpërngulurit më treguan se arsyeja kryesore për të cilën vendasit simpatizojnë Greqinë duhet kërkuar te fakti që ata persona që e kanë njërin prej paraardhësve të tyre nga zona e Himarës/Himara, në përputhje me politikën e brendshme greke marrin *pension grek*. Të shpërngulurit nga jashtë i qortojnë vendasit se ata shtiren si “grekë” vetëm nga interesi për para.

Një nga mësueset e shkollës fillore, e cila bashkë me burrin ishte shpërngulur në Dhërmi/Drimades para 40 vitesh nga një fshat i Labërisë, më tha e nervozuar: “Ata as janë e as kanë qenë kurrë grekë. Shtiren të tillë vetëm për paratë që i marrin nga qeveria greke.”<sup>21</sup> Më pas vazhdoi:

Nëse do të kishin qenë me të vërtetë grekë, atëherë gratë vendase do të kishin vajtuar në gjuhën greke. Kurse ato vajtojnë në shqip dhe jo në greqisht. Për këtë fenomen kanë shkruar shumë historianë. Fakti që gratë vendase vajtojnë në shqip tregon se fshatarët e kësaj zone janë me prejardhje shqiptare. Shumica e tyre e kanë mësuar greqishten pas rënies së regjimit komunist, kur emigruan dhe për disa vite jetuan e punuan në Greqi.

Në bisedat e mëvonshme me të shpërngulur të tjerë nga vende të ndryshme të Shqipërisë, si dhe nga bisedat me turistët shqiptarë që i kalojnë pushimet verore në bregdetin e Dhërmiut/Drimadesit, shumë prej tyre më folën për përdorimin e greqishtes lokale<sup>22</sup> që përdoret nga vendasit në komunikimin e përditshëm. Ata pohojnë se është e pasaktë, pasi sipas mendimit të tyre përmban shumë fjalë që s’janë në gjuhën greke. Një kuzhinierë, që drejton kuzhinën e njërit prej hoteleve (pronari është vendas), u ankua për “greqishten e coptuar” që flitet prej vendasve. Ajo vetë vjen nga Fieri, që gjendet 70 kilometra në veri të Dhërmiut/Drimadesit. Meqë motra e saj kishte jetuar dhe punuar me vite në Greqi,

20 Në vazhdim do t’i quaj shkurt “të shpërngulur”.

21 Në përputhje me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Greqisë nr. 106841/1983 (Tsitselikis 2003: 7) shumica e pensionistëve në Dhërmi/Drimades dhe gjetkë në zonën e Himarës/Himara e marrin pensionin nga institucionet greke.

22 Shumica e turistëve, emigrantëve, punëtorëve sezonalë dhe të shpërngulurve të fundit e konsiderojnë të folmen lokale greke si një nga variantet e greqishtes.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

ajo mendonte se e dinte mirë greqishten. “Për shembull”, vazhdoi e nervozuar, “fjala *okso*, që sipas vendasve do të thotë “jashtë”, në greqisht nuk ekziston. Thuhet *ekso* dhe jo *okso*, siç e shqiptojnë ata.” I thashë se disa prej fshatarëve mendojnë se *okso* është një fjalë greke arkaike që është ruajtur nëpër shekuj në të folmen lokale. Me forcimin e komunizmit dhe të shtetit, të izoluar politikisht dhe ekonomikisht, dhe ndalimit me rreptësi të përdorimit të greqishtes nëpër shkolla dhe në jetën publike, dialekti në Himarë/Himara nuk ka pësuar ndonjë ndryshim thelbësor. Gradualisht u bë më arkaik, pasi vendasit që gjatë komunizmit u shpërngulën në vende të tjera të Shqipërisë, si dhe ata që pas vitit 1990 emigruan në Greqi e përdornin rrallë atë. Kuzhinierja nuk donte t’i pranonte shpjegimet e mia, me të cilat, sipas mendimit të saj, mbaja anën e vendasve. Kuzhinierja vazhdoi se “grekë të vërtetë” janë vetëm ata që jetojnë në zonat me pakicë të njohur greke, pra në vendet në afërsi të Sarandës, Gjirokastrës dhe Delvinës. Edhe të shpërngulurit e tjerë, punëtorët sezonal si dhe disa prej vendasve nga Dhërmiu/Drimadesi<sup>23</sup> mendonin se vetëm gjuha letrare greke është ajo “e vërteta”, kurse dialektet apo stilet e tjera gjuhësore<sup>24</sup> greke janë gjuhë “të rreme”.

Nëse të shpërngulurit në fshat e konsiderojnë *pensionin grek* arsyen kryesore të dallimeve mes tyre dhe *horian-ëve*, vendasit e shikojnë pensionin si ndihmë të qeverisë greke. Pas dekretit të qeverisë greke vendasit e Dhërmiut/Drimadesit dhe të zonës së Himarës/Himara gëzojnë të drejtën e shtetësisë së dyfishtë<sup>25</sup>, njësoj si pakica e njohur greke në

23 Për hollësi të tjera mbi gjuhën shiko nënkapitullin Gjuhët.

24 Fjalën dialekt e përdor si sinonim të fjalës idiom, ky është “nacion neutral superior ndaj të gjitha njësive të tërësisë së shumëllojshmërisë gjuhësore. Në këtë kuptim nocioni i idomës përfshin edhe gjuhën, dialektin, sistemin gjuhësor lokal dhe çdo lloj sociolekti dhe gjuhë specifike të personave të veçantë (dmth. idiolekt)” (Škiljan 2002: 12, shën. 6).

25 Sipas legjisllacionit grek Ligji për natyralizimin e të huajve me origjinë greke (këtu bëjnë pjesë edhe anëtarët e minoritetit grek në Shqipëri) jep të drejtën e marrjes së shtetësisë së dyfishtë. “Natyralizimi është mënyra kryesore me të cilën një i huaj mund të marrë kombësinë greke dhe me këtë shtetësinë e dyfishtë. Kandidatët e mundshëm për shtetësinë e dyfishtë në Greqi janë ata të huaj, të cilëve shtetet ua lejojnë një status të tillë: 1. të kthyerit apo refugjatët që e kanë marrë shtetësinë e shtetit pritisë; 2. anëtarët e minoriteteve greke që janë shpërngulur dikur në shtete të tjera dhe tani po kthehen; 3. emigrantë grekë jo-etnik; 4. bashkëshortët dhe fëmijët e martesave të përziera me grekë dhe të huaj dhe 5. ata që po kthehen Omogenis nga shtetet e ish-bashkimit Sovjetik”. Duke iu referuar nenit 2-2 të Ligjit 2910/2001 mbi natyralizimin e të huajve, personat që përveç shtetësisë greke kanë edhe shtetësi tjetër, konsiderohen si grekë dhe kanë të drejta dhe detyrime të njëjta si shtetasit grekë ... Në bazë të paragrafit 1 të nenit 31 të Kodit Civil Grek, nëse një person ka disa shtetësi, ku njëra prej të cilave është greke, konsiderohet që kjo e fundit të jetë shtetësia kryesore. Një gjyqtar grek një person të tillë mund ta trajtojë si një person me shtetësi greke dhe për raste të veçanta mund të vendosë në bazë të legjisllacionit grek, pa marrë parasysh





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

Shqipëri. Kjo u mundëson atyre ruajtjen e kontaktit me vendin dhe shtetin e origjinës. Sipas rregullores së shtetësisë së dyfishtë, anëtarët e minoritetit grek në Shqipëri (ashtu si në Turqi dhe Egjipt), të cilët kanë jetuar dhe punuar të paktën disa vite në Greqi, gëzojnë të drejtën e pensionit nga fondi shtetëror grek i pensioneve OGA<sup>26</sup>.

Anëtarët e moshuar të minoritetit grek, te të cilët politika e brendshme shqiptare nuk llogarit vendasit e Himarës/Himara, mund të bëjnë kërkesë për Letërnjoftimin e posaçëm për homogjenët e huaj (minoritarët) dhe pas daljes në pension të kthehen në vendlindjen e tyre. Shumica e këtyre pensionistëve jeton me pensionin shqiptar (mes 50 dhe 100 EUR) dhe pjesërisht me atë grek (gjithsej 218 Euro). Pjesën më të madhe të tyre, përveç kursimeve dhe parave që ua dërgojnë fëmijët, e investojnë për rregullimin e shtëpive që kanë dhe ndërtimin e shtëpive të reja. Për këtë qëllim marrin në punë muratorë dhe punëtorë fizikë të tjerë që janë shpërngulur në fshat pas komunizmit.

Çfarë thashë më lartë do ta ilustrim me Dimitrisin që në vitin 1998, në moshën 65-vjeçare, u kthye në vendlindje në fshatin Dhërmi/Drimades. Në Greqi emigroi në vitin 1990, ku punoi si punëtor fizik në bujqësi. Në vitin 1992 iu bashkuan dy djemtë dhe gruaja, edhe kjo vendase nga Dhërmiu/Drimades. Një vit më vonë fëmijët emigruan në SHBA, kurse Dimitrisi dhe gruaja mbetën në Janinë. Në vitin 1998 Dimitrisi doli në pension, dhe si bartës i Letërnjoftimit të posaçëm për homogjenët e huaj (minoritarët), si shtetas grek dhe si punëtor në fermë filloi të marrë pensionin bujqësor në kuadrin e skemës së OGA-së. Organizata e sigurimit për bujqit në Greqi i paguan atij 218 Euro në muaj. Si shtetas i dyfishtë ai mbajti në Greqi edhe shtetësinë shqiptare. Kështu pas kthimit në fshat filloi të marrë edhe një pension të pjesshëm në Shqipëri, rreth 50 Euro në muaj. Dimitrisi vendosi

faktin se një person fizik me disa shtetësi mund të jetë i lidhur në mënyra të ndryshme me Greqinë." (Tsitselikis 2003: 5-6)

26 OGA ose Enti Bujqësor i Sigurimeve Shoqërore u themelua në vitin 1961 me qëllim që t'u siguronte pensionin dhe sigurimin shëndetësor vejjshave, vejanëve dhe popullsisë së zonave rurale në Greqi. Si pasojë e ndryshimit të sistemit të sigurimit në vitin 1998 OGA u riorganizua si Fond i Sigurimit për Bujqit. Parashikohet që OGA do të funksionojë deri në vitin 2026, pra gjatë periudhës së tranzicionit nga sistemi i vjetër në sistemin e ri të sigurimit. Sot OGA ofron këto shërbime: sigurime, pensione, kujdes shëndetësor, shërbime farmaceutike dhe sigurim social për familjet me më shumë se tre fëmijë. Fondi i sigurimeve OGA është në shërbim të bujqëve ose personave që janë të punësuar në ekonominë rurale (pronarët dhe drejtuesit e fermave, punëtorët në bujqësi, mbarështuesit, bletarët etj.), peshkatarëve që s'janë të siguruar në kuadër të ndonjë skeme tjetër sociale dhe në fund të punëtorëve sezonalë. Këta mund të shfrytëzojnë sigurimin bazë të sigurimit bujqësor OGA, në rast se puna e tyre nëpër plantacione, serra, blegtori, pylltari, peshkim dhe veprimtari të tjera gjuetare nuk zgjat më shumë se katër muaj në vit.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

të ndërtojë një shtëpi të re në parcelën pranë shtëpisë së prindërve të tij. Gjatë ndërtimit jetoi te kjo shtëpi, pronar i së cilës është vëllai i tij që jeton dhe punon ende në Greqi dhe që në fshat kthehet vetëm gjatë muajve të verës. Meqë ishte vetëm dhe kishte nevojë për ndihmë, vendosi që të punësonte një familje të re, e cila do të kujdesej për punët e shtëpisë si dhe do të kryente punë të tjera. Kur ishte në kërkim të një familjeje të përshtatshme, një i njohuri i tij që nga koha e kooperativës bujqësore i tregoi për një çift të ri të besueshëm dhe punëtor nga Lushnja.

Behari me origjinë nga Shkodra dhe Ana nga Lushnja, që në atë kohë po kërkonin punë, e pranuan ofertën e Dimitrisit dhe në vitin 1999 u shpërngulën në Dhërmi/Drimades. U vendosën në shtëpinë e tij pjesërisht të përfunduar. Ai e ndërtoi atë me kursimet dhe paratë që ia dërgonin nga jashtë fëmijët dhe gruaja. Ai mori në punë disa muratorë nga Mirdita, të cilët gjatë atij sezoni po jetonin në Dhërmi/Drimades dhe ndërtonin shtëpi për fshatarët e tjerë. Për ndërtimin e katit përdhes ai shpenzoi 15.000 Euro (5000 Euro pagoi për punën dhe të tjerat i shpenzoi për material ndërtimi, transportin, për lidhjen me ujësjellësin dhe rrymën elektrike etj.). Pas shpërnguljes Ana filloi të merrej me amvisëri, kurse Behari ndihmonte Dimitrisin në ndërtim si dhe për punë të tjera fizike. Dimitrisi me pensionin dhe me paratë që i dërgonin e mbaroi edhe katin e parë të shtëpisë, në të cilën jetojnë tani. Për këtë shpenzoi dhe 15.000 Euro për ndërtimin dhe pagën prej 500 Euro të Beharit dhe kunatit të tij. Ky në vitin 2002 u shpërngul në shtëpinë e Dimitrisit për nevoja pune. Ana, Behari, djali i tyre dyvjeçar dhe pjesëtarët e tjerë të familjes së tyre të gjerë tani jetojnë në një pjesë të ndarë të shtëpisë së re të Dimitrisit. Kur nuk i ndihmojnë atij, Behari dhe kunati i tij ndihmojnë fshatarët e tjerë të moshuar në punët e tyre të herëpashershme. Zakonisht i marrin në punë për një ose pesë ditë dhe i paguajnë me paratë e pensioneve greke ose shqiptare. Për punën e tyre Behari dhe kunati i tij fitojnë nga 10 deri 15 Euro në ditë, njësoj si emigrantët e tjerë. Behari një pjesë të parave e harxhon për shpenzimet e jetës, një pjesë e kursen dhe diçka i dërgon familjes së vet dhe asaj të Anës në Shkodër dhe Lushnjë. Dimitrisi ka mendim shumë të mirë për Beharin dhe Anën, po edhe këta flasin me shumë respekt për atë. Edhe pse disa prej fshatarëve nuk janë dakord që ata jetojnë të gjithë bashkë, në përgjithësi e respektojnë Beharin si një punëtor të zotë dhe të ndershëm, i cili, siç thonë shpesh, “nuk është si turqit e tjerë që vjedhin dhe shfrytëzojnë vendasit.” Nga pikëpamja e praktikës së përditshme duket sikur pensionet greke ndihmojnë për krijimin e mirëqënies në jetën e banorëve të Dhërmiut/Drimadesit. Ndihmojnë për kthimin e fshatarëve





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

të moshuar nga Greqia, si dhe mundësojnë punësimin e familjeve të reja që shpërngulen nga zona të tjera të Shqipërisë.

Nga ana tjetër, siç del dhe nga bisedat e përditshme të fshatarëve, pensionet po krijojnë dallime mes “vendasve” dhe “të ardhurve”. Dallimet dhe kufizimet janë pjesë përbërëse dhe krijuese të procesit identifikues së bashku me kategorizimet e ndryshme dhe hierarkizimin e nocionit të “lokalitetit” apo të “të qenurit vendas”. Po të ndjek Gupt-ën dhe Ferguson-in nocioni i lokalitetit nuk ndahet nga nocioni i rajonit, i kombëtares, i ndërkombëtares apo i globalitetit. Njohja e lokalitetit nuk jepet e gatshme, por krijohet historikisht dhe nëpërmjet debatit nga vetë komuniteti (Gupta dhe Ferguson 2001: 6). Në përputhje me këtë është më mirë që komuniteti të përqëndrohet në hulumtimin se si lokaliteti, me dallimet dhe ngjashmëritë e formuara, jeton brenda tij, si dhe të studiojë se çfarë do të thotë në vetvete fjala “lokalitet”. Me këtë nocioni i lokalitetit më shumë sesa me ngjashmërinë lidhet me format e ndryshme të përjashtimit dhe krijimit të shumëllojshmërisë (Gupta dhe Ferguson 2001: 13).

Në Dhërmi/Drimades kategoria e “tjetrit” vendoset edhe brenda grupit të fshatarëve që e mbajnë veten si vendas dhe jo vetëm mes vendasve dhe të ardhurve në fshat. Kështu p.sh. Luka, që në fshat jeton gjithë jetën e tij, mendon se janë *kseni*, si të shpërngulurit (p.sh. Ana dhe Behari), punëtorët sezonal (kuzhinierja nga Fieri), ashtu dhe Urania dhe Janis, që janë faktikisht nga fshati por në kohën e komunizmit u shpërngulën gjatë dhe para disa vitesh u kthyen përsëri.

“Vendosja e dallimeve nuk është pasojë e njohjes së karakteristikave aktuale të përbashkëta apo e shpikjes së “identitetit” nga ndërthurja e tërësishme e karakteristikave lokale, por është rezultat i marrëdhënieve strukturore të pushtetit dhe pabarazisë” (Gupta dhe Ferguson 2001: 14). Fuqia, vendi dhe identiteti janë të ndërthurur me njëri-tjetrin. Më shumë se homogjene dhe të ngritura mbi barazinë, vendi dhe identiteti janë parreshtur nocione konfliktuale (ibid.) Kështu konceptimi nga ana e Lukës i dallimit mes tij, Uranisë dhe Janisit shpreh raportet e forcave, ku pabarazia mes tyre arsyetohet me njohjen e historisë së fshatit nga Luka. Të jesh vendas apo *horiani* sipas tij do të thotë të kesh forcën dhe statusin që kanë vetëm ata banorë që jetojnë në fshat gjatë gjithë jetës së tyre.

## GJUHËT

Gjuha është një nga karakteristikat kryesore mbi të cilën fshatarët mbështesin veçantinë e tyre dhe të qenurit vendas. Në bisedat e përditshme vendasit e Dhërmiut/Drimadesit, Palasit dhe Himarës/Himara





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

përdorin kryesisht dialektin grek lokal<sup>27</sup> dhe pjesërisht dialektin e shqipes jugore (toskë), kurse vendasit në Ilias, Vuno, Qeparo, Kudhes dhe Pilur flasin kryesisht në dialektin toskë. Me gjithë distancat e shkurtra mes këtyre fshatrave, karakteristikë e të cilave është diglosia,<sup>28</sup> thekset në këto të folura janë të ndryshme. Në shpjegimin e dallimeve disa vendas dhe shkencëtarë shqiptarë i referohen ngjashmërive mes dialektit të Himarës/Himara dhe ishullit të Kretës si dhe mes dialektit të Dhërmiut e Palasit dhe atij të Korfuzit. Historiani vendas Bixhili mendon se ngjashmëritë mes dialekteve janë rezultat i lidhjeve të vjetra tregtare, shpërnguljeve sezonale dhe martesave të përziera mes banorëve të Himarës/Himara, Dhërmiut/Drimadesit dhe Palasit dhe zonave të tjera greke në kohën e kolonive greke (Bixhili 2004; Sotiri 2004: 264).

---

27 Vendasit në Dhërmi/Drimades e kuptojnë idiomën e tyre lokale si dialekt dhe nganjëherë edhe si gjuhë. Studiuesit e dialektit në zonën e Himarës/Himara (Sotiri 2001; Hatzhiantoniou 2002) e trajtojnë atë si dialekt. Ky kuptim merret parasysht edhe në këtë punim.

28 Në teorinë e gjuhësisë dialektet dhe të folurat e ndryshme që bashkëjetojnë në shoqëritë e veçanta quhen shpesh "regjstra", "stile" apo "kode". Gjuhëtarët bashkëkohorë mendojnë se dallimet në përdorimin e dialekteve duhen kuptuar në kuadrin e gjerë të dallimeve shoqërore. Ferguson (1959) futi nocionin e diglosisë, dmth. përdorimi i dy gjuhëve në të njëjtin grup shoqëror. Diglosia është e lidhur me ndarjen e jetës shoqërore në grupe të ndryshme institucionesh apo aktivitësh (sfera), në të cilat ... njëra prej gjuhëve është më e përshtatshme apo e detyrueshme" (Grillo 1996: 327). Dallimi kryesor është mes gjuhës formale, që përdoret p.sh. në arsim, dhe gjuhës joformale që përdoret në rrethin familjar. Të dyja gjuhët janë të lidhura mes tyre (ibid.).





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

### **Dhërmi/Drimades**

[1a] *Rotishe eki, prin nambish tish ambulanca. Otan perish to shtrofi kei pash eci eftja apano meria.*

Pyet atje, para se të arrish te ambulanca. Është para bunkerit. Pas kthesës kthehu majtas dhe shko në kodër.

[2a] *Shikonete I mana tu ke t'cipe: Kalimera Shpiruuuuuu! Posh ekshimeroshesh jetat x'manash.*

E ëma e ngre dhe i thotë: Mirëmëngjes Spiros! A fjete mirë (fjl.për.fjl. si u gdhive) biri im (fjl.për.fjl. jeta e nënës)?

[3a] *No'mu pshiha nero jetat x'manash.*

Më jep pak ujë, biri im.

### **Palasë/Palasa**

[1b] *Rotish'e eki, prin nambish' ti sh'ambulanca. Otan perish' to sh'trofi kei pash' eci eftja apano meria.*

[2b] *Sh'ikonete I mana tu ke t'cipe: Kalimera Sh'piruuuuuu. Posh' eksh'himerosh'esh jetat x'manash'.*

[3b] *No'mu psh'iha nero jetat x'manash'.*

### **Himarë/Himara**

[1c] *Rotishe eği, prin nambish tish ambulanca. Otan perish to shtrofi ke pash eci eftja apano meria.*

[2c] *Shikonete I mana tu ke t'cipe: Çalimera Shpiruuuuuu. Posh' ekshimeroshesh jetat x'manash.*

[3c] *No'mu pshiha nero jetat x'manash.*

Shembujt e dhënë ilustrjnë dallimet në shkrimin e dialekteve që fliten nga vendasit në Dhërmi/Drimades, Palas dhe Himarë/Himara. Në këto fshatra fonemi /s/ shqiptohet në mënyra të ndryshme: në Dhërmi/Drimades shqiptohet si /sh/ e butë; në Palasë si /sh' / gjysmë e fortë dhe në







## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

Himarë/Himara si /sh/ e fortë. Vendasit nga Himara/Himara e shqiptojnë /k/ afërsisht si /q/ (si q te “qeni”). Shqiptime të tilla të fonemave /sh/ e butë, /sh’/ gjysmë e fortë, /sh/ e fortë dhe /k/ mund t’i vërejmë kryesisht te banorët më të vjetër, kurse të rinjtë (të lindur pas vitit 1950) nuk e përdorin më shqiptimin e fortë. Në kohën e komunizmit shumë të rinj u shpërngulën në zona të ndryshme të Shqipërisë, kurse pas komunizmit emigruan në Greqi ku morrën diksionin athinas.

Shembujt [1a, b, c dhe 3a, b, c] ilustrojnë ndryshimin e kodeve, një dukuri e shpeshtë te folësit dygjuhësh kur përdorin njëkohësisht dy apo më shumë gjuhë (Grosjean 1982: 145; Hamers dhe Blanc 1989: 148; cf. Petrović 2006: 57). Fjalitë [1a, b dhe c] tregojnë se si në dialektin lokal fjalët greke (*rotishe eki, prin nambish tish*) bashkohen me ato shiptare (ambulanca). Në fjali të tilla si [2, 3], togëfjalëshin *jetat x’manash* apo “jeta e nënës” nënat dhe gjyshet e përdorin për të shprehur dashurinë dhe lidhjen afektive me fëmijët dhe nipat. *Jetat* në shqip do të thotë jetë, kurse *mana* në greqisht do të thotë nënë. Shembulli [2a, b, c] shpreh mënyrën karakteristike të të thirrurit (ndoshta e lidhur me pozitën gjeografike të fshatit). Te *Shpiruuuuuu* theksi bie në rrokjen e fundit dhe jo në të parën. Në shembullin [3a, b, c] janë disa fjalë karakteristike për të folmen lokale. I përdorin kryesisht banorët e moshuar të fshatit (*no’mu* apo greqisht *dino mou*, “më jep”; *pshiha*, “pak”).

### Në kërkim të “gjuhës së parë”

Njësoj si shpjegimi etimologjik i emrit të fshatit edhe shpjegimet mbi origjinën e “gjuhës së parë” në zonën e Himarës/Himara përshkohen nga çështjet kombëtare të prirura drejt interesave pro shqiptare dhe atyre pro greke. Shpjegimet e para pohojnë se gjuha e parë e banorëve “të parë” ka qenë shqipja dhe se greqishtja u shfaq në këtë zonë në kohën e lidhjeve tregtare me banorët greqishtfolës të ishujve fqinjë (Memushaj 2003; Bixhili 2004; Frashëri 2005). Kurse shpjegimet greke janë diametralisht të kundërta dhe thonë se gjuha e parë e kësaj zone ka qenë greqishtja, e cila flitej nga banorët “autoktonë” të kësaj zone; këta u vendosën fillimisht në bregdet, dmth. në *Meghalihora*. Shqipja mendohet të jetë shfaqur vetëm në shekullin e 17 apo 18 kur këtu u shpërngulën disa banorë nga Kurveleshi (Dede 1978; Rusha 2001; Koçi 2006).

Kështu studiuesit pro shqiptarë ashtu si dhe ata pro grekë nga dëshira për të mbështetur hipotezat e tyre merren me çështjen e “civilizimit të parë” në bregdetin jugor shqiptar. Shpjeguesit pro shqiptarë mendojnë se të parët kanë qenë ilirët që më vonë u pasuan nga “civilizimi shqiptar”,





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

kurse studiuësit pro grekë flasin për epirët e vendosur këtu, prej të cilëve buron civilizimi grek i mëvonshëm. Historiani anglez Winniffrith në punimin e tij *Badlands – Borderlands, a History of Northern Epirus/Southern Albania* i hedh poshtë të dyja shpjegimet.

Çështja se cilën gjuhë mund të ketë folur populli i Epirit mbetet ende e kontestueshme. Studiuësit grekë, të cilët mbështesin hipotezat e shumë studiuësve në përfundim, do të donin t'i shpallnin si grekëfolës, pavarësisht nga pohimet e Tukididit dhe Strabonit. Studiuësit shqiptarë mendojnë se ata kanë folur ilirisht, pavarësisht nga dallimi i kujdesshëm që bën Straboni. Duke marrë parasysh kolonitë greke në jug dhe ndikimin e ilirëve në veri, epirotët kanë folur greqisht, ilirisht ose të dyja gjuhët. Në Ballkan, veçanërisht në Shqipërinë e jugut, nuk është asgjë e veçantë që banorët të flasin rrjedhshëm dy apo tre gjuhë ... Por duket qartë se folësit dygjuhësh kanë qenë të rrallë dhe se një epirot tipik ndoshta nuk ka folur as greqisht dhe as ilirisht. (Winniffrith 2002: 47- 48)

Winniffrith konstatoi gjithashtu se fiset ilire dhe epirote i ndryshonin shpeshherë zonat e vendbanimeve dhe udhëtimeve. Studimet e historisë së këtyre gjuhëve dhe karakteristikave gjeografike prej shekullit të 1<sup>-rë</sup> e këtej me metodologji të kufizuara dhe sisteme të ndryshme të krijimit të hartave gjeografike (që p.sh. nuk përfshijnë fotografi nga ajri dhe filmime satelitore),<sup>29</sup> parashikojnë natyrën statike dhe parësore të këtyre çështjeve. Winniffrith mbron një mendim neutral kur konstaton se gjuha e banorëve të parë të zonës së Himarës/Himarës është e vështirë për t'u përkufizuar.

Ashtu siç e ka konstatuar edhe një vëzhgues neutral, ka pak dëshmi bindëse për gjuhën e epirotëve të lashtë , ... por ekziston edhe tepër propagandë shoviniste si e lashtë, ashtu dhe bashkëkohore. Shovinizmi këmbëngul pavarësisht nga shkrimet e shkrimtarëve të historisë, si Tukididi që i përmendte epirotët si barbarë dhe Straboni që i ndante ata si nga grekët, ashtu dhe nga ilirët. Pas kësaj shovinizmi këmbënguli edhe në shekujt më pas kur u rrit numri i dëshmimeve, cilësia e të cilave nuk është më e mirë. (Winniffrith 2002: 49)

Prirjet për rishkrimin e historisë i vërejmë edhe në Shqipërinë post-komuniste. Në këtë kuadër bëjnë pjesë edhe diskutimet rreth gjuhës së parë të Dhërmiut/Drimadesit dhe fshatrave të tjerë në zonën e Himarës/Himara. Këto prirje bëhen më të theksuara gjatë ngjarjeve të rëndësishme politike, p.sh. zgjedhjeve lokale apo qeveritare. Para zgjedhjeve lokale të vitit 2002 dhe atyre qeveritare në vitin 2005 dolën disa botime, autorë të të cilave janë intelektualët lokalë apo historianë "vendas". Këta mundohen

29 Winniffrith p.sh. përmend shembullin e historiografëve anglezë Leake dhe Hammond, të cilët e kishin caktuar gabimisht vendndodhjen e Amantiës dhe Antigonës, dy qytete të rëndësishme antike (Winniffrith 2002: 33).





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

që t'a shpjegojnë teorinë e gjuhës "së parë" me argumente të ndryshme dhe me këtë ta objektivizojnë historinë e Dhërmiut/Drimadesit dhe zonës së Himarës/Himara (p.sh. intelektualët vendas nga Dhërmiu/Drimadesi: Bixhili 2004; Jorgji 2006a, b, c; Gjipopulli dhe Prifti 2006; nga Qeparoja: Rasha 2002; Sotiri 2001 dhe 2004; Koçi 2006<sup>30</sup> dhe historianët: Memushaj 2003; Frashëri 2005; Nasi, Prifti, Onuzi dhe Duka 2004).

### Gjuha dhe arsimit

Përveç pikëpamjeve të kundërta autorët e përmendur kanë edhe disa të përbashkëta. Njëra prej tyre ka të bëjë me arsimin. Autorët pro shqiptarë mendojnë se shkolla është njëri nga faktorët që ka ndihmuar futjen dhe forcimin e përdorimit të gjuhës greke te banorët e Dhërmiut/Drimadesit dhe të Himarës/Himara. Autorët pro grekë mendojnë të njëjtën gjë vetëm se shtojnë se gjuha greke ka qenë e pranishme edhe më parë dhe se me arsimin është forcuar edhe më shumë. Të dyja palët bien dakort që shkollën e parë në zonën e Himarës/Himara e ka themeluar misionari bazilian Neofit Rodino, i cili në vitin 1627 filloi të jepte mësim në greqisht. Disa vite më vonë shkollën e mbyllën dhe në vitin 1633 e hapën përsëri, këtë herë jo vetëm në Himarë/Himara por edhe në Dhërmi/Drimades dhe në Palasë (Sotiri 2004; Jorgji 2006; Gjipopulli dhe Prifti 2006). Nga atëherë, me ndërprerje të shkurtra, në shkollat për djemtë janë zhvilluar orë të rregullta mësimi në gjuhën greke. Në fillim mësimi u zhvillua në kishën e Shën Thanasit, kurse nga viti 1850 në shkollën e re, sot në rrugën kryesore të fshatit buzë detit. Historiografët nuk pajtohen me faktin se kur është ndërprerë mësimi në greqisht. Mësuesi në pension nga Dhërmiu/Drimadesi Marko Gjipopulli pohon se mësimi në gjuhën greke ka vazhduar deri në vitin 1945, kurse gjuhëtarja Natasha Sotiri nga Qeparoja është e bindur se ka vazhduar deri më 1921, kur në Shqipëri nën drejtimin e Ahmet Zogut u forca pushteti qendror dhe u ndërpre mësimi në gjuhët joshqipe (Gjipopulli dhe Prifti 2006: 268).

Mospajtimet lënë vend të zbratur që mbushet me interpretime të ndryshme të motivuara politikisht mbi "gjuhën e parë" dhe përpjekjeve për "ruajtjen" e saj. Gjithsesi, është e qartë se në kohën e pushtetit totalitar shqiptar gjuha shqipe u bë gjuha e vetme zyrtare e shtetit dhe, me përjashtim të zonave ku minoritetit grek të njohur zyrtarisht i njihej e

30 Autorët e përmendur janë me origjinë nga zona e Himarës/Himara, edhe pse këndvështrimet e tyre janë të ndryshme. Dede (1978) dhe Gjipopulli (2007) mbështesin pikëpamjet greke, Bixhili (2004) është në anën e shqiptarëve. Sotiri (2001, 2004) dhe Rasha (2002) janë më neutral, të ndjekur nga Koçi (2006) dhe Jorgji (2006a, b, c) që futën idenë e diversitetit lokal.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

drejta e mësimimit në gjuhën greke, gjetkë (përfshirë Dhërmiun/Drimadesin dhe Himarën/Himara) mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe. 15 vjet pas rënies së komunizmit në qarqet e intelektualëve lokalë u ringjall dëshira për organizimin e mësimimit në gjuhën greke. Kjo u realizua në vitin 2006, kur në Himarë/Himara u hap një shkollë private greke.

Në vitin shkollor 2004 dhe 2005 në shkollën fillore Gjik Bixhili vijonin mësimin 54 nxënës. Pesë prej tyre ishin nga Palasa, ku shkolla fillore ishte mbyllur për shkak të mungesës së nxënësve.<sup>31</sup> Fëmijët e tjerë jetonin në Dhërmi/Drimades. Prindërit e shtatë prej tyre ishin nga fshati, kurse prindërit e fëmijëve të tjerë ishin të ardhur. Për shkak të numrit të vogël të nxënësve klasat ishin bashkuar, klasa e parë me të dytën, e treta me të katërtën etj. Në vitin 2005 filloi zbatimi i sistemit nëntëvjeçar (para këtij ishte tetëvjeçar). Atëherë ishin të punësuar tetë mësues. Njëra nga mësueset jepte mësim në ciklin parashkollor, dy kujdeseshin për katër klasat e para, pesë mësuesit e tjerë jepnin mësim në klasat e larta. Njëra mësuese jetonte në Palasë, të gjithë të tjerët në Dhërmi/Drimades. Katër prej tyre e konsideronin veten *horiani*, tre mësuese ishin të martuara me *horiani*, njëra ishte e ardhur. Njëra prej mësueseve të martuara dhe katër mësues, të ashtuquajtur vendas, përveç dialektit shqiptarojugor flisnin edhe dialektin lokal grek, pjesërisht me theks athinas, që e kishin marrë gjatë qëndrimit të tyre në mërgim. Në shkollë mes tyre flisnin kryesisht shqip, kurse pas mësimimit në fshat, në kishë apo në kafene i përdornin shpesh të dyja gjuhët.

Gjatë pushimit në korridorët dhe në oborrin e shkollës dëgjohej më shumë shqip. Fëmijët që i flisnin të dyja gjuhët (pesë prej shtatë fëmijëve vendas nga Dhërmi/Drimadesi dhe Palasa) u përshtateshin shokëve të shkollës që flisnin vetëm shqip. Dialektin lokal grek e përdornin rrallë. Kur e mësova dhe vetë shqipen dhe punova në shkollë si mësuese anglishteje për nxënësit nga klasa e pestë te e teta, vetëm një herë vura re qëndrim fyes ndaj nxënësve jo shqipfolës. Një vajzë në klasën e pestë nuk e fliste rrjedhshëm shqipen, ngaqë ishte shpërngulur në fshat para pak kohësh me nënën e saj, edhe ajo vendase, të cilat më parë kishin jetuar në Janinë, ku vajza kishte mbaruar katër klasat e para të shkollës fillore. Shokët e

---

31 Njësoj si në Palasë (me 413 banorë) shkolla fillore u mbyll edhe në Pilur (me 536 banorë), ndërkohë që nxënësit nga Iliasi ndiqnin mësimin gjatë gjithë kësaj kohe në shkollën fillore në Dhërmi/Drimades. Sipas të dhënave të Gjipopullit dhe Priftit në Himarë/Himara gjendet edhe shkolla e mesme "Spiro Gjikhuri" me 95 nxënës dhe shkolla fillore "Spile" me 270 nxënës. Shkolla fillore në Vuno (486 banorë) ka 24 nxënës, në Qeparo (1591 banorë) 45 nxënës dhe në Kudhes (904 banorë) 19 nxënës (Gjipopulli dhe Prifti 2006: 185).





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

thërrisnin shpeshherë me shprehje fyese *kaur*<sup>32</sup> (i pafe) dhe *greku i derrit*. Meqë shumica e shokëve të klasës nuk e afronin, shoqërohej me nxënës të klasave të para dhe të dyta, prindërit e të cilëve ishin vendas. Nga vëzhgimet dhe bisedat e mia me mësuesit dy prej nxënësve dygjuhësh nuk kishin vështirësi për ta kuptuar shqipen, njohuritë e tyre ishin të krahasueshme me nivelin e dijes të lëndët e tjera shkollore. Tre fëmijë (nga klasa e parë, e dytë dhe e pestë) kishin vështirësi për ta kuptuar dhe folur gjuhën shqipe në krahasim me suksesin e tyre të lëndët e tjera. Të pestë këta fëmijë dygjuhësh kishin kaluar disa vite apo muaj në Greqi dhe të gjithë, përveç njërit, ishin kthyer në fshat para regjistrimit në shkollën fillore.

### Gjuhët e folura

Shumica e vendasve në bashkëbisedimet e tyre në rrugë, kafene, dyqane apo kisha përdorin dialektin lokal grek të kombinuar me fjalë shqipe. Krahas fjalëve tipike të dialektit lokal (*okso* - jashtë, *psiha* – pak, *ortha* – gjel) në leksik bëjnë pjesë edhe fjalët shqipe për numrat, muajt, stinët, njësitë matëse, institucionet zyrtare, p.sh. *bashki*, *pashaportë*, *kufi*, *partia*, *kryeplak* etj.

Njohja dhe përdorimi i përditshëm i dialektit lokal lidhen me brezin të cilit i përkasin folësit. Brezat më të vjetër, të lindur mes viteve 1920 dhe 1940, përdorin kryesisht dialektin lokal. Ata që kanë ndjekur shkollën fillore geke dinë të lexojnë dhe shkruajnë në greqisht. Shumë banorë të lindur në vitet 1945-1960 e kanë lënë fshatin në moshë të re. Ata u transferuan në zona të tjera të Shqipërisë dhe aty ndërtuan jetë të re, pas rënies së komunizmit shumë prej tyre mërguan në Greqi nga ku më në fund u kthyen në fshat. Edhe këta përdorin greqishten në bashkëbisedimet e përditshme dhe dinë të lexojnë dhe shkruajnë mirë greqisht. Vendasit që kanë mbetur në Shqipëri, flasin pak apo nuk e flasin fare greqishten. Shumica e këtij brezi, të lindur pas vitit 1960 jeton ende në Greqi dhe në fshat kthehet vetëm me pushime në muajt e verës. Greqishtja është gjuha e parë e tyre, kurse shqip nuk flasin mirë. Fëmijët e tyre nuk dinë shqip, pasi kanë lindur dhe po rriten në Greqi.

---

32 Për kuptimin e fjalës *kaur* shiko kapitullin e dytë Konflikti i historive, nënkapitulli Ndarja e njerëzve dhe e vendeve.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

### Gjuha si biletë hyrëse

Kur erdha në fshat njohuritë e mia për shqipen dhe greqishten ishin tepër modeste. Edhe pse të dyja gjuhët i mësova në muajt para se të nisësja, pata shumë vështirësi për t'u kuptuar në të dyja dialektet. Marija, studente në degën e anglishtes dhe letërsisë më ndihmoi në fillim me përkthime, kurse pas largimit të saj fillova të mësoj shqip në shkollën fillore të fshatit dhe greqisht te një fshatare. Mësuesja ime ishte e martuar me një vendas, ndërsa ajo vinte nga një fshat i Gjirokastrës ku jeton minoriteti grek. Në tre muajt e parë të punës në terren bëja çdo ditë orë mësimi në shqip dhe greqisht, përveç fundjavëve. Pas gati dy muajsh niveli i njohjes së dialektit lokal u përmirësua kaq shumë, sa që e përdorja në komunikimin e përditshëm. Pas disa muajsh kuptoja shumicën e bisedave, kurse shqiptimi im ishte ende i rëndë. Meqë shumica e të njohurve të mi ishin vendas, përparova shumë më shpejt në zotërimin e dialektit lokal grek, sesa të shqipes. Përveç kësaj, fjalët greke më dukeshin disi më të afërta nga përdorimi i tepërt në terminologjinë shkencore (p.sh. *anthropos*, *gineka*, *andras*, etj.). Në muajt e fundit të punës në terren e zotëroja me mjaft aftësi greqishten lokale. Shumë prej vendasve e kuptonin suksesin tim në mësimin e greqishtes si konfirmim të "ndjenjës së tyre të të qenurit grek". Shpeshherë pata përshtypjen se për shkak të komunikimit më të mirë në greqisht në krahasim me shqipen, kisha fituar besimin e vendasve gjë që ma bëri më të lehtë depërtimin në jetën e tyre private.

## FEJA

### Feja në Shqipëri

Sipas të dhënave nga burimet e internetit<sup>33</sup> 70% e banorëve të Shqipërisë i përket fesë islame, 20% Kishës Ortodokse Shqiptare dhe 10% fesë katolike romake. Përqindjet janë të përafërta, pasi bazohen në të dhënat e studimeve të vitit 1989. Një nga arsyt kryesore të paqartësisë së këtyre vlerësimeve është përhapja e ateizmit që u nxit nga diktatori Enver Hoxha nga viti 1967.

Edhe pas themelimit të Kishës Autoqefale Shqiptare (autoktone) në vitin 1922 dhe konfirmimit të saj nga Patriarkana në vitin 1937, në shqip<sup>34</sup>

33 CIA – The World Factbook 2007 (<https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/goes/al.html>).

34 Përkthimet e letërsisë fetare janë bërë në vitet 1910 deri 1940 (Jacques 1995: 313-315).





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

është përkthyer shumë pak literaturë fetare (Winnifrith 2002: 135). U përkthye *Dhiata e Re* që përdoret në zonat e minoritetit grek dhe në zona të tjera ku u ruajt krishterimi edhe pas valës islamizuese të dominimit osman. Në zonat e minoritetit grek, si dhe në zonën e Himarës/Himara, ritet fetare zhvillohen në gjuhën greke, kurse në komunitetet e tjera krishtere pjesërisht në shqip dhe pjesërisht në greqisht.

Në vitin 1967 regjimi i Enver Hoxhës nën ndikimin e kulturës së revolucionit kinez e shpalli Shqipërinë shtet ateist. Me këtë u ndalën të gjitha praktikat fetare, u mbyllën apo u shkatërruan shumë kisha dhe xhami. Ndryshe nga shkatërimi i përgjithshëm i kishave, në kundërshtim me atë që po ndodhte nëpër Shqipëri, në Dhërmi/Drimades dhe në vende të tjera të Himarës/Himara kishat u ruajtën. Si pjesë e pasurisë kombëtare kanë qenë të mbrojtura kryesisht kishat e shek. të 12 dhe 13, pra *Panajia Pano*, *Panajia Kato* dhe *Ag. Stephanos*, të cilat kanë qenë gjatë gjithë kohës të mbyllura dhe askush prej vendasve nuk guxonte të hynte brenda. Partia komuniste i kishte nën survejim të rreptë priftërinjtë dhe i kontrollonte, nëse e respektonin ndalimin e kryerjes së riteve fetare. Ritet e rëndësishme si p.sh. Pashkët dhe Krishtlindjet kryheshin në fshehtësi.

Gjatë punës në terren shkoja çdo të dielë në meshë. Shumica e fshatarëve e mirëpritën me ngrohtësi praninë time. Disa thonin se prania ime në kishë i kishte bindur se isha *kali kopela* (vajzë e mirë, apo zemërmirë). Kështu përveç njohjes së gjuhës edhe pjesëmarrja në ritet fetare më mundësoi "hyrjen" në jetën e përditshme të fshatarëve. Më pyesnin parreshtur se cilit besim fetar i përkas, ose më saktë, "a jam kristiane". Përgjigjia ime se jam rritur në një traditë katolike ishte e pranueshme për shumicën e fshatarëve. Zakonisht theksonin faktin se tradita ortodokse dhe ajo katolike kanë rrënjë të përbashkëta. Vura re se si në muajt e parë më vëzhgonin se si silllesh në kishë. Fshataret vërenin mënyrën se si bëja kryqin, tipike katolike, ndryshe nga e tyrja.

### Kisha në Dhërmi/Drimades

Kur fshatarët përshkruajnë Dhërmiun/Drimadesin shpeshherë përmendin numrin e madh të kishave dhe kapelave të vogla të shpërndara nëpër të gjithë fshatin. Gjithsej janë 30, më të rëndësishmet janë tre kishat e përmendura të shek. 12 dhe 13: *Panajia Pano* (kisha e Shën Mërisë në kodër) gjendet në kodër në qendër të një fshati të vogël, *Panajia Kato* (kisha e Shën Mërisë në bregun e detit) dhe *Ag. Stephanos* (Shën Stefani) gjenden në bregun e detit. Këto kisha të vogla përdoren kryesisht për ritin





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

e ditës së emrit të shenjtoreve, kurse kishat e mëdha, *Ag. Haralamb* dhe *Ag. Spiridonas* përdoren rregullisht pothuajse çdo të diel dhe për festa.

Përveç kishave për fshatin janë të rëndësishëm edhe manastiret: *Ag. Thodoros* (Shën Teodori) gjendet në një shkëmb bregdetar në fund të fshatit, në një luginë malore pas fshatit gjendet kisha *Stavridi* (Kryqi), kurse në kalimin që çon drejt saj qëndron një kapelë e vogël *Ag. Pandaimonio* (Shën Pandemoni).

Në çdo lagje (*ghitonia*) të fshatit qendror në Dhërmi/Drimades gjenden kisha të vogla të ndërtuara nga banorët. Nëpër lagje jetojnë njerëz me lidhje nga ana e babait. Nëpër kisha mbahen mesha në ditën e emrit të shenjtoreve të këtyre kishave apo për pjestarët e bashkësive familjare. Për shkak të emigrimit masiv shumë lagje janë abandonuar dhe po shkatërrohen (p.sh. lagjia *Vretej* dhe *Pangalades* në fshatin qendror *Qendra/Kendros* dhe *Gjilek/Gjilekates* në lagjen fqinje). Pavarësisht nga rrënimi kishat janë, në krahasim me rrethinat e mbuluara me bar, relativisht të ruajtura mirë, pasi mirëmbahen nga disa fshatare dhe një adoleshente.<sup>35</sup> Zakonisht i pastrojnë një ditë para ditës së emrave apo për ditë feste.

Tani në fshat gjenden dy priftërinj ortodoksë, të dy vendas. Nga mungesa e priftërinjve ata i kryejnë ritet fetare edhe në fshatra të tjera (Palasë) apo dhe më tutje në zonën e Himarës/Himara. Mesha në Dhërmi/Drimades, në dallim nga vendet e tjera, kryhet rregullisht çdo të diel dhe për festa në kishat *Ag. Harallamb* apo *Ag. Spiridonas*. Pjesa e ritit të këndimit të psalmave bëhet në greqishten e vjetër, më pas vijon shpjegimi në greqishten lokale.

Mesha e së dielës zgjat një orë e gjysmë dhe mbliidhet nga pëshpëritja e grave që ulen në sfondin e kishës. Vendi i grave është në anën e majtë të kishës, nga ku mund të vështrorjnë murin me ikonat apo *ikonostasis*. Burrat e kanë vendin e tyre në të djathtë, nga ku gjithashtu vështrorjnë murin me *ikonostasis* që e lidh aksin e zgjatur të kishës me altarin. Aksi i zgjatur i kishës është vend për të gjithë njerëzit, kurse altari për të shenjtët e më të shenjtëve. Prifti që qëndron para *ikonostasis* i lidh njerëzit me zotin (*Theos*). Në ballkonin e sfondit të kishës ulen fëmijët, adoleshentët dhe gra të moshës së mesme. Nga aty vrojtojnë dhe komentojnë atë që ndodh poshtë tyre ose fëmijët e pabindur që ngatërrohen nëpër shkallë. Mesha ndiqet nga 100 deri 150 njerëz, shumica janë gra (80-100 gra dhe 20-50 burra). Gjatë festave numri i tyre rritet deri në 160-180 njerëz, pothuajse të gjithë vizitorë nga Dhërmiu/Drimadesi.

<sup>35</sup> Një muaj pas largimit tim nga Dhërmiu/Drimadesi (dhejtor 2005) u martua me një emigrant vendas dhe u shpërngul në Greqi.







## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

### Feja dhe jeta e përditshme

Jeta dyzetepesëvjeçare në komunizëm ndikoi shumë në njohjen e fesë dhe të praktikave fetare nga njerëzit në Shqipëri. Meqë nuk ka pasur edukim fetar banorët e Dhërmiut/Drimadesit nuk e njohin mirë përmbajtjen e Biblës. Vështirësi kanë edhe për njohjen e lutjeve, dinë mirë vetëm disa prej tyre dhe këngët fetare. Më shumë për përkatësinë e tyre ortodokse flasin praktikantët fetare në kishë dhe jashtë saj. Në kishë bëjnë kryqin, puthin dhe u përkulen ikonave, ndezin qirinj, ecin në mënyrë të veçantë, dhurojnë *kollyvo* (pjtë e madhe me elb të zier me sheqer dhe rrush të thatë apo arra) gjatë meshave për të vdekurit apo për ditët e emrave të të afërmëve të ndjerë apo të shenjtorëve, dhurojnë edhe *prophoro* (kruh) për ditët e emrave të të afërmëve në jetë. Praktikantët fetare të fshatit jashtë kishës përfshijnë agjërimin, festime të ndryshme dhe aktivitete të tjera shoqërore.

Me gjithë ateizmin e rreptë në kohën e komunizmit shumë nga këto praktika, veçanërisht ato që bëhen në vendet e shenjta, janë ruajtur në fshehtësi nga brezi në brez. Sot, me ndryshimet sociale (emigrimi masiv) dhe politike (demokracia, liria fetare) dhe mundësinë për të ndjekur mediat (programet televizive greke dhe italiane), praktikantët fetare në fshat po ndryshohen dhe ripërvijohen sërish. Në mëngjeset e të dielave nga shumë shtëpi dëgjohej psalmet që njerëzit shikojnë apo dëgjojnë në transmetimet televizive të meshave në programet greke, p.sh. në kanalin televiziv Mega. Përveç Meg-ës ndjekin edhe programe të tjera greke (Alpha, ERT 1 dhe ERT 2 – *Elliniki Radiofonia Tileorassi*), që transmetojnë seriale të ndryshme televizive, në të cilët mund të shikojnë edhe praktikantët fetare, p.sh. martesat fetare, pagëzimet, festimet e ditës së emrit.<sup>36</sup> Në televizor fshatarët shikojnë dhe krahasojnë detaje të shumta të jetës fetare. Gjatë verës në fshat janë të pranishëm edhe shumë vendas emigrantë që jetojnë në Greqi; shpeshherë këta bëjnë vëretje për gjithçka që u duket e “papërshtatshme” në sjelljet fetare të fshatit në krahasim me sjelljet e “drejta” në Greqi. Ata përpiqen t’i mësojnë të afërmit e tyre se si të bëhen “kristjanë të mirë” (*kalos hristianos*). Në një nga meshat e së dielës Eleni p.sh. që jeton me burrin prej 12 vitesh në Greqi, u përpoq të më shpjegonte mua dhe kushërirës së saj se pse nuk është “mirë” që gratë e vjetra të flasin gjatë meshës: “Në Greqi, në kishë nuk flet njeri, jo si këtu, ku gratë bisedojnë me zë të lartë kur prifti thotë lutjet. Pssst ..., “mundohej t’ua mbyllte gojën atyre, por pa sukses.

<sup>36</sup> Sot shikimi i televizorit në fshat është një praktikë e përditshme, pasi, përveç orëve kur nuk ka rrymë elektrike, televizori mbahet ndezur tërë kohën.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

Në Dhërmi/Drimades ndiqet kalendari i kishës ortodokse; festohen festa fetare të rëndësishme, siç janë *Pashkët*, *Mikri Pashka* dhe *Hristughenia* (Krishtlindje) si dhe ditët e emrave të shenjtorëve dhe apostujve. Në kishë festime të tilla bëhen çdo e dytë apo e treta ditë. Vejushat dhe çiftet e moshuara, sidomos gjatë dimrit kur fshati është disi i zbrazur, festojnë ditët e emrave të burrave, djemve dhe nipave të tyre që mbajnë emrat e shenjtorëve. Sipas traditës së fshtatit ditët e emrave të grave festohen më rrallë. Një ditë para festës gratë apo vejushat pastrojnë shtëpinë dhe oborrin. Nëse festojnë ditën e emrit të ndonjë të afërmi të ndjerë, në mbrëmje gatuajnë kolivo. Kurse kur festojnë emrin e ditës së ndonjë të afërmi të gjallë, pjekin prosforo. Të nesërmen herët në mëngjes (rreth orës 6.30) i çojnë prosforën dhe kolivën në kishë dhe ia dorëzojnë ndihmësit të priftit. Në fund të meshës ushqimi bekohet dhe u ndahet besimtarëve. Pas ritit, ajo grua që feston ditën e emrit të të afërmit të saj i fton fshatarët në shtëpi për kafe dhe muhabet.<sup>37</sup>

Zakonet fetare kanë një ndikim të rëndësishëm në aktivitetet e përditshme të fshatareve dhe pjesërisht të fshatarëve. Në festat e mëdha, të dielave dhe në ditët e emrave të shenjtorëve (p.sh. *Ag. Thoma*, që festohet një javë pas *Pashkëve*), fshataret u shmangen punës në plantazhet e ullinjve, nëpër kopshte dhe në shtëpi. Bëjnë përjashtim vetëm muajt e verës kur disa prej tyre ndihmojnë burrat dhe djemtë në punët e aktivitetit turistik (p.sh. restorante, apartamente, hotel etj.). Fshataret e tjera i marrin nëpër gojë ato, pasi mendojnë se një sjellje e tillë nuk është e përshtatshme.

Ka disa fshatare më të vjetra që para festave të rëndësishme fetare respektojnë rregulloren e agjërimit. Agjërimi presupozon përjashtimin e mishit, vajit, prodhimeve të qumshtit, vezëve dhe alkoolit. Mishin nuk e hanë të paktën një herë në javë, zakonisht të premtëve. Agjërimi i përgjithshëm bëhet kryesisht javën para *Pashkëve* dhe Krishtlindjes. Burrat agjërojnë më rrallë, kurse priftërinjtë patjetër. Bindjet fetare ndikojnë shumë edhe në mënyrën e veshjes. Para se të shkojnë në meshë fshataret kujdesen që veshjet e tyre dhe të bashkëshortëve të jenë të pastra dhe të rregulluara. Shumica e grave të vjetra vishen me të zeza, sepse kështu e kërkojnë rregullat e zizë për të vdekurit e afërm të tyre – burrat, djemtë, vajzat, prindërit, vëllezërit dhe motrat, apo kunetërit. Tek veshjet e zeza bëjnë pjesë dhe çorapat e zeza dhe shamia e zezë mbi flokë.

37 Përveç pjesëmarrjes në meshë, vizitat nëpër shtëpi përbëjnë thelbin e jetës sociale të grave në fshat. Duke pirë kafe me biskota, karamela dhe ëmbëlsira të tjera (gliko, kadaif), mysafirët dhe e zonja e shtëpisë bisedojnë për çështjet e fshtatit.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

Në bashkëbisedimet e përditshme në Dhërmi/Drimades përdoren shumë shpesh<sup>38</sup> fjalët “Zot” (*Theos*) dhe “Shën Mëri” (Panajia), zakonisht në shprehje të ndryshme. Kur p.sh. dikush dëshiron të shprehë shpresën dhe dëshirat e veta për të ardhmen thotë: “Lavdi Zotit” (*Doksa tou Theu*) apo “Po deshi Zoti” (Ean thelei Theos) apo “Më parë Zoti” (*Prot’ Theos*). Kur dëgjojnë lajme të papritura apo kur shprehin befasi për ndonjë ngjarje apo për sjelljen e ndonjë personi, gratë përmendin Virgjëreshë Marien.

### Feja dhe gjinia

Feja është e rëndësishme edhe për përcaktimin dhe krijimin e roleve gjinore. Juliet du Boulay (1968) thotë se feja ka rol thelbësor në kuptimin e roleve gjinore në Greqi, ndërkohë që Hirschon (1983, 1989) dhe Dubich (1991) kanë shkruar për detyrimet e shumta fetare të grave greke që përfshijnë ndezjen e qirinjve para ikonave familjare, lutjet për fëmijët dhe të afërmit e tyre, mirëmbajtjen e kishave dhe të varreve. Në këtë mënyrë gratë shërbejnë si urë lidhëse mes familjeve të tyre dhe botës së përtejme (Dubich 1991: 41).

Ashtu si në ishullin Tinos në Detin Egje (Dubich 1991: 42) edhe në Dhërmi/Drimades janë burrat ata që mbikëqyrin ritualet kryesore fetare, d.m.th. meshën, arkivolin dhe dasmat. Shumica e shërbesave në kishë është e rezervuar për meshkujt: prifti dhe ndihmësit e tij që mbledhin kontributet për qirinjtë dhe ndajnë prosforën dhe kolivën, dhe këngëtarët e psalmave. Veprimet e tyre në kishë zhvillohen para besimtarëve, ndërkohë që gratë qëndrojnë të fshehura në sfond.

### Feja dhe lokalizmi

Njësoj si gjuha edhe feja është faktor i rëndësishëm që përcakton dhe forcon pa rreshtur ndjenjën e “të qenurit grek” të vendasve. Ashtu si vendasit nga zona e Himarës/Himara edhe fshatarët e Dhërmiut/Drimadesit deklarohen si *hristian*, të përkatësisë së kishës ortodokse. Pas vitit 1990, për shkak të shpërnguljeve gjithnjë e më të mëdha nga zonat e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut, struktura fetare e fshatit ka ndryshuar. Shumica e të ardhurve janë muslimanë, disa prej tyre deklarohen si ateist. Ata që vetëdeklarohen si muslimanë marrin pjesë shumë rrallë në festat fetare, shumë prej tyre as që kanë hyrë ndonjëherë në xhami. Para përbuzjes së përgjithshme të vendasve që i shajnë *Turkos* ose *Musliman*, duket sikur fenë e tyre shpesh e fshehin. Shumë prej tyre e kanë kuptuar se është pikërisht feja

38 I njëjtë është përshkrimi i Ambelisë në e Eubenë e Veriut (du Boulay 1991: 47-57).





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

ajo që “po u mbyll dyert në Greqi dhe gjetkë”. Për t’i përmirësuar shanset e migrimit të tyre në Greqi dhe Itali, si dhe për t’u pranuar më mirë nga vendasit, i kanë ndërruar emrat muslimanë me të krishterë. Të konvertuarit në fenë krishtere marrin pjesë në ritet kishtarë të festave të rëndësishme. Konvertimin e tyre vendasit e pranojnë në mënyra të ndryshme, disa me dashamirësi, kurse të tjerët shikojnë te ai vërtetimin e asaj që “muslimanët janë njerëz pa besë”<sup>39</sup> dhe krenari.

### NUMËRIMI I POPULLATËS: NUMRA TË LËVIZSHËM

Sipas regjistrimit zyrtar të popullatës së Shqipërisë (INSTAT 2004) në Dhërmi/Drimades jetojnë 1791 banorë; 717 jetojnë në lagjen qendrore dhe në Gjilek/Gjilekates, kurse në fshatin Kondraqi 1074. Në regjistrin e zonës së Himarës/Himara mund të vërehet dallimi mes banorëve të regjistruar dhe atyre që faktikisht jetojnë në fshat. Sipas vlerësimeve të administratës komunale dhe të vendasve në lagjen qendrore dhe në Gjilek/Gjilekates jetojnë faktikisht 300 banorë, kurse në Kondraqi rreth 600.

Arsyet për një dallim të tillë mes banorëve të regjistruar dhe atyre që faktikisht jetojnë në fshat janë të shumta. Disa prej banorëve, vendas nga Dhërmiu/Drimadesi, janë të kthyerit në vendlindjen e tyre dhe nuk janë të regjistruar. Ata u shpërngulën gjatë kohës së komunizmit në zona të tjera të Shqipërisë, më pas emigruan në Greqi dhe pas daljes në pension janë kthyer sërish në fshat. Edhe pse jetojnë në fshat janë ende të regjistruar në zonat ku kanë qenë shpërngulur gjatë komunizmit.<sup>40</sup> Arsyeja tjetër e dallimit mes banorëve të regjistruar dhe atyre që faktikisht jetojnë në fshat qëndron në faktin se shumë banorë pas rënies së komunizmit, pa u çregjistruar nga fshati, emigruan në Greqi dhe nuk janë kthyer ende. Arsyeja e tretë është administrative, pasi në regjistrin civil figurojnë ende banorët e vdekur të fshatit ngaqë nuk është bërë ende njoftimi zyrtar i vdekjes së tyre. Përveç kësaj regjistrimi përfshin edhe disa banorë që kthehen vetëm përkohësisht në fshat apo jetojnë aty vetëm gjatë verës. Disa prej këtyre gjatë verës drejtojnë lokalet, restorantet, motelet apo dhomat për turizëm, kurse dimrin e kalojnë në Greqi. Banorët e tjerë sezonalë janë të shpërngulurit nga zonat e tjera të Shqipërisë, që në zonën e Himarës/Himara punojnë si muratorë apo punëtorë fizikë.

39 Martin Berishaj (Berishaj 2004: 15) e përkufizon besën si “kategori etiko-morale” dhe vlerën kryesore të së drejtës zakonore shqiptare. Besa është sinonim për nderin dhe fenë.

40 Regjistrimi i popullatës së Dhërmiut/Drimadesit në terren ka treguar se nga 89 çifte 75 prej tyre kishin kërkuar transferim në kohën e komunizmit, kurse pas rënies së tij emigruan në Greqi.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

Zyrtarët në bashkinë e Himarës/Himara janë të vetëdijshëm për dallimet në numrin e banorëve të regjistruar dhe atyre që jetojnë faktikisht aty. Njëri prej zyrtarëve të komunës më deklaroi se po mundohen ta përmirësojnë gjendjen, pasi bo bëhet problem gjithnjë e më i madh:

Me sa di unë për këtë gjendje janë fajtorë dy arsye. E para që disa njerëz, si p.sh. Aspasia, hm ... motra e Elenës, ti e njeh atë ... Dokumentet e saja janë në Tiranë. Të jetoje para vitit 1990 në Tiranë ishte diçka e veçantë. Ishte e vështirë të merrje leje transferimi për në Tiranë. Njerëzit që jetonin atje na dukeshin sikur jetonin në kështjellë. Si të ishin shtresa më e lartë e shoqërisë. Ndoshta kanë ende nostalgji për këtë ... Meqë në Tiranë e kishe pothuajse çdo gjë në pëllëmbë të dorës. Pra bëhet fjalë për nostalgji apo për faktin që dikur Aspasia ishte e rëndësishme, sepse jetonte në Tiranë, në një qytet të madh dhe jo në ndonjë fshat të vogël si Dhërmiu/Drimades. Ndoshta për këtë i ka ende aty dokumentet e veta. Arsyeja tjetër, me të cilën kam edhe vetë tani vështirësi, është se po mundohem t'i rregulloj dokumentet xhaxhait tim Fotos. Xhaxhait që më ka vdekur. Gruaja dhe fëmija e tij më janë lutur që ta rregulloj këtë gjë. Kam tre apo katër muaj që po mundohem t'i nxjerr dokumentet në bashkinë e Vlorës. Duket sikur askush nuk punon në Vlorë. Dy herë kam shkuar atje dhe deri tani nuk ka ndodhur asgjë. Kjo është atëherë njëra nga arsyet kryesore që njerëzit nuk mund t'i transferojnë dokumentet e tyre në Himarë/Himara. Arsyeja e parë, hmm ... si ta them ... është çështje mentalitetit apo nostalgjie për jetën në qytetin e madh dhe e dyta është burokracia. Ka edhe arsye të tjera, por përmenda vetëm dy më kryesoret ...

E pyeta se a ka menduar të bëjë diçka për ta përmirësuar gjendjen:

Më ler të të them se ... Më parë për transferimin e dokumenteve në Himarë/Himara është dashur t'i paguash 1000 Lekë shtetit dhe 3000 Lekë bashkisë. Sot bashkia kërkon vetëm gjysmën e kësaj shume, pasi ende duhet t'i paguash shtetit. Në këtë mënyrë ne i ndihmojmë njerëzit që t'i transferojnë dokumentet në Himarë/Himara. Por kjo ende nuk mjafton. Dikur ne kemi qenë 10000, kurse sot jemi 11322. Pra rreth 1000 më shumë sesa para dy vitesh. Dhjetë përqind, kjo nuk është pak! Përveç kësaj, shumica e njerëzve që dikur [ *gjatë komunizmit*, shën. i N. G. B.] jetonin në Dhërmi/Drimades sot jetojnë në Greqi. Atyre nuk u intereson më Dhërmi/Drimadesi. Ndërsa ata që dikur jetonin gjetkë dhe sot jetojnë në Dhërmi/Drimades janë shumë më tepër të angazhuar. Shumica e atyre që kanë jetuar në fshat deri në vitin 1990 sot janë më pak të angazhuar në krahasim me ata që atëherë jetonin jashtë fshatit. Për ata që jetonin këtu nuk kishte ndonjë dallim. Dhërmi/Drimadesi nuk u intereson më, sepse nuk jetojnë dhe nuk votojnë më këtu.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

E pyeta si do ta zgjidhin këtë problem, pasi mund të jenë ende të rëndësishëm për fshatin, të paktën në kohën e votimeve.

Mendoj që kjo lidhet me mentalitetin dhe arsimin e tyre. Shumica e tyre ka punuar nëpër fusha [në kooperativën bujqësore, shën. i N. G. B.] Nuk janë të vetëdijshëm për asgjë tjetër. Meqë mendojnë se nuk mund të ndryshojnë asgjë, mbështeten vetëm në forcat e tyre.

Nëpunësit në bashkinë e Himarës/Himara mundohen t'i zvogëlojnë dallimet në numrin e banorëve të regjistruar dhe të atyre që faktikisht jetojnë aty. Megjithatë, deri tani gjendja është përmirësuar pak. Një nga arsyt janë padyshim procedurat e gjata të regjistrimit në administratën e bashkisë në Vlorë, arsyt e tjera janë vetë njerëzit. Disa prej tyre kanë nostalgji për komunizmin, kur kishin një status më të lartë social dhe privilegje të ndryshme. Atëherë mirëqënia ekonomike ishte e lidhur me vendin e banimit, pasi jeta në qytet kishte shumë dallime nga ajo në fshat. Në fshat njerëzit nuk kishin zgjidhje tjetër përveçse punës në kooperativat bujqësore dhe në dyqanet vendore mungonin shpesh mallrat. Shumë prej tyre treguan se nganjëherë nuk gjenin as bukë. Nëpër qytete, veçanërisht në Tiranë, oferta për vende pune ishte e shumëllojshme, gjithashtu ishin të disponueshme, edhe pse me kufizime, mallra të ndryshme. Arsyen tjetër për mosinteresimin e njerëzve për t'u regjistruar në fshat, nëpunësi i komunës e sheh në faktin që për shumë prej tyre temat e gjera shoqërore, të lidhura me "mirëqenien e përbashkët" nuk janë të rëndësishme. Në vend të kësaj i japin përparësi çështjeve që kanë të bëjnë me familjet e tyre apo me të afërmit e ngushtë. Sipas mendimit të tij kjo është pasojë e arsimit të tyre të ulët dhe e punës shumëvjeçare në kooperativat bujqësore. Njerëzit nuk e kuptojnë se mund të ndryshojnë çdo gjë thjesht me regjistrimin e vendbanimit në vendin ku jetojnë dhe me pjesëmarrjen në zgjedhjet lokale. "Bujqit e thjeshtë", sipas fjalëve të tij, nuk janë të aftë të angazhohen politikisht.

Një nga arsyt pse bashkia e Himarës/Himara nxit regjistrimin e ri të të kthyerve që janë me origjinë nga fshati, por që gjatë komunizmit u shpërngulën në zona të tjera të Shqipërisë dhe vitet e fundit janë kthyer në fshatin e lindjes, është përpjekja për rritjen e numrit zyrtar të banorëve duke rritur në këtë mënyrë numrin e votuesve në zgjedhjet shtetërore dhe lokale. Nga viti 1990 numri i popullatës është rritur vetëm pak, mbi të gjitha nga të ardhurit nga zonat e tjera të Shqipërisë. Shumica e brezit të ri të vendasve pas rënies së komunizmit ka emigruar në Greqi, kurse vendasit më të vjetër shpeshherë shprehin një ndjenjë braktisjeje dhe vetmie. Njëkohësisht janë të shqetësuar për numrin gjithnjë e më të madh të të ardhurve në fshat dhe kanë një ndjenjë sikur "komuniteti i





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

tyre do të shuhet". I shqetëson fakti se pronësia e tokave mund të kalojë në duart e të ardhurve nga zonat e tjera të Shqipërisë. Shpërngulja është gjithashtu edhe problem politik, pasi prej tyre nuk mund të presësh që të mbështesin politikanët lokalë dhe Partinë për të Drejtat e Njeriut<sup>41</sup> që mbështet minoritetin grek në Shqipëri.

Mënyrat e ndryshme të numërimit zyrtar të popullsisë në Dhërmi/ Drimades që përfshijnë disa njerëz dhe lënë jashtë të tjerët, tregojnë për faktin se si pikëpamjet e ndryshme statike formulojnë idetë mbi vende dhe njerëz të caktuar. Nga pikëpamja shtetërore, që merr parasysh numrin e banorëve faktikisht të regjistruar, zona e Himarës/Himara është subjekt shpopullimi, ndërsa nga pikëpamja e bashkësisë lokale është i qartë dallimi mes numrit të të regjistruarve dhe atyre që faktikisht jetojnë në këtë zonë, gjë që bashkia mundohet t'a përmirësojë me uljen e shpenzimeve të reregjistrimit. Sarah Green tregon se si llogaritjet statistike janë "rezultat i bisedimeve ku një këndvështrim se si duken gjërat e mund tjetrin" (Green 2005: 161).<sup>42</sup> Green vazhdon se "mënyra se si duken gjërat në llogaritjet statistike mund të ndikojë indirekt në atë se si gjërat janë faktikisht" (Green 2005: 161).

Mënyra të ndryshme të numërimit prodhojnë gjithashtu numra të ndryshëm të anëtarëve të minoritetit grek në Shqipëri, ku një pjesë e njerëzve përfshihen dhe të tjerët përjashtohen. Në përputhje me mendimin e elitës politike në pushtet (nga viti 2005 *Partia Demokratike e Shqipërisë* me prirje nga e djathta, dhe nga 2001 deri në 2005 *Partia Socialiste e Shqipërisë* me prirje nga e majta) të drejtat e minoritetit grek u njihen vetëm banorëve që jetojnë në zonat që në kohën e komunizmit kanë qenë të njohura zyrtarisht si pjesë të së ashtuquajturave "zona të minoritetit". Pas regjistrimit të popullsisë dhe të pasurisë nga Drejtoria e Statistikave në vitin 1989 (në vitin 1993 u riemërua Instituti i Statistikave INSTAT), zonat minoritare përfshinin 40 fshatra në zonën e Gjirokastrës, 35 fshatra në zonën e Sarandës, 16 fshatra në rrethin e Delvinës dhe 3 fshatra në rrethin e Përmetit (shiko *Minorities: Today and Tomorrow 2003: 11-12* dhe *Demographic Atlas of Albania 2003: 99*). Meqë regjistrimi i popullsisë u përfundua në kohën e komunizmit (katër vjet pas vdekjes së udhëheqësit Enver Hoxha, gjatë presidencës së Ramiz Alisë në vitet 1985-1995) përfshin vetëm numrin e atëhershëm të minoritarëve grekë. Në

41 Në vitin 2002 kandidati i Partisë për të Drejtat e Njeriut, Vasil Bollano, fitoi në zgjedhjet lokale në Himarë/Himara.

42 Green shton: "gjithmonë do të jenë në dispozicion versione të ndryshme, prandaj çdo gjë që tani duket si realitet i drejtë është e diskutueshme dhe mund të ndryshojë në një të ardhme të afërme" (ibid.). Në vazhdim thotë se statistikat përshkohen shpesh nga elemente jostatike që krijojnë pikëpamjet e kundërta ndaj realitetit (Green 2005: 162).





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

vitin 2001 regjistrimi u përsërit, por pa përfshirë pyetjen mbi përkatësinë kombëtare dhe fetare (shiko First Report Submitted by the Republic of Albania, Under Article 25, Paragraph 1, of the Council of Europe 2001). Statistikat zyrtare ndryshojnë shumë nga vlerësimet e organizatave greke (Kondis dhe Manda 1994: 16-18; Bos dhe UNPO Mission 1994: 1-2; Pettifier 2001: 5-6; Minorities: Today and Tomorrow 2003: 12, shiko edhe Green 2005: 170; de Rapper dhe Sintès 2006: 37). Kur në regjistrimin zyrtar të vitit 1989 në zonat minoritare u numëruan 58.758 banorë, organizata greke OMONIA i vlerësoi me 150.000-200.000 (Minorities: Today and Tomorrow 2003: 12, shiko edhe CIA Factbook). Arsyeja e dallimeve qëndron në faktin se Drejtoria Statistike e Republikës së Shqipërisë mori në konsideratë vetëm banorët grekëfolës që jetojnë në fshatrat e zonave minoritare, kurse vlerësimet e organizatave greke përfshijnë të gjithë ata njerëz që ishin deklaruar si besimtarë të fesë ortodokse (Pettifier 2001: 5-6; de Rapper dhe Sintès, 2006: 37).

## FAMILJET, LINJAT DHE KLANET

Organizimi farefisnor në fshat nuk është statik dhe i pandryshueshëm, ai ndryshon parreshtur në varësi të kontekstit shoqëror, kulturor, politik dhe ekonomik. Në kundërshtim me këtë pikëpamje, shumë nga vendasit ma prezantuan farefisnin e vet si një strukturë rreptësisht të përcaktuar, të cilin ia përshtasin jetës së tyre të përditshme, ashtu siç u duket e arsyeshme apo e dobishme.

Të dhënat e paraqitura të punës në terren bazohen në regjistrimin e popullatës që e bëra në 86 shtëpi të lagjes qendrore të Dhërmiut, në 5 familje të Gjilekut/Gjilekates, 9 të Kondraqit dhe 29 të Palasës. Kujtesa gjenealogjike e shumicës së vendasve arrin deri te paraardhësit e brezit të tretë dhe rrallë të katërt. Nga rrëfimet e tyre arrita të konstatoja se si e imagjinojnë vendasit sistemin e martesave dhe të trashëgimisë. Të paktën me njërin prej anëtarëve të çdo familjeje zhvillova biseda të gjata mbi jetën e të gjithë anëtarëve të tjerë, mbi udhëtimet dhe lëvizjet, vështirësitë dhe planet e tyre. Me disa prej tyre, veçanërisht me ata që lidha miqësi, bisedova shpesh herë. Bisedat zhvilloheshin në mënyrë spontane. Pavarësisht nga ato që tregonin për veten e tyre, në dymbëdhjetë muajt e qëndrimit tim në fshat u njoha me praktikat e tyre të përditshme. Shumë aktivitete të rëndësishme të tyre shumë herë fshiheshin në rutinën e përditshme. Kur largohesha për disa ditë nga fshati për në fshatin fqinj Palasë ose për në Vlorë, ku kam zhvilluar një pjesë të vogël të kërkimeve të mia, i kuptova si dallimet ashtu dhe ngjashmëritë e ritmit të përditshëm të këtyre vendeve.







## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

Literatura mbi sistemin farefisnor në Greqi është shumë e gjerë (p.sh. Campbell 1964; Peristiany 1965; du Boulay 1974; Herzefeld 1985; Iosifides 1991; Just 1991), kurse për studimet mbi farefisnisë në Shqipërinë e Jugut nuk është kështu. Shumë studiues të vjetër (p.sh. Durham 1909, 1928; Hasluck 1954; Whitaker 1976 dhe 1981) dhe të rinj (p.sh. Sotiri 2001; Rasha 2001; de Waal 2005) e kanë prekur tërthorazi këtë çështje. Durham, Hasluck dhe Whitaker kanë shkruar disi më shumë për farefisninë në Shqipërinë e Veriut, kurse autorët e tjerë nuk i kanë kushtuar vëmendje të madhe analizës së sistemeve të farefisnisë dhe/ose krahasimit të tyre me krahinave të ndryshme. Arsyeja kryesore për këtë është këndvështrimi i tyre i përbashkët se 45 vjet komunizëm me kolektivizimin e tokave, rritjen e kontrollit të lëvizjes së banorëve në zonat me popullatë greke, shtypjen e komuniteteve fetare, industrializimin e planifikuar dhe kultivimin e idesë së barazisë së shtetasve shqiptarë kanë shkaktuar ndryshimin apo humbjen në kujtesë të shumë formave të organizimit farefisnor (p.sh. *ikoyenia/familje, soi/fis, varka/çeta*).

### Ikoyenia apo familje

Në trajtimin e organizimit të farefisnisë në Dhërmi/Drimades mbështetem kryesisht në studimet etnografike të kryera në rajonet fqinje me të cilat banorët e fshatit kanë pasur kontakte të rregullta, bazuar në shkrimet historiografike dhe rrëfimet personale. Këto gjurmime janë kryer në Epirin e Veriut (Campbell 1964; Iosifides 1991), në Kretë (Herzfeld 1985), në Manin e brendshëm (Seremetakis 1991) dhe në disa pjesë të tjera të Greqisë (Just 1991). Organizimi farefisnor i Dhërmiut/Drimadesit është teorikisht më shumë i ngjashëm me atë të Manit të brendshëm, ku banorët ruajnë klasifikimin farefisnor me tendencë të forta të linjës atërore, ku linja e nënës vlen si lidhje më e dobët.

Nga bisedat me banorët del se njësia themelore e organizimit shoqëror në Dhërmi/Drimades është familja apo *ikoyenia*. Pyetja *Piounou eesai; e/i kujt je ti?* Është një nga pyetjet që fshatarët ua bëjnë shpesh të panjohurve, për të cilët mendojnë se janë nga fshati (për një përshkrim të njëjtë përshkrimin e fshatit në Epirin e Jugut shiko Iosifides 1991: 137; dhe për Rrëshenin në veri të Shqipërisë de Waal 2005: 99). Me këtë pyetje mundohen të verifikojnë se cilës *ikoyenia/familje* i përket një person dhe cila është pozita shoqërore, ekonomike dhe politike, që shpeshherë është e lidhur me familjen.

Kuptimi etimologjik i fjalës *ikoyenia* rrjedh nga fjala *ikos*, d.m.th. shtëpi apo amvisëri, dhe *yenia*, d.m.th. lindje, brez apo linjë farefisnie (Iosifides





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

1991: 137). Teorikisht në Dhërmi/Drimades kuptimi i fjalës *ikoyenia/familje* i referohet shtëpisë apo amvisërisë (*ikos* apo *spiti*) që mban emrin e fisit të babait (*yenia*). Në të kaluarën dhe rrallë edhe sot, fëmijët janë pjesë e *ikoyenia/familjes* së babait. Një familje e tillë tipike përfshin në vetvete çiftin, fëmijët e tyre, prindërit e burrit dhe fëmijët e pamartuar që jetojnë nën të njëjtën strehë dhe hanë bashkë vaktet që përgatiten nga gratë, si dhe të mirat materiale dhe paratë që sigurohen nga të gjithë anëtarët e punësuar të *spiti-t* (shtëpia apo amvisëria). Sot për shkak të migrimeve masive është *ikoyenia/familje* vetëm çifti i vjetër që jeton nën të njëjtën strehë. Çifti ha vaktet që i përgatit gruaja, të përbashkëta janë edhe paratë e pensioneve dhe ato që dërgojnë fëmijët emigrantë. Fëmija që dërgon paratë është zakonisht dhe trashëgimtari i ardhshëm i shtëpisë. Të paktën një herë në vit (në varësi të lejes së pushimeve të veta dhe të gruas) ai i viziton dhe kujdeset për prindërit në shumë aspekte. Nëse prindërit sëmuren, shkojnë për vizitë mjekësore te mjeku i tyre në Greqi dhe jetojnë përkohësisht te familja e djalit. Rrallë kujdesen për prindërit edhe djemtë e tjerë apo djemtë dhe vajzat që jetojnë në mërgim. Në këtë rast janë të gjithë trashëgimtarë të mundshëm të pasurisë së prindërve; parashikohet që njëri apo të gjithë të trashëgojnë shtëpinë, kurse një tjetri mund t'i caktohet si trashëgimi toka. Nëse çifti i vjetër nuk ka pasardhës po vetëm pasardhëse, atëherë pas vdekjes së tyre e trashëgon shtëpinë vajza që kujdeset për ta. Në këto raste çifti i vjetër zakonisht (por jo gjithmonë) konsideron pjesë të familjes së tyre *ikoyenia/familje* vetëm ata fëmijë që kujdesen për të. Por, meqë janë të vetëdijshëm se fëmijët e tyre do të jetojnë më mirë në mërgim në Greqi, tashmë është bërë e zakonshme që anëtarët e *ikoyenias/familjes* të jetojnë shpesh të ndarë, në vende të ndryshme.

Kuptimi i familjes varet nga konteksti dhe për këtë ai është "rrëshqitës" (Just 1991: 124). Në kuptimin e ngushtë nocioni i *koyenias/familjes* i referohet qartë anëtarëve të amvisërisë së përbashkët, që jetojnë në të njëjtën shtëpi (*spiti*). Por siç u tha, sot anëtarë të *koyenias/familjes* janë edhe atë që kanë jetuar dikur në të njëjtën amvisëri dhe që janë shpërngulur për mundësi më të mira ekonomike, por që nga pikëpamja financiare ende kujdesen për njëri-tjetrin. Kuptimi i familjes i "rrëshqet kufijve që përcaktojnë amvisërinë" (ibid.) Mashkulli i Dhërmiut/Drimadesit prindërit apo vëllezërit dhe motrat e tij nuk i sheh të ndarë nga familja vetëm pse nuk jetojnë fizikisht bashkë. Në praktikat e përditshme nocioni *ikoyenia/familje* përfshin lidhjen e gjakut të dyanëshme të një individi deri në brezin e tretë. Në vazhdim për të prezantuar ndryshueshmërinë e kuptimit të nocionit të *ikoyenias/familjes* do të përmend disa shembuj.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

Ksenofoni është i lindur në vitin 1935 dhe tërë jetën e ka kaluar në Dhërmi/Drimades. Në moshën 29-vjeçare u martua me Krisanthin, e lindur në Palasë. Pas martesës Krisanthi u shpërngul në shtëpinë e babait të Ksenofonit, ku jeton së bashku me burrin (*andras*) dhe prindërit e tij (*petherika*). Vëllai (*adelfos*) më i madh i Ksenofonit ka jetuar me gruan dhe fëmijët në Vlorë, kurse motra e tij (*adelfi*) me burrin, fëmijët dhe prindërit (*petherika*) kanë jetuar në fshatin fqinj. Në vitin 1985 Krisanthi lindi djalin e parë, tre vite më vonë vajzën Eleni. Pak kohë pas lindjes së Elenit vdiq babai (*pateras*) i Ksenofonit. Në vitin 1991 vëllai dhe motra me familjet e tyre emigruan në Greqi, kurse Ksenofoni, nëna e tij (*mitera/mana*), gruaja (*ghineka*) dhe fëmijët (*pedia*) qëndruan në fshat. Në vitin 1998 u shpërngulën në shtëpi të re, të cilën e ndërtuan pranë të vjetrës ku jeton nëna e Ksenofonit. Shtëpitë kanë oborr të përbashkët. Edhe pse jetojnë të ndarë, Krisanthi dhe Eleni kujdesen për nënën e sëmurë që ka nevojë për ndihmë. Ndihej edhe prindërit (*zgonis*) e Krisanthit, ose gjyshërit e Elenit (gjyshi *papus* dhe gjyshja *yaya*), që jetojnë vetëm në Palasë. Në vjeshtën e vitit 2005, kur u sëmur babai i Krisanthit, vëllai i saj me gruan dhe fëmijët u kthyen në Palasë për t'u kujdesur për të dy prindërit (figura 1). Pas vdekjes së babait shtëpinë do ta trashëgojë vëllai. Në janar të 2006 Eleni u martua me një bashkëfshatar dhe u shpërngul në *spiti-in* e tij në Greqi, ku tani jeton me burrin, vëllezërit dhe motrat e tij. Martesën e rregulluan Ksenofoni me babain e dhëndrit. Qëkur Eleni u shpërngul në Greqi, flet me prindërit në telefon të paktën një herë në javë. Në verë kthehet me burrin në fshat, ku kanë shtëpinë dhe prindërit e tij. Djali i Ksenofonit është beqar dhe jeton në një nga apartamentet që i jati ka ndërtuar në buzë detit për turizëm në vitin 1997. Ushqehet ende në shtëpi, bashkë me babain, nënën dhe gjyshen. Ksenofoni pret që të martohet sa më parë dhe të kujdeset për të dhe Krisanthin, ashtu siç kujdesen ata tani për nënën e tij.




Figura 1: Familja. Fjalët e shkruara drejtë janë emrat e lidhur me Ksenofonin, kurse ato *pjertas* janë të lidhura me Elenin.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

Xhaxhai i Ksenofonit, *thios* Vasilis (vëllai i babait të Ksenofonit), i lindur më 1928 në Dhërmi/Drimades dhe gruaja e tij Urania, gjithashtu e lindur këtu në vitin 1932, jetojnë sot vetëm në shtëpinë e re që e kanë ndërtuar së bashku me djalin, Vangjelin, i cili pas martesës emigroi në Greqi. Përveç Vangjelisit ata kanë edhe dy vajza që jetojnë në Greqi. Vasilis dhe Urania u kthyen në Dhërmi/Drimades në vitin 2002 dhe filluan të ndërtojnë shtëpinë. Para kësaj nga viti 1992 kanë jetuar në Greqi me djalin *yos*, gruan e tij *nifi* ("nusja") dhe fëmijët (*eghonia*).

Pas 10 vjetësh jetese të përbashkët në të njëjtën banesë në Athinë, ata vendosën të kthehen, ndërkohë që të tjerët qëndruan në Greqi. Vangjeli dhe gruaja e tij nuk kanë ndërmend të kthehen në Shqipëri, të paktën derisa të rriten fëmijët. Vasilis dhe Urania këtë e kuptojnë dhe e pranojnë, pasi jeta në fshatin e izoluar nuk do të kishte qenë e këndshme për ta. Ata bisedojnë në telefon të paktën dy herë në javë me familjen e Vangjelisit. Kur sëmuren marrin, me qira taksinë që udhëton mes fshatrave në periferinë e Himarës/Himara dhe Athinës të paktën dy herë në javë dhe shkojnë te djali për t'u vizituar te mjeku i tij. Gjatë qëndrimit në Greqi për ta kujdeset Vangjeli dhe gruaja e tij. Edhe pse Vasilis në përgjithësi e shikon Vangjelin, gruan dhe fëmijët e tij si pjesë të *ikoyenia/familjes* së përbashkët pasi ndan me ta pronësinë e shtëpisë dhe nganjëherë merr prej tyre edhe para shtesë për rregullimin e saj, i sheh gjithashtu pjesërisht si një familje të pavarur, me plane dhe dëshira të ndryshme për jetën, njësoj si ai në rini. Pyetjes se a pret që djali të kthehet, kur ai dhe gruaja e tij të mos jenë më në gjendje të jetojnë në mënyrë të pavarur, iu përgjigj se Vangjeli është pronar i shtëpisë dhe do të bëjë si t'i duket më mirë për veten dhe familjen e tij. Mbesat i vizitojnë gjyshërit sa herë që vijnë në Shqipëri. Para se të martoheshin Vasilis dhe Urania i trajtonin si pjesë të *ikoyenia/familjes* së tyre, kurse tani vajzat dhe nipërit i konsiderojnë pjesë të burrit (figura 2). Fëmijët e Vangjelisit dhe të motrave të tij teorikisht nuk duhet të martohen mes tyre sepse janë kushërinj dhe pjesë të së njëjtës *ikoyenia/familje*. Praktikisht ky rregull vazhdon edhe në brezin pasardhës duke përfshirë edhe nipërit e motrave dhe të vëllezërve.

Shembujt tregojnë se si kuptimi i *ikoyenia/familjes* ndryshon parreshtur. Nga njëra anë Vasilis e shikon familjen e djalit në Greqi si një *ikoyenia/familje* të pavarur, ndërsa kur bëhet fjalë për pronësinë dhe trashëgiminë e shtëpisë që e kanë ndërtuar bashkë, mendon për ta si pjesë e *ikoyenia/familjes* së tij. Mund të konkludohet se përkatësinë në një *ikoyenia/familje* e përcaktojnë vendi i banimit dhe pronësia e përbashkët.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ




Figura 2: Ndryshimet e kuptimit të familjes. Fjalët e shkruara drejtë i referohen Vasilisit, kurse të pjerrëtat nuses (*nifi*).

Ndryshe nga xhaxhai i tij Ksenofoni ka jetuar në fshat gjatë gjithë jetës. Bashkë me gruan jeton në shtëpinë e re të ndërtuar pranë së vjetrës, ku tani jeton nëna *mitera/mana* e Ksenofonit, kurse djali jeton në një apartament në bregdet. Edhe pse nuk jetojnë nën të njëjtën strehë, i hanë bashkë vaktet e përgatitura nga gruaja e Ksenofonit (*ghineka* ose *sizighos*, bashkëshortja), të përbashkëta janë edhe paratë që fitohen nga Ksenofoni, gruaja dhe djali i tyre. Këta individë Ksenofoni i konsideron pjesë të së njëjtës *ikoyenia/familje*. Deri para pak kohësh bënte pjesë edhe vajza (*kori*) e cila pas martesës mori mbiemrin e burrit (*andras* ose *sizighos*) dhe shkoi të jetonte me familjen e tij në Greqi. Eleni i ruan kontaktet me familjen e origjinës me telefon dhe me vizita të herëpashershme. Të njëjtat detyrime ka ndaj prindërve (*zgonis*) dhe vëllait edhe nëna e saj që ka marrë mbiemrin e *ikoyenia/familjes* Ksenofoni. Gjatë kohës që vëllai i Krisanthit qëndronte në Greqi kujdesej ajo për prindërit, shpeshherë e ndihmonte edhe vajza Eleni. Kur u sëmur babai vëllai i Krisanthit u kthye në fshatin e lindjes. Ai, gruaja e tij (*nifi* i Krisanthit) dhe fëmija e tyre (*nipi* i Krisanthit *anipsios*) konsiderohen tani të afërm të drejtpërdrejtë të burrit të Krisanthit dhe në kontekste të caktuara (p.sh. ndonjë martesë e padëshirueshme) kuptohen si *ikoyenia/familja* e zgjeruar e saj. Prandaj vajza e Krisanthit nuk duhet të martohet me kushëririn (*proto eksadelfos*), gjithashtu është e ndaluar martesë mes fëmijëve të Krisanthit dhe vëllait të saj.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

### Soi ose fisi

Kur fshatarët e Dhërmiut/Drimadesit flasin për grupet e familjeve të mëdha *ikoyenia/familja* që kanë të njëjtin mbiemër përdorin nocionin *soi/fisi*. Edhe pse këto fjalë përdoren si sinonime, studiuesit i përkufizojnë ndryshe. Campbell (1963 dhe 1964: 36-58) në punimin e tij për farefisninë në Greqi bazuar në shembullin e Sarakatsanit e përcakton *soi-* n si lidhje gjaku të dyanëshme. Njësoj e ka përcaktuar *soi-* n edhe du Boulay (1974: 144) që kishte bërë gjurmime në Ambeli. Në Glendi dhe Kretë, Herzefeld (1985) konstatoi se *soi* përdoret si sinonim për linjën atërore, ndërkohë që në Spartohori përcaktohet si atërore por duke përfshirë dy ose më shumë individë me të njëjtin mbiemër që nuk i njohin hollësitë e marrëdhënieve të tyre farefisnore (Just 1991: 121).

Ndërkohë që *soi* kuptimisht lidhet kryesisht me linjën atërore, *fisi* përcaktohet si klan i cili, sipas konstatimeve të de Waaloe (2005: 158, 210) të bazuara në gjurmimet në Mirditë në Shqipërinë e Veriut, përfshin *vllaznitë* me të njëjtin mbiemër. Shkrimtari vendas Spiro Rusha (2001: 119) përmend për Qeparonë *fisën* (vëllazërinë), kurse gjuhëtarja Natasha Sotiri (2001: 5) vëren se njerëzit në bisedat e përditshme flasin shpesh për *vëllazërinë* ose për *mëhallën* në kuptimin e *fisit*.

Nga bisedat me vendasit duket se në Dhërmi/Drimades *soin/fisin* e formojnë pasardhësit nga ana e babait që kanë paraardhës të përbashkët, mbiemër dhe “gjak të njëjtë” ose *ena ema*<sup>43</sup>, shpesh kanë edhe pronë tokësore, zakonisht pyje dhe kullota. Kuptimin e *soi/fisit* mund ta krahasojmë atëherë me kuptimin e *yenia-s* në Manin e Poshtëm që përfshin “të gjithë pasardhësit e linjës atërore me paraardhës të përbashkët dhe me lidhje gjaku tjetër apo fiktive që me proceset asimilatore janë përfshirë në linjën e trashëguesve” (Seremetakis 1991: 25).

Sipas regjistrimit tim të banorëve lokalë në qendrën e fshatit jetojnë 39 *soia* (sh.) ose *fise*. *Soi/fisi* më i madh përfshin tetë *ikoyenia/familje*<sup>44</sup> Për shkak të migrimeve është e pamundur që sot të caktohet me saktësi modeli i *soia/fiseve*. Çdo hierarki është pjesërisht e lidhur me numrin e

43 “Gjaku i njëjtë shpjegohet si nocion i lidhur me gjakun në dejet e të gjithë meshkujve të farefisit dhe fëmijëve të tyre në secilën linjë të anës së babait. Pikëpamjet për kuptimin e gjakut të femrës nuk janë njëta. Kur pyeta për kuptimin e gjakut dhe lidhjeve të tij me meshkujt dhe femrat, njëri prej vendasve më ofroi një shpjegim interesant. Më tha se është burri ai që i jep fëmijës “genet” dhe gjakun, ndërsa gruaja i jep vetëm gjakun e saj. Burri është ai që “krijon”, kurse gruaja ajo që “bart”.

44 Në fshatin qëndror të Dhërmiut/Drimades *soi/fisi* përfshin 8 *ikoyenia/familje*, një *soi/fisi* 4 *ikoyenia/familje*, 4 *soia/fise* kanë 3 *ikoyenia/familje*, 5 *soia/fise* kanë 5 *ikoyenia/familje* dhe 6 *soia/fise* kanë 2 *ikoyenia/familje*.






## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

familjeve që përbëjnë secilin *soi/fis*, por kapitali social i familjeve është më i rëndësishëm se sa numri i tyre.

Dikur anëtarët e secilit *soi/fis* në fshat jetonin bashkë, në lagje të veçanta. Një sistemim i tillë është i dukshëm edhe sot. Në shumë lagje të qendrës së Dhërmiut/Drimadesit dhe Gjilekut/Gjilekatesit qëndrojnë bashkë shtëpitë e të paktën tre *soia/fiseve* (në lagjen *Ag. Strongli* ose *Zhupa/Zhupej* gjenden shtëpitë e *soia/fiseve* Zhupa, Kuçulli dhe Dimitri; në lagjen *Vreto/Vretej* gjenden *soia/fiset* Vreto, Treko, Kumi, Leka, Ramo, Tavaj, Gjipopulli, Gjoni, Stramarko, Caci dhe Boi). Me rregull, shumica e shtëpive në lagje i takon një *soi/fisi*, po lagjja mund të mbajë një, dy apo tre emra: p.sh.emrin e *soi/fisit* (*Zhupa/Zhupej*) dhe emrin e kishës (*Ag. Strongli*); emrin e kishës (*Ag. Dimitris*) dhe shenjat karakteristike topografike (*Qendra*); emri mund të bazohet edhe vetëm në karakteristikat topografike të lagjes (*Rruga e Tashme*, ose *Katomerat*, i poshtëm, ose *Shanes*, lloj i veçantë bari).



Skica 1: Pjesë e lagjes *Zhupa/Zhupej* ose *Ag. Strongli* në Dhërmi/Drimades në vitin 2005. Numrat shënojnë *soi/fiset* e veçanta. Shenjat: 1. Zhupa; 2. Kuçulli; 3. Dimitri.

Gjatë viteve të fundit në fshat janë ndërtuar shumë shtëpi me ndihmën e parave apo të investimeve të emigrantëve.<sup>45</sup> Shumicën e tyre e kanë ndërtuar të kthyerit nga emigrimi, d.m.th. çiftet e vjetra të lindura mes viteve 1920 dhe 1940, që kanë jetuar për vite me rradhë në Greqi dhe pjesërisht emigrantët e lindur pas vitit 1945 që jetojnë ende në Greqi. Shtëpitë janë ndërtuar në rrethinat e abandonuara të fshatit. Në lagjen Allonja të fshatit qendror, që dikur ishte i abandonuar sot gjenden shumë shtëpi të reja që i kanë ndërtuar të kthyerit. Të njëjtë janë edhe Asfaqija dhe *Rruga e Tashme/Katomerat/Shanes* ku dikur gjendeshin vetëm fusha


<sup>45</sup> Këto lloj dërgesash materiale dhe në para si dhe investimet emigrantët në Greqi dhe gjetkë ua dërgojnë prindërve dhe të afërmeve të ngushtë (p.sh. vëllezërve dhe motrave) që kanë mbetur në Shqipëri.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

para se të ndërtoheshin disa shtëpi në vitet 70. Sot aty ka shumë shtëpi të reja (15 në Asfaqi, 8 në *Rruga e Tashme/Katomerat/Shanes*). Në dallim nga lagjet e vjetra në fshatin qendror (*Ag. Dimitri, Zhupades/Zhupej, ose Ag. Strongli, Gerzina, Vretades/Vretej*) ku shtëpitë e secilit fis qëndrojnë bashkë, shtëpitë në lagjet e reja gjenden të shpërndara dhe nuk e ndjekin modelin karakteristik të së kaluarës.



Skica 2: Pjesë e lagjes Asfaqi e Sipërme në Dhërmi/Drimades në vitin 2005, autor Marko Gjokopulli. Numrat shënojnë shtëpitë e banorëve që u përkasin *soia/fiseve* të veçanta. Shenjat: 1. Beli; 2. Kumi; 3. Dhrako; 4. Bixhili; 5. Stramarko; 6. Ramo; 7. Jorgji; 8. Vreto; 9. Dhima; 10. Gjoni; 11. Çulla; 12. Ruci.

### Çeta ose varka

Në Dhërmi/Drimades *soi/fisi* është pjesë e “konglomerateve” më të mëdha që quhen *çeta* ose *varka* dhe janë në nivel lokal të shpërndarë. Kuptimi i fjalëpërfjalshëm i *çetes* është njësi ushtarake, kurse *varka* është mjet lundrues. Kur pyeta për kuptimin e të dy nocioneve në fshat, disa fshatarë më ofruan një shpjegim të lidhur me gjuhën shqipe: *varka* shqiptohet saktë “barka” gjë që në shqip do të thotë varka. Të tjerë mendonin se varka i referohet shprehjes *barku*. Duke marrë parasysh shpjegimet e ndryshme është më e mundshme që shprehja *çeta/varka* t’i referohet klanit,<sup>46</sup> që

46 Në këtë punim kuptimi i shprehjes “klan” i përshtatet teorisë së pasardhësve; brenda saj përcaktohet si grup pasardhësish, i lidhur nga një paraardhës i përbashkët, anëtarët e të cilit nuk i njohin më lidhjet farefisnore me të (Seymour-Smith 1986: 38). Në veprën e tij *Fuqia e fshehtë e besës*, M. Berishaj përdor shprehjen “fis” në vend të “klanit” (Berishaj 2004: 23). Kuptimi i fisit këtu ndjek Kanunin e Skënderbeut (e drejta zakonore shqiptare) që vlen më tepër për Shqipërinë e Veriut (khs. Elsie 2001; de Waal 2005; Vickers 2001). Në Shqipërinë e Jugut, sidomos në zonën e Labërisë, vlejnë Kanuni i Labërisë (Elezi 2006) dhe Kanuni i Papa Zhulit (Backer 2003). Elezi thotë se në zonën e Himarës /Himara vlen Kanuni i Labërisë, kurse Jorgji zgjedh për këtë zonë Kanunin e Papa Zhulit (<http://himara.eu/dhermi/guide-al.html>). Në dallim nga Kanuni i Labërisë, që është botuar pak kohë më parë (2006), Kanuni i Papa Zhulit nuk është i shkruar. Për shkak të mungesës së përgjithshme të literaturës, mbështetem kryesisht te shprehjet dhe interpretimet vendase.







## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

emërtohet sipas paraardhësit të përbashkët për të cilin shumë prej vendasve nuk dinë më se si janë të lidhur me të. Shumica e fshatarëve e përshkruajnë *çetën/varkën* si një grup ekzogam.

### ÇETA/VARKA: MUÇUL KATES

T. JORGJI (mashkull, 2004)



F. ZAHO (mashkull, 2004)



P. DHIMA (mashkull, 2004)



J. SHKURTI (mashkull, 2005)



Z. BELI (femër, 2005)



LEJENDA:

○ ÇETA/VARKA

◌ FIS/SOI

Skica 3: Çeta/varka e Muçulkates. Madhësia e rrethit shënon numrin e *soia/fiseve* dhe madhësinë e *çetës/varkës*. Emrat brenda rrethëve i përkasin *soia/fiseve* të veçanta. Numrat në kllapa pranë emrave shënojnë rradhitjen e emrave të *soia/fiseve* të përmendura nga bashkëbiseduesit.

Në shumë raste shumë vendas nuk kujtohen as për emrin e *çetës/varkës* së vet. Nga 86 anëtarë të *ikoyenia/familjes* në fshatin qendror vetëm 40 prej tyre e dinin emrin e *çetës/varkës* së vet, kurse 41 prej tyre dinin të numëronin vetëm emrat e *soi/fisit* në *çetën/varkën* e vet pa ia ditur emrin asaj. Pesë prej tyre as që kishin dëgjuar ndonjëherë për këtë shprehje. Kur pyeta për emrat e *çetave/varkave* shpesh përmendeshin tetë emra: Muçulkates, Koknates ose Kokdedadtes ose Thodorkoknates, Buates, Draknates, Alades dhe Gjinknates. Kur disa prej vendasve mundoheshin t'a rradhishnin *soi/fisin* e vet në një *çetë/varkë* të caktuar, shpeshherë nuk binin dakord. E gjithë kjo tregon se kjo bashkësi nuk ka më rol të rëndësishëm në organizimin shoqëror të fshatit. Pohimi mbi rregullin ekzogamik të *çetës/varkës* është më tepër retorik, pasi shumë fshatarë as që e mbajnë mend emrin e *çetës/varkës* së vet ose emrin e *soit/fisit* që e përbën atë. Për këtë është e vështirë të verifikohet parimi i ekzogamisë në jetën e përditshme të fshatit.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

Në fshatrat e tjera të zonës së Himarës/Himara, si p.sh. në Palasë dhe Qeparo shprehja çeta nuk dëgjohet në bisedat e vendasve. Kur i pyeta vendasit e Palasës për *çetën/varkën*, shumica prej tyre nuk e njihte këtë shprehje, ndërkohë që katër prej 51 fshatarëve përmendën *çetën/varkën* e *soit/fisit* të vet. Disi më ndryshe ishte në Qeparo ku fshatarët përdornin fjalën *mëhalla* (nga turq. "lagje") në vend të fjalës *çeta/varka*. Sipas shpjegimeve të tyre kuptimi i *mëhallës* ngjan me kuptimin e *çetës/varkës*. Disa qeparotë më thanë se fjala *mëhalla* hyri në përdorim në kohët kur turqit u munduan t'i nënshtronin fshatrat në zonën e Himarës/Himara. *Soia/fise* të ndryshme që atëherë jetonin pranë u bashkuan dhe formuan një *mëhallë*.

Në skicën 3 janë emrat e *soia/fiseve* të veçanta që sipas rrëfimeve të vendasve bëjnë pjesë në *çetën/varkën* e Muçulkates (T.Jorgji, F. Zaho, P.Dhima, J. Shkurti dhe Z. Beli) përmenden numra të ndryshëm dhe pjesërisht emra të *soia/fiseve* të ndryshme. Të gjithë bashkë ishin dakord vetëm për dy emra, Muço dhe Beli. Pra fshatarët nuk janë të një mendjeje se cilët *soia/fise* formojnë *çetën/varkën*. Numrat në kllapa shënojnë rradhitjen sipas së cilës i përmendin *soiat/fiset*.

Mes emrave të parë përmendin emrat e *soit/fisit* të tyre, ndërkohë që të gjithë përmendën emrin e *soi/fisit* Beli, si dhe emrin Muço që në formë parashtese e përmban vetëm emri *çeta/varka*. T.Jorgji që përmendi gjashtë *soia/fise* dhe J. Shkurti që mbande mend katër, në fillim përmendën *soin/fisin* Muço, pastaj të vetin dhe të tretin *soin/fisin* Beli. F. Zaho u kujtua për shtatë *soia/fise*. I pari ishte i veti, i dyti Muço dhe i treti Beli. Edhe P. Dhima që numëroi pesë *soia/fise*, në fillim përmendi të vetin pastaj emrat Beli, Shkurti dhe Muço. Z. Beli numëroi tre *soia/fise*, në fillim të vetin pastaj Muço dhe Gjoka.

Shembujt e përmendur tregojnë se fshatarët e kanë harruar se cilët *soia/fise* formojnë secilën *çetë/varkë*. Gjatë 45 viteve të komunizmit kur u bë homogjenizimi i të gjithë shtetasve të Shqipërisë, disa nocione sociale dhe të farefisnisë u bënë më pak të rëndësishme për jetën sociale, politike dhe ekonomike të fshatarëve, prandaj dhe kategori të tilla si *çeta/varka* përdorshin rrallë në bisedat e përditshme.

### Martelat në fshat

Në të kaluarën, sidomos gjatë kohës së komunizmit, martelat në Dhërmi/Drimades ishin endogame, ndalimi i incestit vlente deri në brezin e dytë ose të tretë të të dyja farefisnive. Kur pyeta për marrëdhëniet endogame në fshat, njerëzit zakonisht më përgjigjeshin: *Papoutsia apo ton topo sou*





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

*kai as enai balomenos*,<sup>47</sup> “edhe pse të arnuara, këpucët e mia janë më të mira”, me këtë donin të thonin se është më mirë të martohesh me një nuse nga i njejti vend i dhëndrit (*apo ton topo*) edhe pse nuk është e “virgjër”. Martesa me të ashtuquajturën “virgjëreshë” ka qenë dikur zgjedhja më e mirë për prindërit e dhëndrit. Vendasit tregojnë se dikur nëna e dhëndrit pas natës së parë të martesës kontrollonte çarçafin për të parë gjakun që do të konfirmonte ndershmërinë e nuses. Për t’iu shmangur turpit, shpesh çiftet e reja përdornin gjakun e shpezëve apo të ndonjë kafshe tjetër. Atëherë mesazhi i kësaj frazeologjie është se prejardhja nga i njëjti vend i dhëndrit dhe i nuses si dhe besimi i tyre kristjan ortodoks janë për banorët e zonës së Himarës/Himara më të rëndësishme se ndershmëria e nuses.

Kur gjatë komunizmit u vu në zbatim kolektivizimi i pasurisë private dhe formimi i kooperativave bujqësore (në vitin 1957), shumë prej vendasve nuk e shihnin më të ardhmen e tyre në fshat, në punën e përbashkët. Shumë prej tyre u regjistruan në shkollën teknike në Vlorë, kurse disa prej tyre shkuan të studionin në universitet në Tiranë apo në Shkodër, pasi kjo ishte njëra nga mundësitë e rralla për t’u transferuar në qytet. Për shkak të këtyre shpërnguljeve numri i martesave në fshat.

Në ditët e sotme, kur të rinjtë shpërngulen gjithnjë e më shumë nga fshati për në Greqi dhe kur çështjet e pronës bëhen gjithnjë e më të rëndësishme, numri i martesave në fshat po rritet gjithnjë e më shumë. Shumë prej tyre lidhen në Greqi ku çiftet e reja vazhdojnë të jetojnë. Shumica e tyre nuk mendojnë të kthehen përgjithmonë në fshat pasi këtu nuk shohin ndonjë të ardhme për fëmijët e tyre. Mungojnë mundësitë e shkollimit dhe të punësimit, infrastruktura nuk është e zhvilluar, të përditshme janë reduktimet e ujit dhe të energjisë elektrike.

Teorikisht pas martesës gruaja bëhet pjesë e amvisërisë së familjes së burrit dhe merr mbiemrin e linjës së tij atërore. Vura re gjithashtu që në disa raste pas martesës ka pasur edhe burra që janë shpërngulur në shtëpinë apo në tokën e famijes së gruas (në 5 nga 86 *ikoyenia/familje*). Kur një grua është vendase dhe martohet brenda fshatit, në bisedat e përditshme i drejtohen me mbiemrin e vajzërisë. Edhe pse pas martesës merr mbiemrin e farefisit të burrit, fshatarët nuk e trajtojnë krejtësisht si të tillë. Edhe pjesëtarët e familjes së burrit e thërrasin atë gjatë gjithë jetës *nifi*, nuse, edhe kur bëhet me fëmijë. Ata thonë se vjen nga ana tjetër, *ali plevra*, dhe rrjedh nga një tjetër *ikoyenia/familje*. Siç u përmend edhe në lidhje me besimin fetar, pozita e saj është liminale dhe e paqartë, e ndarë mes grupit të saj farefisnor dhe atij të burrit. Në të kaluarën ishte krejtësisht e kuptueshme që ajo t’i nënshtrohej burrit, njerëzve të tij,

<sup>47</sup> Kjo shprehje frazeologjike njihet edhe gjetkë në Greqi (Herzefeld 2005: 232).





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

vjehrrës (*i pethera*) dhe grave të tjera në familjen e burrit (*kuniadha*). Në ato kohëra *nifi* nuk sillte pajë (*prika*) të pasur, por një arkë prej druri apo *kashela*, ku ruante disa veshje të sajat dhe shtresat për dhomën e gjumit (çarçafë, perde dhe nganjëherë dhe rrugica). Ka pasur edhe raste kur nusja ka sjellë në shtëpinë e burrit tokë dhe shtëpinë e babait të saj.

### Trashëgimia

#### Tote/Dikur

Shumica e martesave në fshat në të kaluarën ishin me ujdi, ku bihej dakord me bisedime paramartesore mes meshkujve të të dy *soia/fiseve*. Vendimet bazoheshin në dëshirën për të ruajtur pronësinë mbi tokën në fshat dhe të fesë kristjane në zonën ku jetohej. Toka dhe pasuritë e patundshme trashëgoheshin sipas parimit të ndarjes së pasurisë (nëse ishte një trashëgimtar trashëgonte të gjithë pasurinë, nëse ishin më shumë, njëri prej tyre trashëgonte shtëpinë, kurse të tjerët pjesë toke). Kullotat dhe pasuritë e vogla pyjore trashëgoheshin sipas parimit të pasurisë së pandashme (ato i takonin të gjithë anëtarëve meshkuj të *soi/fisit*). Sipas deklaratave të vendasve gratë në kohën e komunizmit nuk kanë mundur të trashëgojnë tokë, edhe në rastet kur s'kishte pasardhës mashkull. Në këto raste pasurinë e merrte kisha ose djali i vëllait të vdekur. Ka pasur edhe raste kur gruaja në shtëpinë e burrit ka sjellë në pajë tokë dhe shtëpinë e babait, nëse në familjen e saj nuk kishte djem ose kur prindërit e burrit kishin shumë pasardhës dha pak pasuri.

#### Sipas dispozitave ligjore

Në ditët e sotme vendasit në Dhërmi/Drimades dhe në fshatrat e tjerë të zonës së Himarës/Himara po përpiqen ta dekollektivizojnë tokën dhe pasuritë e tjera dhe t'i ndajnë ato me mirëkuptim krahinor. Me miratimin e Ligjit për tokën të vitit 1991 (Ligji nr. 7501 për tokat, 19. 7. 1991) u vendos që toka që në kohën e komunizmit ishte pronë e përbashkët dhe nën administrimin e kooperativave të ndahet në mënyrë të barabartë mes anëtarëve të kooperativave. Çdo ish anëtar i kooperativës merrte në këtë mënyrë pjesën e vet të tokës, për madhësinë e saj do të vendosej në bazë të tërësisë së madhësisë së tokës që ishte nën administrimin e secilës kooperativë. Në krahasim me shtetet post komuniste (Rumania, Bullgaria, Hungaria, Sllovenia, Çekia, dhe Sllovakia<sup>48</sup>) dekollektivizimi në Shqipëri nuk u zhvillua në mënyrë të tillë që toka t'i kthehej pronarëve të mëparshëm. Gjatë 500 vjetëve të pushtetit otoman në shumicën e zonave të Shqipërisë

<sup>48</sup> Shiko Hagedorn (2002: 7-8).





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

u forcua sistemi feudal ose *çifligu*<sup>49</sup>. Në disa zona, p.sh. në veri të Mirditës dhe në jug të Shqipërisë (Himarë/Himara, Sarandë, Delvinë, Gjirokastrë dhe pjesërisht Korçë) nëpërmjet pagesës së taksave u arrit të ruhet autonomia administrative dhe ajo fetare. Toka në zonën e Himarës/Himara mbeti në duart e disa pronarëve, kurse në vitin 1945 e mori pushteti komunist. Gjatë dhjetëvjeçarit 1960-1970, në kohën e transferimeve nga zonat rurale në ato urbane, shumë të rinj u shpërngulën nga fshati në kërkim të një jete më të mirë. Pas vitit 1990 shumë prej vendasve që në kohën e komunizmit kishin jetuar në kooperativë ose ishin transferuar nëpër qytete, emigruan në Greqi. Shumë prej tyre nuk u kthyen më kurrë.

Qeparo është i vetmi fshat në zonën e Himarës/Himara ku janë rrespektuar dispozitat e Ligjit për Tokën. Në fshatrat e tjera ky ligj u kuptua në mënyrë më "kreative" dhe toka iu kthye ish-pronarëve (Çakalli etj. 2006: 217-236). Kjo shkaktoi konflikte mes familjeve, *soia/fiseve* dhe në bashkësinë e fshatit. Një grup intelektualësh vendas (Çakalli, etj. 2006) kanë shkruar se ligji çoi në paradokse të vërteta.<sup>50</sup> Sipas dispozitave toka do të duhej të ndahej mes ish-anëtarëve të kooperativës. Nëse një gjë e tillë nuk do të ishte e mundur (p.sh. ngaqë përdoret për qëllime publike), do të duhej që anëtarëve t'u jepnin tokë me një vlerë të njëjtë.<sup>51</sup> Në praktikë kjo dispozitë shkaktoi parregullsi të ndryshme. Nëse një anëtar i kooperativës iu konfiskuan pasuri të ndryshme – shtëpi, fusha dhe kullota, ligji vendoste vetëm kthimin e shtëpisë dhe të kullotave, kurse fushat ia jepnin një anëtar tjetër të kooperativës (Çakalli et. 2006: 229-230). Për shkak të problemeve që shkaktoi zbatimi i ligjit qeveria miratoi Ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronësisë (Ligji nr. 9235), i cili shkaktoi pabarazi të mëtejshme.

Autorët e përmendur prezantuan tre shembuj me të cilët e hidhnin poshtë zbatueshmërinë e Ligjit nr. 9235, i cili nuk merrte parasysh se prej qindra vitesh në zonën e Himarës/Himara po ndodhnin shpërngulje të shumta si brenda territorit të vendit, ashtu dhe jashtë tij, se për shkak të politikës së shtimit të lindjeve numri i anëtarëve të kooperativave nga themelimi i tyre më 1957 u trefishua (de Waal 1996: 171), dhe se klasifikimi i llojeve të tokës (e punueshme, bregore, fushat e hapura, kullota) ndër vite

49 Në fillim të shekullit të 19 si pasuri tokësore vlen *çifligu* ose sistemi feudal i tokave që u zbatua nga administrata osmane. Shumica e popullatës ishin bujq që punonin ose për feudalët ose për insitucionet fetare, të cilat ishin pronarë të shumicës së tokave (Cungu dhe Swinnen 1999: 1).

50 Anomali të tilla si dhe pasojat e tyre i përmend edhe de Waal, që është marrë me studimin e çështjeve të pronave tokësore në Mirditë në Shqipërinë e Veriut (de Waal 1996: 169-192).

51 Kthimi i pronave pronarëve të mëparshëm bëhet në para ose në natyrë. Te kthimi në natyrë toka që ofrohet duhet të ketë të njëjtën vlerë si ajo që ka qenë konfiskuar.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

ka ndryshuar (Çakalli etj. 2006: 217-236). Për shkak të pasaktësisë së këtij ligji bashkësia lokale në bashkëpunim me intelektualët vendas vendosi ta çfuqizojë Ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronësisë (Ligji nr. 9235) dhe të vërë në zbatim marrëveshjen e arritur mes banorëve të zonës së Himarës/Himara.

### Kosta dhe Andrea: prezantimi i një prej shembujve

I ndjeri Kosta, i lindur në vitin 1885, u martua në fshatin Dhërmi/Drimades. Gruaja Marija (e lindur në vitin 1890) pas martesës u transferua në shtëpinë e tij. Ajo kishte vetëm një motër, Sofien (e lindur në vitin 1875), kurse vëllezër jo. Kosta dhe Marija patën tre fëmijë – dy djem (Lambro, lindur në vitin 1909 dhe Mihalisi në vitin 1911) dhe një vajzë (Eftihia, e lindur në vitin 1913). Marija u sëmurë shumë dhe Kosta harxhoi shumë para për ta shëruar; për këtë u detyrua t'ia shiste shtëpinë një bashkëfshatari dhe të shpërngulej në shtëpinë e babait të Marijes. Nga viti 1920 jetuan në të me motrën e Marijes, e cila u kthye në shtëpinë e babait pas vdekjes së të shoqit në vitin 1915. Pas tetë vjetësh Marija vdiq. Djali i parë i Kostës, Lambro, u martua me një vendase, Katerinën (lindur në vitin 1943) e cila erdhi të jetojë në shtëpinë e Kostës, e lënë në trashëgimi Lambrit dhe pasardhësve të tij. Lambro dhe gruaja u kujdesën për Kostën dhe Sofien deri në vdekjen e tyre. Edhe djali i dytë i Kostës, Mihailis, u martua në fshat dhe e ndërtoi shtëpinë në tokën e trashëguar nga Kosta që dikur i përkiste babait të tij. Sipas traditës së vendit vetëm vajza e Kostës nuk trashëgoi asgjë dhe pas martesës u shpërngul në shtëpinë e burrit dhe të familjes së tij.

Përveç shtëpisë së babait të Marijes që iu dha Lambrosit dhe tokës që iu dha Mihailisit, Kosta kishte në pronësi edhe 800 metra katrorë tokë të punueshme në afërsi të shtëpisë dhe 2000 metra katrorë tokë të papunueshme në breg të detit. Tokën e punueshme e trashëgoi Lambro, kurse tokën në breg të detit e trashëguan të dy djemtë. Pas luftës së dytë botërore pasuria tokësore e tyre u shtetëzua. Në vitin 1956 ajo kaloi në administrimin e kooperativës bujqësore. Lambro dhe Mihailisi u bënë anëtarë të kooperativës dhe punuan aty derisa vdiqën (Lambro në vitin 1980 dhe vëllai 13 vjet më pas).


Lambro pati tetë fëmijë, pesë djem dhe tri vajza. Pas vitit 1960 djemtë shkuan me studime në Tiranë, pas studimeve u punësuan në qytete të ndryshme të Shqipërisë: njëri qëndroi në Tiranë, dy shkuan në Përmet, një në Tepelenë dhe tjetri në Sarandë. Edhe pse jetonin jashtë fshatit të origjinës, tre prej vëllezërve u martuan me vajza nga Dhërmiu/Drimades. Dy të tjerët u martuan me vajza nga fshatra të tjera minoritare. Kosta, që trashëgoi emrin e gjyshit dhe jetonte në Tepelenë, u martua me një vajzë





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

nga një fshat në periferi të Gjirokastrës. Janis, që jetonte në Sarandë, e gjeti atje gruan e tij. Të trija vajzat e Lambricit u martuan me bashkëvendas dhe më pas, me përjashtim të së madhes, u transferuan në Tiranë.



Skica 4: Trungu familjar i Kostës dhe i Andreas

Mihailis pati katër djem dhe një vajzë. Njëri prej djemve i vdiq në moshën njëzetvjeçare. Të tjerët ndoqën djemtë e Lambricit dhe shkuan me studime: më i madhi në Tiranë, dy të tjerët në Vlorë. Vajza, fëmija më i vogël, u martua me një djalë nga fshati që studionte në Tiranë. Kur ai gjeti punë atje, u shpërngul dhe ajo. Edhe djali i Mihailisit që kishte studiuar në Tiranë gjeti punë po aty dhe u martua me një bashkëfshatare, e cila pas martesës u transferua tek ai në Tiranë. Dy djemtë e tjerë mbetën në Vlorë dhe u martuan me vajza muslimane.

Pas rënies së komunizmit të gjithë fëmijët e Lambricit dhe të Mihailisit (djemtë dhe vajzat) u shpërngulën në Athinë ku punuan si punëtorë fizikë. Vite më pas fëmijët e Mihailisit u kthyen njëri pas tjetrit në Shqipëri: Andrea u kthye në Dhërmi/Drimades, kurse dy vëllezërit dhe motra në Tiranë. Nga viti 2000 Andrea dhe gruaja janë vendosur në shtëpinë e babait të Andreas. Shtëpinë e ndajnë edhe me vëllezërit e tjerë, sa herë që ata vijnë me pushime në fshat. Kanë rënë dakord që shtëpinë ta ndajnë në dy pjesë. Njëra i takon Andreas dhe fëmijëve të tij, që janë ende beqarë dhe gjatë dimrit jetojnë në Greqi dhe çdo verë kthehen në fshat.





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

Pjesa tjetër e shtëpisë i takon vëllait të madh të Andreas. Vëllai i tretë ra dakord ta përdorë shtëpinë sa herë që vjen në fshat. Në vitin 2001 Andrea dhe djemtë e tij vendosën që në bregdet, në tokën që dikur i përkiste Mihailit dhe Lambrit, të ndërtonin një bar. Edhe pse gjatë procesit të dekollektivizimit kjo pjesë toke nuk iu kthye, Andrea vendosi gjithsesi ta realizonin planin e tyre.

Në vitin 2003 u kthye në fshat edhe Kosta, kushëriri i Andreas dhe djali i Lambrit. Ai u kthye me gruan Ariadne, më vonë erdhi edhe djali Arqileja (vajzat jetojnë në mërgim). Ata u vendosën në shtëpinë e Marijes që, sipas marrëveshjes mes pesë vëllezërve, i takon vëllait të madh Janisit. Meqë Janisi jeton në Greqi, e ka lejuar Kostën dhe familjen e tij të qëndrojnë në shtëpi derisa të ndërtojnë të tyren në tokën e punueshme (800 metra katrorë) që dikur i përkiste babait të tyre. Ndërkohë një ndër vëllezërit e tyre vdiq në Greqi, tjetri hoqi dorë nga pronësia, pasi emigroi me familjen në SHBA. Kur Kosta u kthye në fshat, kërkoi edhe gjysmën e 2000 kilometrave katrorë të tokës në breg të detit, ku kushëriri i tij kishte ndërtuar barin. Ashtu si Andrea edhe Kosta me Arqilenë dëshironin të ndërtonin një bar dhe të fitonin ndonjë para me turizëm. Andrea u detyrua ta shembte barin e tij dhe pak kohë më vonë ndërtoi një hotel të vogël në pjesën e tij të tokës. Për këtë Andrea dhe Kosta u zunë në fillim kur Kosta u kthye (2003) nga Greqia, kurse më vonë për shkak të ngjarjeve politike, lokale dhe të procesit të dekollektivizimit në 2005 u pajtuan përsëri. E kuptuan se ishte më mirë që moskuptimet të zgjidheshin brenda *soi/fisit*, sesa t'ia linin tokën shtetit dhe të mbeteshin pa asgjë.

Kosta dhe Andrea vendosën gjithashtu që të merreshin vesh me vëllezërit për t'ua kthyer atyre dëmshpërblimin nga fitimet e biznesit me turizëm. Në vitin 2005 i rregulluan dokumentet e pronësisë mbi tokat në bashkinë e Himarës/Himara. Nga ky aspekt pozita e tyre është e rregulluar mirë, edhe pse janë të vetëdijshëm që e ardhmja është e pasigurt. Ata mund të mbesin pa toka, nëse shteti do të vendosë t'ua kthejë dëmshpërblimet përfituesve të tjerë, apo nëse ndonjëri prej pasardhësve të vëllezërve të tyre do të vendosë të kërkojë pjesën e pronës së vet.

## PËRMBLEDHJE

Lëvizjet dhe ndryshimet e shumëllojshme mes vendeve dhe njerëzve, emrave të tyre, deklarimeve personale, gjuhëve, besimeve, vlerësimeve të popullatës, marrëdhënieve shoqërore dhe vazhdimësisë së sistemeve vërtiten rreth një vendi të vetëm – fshatit Dhërmi/Drimades.







## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

Këndvështrimet e ndryshme ndaj fshatit dhe përfytyrimet e tij shfaqen dhe jetojnë në kontakt të vazhdueshëm me ngjarjet shoqërore, politike dhe historike që i japin kuptim vendeve; këto nganjëherë janë konfliktuale dhe në kundërshtim me njëra – tjetrën, por edhe të lidhura mes tyre, nganjëherë humbin dhe janë të paqarta.

Shumë studiues (Lefebvre 1974; de Certeau 1984; Ingold 1993 dhe 2000; Gupta dhe Ferguson 2001; Green 2005), që kanë trajtuar proceset e paqëndrueshme të ndërtimit të hapësirës dhe të vendit, tërheqin vëmendjen se vendet dhe njerëzit janë dhe e vendosin njëri-tjetrin në marrëdhënie reciproke dinamike me vende dhe njerëz të tjerë. Por: “Në asnjë vend të botës njerëzit nuk janë vetëm në vendet e tyre; asnjëherë nuk i krijojnë vendet vetvetiu” (Green 2005:90). Historia e studimit të hapësirave ka treguar se një vendi nuk i jep kuptim homogjeniteti i tij, por tërësia e marrëdhënieve mes njerëzve dhe vendeve të ndryshme. Këtu u prezantua se fshati Dhërmi/Drimades formohet nga aspekte të ndryshme – zyrtare, lokale madje dhe antropologjike – që formojnë historitë e tij dhe të banorëve të tij. Në historitë e tyre kuptimet e Dhërmiut/Drimadesit rikrijohen dhe redistribuohen.

Historia e zonës së Himarës/Himara ka treguar se si madhësia e saj ka ndryshuar parreshtur ndër shekuj. Mes shekullit 15 dhe 18 kjo zonë përbëhej nga 50 fshatra, në mesin e shekullit 18 nga 16 fshatra dhe në shekullin 19 vetëm nga tetë fshatra. Përveç numrit të fshatrave ka ndryshuar dhe emri dhe numri i banorëve të tyre. Gjeomorfologjia e tij e afron pozitën e fshatit mes ultësirës bregdetare dhe vargmaleve, relativisht me një shkallë të lartë degradimi dhe erozioni të tokës. Ndër arsyet e tjera historike, shoqërore dhe politike kjo është një nga ato që ka shkaktuar shpërnguljet e vazhdueshme të njerëzve dhe vendeve.

Më pas vazhdon historia e ndryshimit të emrave, kuptimet e të cilëve sot përshkohen nga interesa të ndryshme kombëtare dhe lokale: pro greke, pro shqiptare dhe prolokale. Në përpjekjet e shumta për caktimin e emrit “të parë” të fshatit historiografët që mbështesin si interesat kombëtare, ashtu edhe ato lokale, bashkë me vendasit mbështesin idenë që “në origjinë” vendi i tyre i përkiste si Shqipërisë ashtu dhe Greqisë. Në thelb të dyja shpjegimet tregojnë për përjetimin e shtetit kombëtar si diçka “të natyrshme” dhe “autentike” dhe jo si produkt i shekullit 19.

Me emërtimet e ndryshme janë të lidhura edhe vetëpërcaktimet e atyre vendasve, që e kanë njërin prej prindërve me origjinë nga Dhërmiu/Drimades ose nga zona e Himarës/Himara. Perceptimet e ndryshme të faktit se kush është vendas (*horianos* ose ai që është “i vendit”), ose kush i përket vendit dhe kush jo, lindin në proceset përjashtuese, të





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

krijimit të "tjetrit" dhe të kufizimeve. Këto bazohen në marrëdhëniet e ndërsjella mes njerëzve dhe janë pjesë e proceseve të konfigurimeve të vazhdueshme dhe raporteve të forcës. Kështu dallimet mes Uranisë, Lukës dhe Spiros krijohen nga kontaktet e tyre të ndërsjella dhe në ndryshim të vazhdueshëm si dhe nga negociatat e tyre. Dallimet dhe krijimet e "tjetrit" janë nga njëra anë të theksuara dhe të prodhuara nga vetëpërcaktimet e njerëzve, kurse nga ana tjetër në jetën e përditshme të çdo individi janë larg dhe të parëndësishme. Behari dhe Ana p.sh. nga këndvështrimi i vendasve dhe i prodhimit të ndasive nga ana e tyre, perceptohen si "të ardhur", ndërkohë që në praktikat e përditshme pranohen si pjesë e jetës së fshatit.

Historia e gjuhës tregon se në këtë zonë gjatë shpërnguljeve mijëvjeçare të njerëzve dhe ndryshimit të pushteteve (fiset ilire dhe epirote, grekët antikë, romakët, bizantët, turqit, mbretëria e Zogut, Republika e Shqipërisë) janë folur gjuhë të ndryshme (kryesisht greqisht dhe shqip) në rrethana të ndryshme – në tregtinë përtej detit, në shkollë dhe në kishë, në shtëpi, etj. Duke marrë parasysh mendimin e historianit anglez Winnifrith (2002: 47- 48) është e vështirë të jepet një provë e vlefshme për gjuhën origjinale të Dhërmiut/Drimades dhe më gjerë në fshat. Pavarësisht nga kjo historiografët lokalë dhe vendorë, politikanët dhe banorët këmbëngulin te kërkimi i gjuhës "origjinale" duke përcaktuar hapësirën dhe përkatësinë e tyre.

Përveç gjuhës hapësirën e fshatit e përcaktojnë edhe praktikat fetare me kishat dhe kapelat e vogla. Më shumë se tridhjetë gjenden të shpërndara nëpër fshat dhe tregojnë gjurmët e së kaluarës dhe të së tashmes në fenë e banorëve fshatit. Me ndryshimet e sotme sociale (emigrimi i brezave të rinj të vendasve dhe shpërngulja në fshat e familjeve muslimane nga zona të tjera të Shqipërisë) dhe politike (kalimi nga komunizmi në demokraci) edhe feja bëhet përbërës i rëndësishëm në procese identifikuese.

Pikëpamjet e ndryshme për numrin e banorëve të Dhërmiut/Drimadesit dhe dallimet në numërimin e pakicës greke tregojnë se si përfytyrimet e vendeve dhe të njerëzve përcaktohen edhe politikisht dhe se si këto ndikojnë në këndvështrimet e realitetit të përditshëm. Përveç kategorizimeve individuale, në disa aspekte njerëzit dhe vendet mbeten të papërcaktuar ose "fashiten". E gjithë kjo shumicë këndvështrimesh për numrin e banorëve tregon se imazhet për njerëzit dhe vendet janë subjekt negociatash të vazhdueshme.

Shkrimet mbi familjet, lidhjet farefisnore dhe klanet flasin për kufizimet dhe marrëdhëniet mes asaj që njerëzit tregojnë dhe asaj se si veprojnë. Në kohët e ngjarjeve shoqërore, politike, ekonomike dhe historike, ardhjet





## 1. FSHATI DHE NJERËZIT E TIJ

dhe largimet e ndryshme kanë ndikuar në harrimin, rindërtimin dhe negocimin e gjenealogjive lokale. Rasti i Kostës dhe i Andreas tregon se si në rrethana të caktuara politike dhe ekonomike (qëllimet e shtetit që me ndarjen e tokave t'ua kthejë pronat përfituesve që s'janë me origjinë nga fshati), njerëzit që jetojnë në fshat ose që kthehen vazhdimisht në të krijojnë hapësirën e vet duke përcaktuar aty pronën dhe përkatësinë e vet.

Nëse deri tani në sfond kanë qenë paqëndrueshmëria, lëvizshmëria dhe gërshetimi i perspektivave që krijojnë hapësirën e Dhërmiut/Drimadesit, në vazhdim ato do të vendosen në një kontekst historik që e shpalos në mënyrë më të hollësishme "pozitën" shoqërore dhe vendin që zë Dhërmiu/Drimades në një kontekst më të gjerë.





2.

## HISTORI MOSPËRPUTHJESH

... bota njerëzore [është] një rezultat i shumëllojshëm, tërësi ngjarjesh dhe gjurmimesh të lidhura mes tyre që e shpërbëjnë tërësinë në copa të vogla pa mundur t'a riformojnë atë, duke deformuar të vërtetën. Koncepte të tilla siç janë "populli", "shoqëria" dhe "kultura" i emërtojnë këto copa, dhe në mënyrë të rrezikshme emrat mund të shndërrohen në sende. Vetëm po t'i konsiderojmë rrethanat si tërësi dhe t'i vendosim përsëri atje nga ku i kemi shkëputur, mund t'i shmangim përfundimet mashtruese dhe ta rrisim pjesën tonë të të kuptuarit. (Wolf 1998 [1982]: 23)

Me këto fjalë Eric Wolf komenton krijimin e nocioneve "të mëdha" (p.sh. Perëndimi, Evropa kristiane) si entitete të ndara dhe të pavarura. Shumë sociologë dhe humanistë veprojnë me emërtimet dhe konceptet sikur të ishin njësi homogjene dhe statike. Në këtë mënyrë i ndajnë nga entitetet e tjera, i vendosin në skema lineare zhvillimi, duke bërë që historia shpesh të bëhet histori mbi suksesin moral të secilit entitet. Modelin e botës e krijojnë si "një lloj bilardo botërore" në të cilën entitetet, ashtu si bilat e bilardos, rrotullohen rreth boshtit të tyre dhe përplasen me njëra-tjetrën (Wolf 1997: 28). Në vend të dallimeve që vihen në dukje nga studiuesit bashkëkohorë, do të kishte qenë mirë të studioheshin lidhjet dhe marrëdhëniet mes kulturave, shoqërive dhe historive. Tek e fundit këto "gjallojnë në të njëjtën botë", në të cilën kontaktet mes tyre si direkte, ashtu dhe indirekte, janë të pashmangshme. Shoqëritë, kulturat dhe historitë njerëzore nuk janë sisteme të mbyllyra, por janë tërësi marrëdhëniesh, që krijohen parreshtur, por dhe krijojnë rrjete të shumta marrëdhëniesh shoqërore.

Me rritjen e nacionalizmit në shekullin e 19 dhe të formimit të shteteve nacionale, në debatin evropian shoqëror, politik dhe shkencor u forcua ideja e kombit si "një entitet" i mbyllur dhe homogjen që bashkon individë me gjuhë, tradita dhe kulturë të njëjtë. Intelektualë të ndryshëm (historiografë, etnologë, letrarë, politologë dhe ekonomistë) me zhvillimin e shtypit kanë kryer një rol të rëndësishëm në procesin e homogjenizimit të së kaluarës (Anderson 1998: 54, khs. Kalčić 2006: 65-66). Shtetin kombëtar e trajtuan sikur të kishte ekzistuar prej kohësh.





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Hobsbawm (2002 [1983]: 7) ka theksuar se themelet e shtetit kombëtar janë të ndërtuara mbi riinterpretimet e historisë dhe traditën e imagjinuar. Historia i ka bazat në shkencë dhe në ideologjinë e shtetit kombëtar dhe pikërisht për këtë shpesh “legjitimon veprimet dhe krijon kohezion grupi” (Hobsbawm 2002: 12).

Herzfeld (1982) ka treguar se si studimet e para etnologjike në Greqi krijuan një kontinuitet kulturor për të kontribuar në forcimin e identitetit nacional. Kështu studiuesit dhe intelektualët e mëvonshëm u pajisën me “municion”, i nevojshëm për procesin politik të krijimit të kombit (Herzfeld 1982: 4-8). Më vonë Herzfeld u përqëndrua në çështjen se si vendasit në Rethymnu në Kretë e kuptojnë etnologjinë dhe historinë. Ai konstatoi se njerëzit e “konsumojnë” historinë, e ripërcaktojnë dhe i rikrijojnë kuptimet e ndryshme të saja (Herzfeld 1991: 12). Procesi i përpunimit dhe i rikrijimit i përfshin të gjitha historitë, si historiografinë zyrtare, ashtu dhe historinë e rrëfyer. Pra historitë rikrijohen, përcaktohen dhe mitizohen vazhdimisht. “Historitë përfshijnë historitë vetjake dhe ato shkatërruese si dhe ato që në një kuptim më të gjerë dhe të dukshëm janë hegjemoniste. Konfliktualiteti i tyre është i shkruar në hapësirën e abitatit të tyre” (1991: 13). Veçanërisht ai ka treguar se si e kaluara është shpesh konfliktuale dhe se njerëzit i përdorin imazhet e së kaluarës për ta vendosur (sërisht) dhe forcuar të tashmen. Nga ky aspekt të gjitha historitë janë të trilluara, njëkohësisht secila prej tyre përpiket të jetë “më autentike” se të tjerat. Për këtë Herzfeld debaton mbi historitë e shumëllojshme (“e shumëfishtë”) duke u bazuar te përvetësimi i “së vërtetës” që shpesh varet nga konfigurimi i raporteve të forcës (1991:55). Edhe Pamela Ballinger (2003) pohon se për të kuptuar historitë janë me rëndësi raportet e forcave. Historitë janë të ngujuara në proceset e parreshtura të riformimit të këtyre marrëdhënieve, ndryshojnë dhe rikrijohen në një mënyrë që nuk e ndjek parimin e raportit të qendrës me periferinë. Bazuar në punën e terrenit në krahinën e Giulias, Ballinger arriti në përfundimin se transformimi dhe rikrijimi i historisë krijojnë të ashtuquajturin “terren i prodhimit historik”, ku në rrethana të caktuara shoqërore, politike dhe historike kuptimi i një konfigurimi mbizotëron tjetrin duke i nënshtruar perceptimet e ndryshme të një vendi (2003: 45). Me rëndësi është që ngjarjet e së kaluarës të mos bazohen vetëm në historinë e trilluar por edhe në fakte konkrete (2003: 26). Të kaluarën e përbëjnë trupat e vdekur, numërimi i popullatës, monumentet, ditaret, zbulimet arkeologjike dhe artefaktet e tjera që përbëjnë shpesh bazën materiale për argumentimin e “vazhdimësisë” dhe “autoktonisë”. Nganjëherë zbulimet materiale shprehin edhe historitë e mospërputhjeve





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

dhe të konflikteve që janë pjesë e rrëfimeve historike dhe të prirjeve politike për "pastërtinë" ose/dhe homogjenitetin (po aty).

Prirjet për "pastërtinë" ose/dhe homogjenitetin janë pjesë përbërëse edhe e historiografisë shqiptare. Ideja e "pastërtisë" së popullit shqiptar dhe për rrjedhojë i kombit u përhap në kohën e komunizmit. Në përputhje më këtë historiografët, kryesisht historiografët vendorë, i dhanë përparësi historisë kombëtare dhe jo atë asaj botërore (Schwandner-Sievers 2002: 14). Projekti totalitar i një historiografie të tillë ka krijuar shumë mite mbi vazhdimësinë, barazinë dhe veçantinë e shtetasve shqiptarë. Çdo lloj kundërshtimi që i bëhej këtij miti konsiderohej si "urrejtje ndaj popullit". Pra historiografitë kombëtare, përfshirë dhe atë shqiptare, shpesh bazohen në historitë mitike<sup>52</sup> (Schwandner-Sievers 2002: 12-20), të cilat për të afirmuar autoritetin dhe forcën e politikës së shtetit mundohen të krijojnë imazhin e një të kaluarë, e një të tashmeje dhe të ardhmeje ideale. Historitë mitike i lidhin njerëzit emocionalisht në grupe dhe u japin atyre ndjesinë e kënaqësisë morale, të krenarisë dhe përkatësisë. Historitë mitike janë të rëndësishme në procesin e krijimit, demonizimit dhe përjashtimit të të tjerëve (Schwandner-Sievers 2002: 20; Kalčić 2006: 66).

Pas rënies së komunizmit, në të ashtuquajturën periudhë "tranzicioni", historitë mitike, rrëfimet dhe kujtimet e harruara bëhen sërish të rëndësishme. Një histori mitike shpërbëhet gradualisht në shumë histori mitike dhe secila prej tyre në mënyrën e saj dëshmon për vazhdimësinë, homogjenitetin dhe veçantinë e njerëzve të caktuar në vende të caktuara. Histori mitike të shumëllojshme janë bërë të kontestueshme dhe dallimet mes historisë "gojore" dhe të shkruar janë bërë kalimtare. Sot, në morinë e historive mitike, në rrethana të caktuara marrin kuptim zgjedhjet e disa miteve të caktuara. Njerëzit ndjekin "logjikën" e vet të të kuptuarit të së kaluarës, e cila dallon nga ajo e të "tjerëve" duke krijuar identitetin e vet të rëndësishëm dhe esencial (Schwandner-Sievers 2002: 17).

Në çdo histori mitike gjendet një "e vërtetë" (Schwandner-Sievers 2002: 12). Në dallim me "historiografinë e paanëshme", historiografia nacionale shpeshherë e njëanëshme përdor teknika të veçanta narrative, p.sh. metafora dhe "trope ironike". Historitë mitike krijojnë harta historike dhe politike të mbryjtura me interesa politike dhe ekonomike, veçanërisht me imazhe të ndryshme mbi shtetin nacional; këto prezantohen në

52 Gingrich (1998: 110) e konsideron historinë mitike si njërin prej varianteve të interpretimit të historisë, që e thjeshtëzon ndërlikimin e ndërveprimeve historike në "një rrëfim njëdimensional". Me që përpiqen të afirmojnë një interes të caktuar, historitë mitike i kundërshtojnë në mënyrë sistematike të gjitha interpretimet e tjera të mundëshme të së kaluarës.





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

veprat e historiografëve kombëtarë dhe intelektualëve të tjerë. Shumë prej tyre harrojnë, apo me qëllim nuk e marrin parasysh, faktin se shtetet kombëtare janë produkt i shekullit të 19, kur ende nuk ekzistonin kufijtë shtetërorë. Para shekullit të 19 njerëzit dhe vendet ndaheshin dhe rradhiteshin me një lloj tjetër pushteti administrativ, që nuk bazohej në sistemin e pasaportave, vizave dhe dokumenteve të tjera të nevojshme për kalimin e kufirit.

Për këtë arsye po vazhdoj me përshkrimin dhe ndarjen e njerëzve dhe vendeve para krijimit të shtetit kombëtar shqiptar. Në shekullin e 18 fuqia e regjimit osman filloi të dobësohej dhe kudo në Evropën Perëndimore u shfaq dhe u përhap vetëdija e rilindjes së popujve. Mbështetje për interpretimet e ndryshme të ngjarjeve, heronjve dhe situatave të së kaluarës do të jenë veprat e historiografëve dhe studiuesve të njërit prej fshatrave të Himarës/Himara dhe gjetkë në Shqipëri. Merren në konsideratë ato burime dhe shkrime të cilave u referohen bashkëbiseduesit e mi gjatë kohës së gjurmimeve të mia në vend, ose që kanë qenë në atë kohë subjekt debatesh dhe polemikash shkencore dhe mediatike. Rrallë (p.sh. Frashëri 2005) historiografët dhe studiues të tjerë që mbrojnë interesat kombëtare ose pro shqiptare, apo lokale, i marrin në konsideratë edhe veprat e studiuesve grekë. Qëllim i këtij punimi nuk është analiza e të gjithë historiografisë mbi Himarën/Himara, por analiza dhe prezantimi i historiografive kundërshtarë (njëkohësisht të ngjashme) që janë të njohura edhe për vendasit e Himarës/Himara; për këtë dhe nuk përmenden në mënyrë të veçantë veprat e historiografëve grekë. Merren parasysh sidomos ato tema që në jetën e përditshme janë "legjitime" dhe "rilevante" për bashkëbiseduesit nga Dhërmiu/Drimades dhe nga fshatrat e tjera të Himarës/Himara.

### NDARJA E NJERËZVE DHE E VENDEVE

Nga nevoja për t'i kontrolluar, administrata osmane i ndau njerëzit dhe vendet në Shqipëri dhe gjetkë në Evropën Juglindore në njësi të veçanta administrative dhe organizative, të ashtuquajturat milete, në bazë të përkatësisë fetare (Glenny 2000: 71, 91-93, 112, 115; Mazower 2000: 59-60; Duijzings 2002: 60). Në këtë mënyrë besimtarët e feve të ndryshme ishin të ndarë në muslimanë, ortodoksë, armenë (këtu bënin pjesë edhe katolikët) dhe komuniteti çifut ose në millet. Ndërkohë që muslimanët dhe ata që e pranuan më vonë fenë islame u përjashtuan nga pagesa e taksave, besimtarët e feve të tjera ishin të detyruar t'i paguanin ato. Pikërisht kjo nxitë shumë ortodoksë në Shqipëri që të konvertoheshin "zyrtarisht" në





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

fenë islame, ndërkohë që në jetën e përditshme i ruajtën pjesërisht traditat kristjane (Mazower 2000: 64-80).

Disa (Glenny 2000: 71; Blumi 2002: 49; Duijzings 2002: 60) mendojnë se sistemi i milletit ka qenë themeli për formimin e shteteve të mëvonshme nacionale, të tjerë (Todorova 1997:121-127; 163; Mazower 2000: 63; Green 2005: 147) panë në bashkësitë e ndryshme të milletit vetëm njërën nga mënyrat e ndarjes administrative dhe të organizimit të vendeve dhe njerëzve. Sipas mendimit të Greenit këto mënyra ndarjeje ishin të papërshtatshme për transformimin e tyre në shtete nacionale (Green 2005: 147).

Në bashkësitë e mileteve administrata osmane bënte dallime mes popullatës muslimane dhe jomuslimane (këta i thërrisnin me përbuzje kaur, apo i pafe, apo urrejtës fetarë), mes grekëve ose të pafeve, ose kristjanëve dhe turqve, ose fetarëve apo të konvertuarve. Në gjysmën e parë të shekullit të 19 shprehjet "turk" dhe "grek" më shumë se përkatësinë etnike shënonin përkatësinë fetare. Kjo e fundit nuk i ndante njerëzit nga gjuha, vendi i banimit ose ngjyra e lëkurës (po aty).

Miletet administroheshin nga patriarkët ortodoksë të emëruar në oborrin e sulltanit. Me urdhërin e oborrit mblidhnin taksat dhe gëzonin të drejtën e shoqërimit nga ushtarët turq (Mazower 2000: 60). Në fund të shekullit 18 dhe në fillim të shekullit 19 familje të pasura dhe të arsimuara ortodokse kishin pozita të shquara në administratën osmane në Konstandinopojë, që njiheshin me emrin fanarioti. Fanariotë të shumtë të arsimuar shërbyen në administratën osmane si dragomanë (përkthyes) (Mazower 2000: 61). Fanariotët prezantoheshin si grekë, që atëherë nuk shënonte popullin, por pasurinë, emrin e mirë dhe pozitën e shquar në oborrin osman (po aty). Në dallim nga fanariotët e shquar ortodoksët e tjerë, veçanërisht në Konstandinopojë, ishin të etiketuar si raja (turmë) ose kaur/kaurin, duke i ndarë në këtë mënyrë nga bijtë besimtarë të sulltanit (Jezernik 1998: 180, 182; Mazower 2000: 60; Glenny 2000: 664).

Ndasitë fetare ishin të rëndësishme për administratën osmane, ndërkohë që në jetën e përditshme ndarje të tilla nuk ishin thelbësore (Mazower 2000: 71-74). Për shkak të shtrirjes së rrjetit të shpërnguljeve, udhëtimeve dhe tregtimeve në njësitë ose vilajetet e veçanta administrative, politike dhe demografike, p.sh. në Janinë<sup>53</sup>, përkatësia

53 Në gjysmën e dytë të shekullit të 19 territori i Shqipërisë së sotme ishte i ndarë në katër vilajete: Kosova përfshinte një pjesë të Kosovës së sotme Jugore dhe Shqipërinë Verilindore, Janina shtrihej dikur në të ashtuquajturin Epiri i Veriut, Manastiri që përfshinte një pjesë të Maqedonisë së sotme dhe të Shqipërisë Juglindore, Shkodra që përfshinte pjesën Veriperëndimore të Shqipërisë dhe pjesën jugore të Malit të Zi (Blumi 2002: 49).







## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

vendore ose çështja “nga vjen” ose “nga e ka origjinën” një person nuk ishin thelbësore. Sistemi osman, si një tërësi mënyrash të ndryshme administrimi që ndryshonin gjatë shekujve, bazohej disi në një ndarje tjetër të njerëzve dhe vendeve në krahasim me sistemet e shteteve të bazuara në konceptin e kombit disa dhjetëra vjet më vonë.

Me formimin e shteteve kombëtare në shekullin e 19 gjuha, territori dhe grupet etnonacionale u bënë argumente thelbësore për zgjerimin e idesë së kombit, homogjenitetit dhe unitetit të një grupi të caktuar njerëzish në një vend të caktuar. Deri në fund të shekullit 19 intelektualët që jetonin në mërgim për arsye politike dhe ekonomike, si në Konstandinopojë, Rumani, Bullgari, Egjipt, Greqi dhe Amerikë patën një rol të rëndësishëm për vendosjen dhe afirmimin e shtetit kombëtar (Jacques 1995 [1908]: 287; Malcom 2002: 72).

Në vitin 1878 përfaqësuesit shqiptarë të Lidhjes së Prizrenit<sup>54</sup> Abdyl Frashëri dhe Mehmed Ali Vrioni në Kongresin e Berlinit<sup>55</sup> propozuan themelimin e shtetit shqiptar. Propozimi u refuzua me komentin e Bismarkut se “pa gjuhë të shkruar një popull nuk mund të ekzistojë” (Grameno 1925: 58 dhe Jacques 1995: 257). Këtë gjë vëllezërit Frashëri (Abdyl, Sami dhe Naim)<sup>56</sup> e morrën si shumë serioze dhe filluan përhapjen e gjuhës shqipe në shtyp dhe në shkolla. Frashëri dhe intelektualët e tjerë

---

54 Më 10 qershor 1878 nën drejtimin e Abdyl Frashërit në Prizren u takuan 300 delegatë që biseduan për themelimin e shtetit kombëtar shqiptar; duhej të bazohej në autonominë dhe afirmimin e shqipes si gjuhë zyrtare dhe të krijimit të ushtrisë shtetërore. Ky propozim u paraqit në Kongresin e Berlinit më 13 qershor 1878 (Jacques 1995: 256-257).

55 Kongresi i Berlinit u zhvillua në një kohë kur Evropa po përshkohej nga Pranvera e Kombeve. Më 13 qershor 1878 u takuan përfaqësuesit “e fuqive të mëdha evropiane” të kryesuar nga Bismarku, kryesministri prusian në vitet 1862-1890. Ata diskutuan për kufizimin e ndikimit të ushtrisë ruse në ngjarjet politike të Evropës Jugore dhe shpalljen e pavarësisë së Serbisë, Malit të Zi dhe Rumanisë. Kërkesa e Abdyl Frashërit dhe Ahmet Ali Vrionit për shpalljen e shtetit shqiptar u refuzua (Jacques 1995:257).

56 Abdyl ishte politikan i shquar, Samiu gjuhëtar dhe drejtor i revistët Drita, që botohej në Turqi nga viti 1884, Naim Frashëri ishte poet dhe përfaqësues i bektashizmit (Jacques 1995:290; Winnifrieth 2002: 122-123). Sot poezitë e Naimit trajtohen në tekstet e shkollave fillore (p.sh. vjersha *Shqipëri, o jetëgjatë* është e botuar në faqen e parë të librit të leximit për klasën e katërt, *Leximi 4* [Osmani etj. 2003]).





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

(Fan Noli<sup>57</sup>, Faik Konica, Konstantin Çerkezi dhe Kristo Dako<sup>58</sup>) që jetonin në mërgim, vendosën ta zhvillonin dhe afirmonin gjuhën shqipe si gjuhën e Republikës së pavarur të Shqipërisë (Pollo dhe Puto 1981: 118-121; Jacques 1995: 258; Winnifrith 2002: 122-123; Malcom 2002: 71). Më 28 nëntor 1912 Ismail Qemali shpalli pavarësinë e Republikës së Shqipërisë në qytetin e tij të lindjes, Vlorë. Meqë shpallja u bë në kohën e Luftës së parë Ballkanike (1912), meqë regjimi turk zotëronte ende Janinën në Jug dhe Shkodrën në Veri dhe nga që nisën revoltat e fshatarëve në krahinën e Himarës/Himara (këmbëngulnin për bashkimin me Greqinë), njohja e pavarësisë së Republikës së Shqipërisë nga “fuqitë e mëdha” në takimin e Londrës zgjati një vit (Winnifrith 2002: 129). Kufijtë e sotëm shqiptarë u njohën pas nënshkrimit të marrëveshjes në Firence në dhjetor të 1913. Konfirmimi i kufijve shkaktoi fërkime të shumta mes Shqipërisë dhe shteteve fqinje.

Në ndarjen e njerëzve dhe të vendeve fuqitë e mëdha nuk morrën parasysh se “kush” ishin këta njerëz. Ata ndaheshin sipas vendit ku jetonin. Përkatësia e tyre caktohej me territorin e kufizuar nga kufijtë nacionalë (Green 2005: 149). Green shpjegon se ndarjet e njerëzve dhe të vendeve u bënë në mënyra të ndryshme: “logjika nacionale bazohej në mbivendosjen e njerëzve dhe të vendeve të tyre, duke lëvizur kufijtë, njerëzit ose duke i vrarë ata, duke ndryshuar emërtimet e tyre dhe të gjuhëve të tyre” (po aty). Si luftëtarë të pavarësisë, fuqitë e mëdha përhapën idenë e kombit “si e vërtetë evidente dhe autentike mbi njerëzit që duhet ta drejtojnë dhe ndërtojnë të ardhmen e përbashkët në mënyrë korrekte dhe morale” (Green 2005: 149-150).

---

57 Fan Noli (1882-1956) lindi në afërsi të Adrianopolit në Turqi. Prindërit ishin nga Shqipëria (Jacques 1995: 304). Më 24 qershor 1924 peshkopi Noli u emërua kryeministër i qeverisë shqiptare. Me kthimin e Zogut nga Jugosllavia, qeveria demokratike e Nolit u rrëzua. Winnifrith pohon se për shkak të mungesës së dokumenteve historike është e vështirë të flitet për qëndrimin e popullatës ndaj qeverisë së tij (Winnifrith 2002: 134). Misionari evangjelist amerikan Jacques mendon se mënyra e qeverisjes së Nolit me idetë e tij demokratike ishte tepër radikale për atë kohë. Për ç’rrenjosjen e feudalizmit ai propozoi reformën agrare dhe zvogëlimin e burokracisë. Më 26 dhjetor 1924 pas përmbysjes së qeverisë së Zogut u arratis në Itali dhe nga atje në Gjermani ku jetoi deri në vitin 1932. Sot te shqiptarët konsiderohet si nismëtari i përhapjes së gjuhës shqipe. Gjatë qëndrimit në Gjermani shkroi shumë vepra në gjuhën shqipe, i njohur është edhe për përkthimet e tij në gjuhën shqipe. Në vitin 1932 u kthye në Boston ku filloi botimin e revistës *Republika* (Jacques 1995: 380-381; Winnifrith 2002: 134-135).

58 Përveç vëllezërve Frashëri dhe Fan Nolit në përhapjen e ndërgjegjes kombëtare patën një rol të rëndësishëm edhe Faik Konica dhe Konstandin Çerkezi. Të dy intelektualët jetonin në SHBA, ku ishin diplomuar në Harvard, dhe pjesën më të madhe të jetës e kanë kaluar në Boston (Malcom 2002: 71). Aty jetonte edhe Kristo Dako, redaktori i revistës *Vatra* (Shoqata mbarëshqiptare në Amerikë) dhe Dielli, botimi i të cilave kishte nisur në vitin 1913.





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Në mars të vitit 1914 me zgjerimin e Luftës së Parë Botërore partia pro greke, që mbizotëronte në jug të Shqipërisë, shpalli autonominë e Epirit. Kjo u konfirmua edhe nga kongresi i fuqive të mëdha që u mbledh në maj të 1914 në Korfuz të Greqisë. Ngjarjet politike në vijim që çuan në Luftën e Parë Botërore, bënë që qeveria autonome të përmbysej që vitin e parë (Papadakis 1958).

Si pasojë e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, njerëzit dhe vendet vazhdonin të ndaheshin sipas shteteve kombëtare, të para si njësi të veçanta duke shkaktuar ndarjen e gjuhëve, territoreve dhe kombësive. Pas Luftës së Dytë Botërore dhe forcimit të komunizmit ndërgjegjia kombëtare u bë thelbësore. Në procesin e zgjerimit të planifikuar të ideologjisë komuniste, të hartuar nga Enver Hoxha, në qendër të vëmendjes ishin historia, arkeologjia, gjuha, "kultura" dhe "traditat" shqiptare. Për t'i kontrolluar shtetasit, Hoxha e kufizoi lëvizjen brenda shtetit dhe e ndaloi lëvizjen përtej kufirit shtetëror; kështu, kufizimi i lëvizjes dhe i marrëdhënieve politike dhe ekonomike ndërkombëtare u bënë pjesë përbërëse e strategjisë për përhapjen e idesë së homogjenitetit, të unitetit të shtetasve të Republikës së Shqipërisë.

Në vitin 1950 Enver Hoxha e shpalli si fakt historik zyrtar tezën shkencore se shqiptarët janë pasardhësit e ilirëve (Lubonja 2002: 96), duke përhapur idenë se shqiptarët janë "civilizimi i parë" në Evropën Jugore, që ka banuar "gjithmonë" në territorin e sotëm të Republikës së Shqipërisë. Në këtë mënyrë e fshiu dallimin midis të kaluarës dhe të tashmes (Malcom 2002: 79). Theksonte heroizmin e partizanëve duke e krahasuar me heroizmin e Skënderbeut që u bë heroi kombëtar, luftëtar i shquar kundër ushtrisë osmane. Përveç Skënderbeut famën e heroit kombëtar e gëzonte dhe vetë Enver Hoxha (Lubonja 2002: 96). Me shpalljen e Shqipërisë në vitin 1967 si shtetin e vetëm ateist përhapu idenë e pavarësisë fetare të shtetasve të Shqipërisë.

Për të kontrolluar zonat me popullatë minoritare pas vitit 1945 shpalli të ashtuquajturat *zona minoritare*. Ato përfshinin 99 fshatra në krahinën e Gjirokastrës, Sarandës dhe Delvinës (po aty). Këtu nuk bënë pjesë fshatrat në të cilat jetonin popullatat shqipfolëse dhe greqishtfolëse. Pati fshatra në rrethin e Vlorës dhe në bashkinë e Himarës/Himara ku me direktivat e Enver Hoxhës u ndërpre përdorimi i greqishtes nëpër shkolla dhe gjetkë në jetën publike (Kondis dhe Manda 1994: 21; Pettifier 2001: 97). Sipas disa të dhënave (Kondis dhe Manda 1994: 22; Pettifier 2001: 97) shumë banorë të "zonave minoritare" u shpërngulën në vende dhe fshatra të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut. Shpërnguljet ishin masë e strategjisë politike të zhdukjes së dallimeve mes njerëzve në Veri dhe në Jug të Shqipërisë.





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Në përputhje me qëllimin e asimilimit “të tjetrit” dhe homogjenizimit të popullatës shqiptare, Enver Hoxha urdhëroi ndërrimin e emrave grekë dhe joshqiptarë të vendeve dhe të njerëzve në emra shqiptarë, nxiti gjithashtu ripërcaktimin e zbulimeve arkeologjike nga antike në ilire (Kondis dhe Manda 1994: 21).

Me rënien e komunizmit, vendosjen e demokracisë liberale dhe ndryshimet politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore, në qarqet e shumë historiografëve shqiptarë dhe intelektualëve të tjerë u shfaq nevoja për rishkrimin e historisë. Pas rënies së komunizmit në themelet e historisë së vetme mitike u ngritën histori mitike të shumëllojshme. Këto janë të shumta dhe shprehin pikëpamje dhe interpretime të ndryshme të së kaluarës, të cilat në rrethana të caktuara shoqërore-politike dhe historike bëhen konfliktuale (Schwandner-Sievers 2002: 17). Sot në Shqipëri përmbajtjet e historisë mitike kombëtare dhe lokale ndërthuren mes tyre dhe bëhen shpeshherë pjesë e debatit politik.

Në vazhdim do të prezantohen historitë mitike të shkruara dhe gojore për të kaluarën dhe “origjinën” e banorëve të Himarës/Himara. Sot, historitë mitike të shkruara dhe gojore janë lëndë e rëndësishme e bisedimeve të përditshme të vendasve, sigurisht që janë pjesë edhe e veprave të historiografisë bashkëkohore. Debatet dhe bisedimet mbi “origjinën” dhe përkatësinë e banorëve të Himarës/Himara dëgjohen shpesh nëpër *kafene* ku e kalojnë ditën fshatarët e moshuar. Meqë *kafeneias* në fshat, ashtu si kudo në Mesdhe, janë vende të njohura ku mblidhen burrat (ksh. Campbell 1964; Herzfeld 1985; dhe pjesërisht Cowan 1991), hyrja e grave në to është e kufizuar. E vetmja grua që qëndron në *kafenei* është gruaja e pronarit. Fshatarët hyjnë shumë rrallë në *kafenei*, zakonisht kur duan të blejnë ndonjë gjë të mirë në vitrinat e *kafeneit*, ose kur duan të thërrasin ndonjërin prej të afërmeve të tyre. Gjatë qëndrimit në fshat lidha shoqëri me vajzën e pronarit të kafenesë së fshatit dhe shpeshherë shkonim bashkë atje. Kështu pata mundësi të bisedoja me disa klientë, gjë që si grua e sapomartuar nuk duhej ta kisha bërë. Shumicën e historive për jetën në fshat dikur dhe sot i grumbullova gjatë vizitave të mia në shtëpitë e fshatit, kur mblidhja të dhëna për numrin e popullatës. Historitë e tjera i shkruajta gjatë bisedave të rastësishme me fshatarët në rrugë apo në barin (*kafeteria*<sup>59</sup>) në buzë të detit, ku për disa javë ndihmova si bariste (korrik 2005).

59 *Kafeteria* është një version modern bari, që në Dhërmi/Drimades u shfaq pas vitit 1990. Nëse në *kafeneia* mblidhen kryesisht meshkujt, *kafeteria* vizitohet më shumë nga të rinjtë ose çiftet e reja.





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Historitë e njerëzve në vazhdim ilustrojnë se si dallimet mes historive të shkruara dhe gojore janë të zbehta. Përveç tyre janë edhe shkrimet e historiografëve bashkëkohorë dhe specialistëve të tjerë që trajtojnë të kaluarën, traditat dhe zakonet në bashkinë e Himarës/Himara dhe në fshatrat e saj.

Shkrimet e historiografëve kombëtarë (zakonisht nga vendet e tjera të Shqipërisë) dhe lokalë (nga Dhërmiu/Drimades ose krahina e Himarës/Himara) tregojnë se si përshkrimet dhe interpretimet e periudhave historike të Shqipërisë dhe të krahinës së Himarës/Himara (p.sh. periudha e fiseve ilire dhe epirote, e periudhës bizantine, periudhës së Skënderbeut, koha e administratës osmane etj.) janë nga njëra anë diametralisht të kundërta, por nga ana tjetër të ngjashme. Si historiografët kombëtarë ashtu dhe ata lokalë e trajtojnë bashkësinë lokale apo kombin si njësi të natyrshme, homogjene dhe të mbyllur që i lidh individët në bazë të identitetit, kulturës, historisë dhe territorit të njëjtë dhe të ndryshëm. Pikëpamjet e tyre, si ato pro shqiptare ashtu dhe pro greke, janë vazhdimisht në ndryshim dhe ndjekin shpesh interesat ekonomike dhe politike në nivel lokal dhe kombëtar.

Në vazhdim në sfond nuk është kontrolli apo kontestimi i faktografisë, por ilustrimi i llojit të debatit: prezantohen pikëpamje të ndryshme dhe njëkohësisht të njëjta, me të cilat historiografët kombëtarë dhe lokalë rindërtojnë dhe e prezantojnë sërish të kaluarën e krahinës së Himarës/Himara.

### HISTORI MITIKE

#### Burime gojore

Ishte një ditë e nxehtë korriku kur me Spiron ishim ulur në kafenenë e kushëririt të tij. Ashtu si shumica e shërbimeve turistike në buzë të detit, edhe kjo kafene qëndronte hapur vetëm gjatë verës, nga mesi i majit deri në mesin e shtatorit. Në këtë bar ndihmoja si bariste. Nga që nga sezoni veror na ndanin vetëm disa javë dhe ende nuk kishte shumë klientë, pata mjaft kohë për të biseduar me Spirosin që ishte klient i rregullt.

Spirosi, i lindur më 1939 në Dhërmi/Drimades, është i ve dhe jeton në Tiranë. Në vitin 1957 u transferua atje dhe studioi për agronomi. Pas studimeve u martua me një vajzë nga fshati i tij dhe pas dasmës u kthyen në Tiranë. Në vitin 1990 bashkë me gruan, djemtë dhe vajzën emigruan në Greqi dhe pas njëmbëdhjetë vjetësh u kthyen në Tiranë, ku Spirosi bleu një shtëpi dhe hapi një aktivitet tregtar. Pas dy vitesh gruaja e Spirosit





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

vdiq. Verën, nga korriku në shtator, ai e kalon në Dhërmi/Drimades ku ka trahëguar shtëpinë e babait. Fëmijët e tij, bashkëshortët e të cilëve janë nga Dhërmiu/Drimades, jetojnë në Greqi dhe Spirosi i viziton ata herë pas here. Për banorët e parë të fshatit ai u shpreh si më poshtë:

Dikur, para shumë kohësh, rreth vitit 300 p.e.s., banorët e parë të këtyre trojeve jetonin buzë detit. Vendi i tyre quhej *Meghalihora* (hapësirë e madhe), kurse banorët kaonë ishin njerëz të egër dhe hanin peshq të gjallë. Për shkak të sulmeve të shumta të piratëve, kaonët u shpërngulën në zonën kodrinore që shtrihet mbi bregdet. Piratët u grabisnin gratë dhe të mirat materiale. Kështu banorët e parë të këtyre vendeve i ndërtuan shtëpitë me gurë që i mblidhnin në malet përreth. Kjo ishte rreth shek. 12 – 13 të e.s.

Histori të njëjtë tregoi edhe Nikola, i ve, lindur më 1921 në Dhërmi/Drimades ku ka jetuar tërë jetën e tij. Gruaja e tij e ndjerë ishte gjithashtu vendase. Gjatë komunizmit Nikola punoi në kooperativën e fshatit si bari. Tani jeton vetëm në shtëpinë e babait të tij, të cilën në vitin 2000 e rinovoi me ndihmën financiare të tre djemve (njëri prej tyre ka vdekur). Nikola ka shtatë fëmijë, nga të cilët vetëm njëri jeton në Dhërmi/Drimades, të tjerët kanë emigruar në Greqi. Një pasdite gushti e takova në rrugë para shtëpisë së tij. Ishte nisur për në *kafenënë* e fshatit. Pas pak biseda jonë filloi të zhvillohej rreth të kaluarës së fshatit dhe banorëve të tij. Nikola tregoi se:

Në vitin 600 p.e.s. njerëzit këtu jetonin buzë detit. Ata ishin banorë autoktonë, që e quanin vendin e tyre *Meghalihora*. Për shkak të sulmeve të vazhdueshme të piratëve u ngjitenë në kodër, aty ku sot është fshati Ilias. Nga brezi në brez numri i tyre u shtua, kështu që filluan të shpërngulen edhe në fshatrat e tjera të krahinës së Himarës. Atëherë ishin rreth 56 fshatra, kurse më vonë për shkak të turqve mbetën vetëm shtatë.

Këto rrëfime janë vetëm dy variante të historive të shumta mbi origjinën e banorëve të Dhërmiut/Drimadesit që pata mundësi t'i dëgjoja dhe t'i shkruaja (në ditarin e terrenit apo në shiritin e magnetofonit). Edhe pse jeta e Spirosit dallon nga ajo e Nikolës, historitë e tyre janë pothuajse të ngjashme në pikat kryesore. Të dy flasin për burimin apo për etnogjenezën e banorëve të Dhërmiut/Drimadesit dhe i vendosin ata në Hapësirën e Madhe apo *Meghalihora*. Sipas fjalëve të tyre banorët e *Meghalihorës* si fillim ishin të bashkuar dhe kishin jetuar bashkë në harmoni deri sa nisën sulmet e piratëve. Spirosi përmendi se banorët e *Meghalihorës* (sot Dhraleo) quheshin kaonë dhe sipas përcaktimeve të disa historiografëve (Hammond 1967; Prendi 1982) ishin fise epirote; "origjina" e epirotëve është një nga polemikat qëndrore në historiografinë bashkëkohore të Shqipërisë.





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Historitë vendosin në qendër të vëmendjes idenë se fshatarët janë autoktonë, të parët dhe homogjenë. Duke treguar historitë e tyre mbi origjinën, Spiro dhe Nikola krijojnë vendin e origjinës dhe të përkatësisë së tyre, i caktojnë atij madhësinë dhe hapësirën. Uniteti i banorëve dhe shtrirja e vendit të tyre u prish me shpërnguljen e banorëve autoktonë në kodër, nga ku u shpërngulën gradualisht nëpër vende më të vogla, apo në fshatrat e Himarës/Himara. Kur e vendosin historinë në një kohë të caktuar (shek. i 3 ose i 6 p.e.s), ata mundohen ta prezantojnë atë si legjitime dhe të barazvlefshme me atë të historiografisë.

### Burime të dokumentuara

Mes viteve 2000 dhe 2005 janë botuar shumë vepra që diskutojnë dhe polemizojnë mbi historinë e krahinës së Himarës/Himara. Në hijen e ngjarjeve politike, p.sh. zgjedhjeve lokale dhe parlamentare në Shqipëri, përveç artikujve të shumtë të gazetave dhe njoftimeve të tjera, janë botuar dhjetë libra mbi të kaluarën e krahinës së Himarës/Himara. Në vitin 2006 anëtarët e komunitetit të Himarës/Himara përgatitën faqen e internetit ([www.himara.eu](http://www.himara.eu)) me të dhëna dhe informacione të përgjithshme mbi fshatrat e Himarës/Himara, historisë së saj, ofertave turistike, korrespondenca dhe diskutime në blog si dhe informacione për kërkesat për vizë për në SHBA. Informacionet janë në gjuhën shqipe, greke dhe angleze.

Në vitin 2001, disa muaj para zgjedhjeve parlamentare (24 qershor, të përsëritura më 19 gusht), dy vendas nga fshati Qeparo në Himarë/Himara, Pirro Polo dhe Natasha Sotiri, botuan dy vepra për historinë (Polo) dhe gjuhën (Sotiri) e banorëve të Qeparosë dhe të krahinës së Himarës/Himara. Po atë vit Spiro Rusha, babai i Natasha Sotirit, botoi një libër historie për Himarën/Himara. Në vitin 2003, pas fitores së Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut<sup>60</sup> në zgjedhjet lokale në Himarë/Himara, një pedagog në departamentin e historisë dhe filologjisë në Universitetin e Tiranës botoi një libër mbi etnitetin e kësaj zone. Të njëjtën gjë trajtonin edhe esetë që u botuan një vit para (2004) zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri (2005) në gazetën ditore *Korrieri* (3 dhjetor 2004: 13-15; 4 dhjetor 2004: 14-15; 7 dhjetor 2004: 18-19; 8 dhjetor 2004: 17; 9 dhjetor 2004: 18). Pas zgjedhjeve

60 Për shkak të Ligjit për Partitë Politike (i miratuar në korrik të 1991) që përjashtonte partitë e angazhuara në çështjet fetare, etnike, dhe rajonale, partia politike OMONIA nuk mundi të merrte pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 1992. Për këtë arsye, pak muaj para zgjedhjeve u themelua Shoqata për të Drejtat e Njeriut, e cila përveç të drejtave të minoritetit grek përfaqësonte edhe të drejtat e pakicave të tjera kombëtare dhe gjuhësore në Shqipëri (Bos dhe UNPO Mission 1994: 2).





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

parlamentare, Kristo Frashëri i mblodhi të gjitha këto tekste në botimin *Himara dhe përkatësia etnike e himarjotëve*.

Në muajt para zgjedhjeve parlamentare të viti 2005 dolën edhe tre botime mbi Himarën/Himara. Autori i njërit prej tyre është Foto Bixhili nga Dhërmiu/Drimades. Këtu ai trajton historinë e fshatrave të Himarës/Himara. Në librin tjetër Foto Nina përshkruan biografinë e familjes së vet. Kjo vepër u botua edhe në Athinë në gjuhën shqipe dhe greke. Vepra e tretë u botua nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe trajton historinë, gjuhën, doket dhe zakonet në krahinën e Himarës/Himara.

Si përgjigje ndaj eseve të Frashërit nga gazeta *Korrieri* një fshatar nga fshati Dhërmi/Drimades Kristaq Jorgji, me banim në Tiranë, botoi një artikull në gazetën ditore ABC (1 prill 2006a: 4-6 dhe 8 prill 2006b: 18). Në vitin 2006 doli një botim i redaktuar nga anëtarët e Bashkësisë së Intelektualëve të Himarës, të cilët më 16 dhe 17 dhjetor organizuan në Tiranë një konferencë. Në konferencën mbarëhimarjote u diskutua për problemin e pronësisë së tokave, zhvillimin e turizmit dhe të infrastrukturës si dhe përmirësimit të sistemit shkollor dhe shëndetësor në Himarë/Himara. Po atë vit doli një botim i arkeologut Jani Koçi nga Qeparoja që sot jeton në mërgim në Greqi.

Në vazhdim do të prezantohet mënyra se si historiografët dhe intelektualët e tjerë diskutojnë për të kaluarën e kësaj zone. Në qendër të interesit janë librat dhe artikujt e gazetave, pjesa dërrmuese e të cilave është botuar në Shqipëri gjatë gjurmimeve të mia si dhe pas tyre.

### PIKËPAMJE DHE INTERESA TË NDRYSHME

Vepra me titull *Jipet e lperit* (2004) e vendasit Foto Bixhili, mësues i gjuhës shqipe në pension, shkaktoi te vendasit e tij një lumë me kritika. Ai u kritikua për mungesë koherence dhe informacione të pasakta, me të cilat autori mbron pikëpamjen kombëtare ose pro shqiptare. Bixhili pohon se bindja e vendasve për prejardhjen e tyre nga *Meghalihora* është thjesht një legjendë lokale. Sipas tij banorët “e parë” të Dhërmiut/Drimadesit kanë jetuar në kodër, diku mes Dhërmiut/Drimadesit dhe fshatit fqinj Ilias. “Vendosja e banorëve të parë nën GJONDUSHE ..., një vend i fshehur nga sytë e piratëve të shumtë, që i rrihin shpesh këto brigje, nën guvat e këtyre shkëmbinjave të kësaj lartësie, duhet të jetë i vonshëm” (Bixhili 2005: 44). Interpretimet e Foto Bixhilit, i kthyer në fshat pasi kishte jetuar shumë vite në vende të ndryshme të Shqipërisë dhe më vonë, pas rënies së komunizmit, kishte emigruar në Greqi nga ku u kthye para disa viteve përsëri në Dhërmi/Drimades, janë për shumë vendas të kontestueshme







## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

dhe të dyshimta. Sipas tyre interpretimet historike të Bixhilit janë fryt i indokrinimit nga regjimi i kaluar.

Dy muaj pas librit të Bixhilit doli në shtyp botimi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë *Himara në Shekuj*. Edhe ky botim, njësoj si libri i Bixhilit, u shoqërua nga kritikata e shumicës së vendasve të Dhërmiut/ Drimades dhe Himarës/Himara. Reagim të kundërt pati në Vlorë, ku libri u lavdërua dhe u pranua me dashamirësi nga qarqet e intelektualëve, akademikëve dhe politikanëve të qytetit. Më 10 mars 2005 në Universitetin Teknik "Ismail Qemali" në Vlorë u mbajt një konferencë shtypi; u mbledhën profesorë universitarë, sociologë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, artistë nga Vlora, gazetarë të gazetave kombëtare dhe lokale, televizione të ndryshme dhe disa studentë. Gjatë prezantimit disa prej studiuesve prezantuan pjesë të shkëputura nga studimet e tyre. Foto Bixhili ishte i ftuari i veçantë dhe mbajti një fjalim të përmbledhur për historinë e Himarës/Himara.

Botimi i Akademisë përfshin 24 kontribute shkencore me përmbledhjet e tyre në anglisht ose frengjisht. Aty prezantohet imazhi gjeografik dhe arkeologjik i kësaj zone, historia e saj nga periudha e bronzit deri në Luftën e Dytë Botërore, organizimi i tokave, gjuha, kultura dhe traditat, mitologjia dhe këngët polifonike. Shumica e këtyre kontributeve theksojnë idenë se krahina e Himarës/Himara dhe banorët e saj i përkasin shtetit kombëtar shqiptar.

Në këtë frymë Myzafer Korkuti diskutoi për arkeologjinë e Himarës/Himara dhe të fshatrave të saj, të banuara që në periudhën e bronzit (1600-1200 p.e.s.) dhe periudhën e hekurit (1200-700 p.e.s.). Korkuti shkruan se vendbanimet e Himarës/Himara së sotme dhe të Sarandës ishin të rrethuara me mur. "Banorët e parë quheshin kaonë që, sipas tezave të autorit, ishin pjesë e fiseve ilire. Korkuti përshkruan dhe rrënojat në Himarë/Himara:

Ngritja e një togu vendbanimesh të fortifikuara preurbane gjatë epokës së bronzit e të hekurit në territorin e Shqipërisë është e lidhur me ndryshimet e rëndësishme që ndodhën në gjirin e shoqërisë ilire. [...] Kështu në territorin e Shqipërisë Jugperëndimore, në epokën e bronzit të vonë dhe gjatë epokës së hekurit veçohen tri tipe vendbanimesh të fortifikuara me mure Badher [mes Himarës/Himara dhe Borshit] - Karos [pranë Borshit] - Kalivo [pranë Butrintit], të cilat përfaqësojnë etapa suksesive të zhvillimit të tyre, me shtrirje kohore nga bronzi i vonë deri në fund të epokës së hekurit të shek. VII p.e.sonë. (Korkuti 2004: 39)

Njësoj referon edhe Emin Riza, kur diskuton për arkitekturën e qytetit të Himarës/Himara:





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Duke qenë se qendrat e lashta të fortifikuara, të cilat ruajnë ende brenda tyre ansamble banimi, janë tepër të rralla, si në Shqipëri, ku përmendim Beratin, madje edhe më gjerë në Ballkan, qendra e banuar brenda kalasë antiko-mesjetare të Himarës duhet vlerësuar me kujdes. Ajo paraqet një shembull me interes urbanistiko-arkitektonik në kuadrin e trashëgimisë historiko-kulturore që krijoi etnosi iliro-shqiptar në shekuj. (Riza 2004: 408)

Arqile Bërxfholi në fjalitë hyrëse të kontributit të tij, në të cilin shkruan për historinë e administratës dhe të numrit të popullatës në krahinën e Himarës/Himara ndër shekuj, duke iu referuar edhe arkeologjisë shkruan:

Burimet arkeologjike tregojnë se viset që përbëjnë kompleksin gjeografiko-kulturor të Bregut të Detit (Himarë-Sarandë) kanë qenë të banuara qysh në kohët më të hershme. Kjo trevë përbën një areal të përbashkët me të gjitha trojet etnike shqiptare, e cila është karakterizuar nga popullimi i hershëm e në vazhdimësi deri më sot nga e njëjta popullsi, nga ajo shqiptare. (Bërxfholi 2004: 227)

Kristaq Prifti në kontributin e tij mbështetet në burimet e arkivit dhe në dokumente historike:

Në burimet arkivore, jo vetëm osmane, por edhe në burimet e vendeve evropiane (austrohungareze, franceze etj.), mjaft nga të cilat kanë pasur si objekt analizën e përbërjes kombëtare të popullsisë së vilajetit të Janinës (të Shqipërisë së Jugut), nuk vihet në dyshim kombësia shqiptare e popullsisë së Himarës e të fshatrave të saj. Në asnjë prej tyre, përveç ndonjë burimi me prejardhje nga Athina, siç është "Harta Etnografike e Epiri të Veriut" e cituar më lart e ndonjë tjetër, nuk identifikon të krishterët e Himarës dhe në tërësi të Shqipërisë së Jugut me grekët. (Prifti 2004: 188)

Pozita strategjike, afërsia me ishujt grekë dhe zhvillimi gradual i marrëdhënieve tregtare kanë qenë sipas mendimit të tij faktorë vendimtarë për afirmimin e gjuhës greke në të gjitha fshatrat e krahinës së Himarës/Himara. Përdorimin e greqishtes e nxitën gjithashtu kisha dhe arsimit në kohën e Perandorisë Bizantine (shek. i 13 dhe 16), kur ajo u bë pjesë e ritualeve kishtare ajo hyri dhe në shkollë dhe në fund u bë gjuhë e përditshme (po aty).

Edhe Shaban Sinani shikon në pozitën strategjike të Himarës/Himara njërin prej faktorëve të zhvillimit të marrëdhënieve tregtare. Banorët e krahinës së Himarës/Himara nëpërmjet lidhjeve tregtare iu drejtuan "Perëndimit" për zgjidhje politike (Sinani 2004: 341). Ai shkruan gjithashtu edhe për "etnotipin" e njerëzve në Himarë/Himara:

Krahina e Himarës vjen duke ngushtuar dhe mali i Vetëtimës pak nga pak merr rëndësinë e vijës së takimit të Labërisë me Bregdetin, gjë që nuk





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

vërtetohet më parë, sidomos deri në reformat e Tanzimatit<sup>[61]</sup>.[...]Popullsia vendëse kthen vështrimin nga Selia e Shenjtë dhe nga mbretëritë e Perëndimit, lidh shpresat më këto fuqi, riorienton jetën e vet në drejtimin detar, e lidh jetën me detin, me tregtinë, me peshkimin, me bashkësi të ndryshme etnikisht prej vetvetes, sidomos me Korfuzin. Ndërsa e para çoi në ndonjë dallim pa ndikim në karakterin e etnotipit shqiptar (për shembull, në islamizimin e Labërisë dhe në ruajtjen e krishterimit të himarjotët, tek të cilët shpresa ishte më e madhe), e dyta çoi gjithashtu në ndikime kulturore pasuruese, që provohen me hyrjen e greqishtes si gjuhë pune e komunikimi, më pas edhe si ligjërim popullor, por jo në të gjitha nivelet e ligjërimit... (Po aty)

Me të njëjtin stil, por disi me interesa të ndryshme nga ato të rrëfyesve të historive mbi origjinën e himarjotëve nga *Meghalihora*, këta autorë flasin për origjinën e himarjotëve duke e lidhur atë me “shoqërinë ilire” (Korkuti). Në bazë të zbulimeve arkeologjike dhe të ndërtimeve, origjina e himarjotëve është një pjesë e rëndësishme e “historisë iliro-shqiptare” (Riza). Siç pohon Bërzholi, krahina e Himarës/Himara ka qenë e banuar “që në periudha të hershme” gjë që e dëshmon “territori etnik shqiptar”. Ideja mbi vazhdimësinë, unitetin e banorëve të Himarës/Himara që i përkasin popullit shqiptar” mbrohet edhe nga Prifti. Duke analizuar të dhënat e arkivave, pohon se banorët e Himarës/Himara i përkasin shtetit kombëtar shqiptar dhe se gjuha e tyre e parë është shqipja. Këta studiues në shkrimet e tyre krijojnë lidhje të drejtpërdrejta mes ilirëve dhe shqiptarëve dhe në këtë mënyrë e përshkruajnë kombësinë sikur të ketë ekzistuar “gjithmonë”.

Ashtu si rrëfyesit e historive, edhe historiografët përshkruajnë kalimin linear nga homogjeniteti dhe grupëzimi i vendasve në heterogjenitet dhe zhvendosjen e shumë fshatrave të krahinës së Himarës/Himara. Nëse në historitë gojore ky kalim linear shënohet me sulmet e vazhdueshme të piratëve në *Meghalihorë* dhe të vendosjes së banorëve në zonat kodrinore, shkrimet e historiografëve e shikojnë kalimin linear si pasojë të sistemit të Tanzimatit dhe të zhvillimit të tregtisë përtej detit me ishujt grekë në gjysmën e dytë të shek. 18.

Njësoj si Sinani edhe historiani i shquar Kristo Frashëri flet për përkatësinë e banorëve të Himarës/Himara dhe e përcakton atë brenda kornizës kombëtare. Në veprën e tij *Himara në burimet dokumentare historike* të vitit 2005 shkruan:

Ka mjaft kohë që në Greqi e Shqipëri, në faqet e shtypit të përditshëm ose të trajtesave të veçanta rrihet çështja e Himarës, më saktë çështja e banorëve të saj. Sipas autorëve helenë këta banorë i takojnë kombësisë

<sup>61</sup> Reformat e Tanzimatit apo të rregullit të ri filluan të zbatoheshin pas vitit 1839 dhe synonin transformimin dhe modernizimin e administratës osmane (shiko Škaljić 1966).





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

greke, kurse sipas palës tjetër i takojnë kombësisë shqiptare. Të dy palët sjellin argumente në dobi të pikëpamjeve të tyre, por nuk shohitin argumentet e palës tjetër. Kjo nuk është pa dobi, por është rrugë e lehtë për secilën pikëpamje. Të sjellësh argumente në dobi të tezës tënde duke injoruar ato të palës kundërshtare nuk është debat shkencor. Me këtë metodë problemi mbetet i pazgjidhur dhe të dy palët qëndrojnë të gozhuara pas pikëpamjeve të tyre. Pikërisht për këtë arsye për të dhënë sadopak një kontribut në zgjidhjen e këtij problemi që ngacmon marrëdhëniet midis dy popujve fqinje autori i këtij punimi ka përgatitur një monografi me titull "Himara në burimet dokumentare historike" ku bëhet një orvatje për të ballafaquar argumentet e të dy palëve. Këtu po botojmë një përmladhje të çështjeve kryesore të trajtuara në këtë monografi, e cila do të botohet së shpejti. Sikurse do të shihet, me këtë ballafaqim ai arrin në përfundimin se banorët e Himarës i përkasin pa mëdyshje kombësisë shqiptare. Megjithatë nëse ka arritur ta sqarojë përfundimisht problemin, do ta thonë lexuesit. (Frashëri 2004: 2)

Kristaq Jorgji nga Dhërmiu/Drimades në artikullin e tij të botuar në të përditshmen ABC (prill, 2006) dhe më vonë edhe në faqen e internetit të bashkësisë së Himarës/Himara ([www.himara.eu](http://www.himara.eu)), e kritikoi përpjekjen e Frashërit për t'i bashkuar të dyja pikëpamjet. E kritikoi për njëanshmërinë e tij, që bazohet në forcimin e interesit kombëtar pro shqiptar:

Pyetja e parë që më lindi personalisht pas leximit të shkrimit është se kujt i drejtohet ky shkrim. Si historian, Z. Frashëri mund e duhej t'i drejtohej publikut të gjerë (përfshirë edhe atij himarjot) që do të ishte i interesuar të ndriçohej kjo çështje, për të cilën duhet thënë se ka pozicione edhe të kundërta me synimin për t'u munduar të sqarojë objektivisht (dhe këtu mund të ekzistonte edhe opsioni se kjo gjë duhej ndriçuar edhe më tej). Opsioni tjetër t'u drejtohej me retorikën nacionaliste atyre që nuk arrijnë të kuptojnë se Himarjotët nuk do të pranojnë domosdo t'i shpallin të tjerët me çfarë jua ka qejfi atyre. Kjo zgjedhje e dytë do të qe më pak e lakmueshme për një historian sepse ata d.m.th Himarjotët mund dhe do ta shkruajnë vetë historinë e tyre siç do të binden nga faktet dhe siç e kanë bërë në vite. (Jorgji 2006a: 4)

Në kritikën e veprës së Frashërit, Jorgji mbështet hipotezën e diversitetit lokal dhe të veçantisë së banorëve të Himarës/Himara; ai shkruan për Himarën/Himara:

që ndryshe nga tërë krahinat e tjera pësoi e vetme sulmin e tre sulltanëve të Turqisë, përfshirë edhe Sulejman Kanunliun, (që çoi Perandorinë Turke në apogjeun e saj); që ndryshe nga shumica e shqiptarëve ruajti fenë e të parëve - atë ortodokse; që ka hapur shkollën e parë të njohur në territorin e Shqipërisë së sotme; që kundërshtoi që në vezë pushtetin komunist me votimet e 1945,... (Po aty)





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Me gjithë argumentet kundërshtuese, me të cilat Frashëri mbështet tezën se banorët e Himarës/Himara i takojnë kombit shqiptar ndërsa Jorgji mbron veçantinë dhe diversitetin lokal, të dy e përcaktojnë krahinën e Himarës/Himara dhe banorët e saj si një territor që është pjesë si e shtetit kombëtar, ashtu dhe e "lokalitetit". Edhe pse të dy kritizojnë interpretimet e njëanëshme të shumë studiuesve dhe historiografëve dhe lexuesve të tyre u premtojnë se nuk do të bëjnë të njëjtat gabime, gjithsesi nuk i shmangen njëanshmërisë, pasi në qendër të vëmendjes vendosin interesin nacional apo lokal: Frashëri arrin "në përfundimin se banorët e Himarës i përkasin pamëdyshje kombësisë shqiptare" (2005: 5), kurse Jorgji thekson se ndryshe nga pothuaj tërë zonat e Shqipërisë Himara/Himara "ngeli e pavarur" (Jorgji 2006a: 2).

Te debatet dhe çështjet e përkatësisë së banorëve të Himarës/Himara bëjnë pjesë edhe polemikat mbi origjinën, shpërnguljet, tregtinë, luftrat, përkatësinë fetare dhe autonominë e banorëve.

### MES KONTESTUESHMËRISË DHE LIDHSHMËRISË

#### Ilirë apo epirotë?

Sipas supozimeve historike në krahinën bregdetare të Shqipërisë së sotme të Jugut, përfshirë krahinën e Himarës, në shek. e 6 p.e.s. jetonin kaonët<sup>62</sup> (Cancik dhe Schneider 1997: 1093-1094). Mes autorëve që mbështesin interesin lokal apo nacional shprehen mospajtime për përkatësinë e kaonëve si dhe të vendit që ata zinin në hartën e gjerë shoqërore-geografike. Shumë historiografë që mbështesin pikëpamjet lokale i përcaktojnë kaonët si pjesë të epirotëve (Rusha 2001: 11; Koçi 2006: 13), ata kanë jetuar në territorin e sotëm të Himarës/Himara përafërsisht nga viti 7000 p.e.s. Disi ndryshe argumenton arkeologu nga Qeparoja, Jani Koçi, i cili shkruan se në periudhën kenozoike kjo pjesë e bregdetit të Shqipërisë së Jugut ishte një e tërë me ishujt grekë Korfuz, Ereikoussa dhe Othonas (Koçi 2006: 9-10). Kështu banorët e kësaj pjese kishin marrëdhënie tregtare (po aty). Në dallim nga Koçi, historiografët që mbështesin interesat kombëtare pohojnë se fisi i kaonëve i takonte ilirëve (Ceka 2005; Frashëri 2005: 17) ose pellazgëve (khs. Bixhili 2004). Sipas mendimit të tyre fisi i kaonëve është vendosur në krahinën e Himarës/Himara në periudhën e mezolitit (8000 p.e.s.) (Gjipali 2004: 60-61).

62 Ose në periudhën e hershme të bronzit (rreth 2300/2200-1600 p.e.s.) (Harding 2000: 14-18), ose (4900-2000 p.e.s.) (Fagan etj. 1996).





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Studiuesit e huaj (Jacques 1995; Vickers 2001; Winnifriith 2002), që nuk mbështesin as pikpamjet pro greke, as pro shqiptare dhe as atë lokale, vërejnë se dallimet mes ilirëve dhe pellazgëve janë çështje shkencore dhe subjekt i mosmarrëveshjeve politike. Studimet e tyre tregojnë se për periudhën para erës sonë nuk ekzistojnë dokumente të mjaftueshme që të mund të vërtetonin hipotezën se shqiptarët janë pasardhësit e ilirëve (Jacques 1995: 30, 40; shiko edhe Šašel Kos 2005: 246-247). Miranda Vickers pohon të njëjtën gjë dhe konstaton se hipotezat e përmendura u prezantuan si fakte historike në kohën e komunizmit.

Shkencëtarët bashkëkohorë i përshkruajnë "ilirët" si tërësi fisesh që shtriheshin njëkohësisht në një pjesë të madhe të Gadishullit Ballkanik, deri në lumin Danub në veri. Përgjigjet ndaj pyetjeve se a kanë qenë ilirët apo grekët që kanë populluar një pjesë të jugut të Shqipërisë, të njohur si Epir, mbeten ende të diskutueshme. Ndoshta dikur si ilirët ashtu dhe grekët kanë populluar këto troje ashtu si sot. (Vickers 2001: 1)

Historiani britanik Winnifriith pohon të njëjtën gjë kur trajton gjuhën e epirotëve (2002: 47-48, shiko kapitullin e parë), kurse autorët me prirje lokale pohojnë se gjuha e tyre ka qenë ilirishtja nga e cila, sipas bindjes së tyre, buron gjuha shqipe.

Këto mendime tregojnë se historiografët që mbështesin si interesat pro greke, ashtu dhe ato pro shqiptare i përcaktojnë banorët e Himarës/Himara si një entitet i vetëm "homogjen", i cili i ka takuar "gjithmonë" si popullit shqiptar ashtu dhe atij grekë. Përkatësinë e këtyre banorëve te fiset ilire apo epirote e caktojnë brenda kufijve kombëtarë. Kështu p.sh. si Rusha, që mbështet interesat lokale, ashtu dhe Ceka, Frashëri dhe Bixhili që mbështesin interesat kombëtare, i vendosin kaonët në hartën gjeopolitike të Republikës së Shqipërisë. Asnjëri prej tyre nuk merr parasysh faktin se në periudhën kenozoike territori gjeomorfologjik ku sot shtrihet Himara/Himara ishte disi ndryshe nga sot. Shumica e historiografëve lokalë e kombëtarë dhe studiues të tjerë i trajtojnë fiset epirote dhe ilire sikur të ishin pjesë e modelit evolutiv në të cilin nga bashkësitë fisnore "të thjeshta" u zhvilluan gradualisht të gjitha shtetet "komplekse" kombëtare.

Winnifriith dhe Vickers e vendosin Shqipërinë në Ballkan; Ballkani është sinonim i shumëllojshmërisë, i përzierjes, i paqartësisë dhe mosmarrëveshjeve. Vickers p.sh. shkruan: "Studiuesit bashkëkohorë i përshkruajnë si "ilire" fiset e shumta që popullonin një pjesë të mirë të gadishullit Ballkanik, deri te lumi i Danubit në veri." (2001: 1), kurse Winnifriith: "Në Ballkan, veçanërisht në Shqipërinë e Jugut nuk është aspak e jashtëzakonshme të takosh njerëz që flasin dy a tre gjuhë" (2002: 47). Sipas Todorovës (1997) dhe të tjerëve (Norris 1999; Bjelić dhe Savić





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

2002; Green 2005) kuptimi i Ballkanit që deri në shek. 19 përdorej si emër gjeografik dhe shoqëror për malet që lidhnin Malin e Zi me Adriatikon (Todorova 1997: 25), u ngjyros gradualisht me kuptime politike, historike dhe kulturore. Në letërsinë bashkëkohore Ballkani përdoret shpesh si sinonim për përzierjen, fragmentizmin, bollëkun, hibridizimin, ambiguitetin dhe mosmarrëveshjet. Vickers dhe Winnifrith e përdorin njësoj fjalën Ballkan duke i dhënë kuptimin e turmës dhe të rrëmujës, për shkakun e të cilave nuk mund të gjejnë një përgjigje të qartë dhe të vetme për përkatësinë e fiseve ilire, epirote apo greke. Përcaktimet e tyre, sipas këndvështrimit të Greenit, mund t'i përkufizojmë si një nga ato idetë që s'i dilet dot kurrë deri në fund, sepse bëhet gjithnjë e më e komplikuar ose e pakuptimtë, që krijon thelbin e konceptit të hegjemonisë në Ballkan: kjo do të thotë se Ballkani në kuadrin politik, intelektual, historik, kulturor dhe madje gjeografik është tërësi fraktalesh (Green 2005: 140) të ngërthyera në konceptin e Ballkanit – njëkohësisht i komplikuar dhe “entitet”. Pikërisht këto përcaktime krijojnë thelbin e “konceptit hegjemonist të Ballkanit” (Green 2005: 140). Green tërheq vëmendjen se fraktalizmi është një konstrukt hegjemonik ku gjërat nuk janë tepër komplekse apo të copëtuara, por janë të lidhura ngushtë dhe të pandashme.

### Tregtia përtej detit

Misionari amerikan evangjelist Jacques (1995: 94-95) dhe historiani britanik Winnifrith (2002: 42) i periodizojnë kontaktet e para tregtare në Jugun e Shqipërisë së sotme në fund të shek. të 7 dhe në fillim të shek. të 6 p.e.s. Përgjatë Bregdetit të Shqipërisë së sotme tregtarët e Greqisë së sotme themeluan kolonitë dhe qendrat e tyre tregtare në Epidamnus (Durrës), Apolloni (Pojan), Butrint, Finiq dhe Lissus (Lezha). Më vonë, në shek e 3 p.e.s. një pjesë e Shqipërisë Jugore bashkë me Himarën/Himara e sotme ra në regjimin e mbretit *koinona* të molosëve, që sipas burimeve historike i takonin epirotëve (Hammond dhe Schullard 1976: 697). Në shkrimet e historianëve antikë, p.sh. Straboni dhe Tukididi, termi epirot i referohej kryesisht fiseve dhe jo territorit (Winnifrith 2002: 47).

Në përshkrimin e tregtisë, vendasi dhe arkeologu Koçi (2006: 25) u referohet gjetjeve arkeologjike qeramike të periudhës së neolitit të vonshëm. Njësoj si Rusha (2001: 32-33) edhe Koçi (2006: 21) përmend emra portesh dhe qendrash tregtare bregdetare: Panormë (*Panormus* ose *Panormus Limen*), Spilesë (në Himarë/Himara), Gjipe (mes Dhërmiut/Drimades dhe Vunosë), Jaliskar (në Dhërmi/Drimades). Lista e qyteteve tregtare jepet edhe në veprat e Hammond-it (1967: 125) dhe Winnifrith-





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

it (2002: 96), të cilët përveç porteve të numëruara përmendin edhe bregdetin, të ashtuquajturën Grammata, pranë Dralesë në rrëzë të fshatit Palasë.

Arkeologu Ilir Gjipali (2004: 60) është ndër autorët e rrallë që mbështet pikëpamjet pro shqiptare, por njëkohësisht bie dakord me arkologun Koçi kur i vendos lidhjet tregtare mes banorëve të Himarës/Himara dhe ishujve të sotëm grekë në periudhën e antikitetit të vonshëm:

Midis materialit të qeramikës së pëfituar nga gërmimi, veçanërisht në shtresëzimet e periudhave arkaike, klasike e helenistike, vihet re prania italice ndërsa brenda territorit ku bën pjesë Himara, ka importe edhe nga Apollonia. Në këto periudha Himara duket se ka qenë një qendër e vogël banimi, por duke qenë pjesë e rrugës detare të Bregdetit Jonian, ka pasur kontakte me qendra të rëndësishme prodhimi e tregtimi të kohës, ashtu siç ka ndodhur edhe me qytezën e Sopotit (Borshi) më në jug të saj. (Po aty)

Në trajtesën e tij të përmbledhur në botimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Sinani, duke iu referuar interesave kombëtare, flet për marrëdhëniet tregtare me ishujt grekë nga fillimi i administratës osmane mes shek. 14 dhe 16. Sinani shikon në pozitën bregdetare të Himarës/Himara njërën nga rrethanat e zhvillimit të tregtisë me ishujt fqinjë që Himarën/Himara e lidhte me "Perëndimin" (Sinani 2004: 349). Kurse Prifti në të njëjtin botim, përveç tregtisë, përmend edhe ndalimin e përdorimit të gjuhës shqipe nëpër shkolla nga regjimi osman. Prifti pohon se në këtë krahinë u arrit që nëpërmjet praktikave fetare dhe shkollimit të përhapëj dhe forcohej përdorimi i gjuhës greke.

Veprimtaritë kishare, p.sh. mesha, bëheshin në greqisht. Me kalimin e kohës filluan të hapeshin edhe shkollat greke. Sipas mendimit të historianëve bashkëkohorë, është pikërisht ky njëri nga shkaqet e afirmimit të gjuhës greke në këtë krahinë. Në shekullin 19 gjuha greke përdorej në të gjitha fshatrat e Himarës. Shkaku kryesor për këtë qe dekreti i qeverisë osmane për ndalimin e mësimin në gjuhën shqipe. Në Shqipëri nuk kishte shumë shkolla. (Prifti 2004: 188, përkth. i përkth. të përmbledhjes në anglisht NGB)

Po të ndjekim Winnifrith-in, gjatë pushtimeve osmane dallimet mes grekëfolësve dhe shqipfolësve ndryshonin vazhdimisht, për këtë është e vështirë të caktojmë "me saktësi" kufirin mes tyre (2002: 107). Me gjithë dominimin osman, në fshatrat e Himarës/Himara, Sarandës, Gjirokastrës dhe Delvinës mbizotëronte krishtërimi, i cili ishte i rëndësishëm për ruajtjen e gjuhës greke që banorët e pjesëve bregdetare të Shqipërisë Jugore e përdornin në tregtinë që zhvillonin me ishujt grekë (2002: 108).







## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

### Periudha e Perandorisë Romake dhe Bizantine

Ndërsa lidhjet tregtare përtej detit fillojnë nga periudha e antikitetit të hershëm, ato tokësore fillojnë disi më vonë, mes viteve 27 p.e.s. dhe 476 e.s. kur territori i sotëm i Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut gjendej nën Perandorinë Romake (Hammond 1967:699). Për daljen në det dhe mbrojtjen e zonës bregdetare të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut administrata romake ndërtoi rrugën me emrin Via Egnatia, që lidhte Apoloninë antike (afër Levanit të sotëm) me Rrogozhinën dhe Dyrrachiumin (Hammond 1967:235). Edhe pse sot është e vështirë të caktohet shtrirja e saj, shumë historiografë bashkëkohorë e vendosin paralelisht me lumin Shkumbin nëpër të cilin kalon kufiri mes *gegëve* veriorë dhe *toskëve* jugorë. (Jacques 1995: 134). Përveç Via Egnatiës, administra romake ndërtoi edhe rrugën bregdetare që lidhte Apoloninë me Vlorën, Llogaranë dhe Chimaerën (Himarë/Himarëa, Phoinikën (Finiqi), Vuthrotumin (Butrintin), si dhe rrugën në brendësi që lidhte Vlorën me Amantiën, Antigonën, Dodonën, Ambrakinë dhe Nicopolisin (Hammond 1967: 699-700 dhe Shtojca 2).

Për të kontrolluar provincën e re të Maqedonisë, Perandoria romake në Verilindje krijoi qendra ushtarake dhe një varg fortesash përgjatë Via Egnatiës (Jacques 1995: 134, Winnifrith 2002: 67). Nëpër këtë rrugë tregtia morri një zhvillim të madh, nëpër të kalonin udhëtarë të shumtë dhe forca të armatosura. Me kalimin e kohës aty u krijuan komunitete të mëdha (Winnifrith 2002: 67) dhe qytete të mëdha (p.sh. Apolonia, Dyrrachium, Amantia dhe Byllis) që përjetuan një zhvillim të madh ekonomik. Më në jug u ndërtuan porte të rëndësishme, p.sh. Oricum dhe Onchesmus (në Sarandë) (Winnifrith 2002: 67).

Në shek. e 1 të e.s. nëpërmjet Via Egnatiës udhëtoi misionari Shën Pali dhe përhapoi doktrinën e krishterë dhe nxiti ndërtimin e kishave në rrugën antike. Njëqind vjet më vonë emri Epir, që atëherë shënonte një provincë administrative pjesërisht të pavarur nga pushteti romak, filloi të afirmohej mes politikanëve romakë. Winnifrith pohon se shumica e banorëve të Epirit mes shek. 1 dhe 3 përdorte gjuhën greke, të kësaj periudhe janë gjithashtu edhe disa dorëshkrime në latinisht. Rreth shek. 3 të e.s. Diokleciani e ndau Epirin në dy njësi administrative. *Epirus vetus* shtrihej nga Nicopolisi deri në malin Strel (mali Acroceunia), kurse *Epirus nova* përfshinte qytetet greke p.sh. Dyrrachium dhe Apolonia (Winnifrith 2002: 69-70). Edhe pse sot ndarja mes *Epirus nova* dhe *Epirus vetus* është e paqartë, pro grekët mundohen ta shtyjnë kufirin e Epirit sa më në veri, drejt lumit Shkumbin (po aty). Për këtë shpesh i referohen Strabonit që lumin e shënoi si kufi mes këtyre dy njësive administrative.





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Në shek. 5 Perandoria Bizantine pasoi gradualisht Perandorinë Romake. Nga kjo kohë Via Egnatia i lehtësoi shpërnguljet e normanëve dhe kryqtarëve drejt lindjes dhe dyndjet e gotëve dhe të bullgarëve dhe më vonë në shek. e 16 edhe të turqve (Jacques 1995: 134-164).

Mes shek. 12 dhe 13 kur Bizanci u forcua shumë dhe u përhap krishtërimi, në Dhërmiun/Dhrimadesin e sotëm dhe në Himarë/Himara u ndërjuan shumë kisha. Mbishkrimet e vjetra në disa prej kishave të fshatrave për historiografët bashkëkohorë dhe intelektualët e tjerë janë një tjetër mollë sherri. Për këto mbishkrime Frashëri thotë kështu:

Përkatësia jo greke e banorëve të saj kuptohet edhe nga mbishkrimi i vitit 1751 që ndodhet në murin e Kishës së Ipapandisë në Dhërmi, ku përmenden dy banorë nga Dhërmiu, të dy priftërinj, njëri me emrin Papa Ilija Leka, tjetri Andon Starat Gjika, emrat e të cilëve i takojnë pa dyshim antroponimisë shqiptare. (Frashëri 2005: 77).

Si përgjigje ndaj përfundimeve të Frashërit intelektual i vendos Jorgji shkruan:

Besoj se Z. Frashëri e ka fjalën për emrat Leka dhe Gjika kur i quan “të onomastikës shqiptare”.

Mbase së pari duhet sqaruar se Dhërmiu, nga është marrë argumenti ka (mos qofsha i gabuar) me tepër se 30 kisha [Jorgji i referohet kishave dhe në veçanti kapelave të vogla, shn. i N.G.B.] dhe Himara (qendra e banuar) ka mbi 80 të tilla. Të thuash se mbishkrimi i bërë në njërin prej tyre në greqisht, provon se banorët e Dhërmiut, janë shqiptarë, nuk më duket tepër normal. (Jorgji 2006a: 5)

Jorgji thekson se në muret e kishave të vogla dhe të kapelave në Dhërmi/Drimades gjenden 8 mbishkrime, dhe shton:

Theofan Popa ka botuar librin “Mbishkrime të kishave në Shqipëri” dhe ka raportuar vetëm për Dhërmiun mbi tetë shkrime në po aq kisha. (Shënimi i sjellë nga z. Frashëri është nr. 826 në libër dhe ndodhet në faqen 303). Por edhe kisha e Shën Premtes ka të njëjtat emra edhe e Gjon Theologut, edhe e Ungjëllimit, e Shën Thanasit. Çështja e emrave të tillë si Lek, Gjon, Gjika edhe nga shkencëtarë shqiptarë (shih Androkli Kostallarin) – janë cilësuar të adaptuar dhe me prejardhje. Mbase duhet sjellë në kujtesë se emrat shqiptarë janë Bardhyl, Teuta, Dardan, etj etj. Kam përshtypjen se Z. Frashëri është shpejtuar në nxjerrjen e argumenteve. (po aty)

Frashëri dhe Jorgji i përcaktojnë emrat e përveçëm sipas përkatësisë kombëtare, kurse historiani britanik Winniffrith shkruan:

Shkrimet greke janë të rralla, gjë që është për të ardhur keq, nëse na intereson ruajtja e bashkësisë grekëfolëse në krahinën e Himarës/Himara, Pogonit dhe disa vendeve të tjera në krahinën e Sarandës. Dëshmitë për





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

këtë mund të gjenen vetëm në traditën popullore dhe mbishkrimet greke në muret e kishave të vjetra. Por asnjëri prej burimeve të përmendura nuk vërteton ruajtjen e gjuhës greke pas pushtimit të Shqipërisë në shek. e 14. dhe ndërhyrjen e osmanëve në shek. e 15. (Winnifrieth 2002: 102)

Përveç gjuhës dhe përkatësisë kombëtare, objekt mosmarrëveshjeje mes autorëve lokalë dhe atyre kombëtarë janë edhe emrat e njerëzve dhe të vendeve. Nga sa u tha më lart është e qartë se në sfondin e mosmarrëveshjeve mbi përkatësinë e banorëve të krahinës së Himarës/Himara janë ndryshimet ekonomike, politike demografike dhe gjeomorfologjike që kanë shkaktuar shpërnguljen e njerëzve, dyndjet e popujve (normanët, bullgarët dhe turqit), zhvendosjet tektonike, ndryshimet në ndarjen administrative dhe politike të njerëzve dhe vendeve në krahinën e Himarës/Himara. Por në shumicën e debateve të autorëve lokalë dhe kombëtarë vazhdimësia e këtyre lëvizjeve dhe shpërnguljeve shpesh injorohet. Në vend të saj autorët theksojnë të konceptuarit kombëtar dhe lokal brenda të cilit flasin për çështjet e formimit kombëtar dhe atij lokal.

### Heroi kombëtar Skënderbeu

Në shek. 15, kur fuqia e pushtetit osman dhe islamizimi po zgjerohej nëpërmjet Evropës Juglindore, shpërnguljet në krahinën e Himarës/Himara vazhdonin. Me gjithë dyndjet e parreshtura të ushtrisë osmane në krahinën e Shkodrës, Lezhës, Durrësit, Vlorës, Himarës/Himara dhe Sarandës, himarjotët i ruajtën marrëdhëniet tregtare me Republikën Veneciane. Disa prej tyre iu bashkuan ushtrisë veneciane si mercenarë dhe bashkëpunuan në kryengritjen kundër fuqisë osmane (Jacques 1995: 172).

Në historiografinë bashkëkohore të Shqipërisë shek. 15 njihet si ai i Gjergj Kastrioti Skënderbeut që mes viteve 1443-1468 luftoi kundër pushtetit osman. Popullariteti i tij u zgjerua veçanërisht në kohën e komunizmit, kur historiografët nacionalistë i atribuonin një kuptim kombëtar dhe e quajtën mbrojtës të Shqipërisë dhe të shtetasve të saj (Glenny 2000: 43). "Figura dhe veprat e tij u bënë një përzierje faktesh, të vërtetash, gjysmë të vërtetash, trillimesh dhe folklori" (po aty). Disa historiografë (p.sh. Jacques 1995: 187-188) pohojnë se Skënderbeu ishte i lidhur me islamin, kishën ortodokse dhe atë katolike në Romë, kurse historiografët pro shqiptarë theksojnë "neutralitetin" e tij fetar dhe e lidhin me idetë nacionale, apo të ashtuquajturin "shqiptarizëm" (Frashëri 2005:29-38; Malltezi 2004: 111-112, 123).





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Historiografia shqiptare nuk i përmend lidhjet e Skënderbeut me krishtërimin dhe Republikën Veneciane. Në kohën e komunizmit transformimi i Skënderbeut në hero kombëtar ndihmoi në krijimin e kontinuitetit kombëtar dhe forcimit të idesë së pavarësisë shqiptare nga “e kaluara osmane” (Glenny 2000: 43). Nga njëra anë kjo i afroi shtetasit shqiptarë me Evropën dhe nga ana tjetër shërbeu për të fituar simpatinë dhe mbështetjen e fuqive të mëdha evropiane (Glenny 2000: 43, pjesërisht edhe Winnifriith 2002: 101).

Në botimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Luan Malltezi shkruan si më poshtë:

Himara, si çdo krahinë e vendit, ka histori të lidhur ngushtë me atë të të gjithë vendit. Le të kujtojmë këtu luftën e shqiptarëve nën udhëheqjen e Skënderbeut në shek. XV... Ata (himarjotët) kanë ruajtur brez pas brezi edhe këngë për vdekjen e Skënderbeut, ku thonë se presin kthimin e tij... Për himarjotët mund të thuhet edhe diçka tjetër e veçantë. Ata janë ndër shqiptarët që kanë fiksuar në kujtesën e tyre se janë pasardhës të Aleksandrit të Madh dhe të Pirros. Pasardhës të Pirros e ka quajtur veten edhe Skënderbeu dhe bashkë me të gjithë shqiptarët në shekullin XV. (2004: 121-122)

Malltezi pohon se banorët e Himarës/Himara ishin luftëtarë me vlerë në ushtrinë e Skënderbeut, ata luftuan kundër pushtetit osman, gjë që më vonë çoi në formimin e kombit shqiptar. Nga njëra anë thekson njësimin e banorëve të Himarës/Himara me shqiptarët (“himarjotët janë shqiptarë, që në kujtimet e tyre popullore), në anën tjetër pranon dallimet mes tyre, të cilat duhen kapërcyer. Në fjalinë e fundit Malltezi përmend besnikërinë e himarjotëve, shqiptarizmi i të cilëve është ruajtur në kujtesën popullore. Për këtë i qëndruan të devotshëm Aleksandrit të Madh dhe Piroso që sipas shkrimeve të historiografëve të huaj (khs. Winnifriith 2002: 22), është i njohur si mbreti i Epirit.<sup>63</sup> Edhe pse është folur shumë<sup>64</sup> për përkatësinë e Aleksandrit të Madh dhe Piroso,<sup>65</sup> Malltezi i përshkruan si paraardhës të

63 Për Malltezin të dy heronjtë i përkasin popullit shqiptar. Mbreti Piro mendohet të ketë jetuar rreth shek. 3 p.e.s dhe se ishte i afërm me Aleksandrin e Madh (Winnifriith 2002: 22). Meqë ushtarët e vet i emërtoi “bijtë e shqipës”, edhe vetë njihet me emrin “Shqiponjë” (Jacques 1995: 116).

64 Më shumë për këtë shiko Danforth (1995: 33-38, 43-48).

65 I ati i Gjergj Kastriot Skënderbeut, Gjon Kastrioti, iu kundërvu pa sukses sulmit të parë osman. Për këtë sulltani mori peng tre djemtë e tij që më vonë luftuan si jeniçerë në ushtrinë turke. Pas mbarimit të akademisë ushtarake Gjergj Kastriot Skënderbeu i solli shumë fitore ushtrisë osmane. Bëmat dhe fitoret e tij ushtarake krahasoheshin shpesh me ato të Aleksandrit të Madh. Për këtë Skënderbeut i vunë nofkën Arnavutlu Iskender Bey, ose Aleksandri i Madh. Më vonë Skënderbeu iu kundërvu osmanëve. Njëri nga biografët më të njohur të Skënderbeut ka qenë Marin Barleti që mes viteve 1506 dhe 1510 botoi në Romë





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Skënderbeut dhe se i përkasin popullit shqiptar.

Një interpretim disi të ndryshëm për rolin e burrave të Himarës/Himara kundër ushtrisë osmane bën historiografi lokal Spiro Rusha:

Himarjotët morën pjesë në radhët e ushtrisë së Skënderbeut qysh në betejën e parë të Torviollit, në vitin 1444, kundër forcave të njërit prej gjeneralëve më të mirë të Sulltanit, Muratit të II, të komanduara nga Ali Pasha. Në këtë betejë derdhën gjakun shumë himarjotë, midis të cilëve dhe komandati i tyre. Sa kohë jetoj Skënderbeu, himarjotët, si nënshtetas të tij besnikë, morën pjesë në të gjitha betejat e udhëhequra prej tij. Pas humbjes fatale të shkaktuar nga vdekja e papritur e tij (1468), Himara i priti me luftë forcat turke që u sulën për të pushtuar krahinën. (Rusha 2001: 41)

Malltezi dhe Rusha i konsiderojnë banorët e Himarës/Himara si luftëtarë me vlerë të ushtrisë së Skënderbeut. Ndryshe nga Malltezi, që shpirtin e tyre luftarak e përshkruan si shprehje të shqiptarizmit të tyre, Rusha shikon tek ata çelësin për ruajtjen e autonomisë dhe lokalizmit identifikues të banorëve të Himarës/Himara. Nën dritën e premisave të Malcomit për përhapjen e mitit të luftrave të vazhdueshme (2002: 73), si Rusha ashtu dhe Malltezi krijojnë mitin e luftrave të parreshtura kundër pushtetit osman dhe në përputhje me këtë përhapin idenë e unitetit të banorëve të Himarës/Himara.<sup>66</sup>

“Luftra të parreshtura”: Kryengritjet kundër regjimit osman

Me përjashtim të disa zonave të largëta dhe të paarrishme malore në krahinën e Mirditës në Veri dhe të disa vendeve në Jug të Shqipërisë mes shek. 14 dhe 15 pjesa më e madhe e Shqipërisë ishte nën regjimin e administratës osmane. Pjesa më e madhe e Shqipërisë së Veriut ishte e ndarë në njësi administrative të quajtura sanxhak dhe të dokumentuara në deftere (librat e taksave) (shiko Winnifrieth 2002: 99; shiko edhe Voje 2006). Nën administratën turke ishin dhe sanxhaku i Gjirokastrës, Sopotit, Klisurës, Belgratit (Beratit), Tomorincës, Iskraparit, Pavlos, Kurtikut, Çartalos

librin me titull *Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut princit të epirotëve*. Në vitin 1967 vepra e tij u përkthye në shqip (Barleti 1967).

66 Në faqen e internetit Youtube gjenden shumë filmime që zbulojnë kontradiktat e përkatësisë së Skënderbeut popullit grek apo atij shqiptar (<http://www.youtube.com/watch?v=2VcMfNDXYkl&mode=related&search><http://www.youtube.com/watch?v=j5h0vUhZnnc&mode=related&search>).

E emërtojnë si Aleksandri i Madh “i dytë” (<http://www.youtube.com/watch?v=WgPO3JRbaeo&mode=related&search>). Seria e spektakleve me titullin Portokalli, të transmetuara në televizionin kombëtar, është një parodi e këtyre debateve kontroverse ([http://www.youtube.com/watch?v=j4\\_j7-yYay8](http://www.youtube.com/watch?v=j4_j7-yYay8)).





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

dhe Akcahisar. Sanxhaku i Gjirokastrës ishte i ndarë në nahijet e Sopotit, Himarës/Himara, Vagaynetia dhe Lahtakasou (në jug të Pogonit) (po aty).

Pavarësisht nga pikëpamjet e ndryshme të studiuesve – lokalë (Rusha 2001: 56-57; Jorgji 2006a: 4-6 dhe 2006b: 18), nacionalë (Pollo dhe Puto 1981: 88-89; Thëngjilli 2004: 147) dhe studiuesve relativisht neutralë (Winnifrith 2002: 104-105) të gjithë studiuesit dhe autorët janë të të njëjtit mendim se krahina e Himarës/Himara së sotme ka qenë e pavarur nga administrata osmane. Për pavarësinë e banorëve të Himarës/Himara Winnifrith ka shkruar:

Tre krahina në Shqipëri kanë pasur pozitë të veçantë. Sot në të treja këto jetojnë grekë ose vllahë. Këto janë fshatrat bregdetare afër Himarës, fshatrat vllahë afër Voskopojës në lindje, dhe fshati Dhrovjan në Sarandë. Dëshmitë janë disi të dyshimta, por në të tre këto zona ka një numër të bindshëm kishash, që tregojnë një shkallë të caktuar lirie dhe pasurie. (Winnifrith 2002: 104)

Pas vitit 1537, kur burrat e krahinës së Himarës/Himara e mundën ushtrinë e sulltan Sulejmanit të parë të Madhërishtë, pavarësia e kësaj zone u forcua më shumë. Historiografët shqiptarë Pollo dhe Puto (1981: 88-89) shkruajnë se ushtrinë e Sulejmanit e drejtonte veziri i madh Ayez Pasha, të cilit sulltani i kishte dhënë urdhër t'i shfaroste të gjithë burrat e Himarës/Himara për të siguruar daljen në Itali. Këtu përshkruhen bëmat heroike të burrave të Himarës/Himara, që u zhvilluan nga vera në vjeshtë kur ushtria turke u tërhoq (Pollo dhe Puto 1981: 89). Njësoj si Himara/Himara edhe banorët e Dukagjinit, Mirditës, Shpatit dhe Labërisë e fituan me luftë pavarësinë dhe të drejtën e ruajtjes së vetadministrimit lokal, ose të venomesë<sup>67</sup>. Bashkë me himarjotët atyre nuk u duhej të respektonin listën e gjatë të detyrimeve (rayah) sipas rregullores, por duhej gjithsesi t'u paguanin turqve haraçin, taksat, gjë që simbolizonte nënshtrimin ndaj tyre (po aty).

Historiografi Spiro Rusha (2001: 57) nga Qeparoja përmend më shumë të dhëna mbi pavarësinë e Himarës/Himara që atëherë, ashtu si sot, përfshinte tetë fshatra: Palasë, Dhërmi/Drimades, Ilias, Vuno, Himarë/Himara, Pilur, Kudhes dhe Qeparo. Fshatarët e ruajtën vetëadministrimin deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Pozita e pavarur e saj presupozonte të drejtën për vetëadministrim lokal, emërimin e *kapedanëve* apo komandantëve, armatimin dhe vizitën e sulltanit të Delvinës në Vlorë, flotën e lirë me anijet e tyre, eksportin pa pagesën e taksave si dhe përfaqësuesin e tyre në oborrin e sulltanit në Stamboll. Përveç të drejtave statusi i pavarur i banorëve të Himarës/Himara parashikonte

<sup>67</sup> *Venome* ose ligj i pashkruar në të cilin bazohej administrimi lokal i një zone të caktuar (Pollo dhe Pluto 1981: 293).





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

edhe detyrime, si pagimin e haraçit që e paguante *kapedani* i fshatit dhe detyrimi për të luftuar për ushtrinë turke nën flamurin e tyre sa herë që do t'u kërkohej (po aty).

Thëngjili, që është bashkëautor i botimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ka shkruar se himarjotët kanë marrë pjesë edhe në forcat ushtarake të Napolit dhe në shtete të tjera thjesht për arsye politike dhe ekonomike:

Edhe pse himarjotët e fituan me luftë pavarësinë e provincës së tyre, shfrytëzonin çdo bashkëpunim ndërkombëtar me forcat krishtere, Spanjën, Napolin, Austrinë, Rusinë etj. (Thëngjili 2004: 147-148, përkth. i përkth. të përmbledhjes në anglisht NGB)

Ky bashkëpunim ka pasur vetëm një qëllim, "shporrjen e osmanëve nga Ballkani", pasi:

Himarjotët shprehën gadishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në të gjitha aksionet për shporrjen e osmanëve nga Ballkani. Në të shumtën e rasteve u besuan premtimeve, por në fund mbetën vetëm para osmanëve, me përjashtim të disa rasteve të rralla që u mbrojtën falë bashkëpunimeve duke siguruar fitore të sigurta. (Thëngjili 2004: 149 përkth. i përkth. të përmbledhjes në anglisht NGB)

Studiuesit e përmendur më lart janë të një mendimi se banorët e Himarës/Himara në shek. 16 ishin të pavarur. Por shkrimet e tyre dallojnë nga mënyra e interpretimit, pasi ndjekin interesat kombëtare apo lokale. Neutrali Winniffrith mendon se gjuha greke dhe numri i madh i kishave është treguesi kryesor se kjo krahinë ishte autonome dhe e pavarur nga forcat osmane. Pollo dhe Puto i përshkruajnë himarjotët si luftëtarë të guximshëm që luftuan kundër turqve për të ruajtur autonominë e tyre, kurse Rusha përshkruan me hollësi autonominë dhe pavarësinë e tyre që përfshinte një sërë të drejtash dhe detyrimesh që i ruajtën deri në Luftën e Dytë Botërore (1941). Thëngjili ka një mendim disi të ndryshëm nga këta kur shkruan se autonomia e këtyre banorëve është rrjedhojë e kontakteve dhe tregtisë me shtetet përtej detit që atyre u solli përfitimin ekonomik dhe ruajtjen e fesë.

### Lëvizje njerëzish dhe vendes

Sipas shkrimeve të studiuesve të huaj (Mazower 2001: 26-29, Winniffrith 2002: 103), karakteristikë për shek. 15 dhe 18 janë lëvizjet dhe shpërnguljet e banorëve në vendet përtej detit ose në brendësi të Shqipërisë së sotme të Veriut dhe Jugut (Winniffrith 2002: 103). Atëherë numri i fshatrave të territorit të atëhershëm të Himarës/Himara u zvogëlua ndjeshëm.





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Rusha (2001: 43) përshkruan shpërnguljet e shumta të banorëve të Himarës/Himarë. Shumë prej tyre u shpërngulën në Sicili, në Palermo, ku themeluan vendbanimin *Piana dei Greci* (katundi grek). Emri lidhej me banorë, pjesa më e madhe e të cilëve ishin ortodoksë që shpesh e quanin veten grekë (Derhemi 2003:1017). Më vonë ky vendbanim u quajt *Piana degli albanesi* (Hora e arbëreshëve) që sot banohet nga arbëreshët. Këta në komunikimin e përditshëm përdornin dialektin jugor të shqipës me greqizma të shumtë dhe elemente leksikore siciliane (Derhem 2003: 1021-1022). Shumë historiografë mendojnë se arbëreshët kanë qenë banorët e parë të Shqipërisë. Rusha (2001: 43) në veprën e tij pohon se në vendbanimin *Piana degli albanesi* përveç arbëreshëve u shpërngulën edhe banorët e Himarës/Himara. Kjo duket nga lagjja me emrin Himarjotët.

Në shek. 17 shumë të rinj nga krahina e Himarës/Himara vijuan shkollën ushtarake në Napoli dhe më vonë shërbyen si ushtarë mercenarë në ushtrinë e Napolit. Kronisti britanik Corner shkruan në dokumentet zyrtare të vitit 1670 se ushtria mbretërore e Napolit kishte rreth 200 ushtarë mercenarë nga Himara/Himara. Shumë prej tyre pas daljes në pension u kthyen në vendlindje, ku gëzuan pensionin ushtarak mujor nga ushtria e Napolit (Mbretëria e Sicilisë) deri në vdekje (Corner 1670, te Zamputi dhe Pulaha 1990:399). Edhe udhëtari me origjinë britanike Leake (1967: 12) përmend se në fillim të shek. 19 rreth 100 banorë të Himarës/Himara merrnin pensionin ushtarak nga ushtria e Napolit.<sup>68</sup>

Përveç shpërnguljeve në Sicili, Himara/Himara karakterizohet edhe nga shpërnguljet në Italinë e Veriut ku shërbyen në ushtrinë e Republikës së Veneciës. Në vitin 1685 diplomati italian Contarini shkruan kështu për ta:

Venecianët i nxisnin himarjotët të luftonin kundër osmanëve dhe në vend që t'i dorëzoheshin atyre, duhej t'u paguanin haraçin. Me këtë ushtria veneciane siguronte qasje në territorin osman. Nxitja dhe ndihma e Republikës Veneciane ishin të mirëseardhura mes banorëve të Himarës, pasi territori i tyre nuk ishte shumë pjellor. Duke i shërbyer venecianëve, ata siguronin mjetet që u duheshin për të jetuar. Duke marrë pjesë në ushtrinë mercenare, banorët e Himarës ruanin kontaktet me venecianët. Përveç këtyre kontakteve ata kishin marrëdhënie tregtare edhe me

68 Leake shkruan: "Në fshat jetojnë rreth 100 pensionistë të mbretërisë së Napolit, së bashku me oficerët në pension që e marrin pagën nga komandanti Zakha; ky e viziton çdo vit Korfuzin, ku merr pagat nga konsulli i Napolit. Ai merr një pension mujor prej 12 dukatësh për shërbimin e tij ushtarak, katër për punën e tij ndërmjetësuese dhe tetë dukate në muaj për vejtashat e ushtarëve të vrarë në luftë. Përqindja e lartë që ai merr nga kjo punë e lehtë i jepet për të garantuar sigurinë e funksionit të tij si një burrë me influencë në këtë krahinë. Zakho-Ghiorgji gëzon te të gjithë reputacionin e kryetarit të Khimarës, përveç atyre që janë në anën e Liganates dhe që, kuptohet, kanë për kryetar Alexodhemini." (Leake 1967: 12).







## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Korfuzin që atëherë bënte pjesë në Republikën e Veneciës. (Contarini 1685, te Zamputi dhe Pulaha 1990: 350, përkth. i përkth. të N.G.B).

Ngjashëm me Contarinin shkruan edhe Cardoni (1685):

Venecianët rekrutuan shumë himarjotë, gjë që u kushtoi jetën, por edhe u mbrojtën prej venecianëve. Pasurinë ua besuan bashkëvendasve, pasi për vite me rradhë tregtuan me Korfuzin. Premtimet e venecianëve i nxitën himarjotët të merrnin pjesë në luftën e tyre kundër kryetarit të Delvinës, i cili kishte 1500 princa dhe 400 kuaj. Himarjotët i mundën dhe për ta provuar fitoren i sollën gjeneralit kokat e tyre. (Cardoni 1685, te Zamputi dhe Pulaha 1990: 350, përkth. i përkth. të N.G.B.).

Rusha (2001: 49) pohon se në shek. 17 për shkak të luftrave të vazhdueshme mes osmanëve dhe banorëve të Himarës/Himara, aty pati një uri kaq të madhe sa që vendasit hanin rrënjë bimësh, pasi s'kishte gjë tjetër. Meqë bashkëpunuan me venecianët në shumë luftra kundër osmanëve, në kohën e mjerimit i kërkuan ndihmë Republikës së Veneciës duke shpresuar se do të bëheshin pjesë e saj.

Përveç venecianëve, banorët e Himarës/Himara i kërkuan ndihmë edhe monarkisë austriake, më vonë bashkëpunuan edhe me gjeneralin Orlo dhe Rusinë.

Përhapja e islamit e bëri të pamundur zgjerimin e krahinës së Himarës dhe e dobësoi mundësinë e rezistencës së himarjotëve kundër administratës osmane. E kësaj periudhe është edhe kërkesa e himarjotëve për ndihmë drejtuar perandoreshës Elizabetë (1759), perandorit austriak (1785), etj. Në vitin 1750 himarjotët lidhën një marrëveshje me Veneciën dhe e çliruan kështjellën e Sopotit, por Venecia i la në baltë. Kur në vitin 1770 gjenerali rus Orlo pa përpjekjet e himarjotëve, në përputhje me interesat ruse, i nixiti të gjithë të krishterët në Shqipërinë e Jugut që të bashkëpunojnë në luftën kundër muslimanëve. Dhe himarjotët mbetën përsëri "duar zbrazur". (Thëngjilli 2004: 148-149, përkth. i përkth. të përmbledhjes në anglisht të N.G.B.)

Këta studiues flasin për shpërnguljet dhe bashkëpunimin e banorëve të Himarës/Himara me ushtrinë napoletane dhe veneciane, gjë që ishte vazhdim i sulmeve të parreshtura të ushtrisë osmane mes shek. 16 dhe 18. Me gjithë këtë Rusha dhe Thëngjilli i interpretojnë këto ngjarje në kuadrin e interesave të veta: kështu p.sh. Rusha përmend shpërnguljen e shumë himarjotëve në Palermo, ku dhe ngritën vendbanimin *Piana dei greci*, dhe përmend disi i kursyer në fjalë se venecianët ua kishin kthyer kërkesën himarjotëve për t'u bërë pjesë e Republikës së Veneciës. Kurse Thëngjilli e komenton disi me sarkazëm se: "Venecia e la [Himarën/Himara] në baltë".





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

### Ali Pashë Tepelena

Në shek. 18 fuqia dhe kontrolli i oborrit filloi të dobësohej. Në gjysmën e dytë të shek. 18 territori i Shqipërisë së sotme ndahej në dy pashallëqe<sup>69</sup>, Shkodra dhe Janina. Me krijimin e pashallëqeve në Shqipëri lindi klasa feudale (Pollo dhe Puto 1981: 94-95), që ishte e pavarur nga shtesa feudale turke. Kjo ndarje shkaktoi kontradikta mes feudalëve shqiptarë dhe pushtetit qëndror osman (Pollo dhe Pluto 1981: 94-95).

Pashallëqet ishin njësi relativisht autonome, të udhëhequra nga sundimtarët e emëruar në oborrin e sulltanit. Sipas burimeve historike pashallëku me qendër në Janinë përfshinte Shqipërinë e Jugut dhe Epirin në Greqi. Ai udhëhiqej nga Ali Pashë Tepelena që dinte shumë pak turqisht. Me qenë se pavarësia e tij shihej si “e rrezikshme”, pushteti i Stambollit nuk e donte (Jacques 1995: 249-250).

Me dobësimin e pushtetit osman në gjysmën e dytë të shek. 18, pashallëku autonom u nda në katër vilajete: Shkodër, Kosovë, Manastir dhe Janinë. Në vend të komandës feudale ushtarake, oborri osman njohu latifondistët feudal (pronat e mëdha), që u zhvilluan shumë shpejt në kohën e pashallëqeve (Pollo dhe Pluto 1981: 104). Me ndarjet politike dhe administrative vazhduan edhe shpërnguljet dhe udhëtimet e banorëve të Himarës/Himare; këto ishin më shumë të lidhura me lidhjet tregtare, sezonale dhe punët me kontratë.

Disa fshatarë të moshuar të Dhërmiut/Drimadesit (të lindur mes viteve 1930 dhe 1940) kujtojnë rrëfimet e gjyshërve të tyre që përshkruajnë shpërnguljen e detyrueshme të fshatarëve nga Ali Pashë Tepelena për në Salaora<sup>70</sup> në gjirin e Artës në Greqi rreth vitit 1810, kur ai dha urdhër për zhvillimin e Salaorës në një port të rëndësishëm të gjirit të Artës. Në atë kohë në Salaorë u përhap epidemia e gripit spanjoll<sup>71</sup> që morri shumë jetë. Me gjithë përpjekjet e Ali Pashës që t'i dënonte banorët e Dhërmiut me punë të detyrueshme në Salaorë dhe vdekjeve të mundshme nga

69 Pashallëk quhej territori që gjatë regjimit osman gjendej nën administrimin e Pashës. Pashallëku nuk përkonte me territorin që ishte në kompetencat e administratës së shtetit turk (Pollo dhe Puto 1981: 291).

70 Hammond (1967) pohon se Salaora në periudhën e dominimit të Ali Pashës ishte një ishull.

71 Gripin spanjoll apo *influenza pandemic* (lat.) e shkaktoi një virusi i fortë dhe vdekjeprurës i pazakonshëm influenza A, i përhapur në vitet nga 1918 deri në 1920. Në historinë e njerëzimit gripi spanjoll vlen si epidemia më shkatërruese, pasi brenda 18 muajve shkaktoi vdekjen e 50 deri 100 milionë njerëzve. Në dallim nga epidemitë e tjera të gripit që godasin kryesisht fëmijët, të moshuarit dhe njerëzit me shëndet të dobët, viktimat e gripit spanjoll qenë njerëz të rinj dhe të shëndetshëm (<http://who.int/mediacentre/factsheets/fs211/en/>).





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

gripi spanjoll, disa fshatarë gjithsesi mbijetuan. Pas rënies së Ali Pashës pasardhësit e tyre u shpërngulën në malin e Pogonit në Epir, ku ngritën fshatin Drimades.

Shpërngulja e detyrueshme e banorëve të Dhërmiut/Drimadesit përmendet edhe në veprat e vendasve Kristo Dede dhe Foto Bixhili si dhe në udhëzuesin turistik në internet të krahinës së Himarës/Himara ([www.himara.eu](http://www.himara.eu)). Duke iu referuar Dedes Bixhili e përshkruan kështu këtë ngjarje:

Periodha e shpërnguljes dhe e mërgimit në përmasa të mëdha, mbaron me shpërnguljet e detyruara të himarjotëve të Nivicës e të Shën Vasilit në Trikalë dhe Tesali dhe të dhrimadhiotëve në moçalishtet e Sallahorës, afër Pargës, në pranverën e vitit 1810, nga Ali Pashë Tepelena. Nga ky fshat u shpërngulën rreth 2500 frymë, sipas K.Dedes, shumica e të cilëve vdiqën nga kushtet e vështira dhe malarja. Një pjesë e vogël, ndoshta pas vdekjes së Aliut, nuk u kthyen më. Ata u vëndosen në malet e Pogonit, ku ruajtën dhe emrin e fshatit të origjinës. Në Dhrimadhe, u kthyen në shtator të vitit 1822, rreth 700 frymë, nga të cilët 180 femra. (Bixhili 2004: 84)

Në prezantimin turistik të Himarës zhvendosja sistematike e banorëve të Dhërmiut/Drimadesit përmendet kalimthi:

Ali Pasha u mundua t'a nënshtronte Himarën me të gjitha mjetet që kishte në dispozicion, ta ngushtonte lakun rreth rrajonit, ta zaptonte dhe shkatërronte Himarën, t'i dëbonte banorët në Salaorë pranë Artës si dhe të ndërtonte kështjellën Panormos në rrënojat e kështjellës dhe manastirit të vjetër për të kontrolluar himarjotët ([www.himara.eu](http://www.himara.eu), dhjetor 2007).

### Udhëtarët e huaj

Që në fillim u përmendën disa udhëtarë të huaj, p.sh. poeti Bajron, shkrimtari angez Leake dhe piktori Lear që në vitet 1809 dhe 1810 udhëtuan nëpër Epir. Kujtimet e udhëtimeve të tyre kanë qenë njëri prej burimeve që kanë krijuar shpesh paragjykime, pikëpamje ekstreme dhe përgjithësime, të cilat kanë krijuar te lexuesi në "Perëndim" imazhin publik për të ndryshmen dhe të tjerët (Todorova 1997: 62-63).

Edhe shkrimet e udhëtarëve britanikë Lear (1988 [1851]) dhe Leake (1967 [1835]) bëjnë pjesë tek ajo literaturë në bazë të së cilës "lexuesit perëndimorë" kanë krijuar paragjykime për "të ndryshmen himarjote". Studuesit me prirje prolokale dhe pronacionale i citojnë ata dhe i interpretojnë në fuksion të interesave të tyre.

Si shembull dhe për t'i kuptuar më mirë ata, vijnë disa paragrafë të Lear-it dhe Leake-ut:





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

E gjithë turma e shtëpisë, me nipër dhe kushërinj të shumtë, ishte mbledhur në oborr dhe priste të na përshëndeste kur hymë në oborr nga ku kaluam në kuzhinë, ku gratë e shtëpisë na përshëndetën me ndrojtje, gjë krejtësisht e zakonshme për kë jetonte në familje të tilla orientale. (Lear 1988: 136).

Për një person që e njeh mirë gjuhën greke (që këtu e flasin pothuajse të gjithë ose të paktën e kuptojnë), do të kishte qenë tepër interesante të udhëtonte nëpër Himarë [*Khimára*] dhe të mblidhte informata të sakta për traditat dhe jetën e këtyre njerëzve primitivë. Vetë arrita t'i marr disa informata nëpërmjet italishtes që e përdor shumica e banorëve të Vunosë. Kur e pyeta Anastasin se a do të hanin darkë me ne edhe nëna dhe gruaja e tij, mora vesh se gratë asnjëherë nuk hanin me burrat. Gjithsesi gruaja e tij Maripol dikur ka qenë i rëndësishëm. Të gjithë banorët e Himarës janë me origjinë greke dhe flasin dialekt grek edhe pse banorët e vendeve ku kalova janë shqiptarë dhe kristianë, me përjashtim të disa familjeve, p.sh. Kasneci. Himarjotët e këtushëm pohojnë se vendi i tyre ka gjashtëdhjetë e dy kisha (Lear 1988: 139, *pjerrtas* në origj.)

Të gjitha shtëpitë në Himarë janë prej guri të errët dhe kanë shenja që tregojnë për kohë më të mira; në çdo anë ka grumbuj rrënojash dhe shumë plera. Muret e shtëpisë janë të kohërave të ndryshme dhe tregojnë se ky akropol dikur ka qenë i rëndësishëm. Të gjithë banorët e Himarës janë me origjinë greke dhe flasin dialekt grek edhe pse banorët e vendeve ku kalova janë shqiptarë dhe kristianë, me përjashtim të disa familjeve, p.sh. Kasneci. Himarjotët e këtushëm pohojnë se vendi i tyre ka gjashtëdhjetë e dy kisha (Lear 1988: 144).

Duket se vitet e arta të lirisë në Himarë kanë qenë ato të pushës nga Vlora, para se Aliu të zaptonte të gjithë Shqipërinë; nga dominimi i tij kjo racë e shqetësuar u vyshk dhe u thye: "I shërbejmë sultanit", thonë; kur i pyesim a janë shqiptarë apo turq përgjigjen: "Asgjë prej këtyre, ne jemi himarjotë." (Lear 1988: 147-148)

Emri i Himarës [*Khimára*] përdoret në përgjithësi për të gjithë kreshtën e malit të quajtur Acroceraunia, nga kepi i Qefalit te ai i Glossit, përfshirë dhe luginën e Orikumit. Nga jugu në veri vendet gjenden me këtë renditje: Nivítza, Lúkovo, Pikérnes, Sopotó, Kieperó, Khimára, Vunó, Dhrymádhës, Palása dhe Dukádhës ... Të gjitha këto vende kanë doke dhe zakone gjysmëbarbare. Greqisht flasin pothuajse të gjithë meshkujt, kurse italisht flasin ata që kanë jetuar jashtë; gratë në përgjithësi përveç shqipes dinë shumë pak ndonjë gjuhë tjetër. (Leake 1967: 88).

Nivítza është e banuar nga muslimanët Liape, gjendet në majë të shkëmbit dhe rrethohet nga lugina dhe përrenj. Muri i lashtë rrethues dhe kështjella janë pjesërisht të ruajtura mirë. Të gjithë ata që e kanë parë murin janë të një mendimi se ngjan me disa ndërtime helenike që sot shërbejnë si themele për shtëpitë e reja në Himarë. Përveç emrit, këto





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

rrënoja dëshmojnë pamëdyshje se Khimára shtrihet në të njëjtin vend si Himera [*Chimæra*], gjë të cilën mendoj se e ka vënë re vetëm Plini. (Leake 1967: 89-90)

Rami Memushaj, një prej atyre studiuesve që fjalët e Leak-ut i ka interpretuar në përputhje me pikëpamjen kombëtare pro shqiptare, pohon:

“Greqishtja flitet pothuajse nga të gjithë burrat, ndërsa italishtja prej atyre që kanë qëndruar atje, kurse gratë, në përgjithësi, dinë pak nga secila gjuhë, por kryesisht flasin shqip” (Leake 1967: 88).

Me islamizimin e fshatrave në brendësi të kësaj zone dhe rrudhjen e krahinës së Himarës në 14 e pastaj vetëm në shtatë fshatra të krishtera, përpjekjet për greqizimin e saj nëpërmjet kishës dhe shkollës greke u shtuan. Pas largimit të misionarëve bazilianë nga Himara, Patriarkana dhe despotët grekë nuk kishin më pëngesa për të çelur aty shkollat e tyre. Kjo është periudha kur në fshatrat e krahinës, sidomos në Himarë, Dhërmi, Palasë dhe më pak në Qeparo, fillon ekspansioni i greqishtes, që shfaqet në përdorimin e saj në të gjitha funksionet: si gjuhë e kishës, e shkollës, e marrëdhënieve tregtare, madje edhe si gjuhë e komunikimit të përditshëm. (Memushaj 2003: 169)

Të njëjtat gjëra përmend Frashëri që në njërin prej shkrimeve të tij, të botuar në fillim të Korrieri (dhejtor 2004) dhe më vonë edhe në njërin prej kapitujve të librit të tij (2005), e interpreton Leakun në kuadrin e qëndrimit pro shqiptar:

Sikurse shihet midis historianëve shqiptarë dhe atyre grekë ka pikëpamje të kundërta në tre drejtime [*Palasë, Dhërmi/Drimades* dhe *Himarë/Himara*]. Sipas të parëve, banorët e këtyre tre fshatrave i përkasin kombësisë shqiptare dhe e kanë greqishten si gjuhë të dytë, sipas shkrimtarëve helenë ata i përkasin kombësisë greke dhe e kanë shqipen si gjuhë të dytë. E dyta, sipas të parëve idioma greqishte e këtyre tre fshatrave ka depërtuar nga jashtë në kohët e vona, sipas të dytëve ajo është me origjinë mesjetare, madje antike. E treta, të parët [*pra historianët shqiptarë*] e besojnë konstatimin e vëzhguesit të mprehtë anglez W. M. Leake, i cili pasi vizitoi Himarën më 1804 thotë: “Pothuajse të gjithë burrat dinë greqisht dhe ata që kanë qenë në kurbet flasin edhe italisht; por gratë përgjithësisht s’dinë asnjë gjuhë tjetër veçse shqipes” kurse të dytët nuk e kanë kundërshtuar me argumenta pohimin e M. Leake, i cili e thotë shkoqur se greqishtja në kohën e tij nuk ishte gjuhë familjare. (Frashëri 2005: 15)

Intelektuali vendas Kristaq Jorgji mbështet pikëpamjen e kundërt në përgjigje të Frashërit, botuar në të përditshmen *ABC* (1 prill 2006a):

Për Likun duhen bërë disa shënime të nevojshme. Së pari, natyrisht është për t’u theksuar se ndryshe nga Liri (Edward Lear), Liku dinte shqip sepse





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

ka bërë edhe një studim për fonetikën shqipe, nëse s'gabohem. Por dëshmia e tij, për mendimin tim, ka një të metë, pasi ai ka qëndruar vetëm një ditë në Himarë, dhe sipas zakonit të asaj kohe gratë nuk dukeshin para mysafirëve. (Vetë Liri shkruan pak më vonë në kohë për të njëjtin zakon "Kur e pyeta Anastasin (shoqëruesi i Lirit nga Vunoj KVJ) se përse gruaja dhe nëna e tij nuk erdhën për drekë, ai u përgjigj se gratë nuk hanë kurrë me burrat, porse gruaja e tij, Marina, do të vinte dhe do të rrinte gjatë drekës". Natyrisht që ekziston dhe mundësia që Lik të ketë dëgjuar bisedën e bërë nga gratë në kuzhinë, por ka vënd për të dyshuar për vërtetësinë e pohimit. Në tekstin anglisht të tërheq vëmëndjen edhe fakti tjetër se tërë vëllazëritë e Himarës, ai i jep në gjuhën greke. Kështu Zaho Jorgji, i shkruar në tekstin anglisht Zakho –Ghiorgi është raportuar edhe në greqisht si Ζαχαρίας Γεωργίου; fisi Koykadhes jepet si Κωυγκάδδεις, ndërsa kreu Andrea Pollo jepet në anglisht si Andrew Polus dhe në greqisht si Ανδρέας Πόλλος.

Por duke u kthyer tek ato që kanë shkruar Liri dhe Liku, një gjë është e qartë – se për të dy anglezët himarjotët kanë folur gjuhën greke. Por duhet thënë, se sado vëzhgues të kenë qenë, për të dy ata koha e qëndrimit në Himarë ka qenë tepër e shkurtër. Liri ka fjetur vetëm katër netë (datë 24, 25, 26, 27 Tetor 1848 - respektivisht 3 netë në Vuno dhe një natë në Palasë), ndërsa Liku ka fjetur në Himarë vetëm në datën 11 dhjetor 1804). Ndaj ata mund të merren në konsideratë, por nuk janë tepër të besueshëm, nëse do të kemi dëshmi të tjera. (Jorgji 2006a: 5)

Në vazhdim Jorgji i referohet misionarit Nilo Borgio dhe Skiroit:

Relacioni i tretë për vitet 1730-1735 thotë "Himara, Provincë malore e Epirit që shtrihet me dy pothuaj-krahë malesh midis Vlorës dhe Delvinës, mbi humnerat e të cilave shtrihen shumë fshatra (it. terre), përmes qytetit peshkopal të Himarës (it. Citta Vescouile di Cimarra, që i jep krahinës emrin e saj; dhe përveç qytetit të vetë Himarës, dhe Dhërmiut (it. Drimadhes) dhe Palasës të banuar nga Grekë; të tjerët janë Shqiptarë, nënshtruar Portës Osmane".

Pra nuk është një njoftim i vetëm siç thotë z. Frashëri, gjithnjë sipas atyre që ka shkruar Nilo Borgia. Dhe do të tërheqim vëmëndjen edhe një herë për elementin kohë që përmendëm në rastin e udhëtarëve anglezë. Skiro nuk është kalimtar ditësh në Himarë- përkundrazi - ai vjen në Himarë në vitin 1716 e qëndron deri në 1729, dhe më pas në periudhën 1730-1735. Pra ai ka një përvojë shumëvjeçare në krahinë dhe nuk mund të hidhet poshte aq lehtë me frazën " nuk është në gjëndje të shpjegohet" siç shkruan z. Frashëri. Ai duhet marrë në konsideratë serioze dhe me precedencë. Sepse ka kontakt të konsiderueshëm me himarjotët, në një kohë e cila minimalisht është 1000 herë me e madhe se sa ajo e Lirit dhe 5000 herë më e madhe se e Likut. Besoj se nuk duhet të zgjatemi më tepër. (Jorgji 2006a: 5)





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Kujtimet e udhëtimeve të Leakut dhe Learit bazohen kryesisht në bisedat e tyre të shkurtra me vendasit dhe mbështeten nga pohimet e autorëve antikë (Plinij). Përshkrimet nga Leaku dhe Leari të kësaj krahine, të arkitekturës, gjuhës, kulturës, përkatësisë dhe origjinës së banorëve janë të përmendura shpesh në veprat e studiuesve bashkëkohorë. Kur Memushaj dhe Frashëri përmendin fjalët e Leakut për gjuhën e vendasve i shkëpusin ato nga konteksti. Në shkrimet e tij Leake përshkruan arkitekturën helene të krahinës së Himarës/Himara. Jorgji si mbështetës i interesit lokal e kritikon interpretimin e Frashërit dhe e akuzon atë se manipulon me të dhënat me të cilat i mashtron lexuesit e vet. Jorgji e vazhdon debatin e vet me argumente që e forcojnë interesin prolokal. Të tre shkrimtarët bashkëkohorë nuk i përmendin periudhat e shpërnguljeve të shumta, zhvendosjen dhe ndarjen e njerëzve dhe të vendeve si pasojë e pushtimeve të parreshtura osmane dhe ndarjes administrative të territorit nga ana e tyre. Pikërisht këto pra përbëjnë nxitjen e mospërputhjeve dhe kontradiktave të sotme që përshkojnë studimet e përmendura të autorëve bashkëkohorë.

### Rilindja – Zgjimi kombëtar

Në gjysmën e parë të shek. 19, kur mes intelektualëve shqiptarë në mërgim lindën idetë e formimit të shtetit kombëtar shqiptar, shumica e territorit të Shqipërisë dhe Evropës Juglindore ishte ende nën regjimin osman. Disfatat e shumta të ushtrisë osmane e dobësuan pushtetin e tij ekonomik, administrativ dhe ushtarak. Për ta forcuar kontrollin mbi territoret e saja dhe për ta konsoliduar më shumë sistemin e taksave, në vitin 1839 administrata osmane filloi të zbatonte reformat e Tanzimatit (Vickers 1999: 25). Atëherë vilajeti i Janinës ndahej në pesë sanxhaqe: Janina, Preveza, Gjirokastra, Berati dhe Larissa (Winniffrith 2002: 121). Në kuadrin e këtyre reformave u themeluan miletet, apo njësitë administrative, që i kategorizonin banorët sipas përkatësisë fetare (ortodoksë, katolikë, çifutë dhe vllahë) (Winniffrith 2002: 122).

Prifti në trajtesën e tij të botuar në përmbledhjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë e përcakton vilajetin si një krahinë në bazë të së cilës u krijua më vonë shteti shqiptar:

Në burimet arkivore, jo vetëm osmane, por edhe në burimet e vendeve evropiane (austro-hungareze, franceze etj.), mjaft nga të cilat kanë pasur si objekt analizën e përbërjes kombëtare të popullsisë së vilajetit të Janinës (të Shqipërisë së Jugut), nuk vihet në dyshim kombësia shqiptare e popullsisë së Himarës e të fshatrave të saj...





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Në një nga dokumentet e nxjerra nga Biblioteka e Firences, që i takon muajit tetor të vitit 1500, thuhet: “Himara është një vend i rrethuar me male, aty fillojnë malet e Epirit, që quhen Akrokeraune (Akroceraune), banorët e këtij vendi janë ilirë, që tani quhen shqiptarë (Accole e jus Illyri, quos nune Albaneses)” (Dokumente për historinë e Shqipërisë 1479-1506, pjesa e dytë (1499-1506): 217). Në këtë dokument pranohet pa asnjë mëdyshje përdorimi si gjuhë amtare i gjuhës shqipe nga himarjotët, ndërsa gjuha greke ishte gjuhë krejt e huaj për ta...

Në mjaft dokumente venedikase të shek. XVI, që bëjnë fjalë për qëndresën kundërosmane të himarjotëve, dëshmohet qartë përkatësia e tyre etnike shqiptare. (Prifti 2004: 156)

Jorgji e kritikoi këtë lloj përkatësie:

Në shumë shkrime historike shpesh ndihet era (apo furtuna) e kohërave moderne. Me këtë dua të them se shumë nga ata që shkruajnë mendojnë se bota e Turqisë, apo ajo e Lashtë, është si koha e sotme – me shtete me pasaporta dhe me viza. Ky është një vështrim tepër i cekët. Duhet të risjellim në kujtesë se deri në shekullin XVIII nuk kishte kombe dhe as shtete, siç i kemi sot. Edhe Greqia e lashtë, për të dhënë një ilustrim, është një entitet i përbashkët vetëm në lojrat Olimpikë, e pas mbylljes së tyre Sparta, Athina, Teba, Megara ndërmjet tyre qenë po aq armiq sa edhe Persët. Në librin “Vëzhgime lliro-Shqiptare” të përpiluar nga Ludwig van Thalloczye të përkthyer nga Mustafa Merlika Kruja citohet se “Deri në 1726, emri shqiptar ishte i panjohur në krahinën e Shkodrës dhe deri sodi s’kemi asnji provë që të jetë njohur në ndonji tjetër krahinë të Shqipërisë”. Siç shkruan Castellan “Do të ishte pra tepër e thjeshtëzuar të përfytyrohej, siç bënin historianët nacionalistë të shekullit XIX, një qëndrueshmëri blloqesh etnike që të justifikonin kufij modernë të paprekshëm”. (Jorgji 2006a: 6)

Ndarjet administrative osmane të njerëzve dhe vendeve në historiografinë moderne interpretohen nga këndvështrime të ndryshme. Njëri prej tyre është i lidhur me kuptimin e kombësisë. Siç u përmend edhe në kapitullin hyrës (*Ndarja e njerëzve dhe e vendeve*), shumë autorë panë në sistemin e mileteve themelin e shteteve të ardhshme kombëtare. Njësoj si këta autorë i trajtojnë miletet, Prifti trajton vilajetet. Shkrimet e tij ilustrojnë përpjekjet për riinterpretimin e së kaluarës dhe ripërcaktimin e kombësisë. Jorgji e trajton në mënyrë kritike Priftin dhe i tërheq vëmendjen për irrilevancën e diskutimeve mbi përkatësinë kombëtare në fillim të shek. 19, kur kufiri shtetëror në territorin e Shqipërisë së sotme nuk ekzistonte.







## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

### Krijimi i shtetit kombëtar shqiptar dhe protokollit i Korfuzit (1914)

Më 28 Nëntor 1912, kur Ismail Qemali shpalli pavarësinë e Shqipërisë, u themelua dhe Principata e Pavarur e Shqipërisë. Ajo ishte nën kontrollin e fuqive të mëdha (Franca, Perandoria Ruse, mbretëria e Britanisë së Madhe dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës). Pavarësia u shpall në vendlindjen e Qemalit në Vlorë, në kohën e Luftës së Parë Ballkanike mes grekëve dhe osmanëve (1912-1913). Në maj 1913, pas mbarimit të Luftës Ballkanike, çetat greke pushtuan Janinën dhe pjesën dërrmuese të territorit të Shqipërisë së sotme të Jugut. Shkodra u pushtua nga ushtarët malazezë (Winnifrith 2002: 129). Mes Luftës së parë (1912-1913) dhe të dytë (1913) Ballkanike banorët e Shqipërisë së sotme kishin këndvështrime të ndryshme për përkatësinë e tyre (po aty): disa prej tyre donin të qëndronin nën mbrojtjen e administratës osmane, të tjerët u përpoqën t'i bashkoheshin Greqisë. Te këta të fundit mbizotëronin ortodoksët e Shqipërisë së Jugut. Ndër ta ishin edhe banorët e Himarës/Himara, të cilët protestuan kur u konfirmuan kufijtë e sotëm të Shqipërisë në vitin 1913, pasi donin të bashkoheshin me Greqinë.

Në tetor të vitit 1914 ushtria greke marshoi zyrtarisht në Shqipërinë e Jugut dhe e pushtoi Himarën/Himara, Gjirokastrën dhe Korçën (Jacques 1995: 359). Kurse Winnifrith (2002: 131) njofton se banorët e territorit të pushtuar të Shqipërisë së Jugut e pranuan mirë administratën greke, Jacques (duke iu referuar Gramenos) përmend qëndrimin brutal të ushtrisë greke ndaj popullatës së këtushme. Pak pas kësaj u mbajt Protokollit i Korfuzit ku u shpall pavarësia e qeverisë së Epirit që do të kishte përfshirë krahinën e Himarës/Himara, Gjirokastrën dhe Epirin e sotëm në Greqi. Qeverinë e re autonome e konfirmoi edhe princi gjerman Wilhelm zu Wied, i cili nga 21 shkurti deri më 3 shtator 1914 u vu në krye të Principatës së Shqipërisë. Qeveria e pavarur e Epirit pati një flamur me ngjyrë të kaltër dhe të bardhë dhe një shqiponjë të zezë në mes. Ky simbol u arrit të përdorej zyrtarisht vetëm në pullat postale (po aty). Marrëveshja e Korfuzit nuk zgjati shumë, u ndërpre nga Lufta e Parë Botërore që filloi zyrtarisht në korrik të 1914.

Pas vitit 1912 kufiri shtetëror mes Shqipërisë dhe Greqisë u bë subjekt bisedimesh dhe mosmarrëveshjesh ndërkombëtare mes shumë shteteve. Atëherë qeveria "e përkohshme" shqiptare u përpoq t'i bashkonte disa pjesë të Epirit me Shqipërinë, kurse udhëheqja politike greke këmbëngulte për ta bashkuar një pjesë të Shqipërisë së Jugut me Greqinë (shiko Winnifrith 2002: 130). Në faqet e internetit të bashkisë së Himarës/Himara, në rubrikën mbi historinë e kësaj zone ngjarjes së shpalljes së pavarësisë





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

së Shqipërisë i bën hije përshkrimi i heroit lokal Spiro Milo, luftëtarit të guximshëm për pavarësinë, çlirimtarit të krahinës së Himarës/Himara dhe të Shqipërisë nën regjimin osman, gjë që Himarës i solli autonominë.

Më 5 nëntor 1912 majori Spiros Spiromilos nga Himara drejtonte çetën e vullnetarëve të Himarës dhe të xhandarëve nga Kreta që zbriti në Himarë dhe e çliroi atë. Në ditët në vijim mund ta kishite çliruar të tërë shtetin. ([www.himara.eu](http://www.himara.eu), vizituar herën e fundit në dhjetor 2007)

Spiro Milo përmendet edhe në shkrimet e Frashërit. Në dallim nga përmbajtja në faqen e internetit, Frashëri nuk e përshkruan atë si çlirimtar të Himarës/Himara, por si një luftëtar të aftë dhe të stërvitur mirë në Napoli:

Një nga oficerët e regjimentit ishte kapiteni Spiro Milo, një himarjot i shkolluar në Akademinë Ushtarake të Napolit, i cili nuk kishte mësuar ende mirë greqishten. Spiro Milo me disa qindra vullnetarë himarjotë, dhermiotë, palasiotë dhe të tjerë kaluan menjëherë në Greqi dhe morën pjesë në kryengritjen çlirimtare deri në përfundimin e saj. Në sajë të gradave dhe shpërblimeve të tjera për kontributin që ata dhanë në fitoren e saj disa nga këta vullnetarë qëndruan në Greqi, morën nënshpirtësinë greke, pa i ndërprerë lidhjet me vendlindjen. Shumica u kthyen, së bashku me dekoratat dhe greqishten, në vendlindjet e tyre. Kështu për disa kohë Himara u bë krahinë me banorë me tre gjuhë – shqipen, si gjuhë amtare, italishten dhe greqishten si gjuhë të dytë. (Frashëri 2005: 93-94)

Në përgjigje të Frashërit, Jorgji iu referua librit me kujtime të Eqerem Bej Vlorës, i cili doli në shtyp pas vdekjes së tij në veprën me titull *Kujtime* (2001). Në një artikull gazete Jorgji ka cituar një fragment kujtimi për Spiro Milon:

Ndërkaq i shkrova edhe një letër komandantit të trupave greke në Himarë, kolonel Spiro Spiro Milos (Milaj), i cili, fare pa u trazuar, i kish dhënë vetes titullin udhëheqës i Himarës (Archegos tis Himaros). Unë e njihja shumë mirë atë vetë dhe farefisën e tij që jetonte ende në Himarë; mund të them, madje, se kisha miqësi me ta. Ne na ndanin vetëm pikëpamjet politike dhe këtu ishim kundërshtarë. Andej nacionalistë grekë, të cilët nga fanatizmi fetar dhe prapambetja politike, përpiqeshin me të gjitha mënyrat, ta bashkonin Himarën me Greqinë, këtej një nacionalist shqiptar, por njëherësh edhe ithtar besnik i parimit shtetëror osman. Megjithatë, unë kisha respekt për këtë familje; ajo shquhej për karakter, besnikëri ndaj miqve, trimëri dhe qëndrueshmëri. Që letra ime në këto rrethana, nuk mund të kish asnjë ndikim, këtë e dija mirë. Sidoqoftë, unë shkrova se shqiptarët e krishterë apo myslimanë janë vëllezër, përmenda prejardhjen shqiptare të shtëpisë së tij dhe iu luta të mos shkaktonte gjakderdhje midis popullsisë së të njëjtit vënd, se ndryshe ne do të sulmojmë. Natyrisht





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

që nuk mora asnjë përgjigje, dhe në vend të saj, një repart i fortë kretohimarjot sulmoi Qafën. (Bej Vlorës 2001: 307, te Jorgji 2006a)

Në vazhdim Jorgji përmend se Spiro Milo iu përgjigj Bej Vlorës. Por kjo përgjigje është e panjohur për historiografinë shqiptare. Letra me përgjigjen e Milos është e botuar në veprën e historiografit italian Cassavetti (1914) *Hellas dhe luftrat ballkanike*:

Ju thoni se Italia dhe Austria do të vendosin principatën shqiptare; ne po presim ngritjen e saj dhe do të gëzohemi nëse kjo ngjet; pasi edhe në këtë rast ne do të tregojmë veten si vëllezër të kësaj principate, pasi ndjenjat tona fisnike janë po ato që kanë qenë dhe nuk do të ndryshojnë, sepse ne nuk harrojmë që ju jeni vëllezërit tanë që jeni ndarë nga ne duke mohuar besimin tone. Është vërtet e nevojshme të sjellim ndër mend se banorët e Kuçit para 90 vjetësh qenë të krishterë dhe se ata kanë të afërm ndër banorët e Himarës? Vetë emri i Gjolekës (i cili së bashku me Eqrem Bej Vlorën u kish dërguar letrën himarjotëve KVJ) tregon besimin që i përkisnin të parët e Shefqet Beut... E sa për kërcënimet tuaja, besoj se ato nuk janë as për Spiro Milon dhe as për banorët e Himarës, pasi edhe bijtë e Gjolekës e dinë se ne dimë ti përdorim Mauzerët dhe Martinët aq mirë sa edhe ata. Është dikush tjetër që kërcënon pas Gjolekës, duke u fshehur pas tij, por ai tjetri nuk ka luftuar as vetë dhe as të parët e tij. (Cassavetti 1914: 237-239, te Jorgji 2006a: 2,3)

Historiografi kombëtar Muin Çami (në trajtesën e tij në botimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë) e lidh heroin lokal Spiro Milo me lëvizjen separatiste në krahinën e Himarës/Himara që çoi në autonominë e saj. Statusi i autonomisë u konfirmua në vitin 1914 me nënshkrimin e Protokollit të Korfuzit nga ana e fuqive të mëdha. Çami përshkruan edhe dyzimin e banorëve të Himarës/Himara:

Banorët e Himarës ishin të ndarë në dy grupe. I pari dhe më i madhi mbështeste vendimet e parlamentit të Vlorës, kurse i dyti ndiqte lëvizjen separatiste pro greke. Grupin e separatistëve e drejtonte Spiro Milo që shpalli autonominë e krahinës. Spiro Milo ishte një njeri me rëndësi në lëvizjen separatiste të Shqipërisë së Jugut. (Çami 2004: 209, përkth. i përkth. të përmbledhjes në frengjisht i N.G.B.)

Nëse për shumicën e intelektualëve lokalë Protokollit i Korfuzit vërtetoi "të qenurit grekë" të banorëve të Himarës/Himara, në shkrimet e historianëve kombëtarë përmendet kalimthi (p.sh. Frashëri 2005) ose komentohet disi ndryshe (p.sh. Çami 2004: 196, Prifti 2004: 190). Kështu p.sh. Prifti banorëve të Himarës/Himara u atribuon një rol të rëndësishëm në kundërshtimin e bashkimit me Greqinë:

Pas shpërthimit nga "Aleanca Ballkanike" të Luftës Ballkanike kundër Turqisë, në tetor të vitit 1912 krahina e Himarës, si e gjithë Shqipëria e





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Jugut, u bë objekt i veprimeve pushtuese të Greqisë. Ushtria greke rrethoi Janinën dhe pa prituri përfundimin e luftimeve në këtë qytet, shtiu në dorë ishullin e Sazanit dhe në fund të nëntorit zbarkoi në Himarë, të cilën e pushtoi bashkë me disa fshatra përreth. Flota greke bllokoi Vlorën dhe e vuri atë nën kërcënimin e vet... Edhe në këto kushte të rënda të pushtimit grek shumica e popullsisë së krahinës së Himarës nuk iu nënshtrua trysnisë së agjentëve grekë, që synonin ta shkëpusin nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe e përkrahu atë. Në mbledhjen që mbajti në Vuno, më 14 mars 1913, pleqësia e krahinës së Himarës, duke iu përgjigjur të deleguarve të Qeverisë së Vlorës, Epaminonda Kolekës dhe Jani Mingës, i dërgoi një letër "Kuvenerit të Vlorës", në të cilën përshëndeste thirrjen e Kuvendit të Vlorës, ngritjen e flamurit kombëtar dhe formimin e Shqipërisë së lirë, që e vlerësonte edhe si një goditje të planeve të "Etniki-së" greke...

Edhe pas kësaj qëndrese të popullsisë së Himarës kundër pushtuesve grekë dhe përpjekjeve të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës (më 1912-1913) për dëbimin e tyre nga kjo krahinë, Greqia vazhdoi ta mbante atë të pushtuar edhe pas vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës (të 22 marsit dhe 11 gushtit të vitit 1913) për kufijtë veriorë, verilindor dhe jugor të Shtetit të Pavarur Shqiptar. Megjithatë, orvatjet e reja ushtarake dhe politike që Athina bëri gjatë viteve që pasuan për aneksimin e kësaj krahine dhe të Shqipërisë së Jugut në tërësi, dështuan. (Prifti 2004: 184, 186, 187)

Një imazh krejt tjetër ofrojnë redaktorët e faqes së internetit, që në vend të protestës së banorëve të Himarës/Himara shkruajnë për pavarësinë e saj:

Më 9 shkurt 1914 banorët e Himarës protestuan kundër planit të fuqive të mëdha për përfshirjen e fshatit brenda shtetit shqiptar. Deri më 1921, me gjithë administratën greke dhe pushtimin e ushtrisë italiane, Himara arriti ta ruajë autonominë e vet. (<http://himara.eu/index-en.html>, dhjetor 2007)

Nga sa u përmend më lart dalin qartë përcaktimet e ndryshme që i bëhen përkatësisë së banorëve të Himarës/Himara. Nga këndvështrimi lokal Himara/Himara përshkruhet si pjesë autonome e Greqisë; banorët e saj bënë përpjekje të mëdha për autonominë që më shumë lidhej me Greqinë sesa me Shqipërinë. Të ndryshme janë përshkrimet që rrezatojnë interesin nacional. Çami, p.sh. thekson mendime të ndryshme për bashkimin me Greqinë. Citimet ilustrojnë gjithashtu se si ngjarjet e së kaluarës, p.sh. Protokollin e Korfuzit, në veprat e mbështetësve të pozitës pro shqiptare nuk përmenden, kurse në veprat e mbështetësve të pikëpamjes prolokale zënë vend qendror. Po kështu janë edhe vlerësimet e rolit të heroit Spiro Mila: në faqet e internetit, që mbështesin interesat lokale ai përshkruhet si çlirimtar i Himarës/Himara nga dominimi proosman. Edhe Çami e përshkruan kështu Spiro Milon, por në qendër është roli i tij drejtues





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

në luftën çlirimtare. Çami thekson pikëpamjet e ndryshme të himarjotëve: shumica e vendasve mbështet pikëpamjet nacionaliste, kurse pakica ato separatiste. Frashëri që ka prirje pro shqiptare e përshkruan Spiro Milon disi ndryshe: që ka qenë mercenar në ushtrinë greke, që gëzoi të drejtën e pensionit të qeverisë greke. Jorgji e kritikon njëanshmërinë e Frashërit dhe mendon se mënyra e tij e të shkruarit i ngjan edhe studiuësve të tjerë që mbrojnë interesat kombëtare dhe theksojnë vetëm të dhëna të caktuara, të tjerat nuk i përmendin; si shembull citon korrespondencën mes Spiro Milos dhe Eqrem Bej Vlorës.

Korrespondenca e tyre shpreh mospajtimet mbi përkatësinë e himarjotëve. Bej Vlora përmend interesat pro greke të Milos, por gjithsesi e sheh atë së bashku me himarjotët si pjesë e popullit shqiptar. Në kundërshtim me këtë, Milo tërheq vëmendjen mbi shumëllojshmërinë dhe ndjenjat lokaliste të banorëve të Himarës/Himara: "Edhe nëse dëshmojmë se në këtë principatë jemi vëllezër, do t'i ruajmë idetë tona fisnike që do të qëndrojnë gjithmonë të njejtë." Bej Vlora dhe Milo bien dakord mbi lidhjen dhe vëllazërinë mes himarjotëve dhe banorëve të tjerë të Shqipërisë, por vëllazërimin e shohin në mënyra të ndryshme: Bej Vlora flet për përkatësinë kombëtare, kurse Milo për atë fetare. Arsyeja kryesore për divergjencat e tyre është kritika për citimet e njëanëshme dhe theksimin e fakteve të mbledhura.

### Lufta e Parë Botërore (1914-1919)

Qeveria italiane i dërgoi trupat e saja ushtarake në ishullin e pabanuar të Sazanit para se Italia të hynte në luftë më 1914. Në ditën e Krishtlindjeve ushtria italiane e pushtoi Vlorën dhe e justifikoi pushtimin si mbrojtje të përkohshme të territorit nga ushtria greke që u detyrua të largohej nga Shqipëria e Jugut (Jacques 1995: 360).

Në mars të 1915 qeveria italiane nënshkroi një marrëveshje të fshehtë me shtetet aleate, Britaninë e Madhe, Francën dhe Rusinë. Tre javë më vonë, më 26 prill 1915, trupat ushtarake italiane u bashkuan me ato të aleatëve. Me nënshkrimin e marrëveshjes udhëheqësit e fuqive aleate i premtuan Italisë një pjesë të Shqipërisë së Jugut (Vlorën, ishullin e Sazanit, krahinën rreth lumit Vjosë e deri në veri, lindje dhe jug të Shqipërisë, si dhe Himarën/Himara) (Pollo dhe Pluto 1981: 165-166; Jacques 1995: 360-361). Më 4 maj 1915 ushtria italiane hyri në luftë dhe administrata greke, që në bazë të Protokollit qeveriste në jug të Shqipërisë, u përmbys (Jacques 1995: 359). Ushtarët italianë hynë në Vlorë dhe e pushtuan të gjithë bregdetin jugor shqiptar. Kjo çoi në një krizë të përgjithshme ekonomike dhe uri në





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

këtë krahinë, gjë që shërbeu si arsye për shpërngulje të reja në Himarë/Himara dhe kudo nëpër Shqipëri. Gjatë pushtimit italian të burgosurit e austro-hungarisë e zgjeruan rrugën magjistrale që kalonte nëpër qafën e Llogarasë drejt fshatrave të Himarës. Riparimi i rrugës i përmirësoi lidhjet mes qytetit të Vlorës dhe Himarës/Himara.

Në vitin 1916 ushtria austriake e mundi ushtrinë serbo-malazeze që kishte pushtuar Shqipërinë e Veriut. Pas fitores Austria e pushtoi territorin e Shqipërisë së Veriut dhe të Mesme deri në lumin Vjosë në jug (Jacque 1995: 362-363), kurse Italia mbajti Vlorën dhe Gjirokastrën, ndërkohë që francezët pushtuan Korçën. Kufiri mes territorit që dikur i përkiste qeverisë autonome të Epirit dhe pjesës tjetër të Shqipërisë u shndërrua në fushë beteje mes ushtrisë austriake nga njëra anë dhe asaj franceze nga ana tjetër (Winnifriith 2002: 131).

Në vitin 1917 qeveria greke, e cila deri atëherë kishte ndenjur neutrale, vendosi t'i bashkohej aleatëve. Pak kohë më pas ushtria e saj e kontrollonte përsëri Janinën dhe territorin në rrethin e Solunit. Pothuajse deri në fund të Luftës së Parë Botërore ushtria greke komandonte në krahinën e dikurshme të Epirit të Veriut. Para përfundimit të luftës në vitin 1918 Epiri kaloi nën administratën italiane dhe franceze (Winnifriith 2002: 132).

Pas luftës kufijtë e Shqipërisë së sotme, të miratuara zyrtarisht në vitin 1913, u bënë përsëri subjekt bisedimesh. Qeveria Greke këmbëngulte mbi autonominë e Epirit të Veriut dhe bashkimin e territoreve të dikurshme të Perandorisë Bizantine. Plane të njëjta kishte dhe administrata italiane që po përpiqej të mbante Vlorën me rrethin e saj, kurse Serbia dhe Maqedonia përpiqeshin të merrnin veriun e Shqipërisë (Pollo dhe Puto 1981: 175; Jacques 1995: 366-367; Winnifriith 2002: 132-133).

Interesat e qeverisë italiane dhe greke çuan në nënshkrimin e marrëveshjes së fshehtë mes Tittonit dhe Venizellit. Ata lidhën fjalën se do ta ndihmonin njëri-tjetrin në arritjen e kërkesës së tyre për kontrollin mbi disa krahina të Shqipërisë së sotme (Pollo dhe Puto 1981: 175): ministri italian ia njohu qeverisë geke të drejtën për kontrollimin e Gjirokastrës dhe Korçës, kurse ai grek e mbështeste kërkesën e Italisë për të kontrolluar Vlorën (po aty). Fuqitë e mëdha e ratifikuan pothuajse këtë marrëveshje, që shkaktoi polemika dhe mospajttime të shumta te nacionalistët shqiptarë.

Mendimet e banorëve të Shqipërisë ishin të ndara. Përveç brezit të ri të nacionalistëve shqiptarë që kishin luftuar për pavarësinë e Shqipërisë, disa banorë dëshironin bashkimin me Italinë, të tjerë me SHBA-në, të tretët me Greqinë. Me gjithë objektivat e ndryshme shumica e tyre iu bashkua demonstratave në Vlorë më 28 nëntor 1919 (Pollo dhe Puto 1981: 176).





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Për ta vënë në jetë pavarësinë e Shqipërisë, një grup udhëheqësish kombëtarë u mblodhën në Kongresin e Lushnjes më 21 janar 1920. Delegatët e Republikës së Shqipërisë konfirmuan edhe njëherë kufijtë shtetërorë të caktuar në vitin 1913. Ata diskutuan gjithashtu edhe për gjendjen financiare të Shqipërisë, e shpërndanë qeverinë e përkohshme dhe zgjodhën të renë (Jacques 1995: 367-368). Qeveria e re përbëhej nga oficerë, ndër të cilët edhe Sulejman Bej Vlora, Alfred Zogu dhe Sotir Peci (po aty). Qeveria e re u angazhua për largimin e administratës ushtarake franceze në Korçë dhe asaj italiane në Vlorë. Ndërkohë që ushtarët francezë u larguan nga Korça në një periudhë relativisht të shkurtër, ata italianë vazhduan të qëndronin në Vlorë deri në kryengritjen e përgjithshme të këtij qyteti dhe vendeve rreth tij që çoi në Luftën e Vlorës (Pollo dhe Puto 1981: 178; Jacques 1995: 371).

Lufta e Vlorës është një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e Shqipërisë; edhe sot e kësaj dite është frymëzim patriotizmi, bashkimi dhe heroizmi i popullit shqiptar. Lufta shpërtheu më 1920. Përveç ushtrisë në Vlorë ajo përfshiu edhe bashkëvendësit nga shumë krahina të Shqipërisë. Lufta zgjati deri në nënshkrimin e marrëveshjes me qeverinë italiane që shpalli largimin e ushtrisë së saj, gjë që u realizua më 2 shtator 1920 (Pollo dhe Puto 1981: 179)

Kufiri mes Shqipërisë dhe Greqisë ishte një nga temat më të nxehta të politikës ndërkombëtare të viteve 1920-1925. *Meghali idea* (ideja e madhe) greke dhe përpjekjet për rifitimin e autonomisë së qeverisë së Epirit të Veriut u refuzua përsëri në Konferencën e Firences më 1925, ku u konfirmuan kufijtë e vitit 1914, gjë që nuk ishte në favor të delegatëve grekë (Winnifrith 2002: 132-133). Delegatët italianë këmbëngulnin në konfirmimin e kufijve të vitit 1913, kurse delegatët nga Britania e Madhe dhe Franca prezantuan kufijtë në favor të kërkesave për Epirin e Veriut të pavarur ku Voskopoja do t'i takonte Shqipërisë. Delegatët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ishin për kompromis, sipas të cilit qeveria greke do të merrte territorin që shtrihet nga Himara/Himara në Tepelenë me kufi lumin Vjosë (po aty). Winnifrith mendon se propozimi i SHBA ishte ndoshta ndër më të mirët, edhe pse "shumë banorë shqipfolës, simpatizues të Shqipërisë, disa grekëfolës dhe ata që favorizonin Greqinë, por ishin vendosur në Korçë", do të mbeteshin jashtë këtij territori (Winnifrith 2002:133).

Foto Bixhili (2004: 253) në librin e tij mbi historinë e krahinës së Himarës/Himara shkruan se njëri nga përfaqësuesit e zgjedhur të Kongresit të Lushnjes ishte dhe Spiro J. Koleka nga Vunoi. Bixhili e përshkruan si





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

heroin kryesor dhe nxitësin e Luftës së Vlorës që përfundoi me largimin e ushtrisë italiane nga Vlora dhe nga i gjithë territori i Shqipërisë.

Në këto rrethana, më 20 janar 1920, mbledhet Kuvendi Kombëtar i Lushnjës, i cili i bën edhe një herë të njohur botës se “Shqipëria është shtet i pavarur që më 28 nëntor 1912 dhe se shqiptarët nuk pranonin asnjë formë mandati apo kujdestari të huaj” (A. Ermenji, fq. 386).

Pas kësaj, me organet që krijoi dhe masat që mori, përshtypjet e Konferencës ndryshojnë. Në qeverinë e parë të dalë nga ky Kuvend, bën pjesë dhe vunjtësi Spiro J. Koleka. Është ky, që më pas bashkë me Osman Haxhiun e Qazim Kocullin do të jenë organizatorët e Luftës së Vlorës.

Dhe pas kësaj pëfundimet dihen. Të gjitha planet si dhe “Marrëveshja Titoni-Venizello” e datës 22 korrik 1920, prishen dhe më 2 gusht, konti Mazoni do të nënshkruajë Pavarësinë e Plotë të Shqipërisë, si dhe tërësinë tokësore të saj, të kufinjve të vitit 1913.

Nuk ishte “miqësia dhe simpatia e veçantë personale e ministrit të jashtëm italian Sforca me Mustafa Qemalin, që dënoi Marrëveshjen Titoni-Venizello, por kurajoja dhe vendosmëria e qeverisë shqiptare, që detyroi forcat greke të Trikupit të gozhdohen në lartësitë e Viglicës dhe të Kapshticës deri sa më 15 maj 1920, të nënshkruhet marrëveshja midis të dy palëve (V. Jeorgiju, fq. 277-278). Me këtë marrëveshje, në fakt, qeveria greke njehe qeverinë e Tiranës si dhe “heqjen dorë nga pretendiment e saj” (Bixhili 2004: 253-254).

Edhe Çami i cakton një vend të rëndësishëm heroit Spiro J. Koleka në historinë e Vlorës dhe të Shqipërisë në përgjithësi:

Ndëkaq në ngjarjet madhore që u zhvilluan në Shqipëri në mbarim të Luftës I Botërore, një vend të veçantë zë Spiro Gogo Koleka<sup>72</sup> me veprimtarinë e tij për mbledhjen e Kongresit të Lushnjës dhe për vënien në jetë të vendimeve të rëndësishme të këtij Kongresi. Në ato vite S. Koleka banonte në Vlorë dhe këtu ai u angazhua në luftën politike të kohës së bashku me figura të njohura të Vlorës, si Osman Haxhia (Nuriu), Jani Minga, Halim Xhelo dhe shumë të tjerë. Tok me këta ai ka hartuar dhe nënshkruar mjaft dokumente, dërguar përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në Konferencën e Paqes, si Presidentit të SHBA Vudro Uilsonit (Woodrow Willson), kryeministrit anglez David Llojd Xhorxh (David Lloyd George) etj. Në këto dokumente është shprehur vendosmëria e popullit të Vlorës për të kundërshtuar me çdo mjet sovranitetin italian.

Në këtë kohë (1990) në vend u zhvillua një lloj debati politik midis atyre që ishin për pranimin e protektoratit italian mbi shtetin shqiptar dhe kundërshtarëve që shpreheheshin për paprekshmërinë e pavarësisë kombëtare. Ky debat u pasqyrua edhe në Himarë. Në Vuno, nën ndikimin e vëllezërve Koleka, vepronte një grup i madh kundër protektoratit italian. Ky qëndrim iu shpreh edhe konsullit amerikan Josef Haven kur ky vizitoi

72 Foto Bixhili (2004: 253) e ka fjalën për Spiro J. Kolekën. Gogo është shkurtimi i emrit Jorgo.







## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

atëhere Himarën për qëllime vëzhgimi dhe për të informuar organet eprorë të tij. Protektorati italian, i miratuar në Konferencën e Paqes në formën e vendosjes së shtetit shqiptar të pasluftës nën mandatin e Italisë, u hodh poshtë nga Kongresi i Lushnjës. Delegatët e këtij Kongresi e zgjodhën Spiro G. Kolekën anëtar të Këshillit Kombëtar, siç quhej asokohe Parlamenti, çka ishte një tregues i vlerësimit të punës së tij në fushën e atdhetarisë. Në maj të vitit 1920, d.m.th. 3-4 muaj pas Kongresit, S. G. Koleka u caktua anëtar i qeverisë, duke i ngarkuar detyrën e mbajtjes së lidhjeve me Komitetin e Mbrojtjes Kombëtare të Vlorës, që po përgatiste luftën e armatosur çlirimtare kundër forcave italiane...

Lufta e Vlorës nisi në një kohë kur forcat ushtarake italiane ishin tërhequr nga brendësia e territorit shqiptar dhe ishin përqëndruar në zonën e fortifikuar të Vlorës me mendimin se kështu mund të përballonin ndonjë orvatje e shqiptarëve për t'u kërkuar me forcë autoriteteve italiane të hiqnin dorë nga planet e tyre për ta mbajtur Vlorën, Tepelenën dhe Himarën të ndarë politikisht nga pjesa tjetër e vendit, që ndryshe do të thoshte të hiqnin dorë nga mbajtja e tyre nën sovranitetin e Italisë...

Në mbarimin me fitore të Luftës së Vlorës S. Koleka, si njëri ndër mbështetësit me peshë të kësaj lufte dhe si himarjot, doli me fjalime publike, përmbajtja e të cilëve dëshmon për kulturën e tij dhe për vlerësimin e saktë që i bënte fitores së Luftës. Ai ka deklaruar përpara manifestuesve në Vlorë se me luftën e tyre ata "i kishin treguar botës së qytetëruar se Shqipëria është thënë që të rrojë dhe do të rrojë" dhe se me gjakun e derdhur u luajt "fati jo vetëm i Vlorës, por mund të them i gjithë Shqipërisë (Gazeta *Mbrojtja Kombëtare*, Vlorë, më 14. 8. 1920). (Çami 2004: 205-206)

Intelektuali lokal Rusha për të shkruan disi ndryshe:

Mbas luftës së parë Botërore dhe Kongresit të Lushnjës të vitit 1920, kur u rrëzua qeveria e Durrësit dhe u formua kabineti i Sulejman Delvinës me qendër në Tiranë dhe kur, njëkohësisht shpërtheu lufta e Vlorës, për dëbimin e pushtuesve italianë të cilët ishin vendosur në Vlorë qysh më 1914, Himara mbeti e veçuar dhe për arsye të gjendjes së acuar me autoritet e qarkut të Vlorës, e cila kish burimin qysh në kohën e luftrave ballkanike 1912-1913, mbasi autoritetet e Vlorës synonin t'i mohonin privilegjet e fituara gjatë pushtimit otoman, të cilat ishin rezultat i një lufte të përgjakshme shekullore. Për të zgjidhur këtë konflikt u arrit një marrëveshje paraprake midis qeverisë shqiptare dhe Himarës. U dërgua në Himarë si përfaqësues i qeverisë së Tiranës, deputeti i Vlorës Spiro G. Koleka, për të dëgjuar ankimet dhe kërkesat e himarjotëve, të parashtruara nga tre përfaqësues. Në përfundim të bisedimeve u arrit marrëveshja e mëposhtme, sipas së cilës shteti vendosi t'i bëjë "an princip" këto koncesione preliminare kahinës së lartpërmendur.





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

- I. Venomet e vjetra ekonomike për një pagesë të prerë të njihen.
- II. Feja: liri e plotë dhe pasuria e kishave të jetë e tyre.
- III. Arsimi: Gjuha shqipe do të jetë e domosdoshme (obligatoire) edhe zyrtare. Greqishtja të jetë e lirë të mësohet si gjuhë e dytë, kur populli të shfaqë dëshirën.
- IV. Shërbimi ushtarak: do të bëhet si në viset e tjera, por klasat e ndryshme që janë sot në moshë ushtarake edhe ato që do të hyjnë deri në vitin 1923 do thirren për stërvitje vetëm tre herë në muaj; pëgjithësisht shërbimi ushtarak i kësaj krahine do bëhet që nga Shkumbini e poshtë. Në kohë lufte do merren parasysht rregullat e përgjithshme të shtetit pa ndonjë eksepsion.
- V. Nënprefektura: Nënprefekti e komisari i policisë do të jenë kristianë dhe jo himarjotë.
- VI. Gjykatortja: Të këtë në Himarë një gjykatore jo më të vogël se pajtuese dhe kryetari do të jetë kristian dhe jo himarjot.
- VII. Deputetët: Himara ka të drejtë të ketë dy deputetë pa mos vështruar numrin e popullsisë.
- VIII. Amnisti: duke marrë parasysht ngjarjet e kohës anormale të shkuar jepet amnisti (falje) e plotë për të gjitha fajet penale e politike që kanë ngjarë deri sot.
- IX. Hollësira: për të shpjeguar dhe hollësitë e duhura do të vejë një komision në qeverinë qendrore.

Për himarjotët e lartpërmendur pranuar nga ana e Delegatit plotfuqie, për të marrë formën legale do të paraqitet në Parlament.

Vlorë 2 qershor 1921

Delegati i Plotfuqishëm  
(Rusha 2001: 121-123)

Disa prej kërkesave që u prezantuan nga Spiro Koleka para parlamentit në Vlorë përmenden edhe në përmbledhjen e Konferencës Panhimarjote (dhjetor më 2005 në Tiranë):

Është qeveria e Sulejman Delvinës që bëri tentativën e parë shqiptare për këtë qëllim. Për t'a bërë të shkurtër një histori të gjatë, qeveria e Sulejman Bej Delvinës, duke përdorur ndërmjetësinë e një Himarjoti të shquar, Spiro Koleka (i parë) u tërhoq dhe midis qeverisë dhe Himarjotëve u vendos një marrëveshje, disa prej pikave po i raportojmë më poshtë, sikurse janë raportuar nga autori S. Rusha:

- Njohja e venomeve të vjetra për një pagesë të prerë
- 2. Feja - liri e plotë dhe pasuria e kishave të jetë e tyre...
- ...





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

- 7. Himara ka të drejtë të këtë dy deputetë pa marrë parasysh numrin e popullsisë (Çakalli, Dhima etj. 2006: 226, me shkronja të nxira në origjinal).

Studiuesi anglez Pettifer e përmend Spiro Kolekën në njërin prej shënimeve të tij në raportin mbi minoritetin grek në Shqipëri:

Mes udhëheqësve të njohur shqiptarë të lëvizjes komuniste kishte dhe anëtarë që ishin pothuajse, ose pjesërisht, grekë, si njëri prej anëtarëve të byrosë politike Spiro Koleka, i cili ishte nga një vend kryesisht grek Himara. (Pettifer 2001: 18)

Të ky kapitull shpalosen përpjekjet e qeverisë italiane, greke, franceze dhe austriake për të marrë kontrollin mbi pjesë të ndryshme të territorit të Shqipërisë pas Luftës së Parë Botërore. Për t'i parandaluar aspiratat e tyre rilindasit shqiptarë organizuan lëvizjen kombëtare qëllimi i së cilës ishte themelimi i shtetit të pavarur kombëtar të Shqipërisë. Kur historianët bashkëkohorë përshkruajnë kohën e lëvizjes kombëtare, krijojnë mitet mbi homogjenitetin, unitetin dhe barazinë e pjesëmarrësve të saj, duke i përcaktuar qoftë si pjesë të shtetit kombëtar, qoftë të bashkësisë lokale. Në shkrimet e tyre ata ndërtojnë edhe mitin e heroit Spiro koleka. Historianët me prirje nacionaliste e paraqesin atë si hero kombëtar dhe luftëtar të guximshëm për pavarësinë e Shqipërisë. Kurse përshkrimet e autorëve lokalistë e paraqesin atë si çlirimtar të Himarës/Himara dhe luftëtar të bashkimit, homogjenitetit dhe pavarësisë së bashkësisë lokale në Himarë/Himara. Shkurt, të dyja këto këndvështrime e vendosin Kolekën në kontekste të ndryshme politike për të mbështetur argumentet e tyre, apo interesat e tyre. Mbështetësit e interesit pro shqiptar e lidhin atë me Kongresin e Lushnjes, rrjedhojë e së cilit qe edhe Lufta e Vlorës dhe çlirimi i Shqipërisë nga pushtimi italian, kurse për mbështetësit me prirje lokaliste konsiderohet si nismëtar i pavarësisë së Himarës/Himara.

### “Lëvizjet për demokracinë” (1920-1925)

Disa muaj pas largimit të çetave italiane nga Vlora, Sulejman Bej Delvina së bashku me udhëheqjen e tij administrative dha dorëheqjen dhe kryetari i qeverisë së re shqiptare u zgjodh Ilias Vrioni. Në këtë kohë u kthye në Shqipëri peshkopi Fan Noli që për shumë vite kishte jetuar në Boston, në SHBA. Noli ishte i njohur për aktivitetin e tij politik dhe përpjekjet për afirmimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe (Jacques 1995: 373). Në shkurt të vitit 1922 parlamenti shqiptar me nismën e tij e ratifikoi deklaratën për të drejtat e minoritarëve që i referoheshin banorëve grekëfolës në rrethinat e Gjirokastrës dhe Sarandës. Fshatrat e bashkisë së sotme të Himarës/





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Himara bashkë me fshatrat e rrethinave të Konicës mbetën jashtë zonës së minoritetit (Clayer 2003: 160 dhe 2006).

Më 2 dhjetor 1992 ministri i punëve të brendshme Ahmet Zogu u emërua kryeministër. Për shkak të fushatës së korruptuar zgjedhore të 27 dhjetorit 1923, Zogu me anëtarët e kabinetit të tij dha dorëheqjen një vit më vonë. Anëtarët e parlamentit shqiptar në vendin e kryeministrit emëruan Ilias Vrionin. Në qershor të vitit 1924 në Berat shpërtheu revolucioni demokratik që më vonë u përhap në vende të tjera të Shqipërisë (Jacques 1995: 380). Zogu u arratis për në Jugosllavi dhe pushtetin e mori në dorë partia demokratike e Fan Nolit. Qeveria e tij zbatoi shumë reforma, p.sh. zhvillimin e demokracisë, ndërprerjen e feudalizmit, zbatimin e reformës agrare dhe zvogëlimin e burokracisë (po aty). Edhe pse Noli ishte mbështetës i demokracisë, nuk pajtohej krejtësisht me përdorimin e gjuhës greke nëpër shkolla dhe kisha në Shqipëri. Qe një ndër nismëtarët e themelimit të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare të shpallur në Kongresin e Kishës Ortodokse që u mbajt në Berat më 10 shtator 1922 dhe që u konfirmua zyrtarisht nga Patriarku Ekumenik më 12 prill 1937 (Kondis dhe Manda 1994: 17-18; Jacques 1995: 397). Presidenca e Nolit nuk zgjati shumë. Më 14 dhjetor 1924 Zogu marshoi me ushtrinë e tij në Tiranë. Pesë ditë më vonë Noli shpalli gjendjen e jashtëzakonshme dhe më 26 dhjetor së bashku me disa përkrahës politikë u arratis për në Itali (Jacques 1995: 380).

Sipas informatave të Winnifrithit (2002: 134) historianët grekë nuk kishin simpati as për Zogun, pasi ishte musliman, as për Nolin, i cili gjatë qëndrimit në SHBA ishte përpjekur për pavarësinë e Shqipërisë. Kurse historianët shqiptarë në kohën e komunizmit e prezantuan si figurë pozitive dhe hero të rëndësishëm dhe rilindas kombëtar, pavarësisht nga pjesëmarrja në formimin e kishës ortodokse shqiptare. Përkundrazi, Zogu u prezantua si udhëheqës i regjimit “të keq”, të feudalizmit (po aty).

Në historinë bashkëkohore të krahinës së Himarës/Himara Noli dhe Zogu paraqiten negativisht. Siç përshkruan Bixhili, i cili është më afër interesit pro shqiptar, reformat e Nolit më 1924 shkaktuan revoltën e himarjotëve:

Në këto vite, dy janë figurat politike që luajtën rol në fatet e kombit dhe të krahinës, Theofan Stilian Noli (Mavromati) dhe Ahmet Zogu. Për periudhën që ata ishin në krye të shtetit shqiptar, ndodh dhe një “revoltë himarjote”. Përplasja e parë bëhet në fund të gushtit dhe fillim të shtatorit 1924, kur qeveria e Fanolit kërkon të vendosë detyrimet dhe kontrollin e shtetit mbi prodhimet dhe të ardhurat qytetare. Këto “revolta”, si dhe të mëpasmet e viteve 1932 dhe 1934-1937, kanë të njëjtin shtab drejtues...





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Të gjitha kryengritjet shpërthyen, pasi banorët e Himarës kërkonin të njëjtat privilegje siç i kishin pasur nën administratën osmane dhe më vonë si bashkësi grekëfolëse. Kërkonin të njiheshin si pjesë e minoritetit grek. (Bixhili 2004: 267-268)

Autori vendas Rusha në veprën e tij jep disi më shumë të dhëna mbi kryengritjen në Himarë/Himara:

Mbas revolucionit demokratiko-borgjez të qershorit 1924, kur A. Zogu me pasuesit më besnikë të tij u strehua në Jugosllavi mbasi vrau me anë të agjentëve të tij patriotin Avni Rustemi, u krijua qeveria demokratike e kryesuar nga Fan.S.Noli. Por qeveria e Nolit nga përbërja e saj nuk ishte e pastër. Në gjirin e saj kishte edhe bejlerë të cilët edhe pse nuk ishin implikuar në vrasjen e Avniut, nuk ishin për një qeveri, e cila të ndërmirte reforma demokratike. Në këto kushte, krahu i djathë i qeverisë dhe i parlamentit vazhduan të pengonin marrjen e masave për demokratizmin e vendit dhe të krijonin incidente për dobësimin dhe rrëzimin e saj. Një nga këto incidente ishte edhe orvajtja e organeve drejtuese të autoriteteve qeveritare të Qarkut të Vlorës kundër Himarës, të kryesuar prej Azis Çamit dhe Qazim Koculit, njëri komandant i xhandarmërisë së qarkut dhe tjetri prefekt i Vlorës. (Rusha 2001: 124-125)

Rusha vazhdon se shkaktarë për incidentin në Himarë/Himara ishin Noli dhe Zogu. Rusha përshkruan ngjarjen tragjike që shpërtheu kur vendasit e kundërshtuan urdhrin për pagesën e tatimit mbi tokën, ose xhelepin dhe tatimin mbi prodhimin:

Azis Çami urdhëroi xhandarët të përdornin forcën për ndalimin e grave të Himarës të hynin në vreshta. Gratë iu kundërvunë me kosore, sopata e cfurqe. Xhandarët vranë 2 gra dhe gratë plagosën dy xhandarë dhe një officer. Ngjarja ka ndeshur më 3 shtator të vitit 1924. (Rusha 2001: 124)

Në vazhdim Rusha citon një këngë popullore që përshkruan revoltën dhe vrasjen e dy grave vendase dhe komenton:

Ngjarja e vrasjeve të Himarës, acaroi gjendjen jo vetëm kundër Azis Çamit dhe Qazim Koculit, të cilët ishin inisiatorët e ndërmarrjes së aksionit, por edhe kundër qeverisë demokratike-borgjeze të Revolucionit të Qershorit dhe personalisht edhe kundër kryetarit të qeverisë, Fan.S.Nolit dhe anëtarëve të kabinetit të tij. (Rusha 2001: 126)

Këtë ngjarje e përmendin edhe autorët e botimit të Konferencës Panhimarjote:

Në 1924, është qeveria e Nolit, cilësuar si nga më demokratiket, që tenton të heqë venometë dhe me to edhe cilësitë e veçanta të krahinës. Në këtë histori hyjnë edhe dy personazhe të tjera - prefekti i Vlorës - Qazim KOCULI dhe komandanti i xhandarmërisë së qarkut të Vlorës Azis ÇAMI.





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Në qeverinë e Fan NOLIT u diskutua gjatë dhe u argumentua se në shtet unik nuk mund të këtë njësi autonome! Një argument, i cili edhe sot është aktual edhe pas 80 vjetësh dhe pas 50 vjet demokracie dhe pas kaq përvojash demokracie!!

Sidoqoftë, qeveria "demokratike" vendos të përdorë forcën dhe nis forcat e policisë. Në 3 Shtator 1924 xhandarët vranë dy gra dhe gratë plagosën dy xhandarë dhe një oficer. Si rezultat, qeveria heq dorë. Kjo ngjarje përjetohet edhe në këngën popullore himarjote. (Çakalli, Papa et al.: 226, me shkronja të mëdha shtypi edhe në origjinal)

Kurse historiani shqiptar Muin Çami – që (rastësisht) ka të njëjtin mbiemër si një prej nismëtarëve të revoltës në Himarë/Himara, Azis Çami – në trajtesën e tij në botimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nuk e përmend këtë ngjarje, por përshkruan dyzimin e banorëve të Himarës/Himarë:

Mes viteve 1921 dhe 1924 himarjotët ishin të ndarë në dy grupe. Njëri mbështeste forcat përparimtare dhe udhëheqjen demokratike dhe antifeudale [*Fan Noli*], kurse tjetri mbështeste konservativët [të moshuarit në Himarë/Himara] që këmbëngulnin në njohjen e disa të drejtave të veçanta që i kishin pasur në të kaluarën [ligjin e pashkruar *venome*]. (Çami 2004: 210, përkth. i përkth. të përmbledhjes në frëngjisht NGB)

Përsa u përmend më lart vërteton konstatimet e Schwandner-Sievers mbi historitë mitike, të ndërtuara në mënyrë të tillë që theksojnë disa ngjarje dhe evitojnë të tjerat për të mbështetur interesat aktuale. Brendësia e citimeve të mësipërme ilustron faktin se si një ngjarje e caktuar, p.sh. incidenti në Himarë/Himara, i përmendur nga autorët lokalë (shiko) Rusha 2001 dhe Çakalli, Papa etj. 2006) mitizohet dhe përdoret për ilustrimin e shpirtit luftarak dhe veçantisë së himarjotëve.

Kur studiuesit lokalë përshkruajnë incidentin theksojnë idenë e luftrave "të parreshtura", së pari kundër pushtetit osman dhe më vonë kundër krijimit të shtetit të pavarur shqiptar duke theksuar pavarësinë e vendasve. Të njëjtin stil ligjërimi përdorin edhe studiuesit pro shqiptarë dhe i përshkruajnë himarjotët si heronj që me shpirtin e tyre luftarak kontribuan në krijimin e shtetit kombëtar.

### Ahmet Zogu (1925-1939)

Pas emërimit të Ahmet Zogut si kryeministër Shqipëria u shpall Republikë. Më 32 janar 1925 Parlamenti Shqiptar e zgjodhi atë unanimisht President të Republikës. Republika e pavarur kishte flamurin e kuq me shqiponjën dykrenare në mes, shpalli shqipen si gjuhë zyrtare dhe Tiranën kryeqytet (Jacques 1995: 382). Qeveria centraliste e Ahmet Zogut, që bazohej në





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

bashkimin e shtetasve pa dallime mes Veriut dhe Jugut të Shqipërisë, vuri në zbatim një sistem të njësuar taksash. Udhëheqja e Zogut u përpoq për modernizimin e bujqësisë, zhvillimin e ekonomisë, përmirësimin e sistemit arsimor dhe përhapjen e ateizmit (Jacques 1995: 386). Në vitin 1928 Zogu u vetëshpall mbret. Në mbretërimin e tij tetëvjeçar u përpoq për standardizimin e gjuhës shqipe dhe zvogëlimin e dallimit midis dialektit verior dhe atij jugor (*geg* dhe *tosk*). Këtë e arriti me vendosjen e sistemit të njësuar shkollor. Më 1933 i ndërpreu të gjitha shkollat e huaja, greke, rumune dhe shkollën amerikane në Korçë (Jacques 1995: 382-393). Si shumë intelektualë të tjerë, Frashëri, Pashko Vasa, Andon Zako Çajupi etj, dhe rilindas të tjerë që jetonin në mërgim, edhe Zogu u përpoq të zhdukte çdo dallim fetar dhe bashkimin e popullsisë, por pikëpamjet e tija ishin konservative dhe bazoheshin në feudalizëm në krahasim me intelektualët demokratë.

Dallimi fetar i nisur në periudhën e pushtetit osman u bë sërish i dukshëm. Vetëm se këtë herë nuk u shfaqën në njësitë administrative (khs. mileti), por u njësuat brenda sistemit të shtetit kombëtar. Kështu numërimi i banorëve të Shqipërisë në vitin 1930 përfshinte edhe pyetjen mbi përkatësinë fetare, numëroheshin 70% muslimanë, 20% ortodoksë dhe 10% katolikë<sup>73</sup> (Jacques 1995: 396). Sipas vëzhgimeve të Jacques-it ndarjet fetare u bënë pjesë e të përditshmes së individit dhe të prezantimit të vetvetes. Kështu ata që përcaktoheshin si kristjanë, i quanin muslimanët tradhëtarë, ose “turq”, dhe ata që vetëpërcaktoheshin si muslimanë i përbuznin kristianët si “adhurues të ikonave”, “derra” dhe shpesh i quanin *kaur*, ose të pabesë, kurse katolikët ishin të bindur se “të gjithë muslimanët binin erë të keqe” (Jacques 1995: 396). Përshkrimi i dallimeve shoqërore në bazë të ndasive fetare që buronin nga ndarje të ndryshme administrative të njerëzve dhe vendeve, u ripërcaktuan në retorikën dhe në simbolet e njerëzve dhe u riformuan në jetën e përditshme të tyre.

Në librin për historinë e krahinës së Himarës/Himara Rusa nuk e trajton marrëdhënien e himarjotëve ndaj bashkimit fetar. Ai përshkruan pasojat e centralizimit të Zogut në bazë të të cilit himarjotët u detyruan ta ndërpresin vetëadministrimin lokal. Me këtë u shfuqizuan ligjet e pashkuara, d.m.th *venomi*, që caktoheshin dhe bilancoheshin nga fraksionet e posaçme të *soia*/fiseve ose *gerundhia*:

Me qëllim djallëzor ata sollën si argument pretekstin e tyre se tani jemi një shtet modern dhe ligjet, në përgjithësi duhet të jenë të njëjlojta në tërë territorin e tij; të ashtuquajturat venome të krahinës së Himarës, nuk

73 Numërimi i popullatës përfshiu edhe disa çifutë, protestantë, ateistë dhe disa të tjerë në kategorinë “tjetër” (Jacques 1995: 396).





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

kanë më vend. Duhet që edhe Himara t'iu nënshtrohet të njëjtave ligje, si të gjitha krahinat e tjera, pasi nuk jemi më në kohën e Turqisë, ku për krahina të ndryshme zbatoheshin ligje të ndryshme (si p.sh. për Himarën, Mirditën etj.) (Rusha 2001: 127)

Reagim ndaj ndërprerjes së venomeve nga Zogu qenë dy revolta të mëdha të vendasve. Ata kërkuan pavarësinë e krahinës dhe shpalljen e statusit të prefekturës:

Edhe dy herë të tjera gjatë regjimit të A.Zogut u tentua për suprimin e privilegjeve të N/Prefekturës së Himarës, një herë në vitin 1927 dhe herën tjetër në vitin 1932. Por duke u ndodhur përpara kundërshtimit të vendosur të popullit, dinaku A.Zogu (më vonë Zogu I), nuk e çoi çështjen deri në masa të skajshme. Të dy herët ai u tërhoq duke ia lënë përgjegjësinë autoriteteve vartëse, ndërsa ai vetë mbas peticionit telegrafik që iu drejtua nga paria e Himarës thirri një përfaqësues prej secilit nga të shtatë fshatrat dhe mbasi dëgjoi kërkesat e tyre deklaroi se nuk do të hiqeshin privilegjet e Himarës, se "Himarën, shtoi Ai, unë e kam si Matin"<sup>74</sup> (Rusha 2001: 128-129)

Njësoj raportojnë edhe të tjerët (Bollano, Milo etj.) në botimin e Konferencës Panhimarjote:

I dashtuni Mehdi Bej.

Shpresoj se Juve, Nyre Hanmi dhe gjithë Familja të jeni me shëndet të mirë, po dhe na të gjithë mirë jemi.

Kam fillue përgatitjen e memurëve, natyrisht kam shënime, porrë do të më pëlqentë një autoritet e q'í ka ndodhë në çështjet mbrëdna, të më japër sa shpjegime ma të gjona. Pra n'asht se do të keni mundësi të më jepni sa hollësina mbi këto pika qi po ju rendoj poshtë:

1. Veprimet e Komisionit Internacional të Korfizit më 1914
2. Mbi Dhenamet e Himarës
3. Veprimet e Komisionet Lidhjes së Kombeve në Shqipërinë e Jugut
4. Veprimet e Komisionit Delimitationit të Kufive
5. Vrasja e Gjeneral Telinit
6. Grindjet dhe përfundimi i Shën-Naumit dhe Vermoshit.
7. Këto në ka posibilitetin t'mi shkrueni jerësisht se, dot dëshiroshqe qe një personalitet që i ka dhanë. Shqiprisë shërbime të shkëlqyeshme.
8. Tue ju urue shëndet, Juve, Nyre Hanmit dhe gjithë Familjen ju marrë në grykë.

Cannes 20 Janar 1960

Zogu (firma) (Çakalli, Papa etj. 2006: 227)

---

<sup>74</sup> Mati është krahinë shqiptare ku familja e Zogut kishte autoritet feudal.







## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Përveç ndërprerjes së *venomesë*, Bixhili shkruan edhe për reformën e arsimit dhe raporton për ndarjen shoqërore të banorëve në grupin e të kuqe dhe të bardhëve:

Edukimi dhe arsimi i qytetarëve shqiptarë i përkiste shtetit. Arsimi fillor ishte i detyrueshëm dhe falas për të gjithë shtetasit, pa dallim seksi dhe besimi. Shkollat ekzistuese private, që kanë qenë në veprim deri sot, mbylleen (L. Spiru 1966: 180, përmbledhur sipas Bixhilit 2004: 281)

Ndryshe nga autorët lokalë, të cilët përmendin dhe komentojnë reformën e arsimit dhe pasojat e tjera që i solli mënyra e qeverisjes centralizuese të Zogut, Virion Koka përmend në botimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë lëvizjet irredentiste të vendasve të nxitura nga politikanët grekë:

Mes viteve 1920 dhe 1930 u shfaqën tensione të shumta në kufirin mes Shqipërisë dhe Greqisë si rezultat i propagandës athinase për Epirin e Veriut, që qeveria në Tiranë e refuzoi me sukses. Qeveria e Zogut, që mbështetej nga Lidhja e Kombeve i kundërshtoi prirjet e Athinës për aneksimin e Shqipërisë së Jugut. Me gjithë propagandën e fuqishme greke dhe krizën e përgjithshme ekonomike në Shqipëri, Greqia nuk arriti ta aneksonte Himarën. Edhe pse tre fshatra në Himarë ishin dygjuhëshe (banorët flisnin edhe greqisht) qeveria e Ahmet Zogut e ndaloi përdorimin e gjuhës greke në shkolla. (Koka 2004: 222, përkth. i përkth. në frengjisht të përmbledhjes NGB)

Rusha (2001: 129) përmend marrëdhëniet tregtare me ishujt grekë që disa familje të pasura të Dhërmiut/Drimades arritën t'i ruajnë edhe gjatë periudhës së Zogut. Për shkak të krizës ekonomike dhe rrethanave politike shumë banorë të fshatit emigruan në Greqi dhe disa në Itali. Në historinë bashkëkohore nuk përmenden të dhëna për këto migrime, për to dëgjon vetëm nga rrëfimet e vendasve të moshuar. Shumë prej tyre kujtojnë shpërnguljet dhe udhëtimet jashtë fshatit dhe anasjelltas. Shumë burra nga fshati gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore (1919-1939) emigruan përkohësisht në Janinë, Lavria dhe në vende të tjera të Epirit, në Korfuz dhe vende të tjera të Greqisë, Francës, Italisë dhe SHBA si punëtorë me kontratë të përkohshme. Pas daljes në pension, shumë mërgimtarë në vendet evropiane u kthyen në vendlindje, me përjashtim të atyre nga SHBA. Përveç rrugëve detare, vendasit përdornin edhe ato tokësore. Shumica udhëtonin me kombi. Sipas rrëfimeve të disa fshatarëve në fshat në atë kohë gjendeshin përafërsisht gjashtëdhjetë shoferë. (shiko edhe <http://www.answer.com/topic/himar-1>, vizituar për herë të fundit në dhjetor 2007).





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Politika e mbretit Zog nxitu dhe përhapi barazinë gjuhësore, fetare dhe rajonale që kishin nisur të formoheshin në shekujt e mëparshëm. Njerëzit i rikrijuan ato, ua përshtatën vetvetes, i ripërcaktuan në varësi të kontekstit të tyre kulturor dhe shoqëror. Dallimet nuk qenë as përsëritje e ideve politike të imponuara dhe as produkt “krijimtarie” individësh të caktuar (khs. Herzefeld 2005), por qenë “jo krejtësisht përsëritje” të ideve politike (khs. Green 2005). Kështu, p.sh. në rrethanat e përmendura historike dhe kulturore, politike dhe shoqërore, individë të veçantë i kuptuan dallimet e imponuara si prirje irredentiste dhe dëshirë për t’u bashkuar me Greqinë, të tjerët u përpoqën të ruanin pozitën e mëparshme në territorin shqiptar.

### Lufta e Dytë Botërore (1939-1945)

Pushteti i Zogut nga pikëpamja politike ishte relativisht i pavarur nga shtetet e tjera, kurse nga ana ekonomike dhe financiare varej nga huatë e mëdha të qeverisë italiane që Zogut i huazojë rreth 60 milionë dollarë amerikanë dhe që ai i kishte investuar në ndërtimin e infrastrukturës (rugë, ndërtesa, shkolla, shërbime shëndetësore dhe forcat ushtarake). Thuhet se nga këto huazime grumbulloi edhe pasuri personale që shkonte rreth katër milionë dollarë amerikanë që e depozitoi në bankat e Francës dhe Zvicrës (Time 17. 4. 1939: 20, te Jacques 1995: 404). Si shpërblim për huazimet Musolini i kërkoi Zogut (1922-1943) bashkim monetar dhe doganor dhe depërtim të lirë të forcave ushtarake italiane në Shqipëri. Zogu e refuzoi ultimatumin e Musolinit, po megjithatë më 7 prill 1939 ushtarët italianë hynë në Shqipëri (Jacques 1995: 404-405). Pak pas kësaj mbreti Zog u arratis në Londër (Jacques 1995: 405; Winniffrith 2002: 136).

Ndryshe nga Lufta e Parë Botërore, në të dytën ushtria italiane përdori strategjinë fashiste, duke zbatuar dhunën ekonomike dhe kulturore (Jacques 1995: 410-414). Edukatorët italianë morrën në dorë kontrollin e sistemit të arsimit dhe Shqipëria u pushtua nga gazetatat dhe filmat italianë. Ushtria italiane u kujdes për përmirësimin e ekonomisë dhe infrastrukturës në shtet. Kështu ndërtoi sistemin e ujit të pishëm në qytetet dhe zonat e mëdha, ndërtoi shumë ura, rregulloi të vjetrat dhe ndërtoi rrugë të reja dhe i furnizoi dyqanet tregtare me mallra italiane (Jacques 1995: 414).

Si kundërpërgjigje ndaj manipulimit të udhëheqjes italiane, në maj të 1939 u themelua Fronti Kombëtar, *Balli Kombëtar* (BK). Ai drejtohej nga pronarë tokash të përparuar dhe intelektualë ortodoksë. Mënyra demokratike e udhëheqjes u përpoq për shporrjen e ushtarëve italianë nga territori shqiptar dhe të bashkimit të Kosovës, që deri atëherë kishte qenë pjesë e Jugosllavisë, dhe të *Çamërisë* (*Çamëria/Τσαμουριά*, ose





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

*Tsamouría*) apo pjesën bregdetare të Epirit në Greqi, me Shqipërinë. Po atë vit u themelua Lëvizja për Çlirimin Kombëtar (LÇK) e Partisë Komuniste. Në të bashkoheshin grupe disidentësh të themeluara në kohën e regjimit të Zogut. Gjatë luftës LÇK u bë lëvizja kryesore e rezistencës shqiptare që u përpoq për shporrjen e italianëve dhe vendosjen e sistemit komunist. Balli Kombëtar dhe Lëvizja për Çlirimin Kombëtar nuk kishin marrëdhënie të mira, pasi kishin vizione të ndryshme: BK mbështeste demokracinë, kurse LÇK komunizmin.

Pas vitit 1943, kur ushtria italiane u dorëzua dhe kontrollin mbi territorin shqiptar e morën çetat gjermane, LÇK luftoi për largimin e ushtrisë gjermane nga territori shqiptar dhe për shkatërrimin e BK. Po atë vit LÇK mori mbështetjen e qeverisë britanike që e furnizoi me armë edhe pse ishte në dijeni mbi konfliktet mes LÇK dhe BK (Jacques 1995: 442-424). Në vitin 1944 LÇK mori emrin Fronti Nacionalçlirimtar dhe udhëhiqej nga Enver Hoxha. Në qershor të 1944 Hoxha nisi ofensivën kundër gjermanëve, forca e të cilëve sa vinte e dobësohej. Më 29 nëntor 1944, pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, ai marshoi fitimtar në Tiranë dhe morri pushtetin mbi të gjithë territorin e Shqipërisë.

Ushtria italiane i pushtoi fshatrat në krahinën e Himarës/Himara më 1940. Për t'i zënë pritë ushtarëve grekë që vinin nga jugu, u vendos në Palasë dhe Dhërmi/Drimades. Njësitë ushtarake italiane u dhanë urdhër vendasve të shpërnguleshin nga fshati dhe për këtë çdo anëtar familjeje (mbi 18 vjeç) mori një kompensim me para<sup>75</sup>. Pothuajse të gjithë fshatarët u shpërngulën përkohësisht për shtatë apo tetë muaj te miqtë apo të afërmit e tyre të largët në Vlorë, Nartë apo Durrës.

Historiografët bashkëkohorë shpërnguljen e përkohshme të fshatarëve të Palasës dhe Dhërmiut/Drimadesit nuk e përmendin. Ajo përmendet vetëm në biografinë familiare të vendasit Foto Nina (2004: 129-130):

Gjatë kësaj periudhe, banorët e fshatrave të Palasës dhe Dhërmiut, u shpërngulën me dhunë nga ushtria italiane për në brendësi të vendit (territorit). Familja jonë muhaxhire, u vendos në fshatin Nartë të Vlorës, ku qëndroi për 7-8 muaj (tetor-nëntor 1940- prill-maj 1941), gjë që pasqyrohet edhe në dy vjersha të bukura drejtuar nartiotëve bujarë mikpritës. Kur familja u kthye në fshat gjeti shtëpi të rënuara dhe toka djerrë (po aty).

Historiografë të tjerë, p.sh. Rami Memushaj dhe autorët e botimit të Akademisë së Shkencave që mbështesin pikpamjen pro shqiptare, si

<sup>75</sup> Kompensimi ishte rreth 8000 lekë (ose 65,52 euro) dhe mjaftonte për mbulimin e shpenzimeve ditore për një vit.





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

dhe Jano Koço, mbështetës i pikëpamjes lokale nuk e përmendin Luftën e Dytë Botërore. Vepra e Memushajt mbi kulturën, traditat, historinë dhe etnitetin në Himarë/Himara mbaron me periudhën e hershme të shek. 19 dhe përmendjen e shtetit kombëtar shqiptar, kurse autorët e botimit shkencor të Akademisë e mbyllin debatin në vitin 1930 kur filloi të dobësohej fuqia e mbretit Zog. Vendasi Koçi e përfundon historinë dhe arkeologjinë e krahinës së Himarës/Himara në vitin 1868 dhe me konfirmimin e pavarësisë së saj.

Me përjashtim të vendasve Bixhili dhe Nina studiuesit e tjerë e përmendin kohën e Luftës së Dytë Botërore vetëm në disa rrjeshta. Kështu Kristo Frashëri me prirje pro shqiptare e përmend këtë kohë përciptazi në paragrafët e fundit. Për ta mbështetur faktin e përkatësisë kombëtare të himarjotëve ai shkruan:

Nga kjo pikëpamje, sikurse u tha, doket, zakonet, këngët, vallet, veshjet, legjendat, mentalitetet dhe normat kanunore të himarjotëve nuk kanë afëri as me ato të grekëve të Helladës, madje as me ato të banorëve të minoritetit grek të Shqipërisë, por vetëm me ato të Shqipërisë dhe veçanërisht me ato të Labërisë. Kjo është arsyeja që edhe pas Luftës së Dytë Botërore, himarjotët, pavarësisht nga disa zëra të veçuara, u deklaruan vetë se i përkisnin kombësisë shqiptare. Dëshmi është fakti se asnjë nga fshatrat e Himarës nuk është përfshirë në listën e vendbanimeve të minoritetit grek në Shqipëri, të regjistruara në Lidhjen e Kombeve më 1935. Megjithatë disa qarqe politike të Greqisë vazhdojnë edhe sot e kësaj dite të ngrenë, me një këmbëngulje fanatike, tezën e tyre se banorët e Himarës janë pjesë e minoritetit grek dhe se në bazë të akteve ndërkombëtare Shqipëria duhet t'ua plotësojë atyre të gjitha të drejtat që u takojnë minoriteteve, duke filluar që nga arsimi greqisht dhe duke përfunduar deri te flamuri helen. (Frashëri 2005: 95-96)

Edhe Rusha e përmend Luftën e Dytë Botërore në disa fjali dhe ndryshe nga Frashëri e shikon atë si ngjarje historike të rëndësishme për banorët e Himarës/Himara. Ai e përshkruan kështu shpirtin e tyre luftarak:

Traditat e lashta luftarake dhe liridashëse të popullit të Himarës luajtën një rol me rëndësi edhe për pjesëmarrjen e tij në luftën N.Çlirimtare kundër pushtuesve fashistë italo-gjermanë, gjatë së cilës me dhjetra partizanë dhanë edhe jetën e tyre, midis të cilëve dy Heronj dhe një Heroinë e Popullit...

Edhe pse në këto vargje flitet për 7 fshatrat Qeparo-Palase që i mbrojtën privilegjet e lashta deri në çlirimin e vendit mbarë nga lufta N. Çlirimtare, tiparet e këtyre vargjeve, në lidhje me trimërinë, doket e zakonet, etj. u përkasin të gjitha fshatrave të Himarës së lashtë nga Dukati në Tepelenë, e Sarandë. (Rusha 2001: 149-150)





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Në guidën turistike të faqes së internetit ([www.himara.eu](http://www.himara.eu)) luftrat mes ushtarëve gekë dhe italianë në këtë krahinë përmenden pjesërisht në kapitullin mbi historinë e kësaj krahine:

Në kohën e luftës mes Greqisë dhe Italisë në vitet 1940 dhe 1941 në krahinën e Himarës u zhvilluan beteja të rëndësishme. Më 22 dhjetor 1940 ushtria greke marshoi drejt Himarës dhe banorët e saj e përshëndetën me entuziazëm. ([www.himara.eu](http://www.himara.eu), vizituar për herë të fundit në dhjetor 2007)

Përveç Himarës/Himara, ushtria greke pushtoi pjesën më të madhe të Shqipërisë së sotme të Jugut dhe Epirin e Veriut (Winniffrith 2002: 136). Foto Bixhili është një ndër të rrallët vendas që në njërin prej kapitujve të fundit të veprës së tij përshkruan pushtimin italian dhe grek të Himarës/Himara. Njësoj si Frashëri dhe Rusha edhe Bixhili përmend shpirtin luftarak të himarjotëve, emrat e çetave që vendasit i krijuan gjatë luftës, si dhe emrat e vendasve që u internuan nga ushtria italiane. Përshkroi luftën mes italianëve dhe grekëve që përfundoi me çlirimin dhe themelimin e Shqipërisë së pavarur.

Në vitet e para të luftës, që nisin me agresionin fashist italian kundër Greqisë, nëpërmjet tokës shqiptare të pushtuar më parë, himarjotët bashkëpunuan (jo me armë) me ushtarët grekë si shqiptarë në tokën e tyre. U ndoqën e u internuan prej italianëve si shqiptarë që ndihmonin grekun, si filogrekë (Bixhili 2004: 303)

Në vazhdim Bixhili (2004: 302-311) përshkruan hyrjen e ushtrisë italiane në Greqi dhe largimin e ushtarëve grekë nga territori i Shqipërisë së Jugut. Pothuajse i gjithë territori shqiptar erdhi nën kontrollin e ushtarëve italianë. Më vonë, më 1943 kur Italia kapitulloi, territori i Shqipërisë kontrollohej nga ushtarët gjermanë. Bixhili përmend emrat e shumë vendasve që vdiqën në luftën kundër pushtuesit dhe e mbyll kapitullin me himnin për banorët e Himarës/Himara:

Kohë (Lufta e Dytë Botërore) të vështira e me mjaft tallaze. Megjithatë himarjoti gjente forca t'i përgjigjej pabesisë "narodnike" të ndonjërit prej djemve të tij, sa dhe dinakërisë bizantine, me zemërgjerësinë, mençurinë, durimin dhe pjekurinë burrërore, që e ka karakterizuar në shekuj... (Bixhili 2004: 314)

Në vitin 1944 anglezët çliruan një pjesë të Shqipërisë së Jugut (Winniffrith 2002: 136-137). Pas kësaj ngjarjeje çështja e kufijve ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë u bë subjekt bisedimesh ndërkombëtare. Mosmarrëveshjet politike mes Greqisë dhe Shqipërisë arritën kulmin në vitin 1946, kur udhëheqja greke dëboi shqipfolësit muslimanë, d.m.th. çamët (*tsams*) nga Igumenica për në Shqipëri. Konflikti për kufijtë





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

shtetërorë mes Greqisë dhe Shqipërisë kishte më shumë natyrë politike, pasi në jetën e përditshme kufiri ishte i kalueshëm dhe tensionet ishin më pak të dukshme. Kjo vlejti deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, kur diktatori komunist Enver Hoxha ndërpreu marrëdhëniet me shtetet fqinje. Pas ndërprerjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë më 1948 Enver Hoxha i mbylli kalimet kufitare dhe e ndaloi rreptësisht kalimin e tyre. Me izolimin e shtetit shqiptar Shqipëria “u zhduk” nga harta gjeopolitike e Evropës.

### Komunizmi (1945-1990)

Nga veprat e historiografëve bashkëkohorë dhe intelektualëve të tjerë del qartë se për periudhat e së “kaluarës së largët”, p.sh. antikiteti, perandoria romake etj., shkruhet dhe polemizohet. Përkundrazi, komunizmi ose “e kaluara e afërt” pothuajse nuk përmendet. Edhe pse nga rënia e komunizmit kanë kaluar 20 vjet, duket sikur në shkrimet e historiografëve kombëtarë dhe lokalë si dhe në rrëfimet e njerëzve komunizmi mbetet i pakontestueshëm ose i fshehur në sfondin e të përditshmes së vendasve. Shpesh duket se në historiografinë bashkëkohore ai mbahet fshehur përshkak të përvojave negative të vetë studiuesve.

Në pjesët e tjera u prezantuan debatet dhe polemikat e historiografëve bashkëkohorë mbi ngjarje dhe rrethana të ndryshme të “së kaluarës së largët”, kurse në këtë pjesë prezantohet fakti se për komunizmin flitet kalimthi, apo s’flitet fare.

Pothuajse të gjitha veprat e studiuesve lokalë dhe kombëtarë, siç janë Prifti, Çami, Sinani dhe autorë të tjerë të trajtesave të përmbledhura në botimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, si dhe Bixhili, Frashëri, Rusha, Memushaj e të tjerë, fillojnë me çështjen e përkatësisë kombëtare të ilirëve dhe epirëve. Nëse hyrjen e veprave e fillojnë me të njëjtën çështje dhe periudhë, e mbyllin atë me periudha të ndryshme. Historiografi me prirje kombëtare Rami Memushaj dhe intelektualët lokalë (Jani Koçi dhe autorët e botimit të Konferencës Panhimarjote) e mbyllin veprën me përshkrimet e shek. 18, me pavarësinë e banorëve të Himarës/Himara dhe çlirimit të tyre nga pushteti osman. Trajtesat e botimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë shtrihen deri në periudhën e vitit 1930, d.m.th. në kohën e mbretërisë së Zogut, këtu Frashëri përmend shkurt kohën e Luftës së Dytë Botërore, e cila prezantohet më gjerë në kapitullin përmbledhës të veprës së Foto Bixhit.

Një ndër të vetmit që trajton kohën e komunizmit është Foto Nina. Në biografinë familjare gjenden disa të dhëna mbi vendasit në Himarë/Himara gjatë dhjetëvjeçarit 1945–1955. Nina shkruan se pas Luftës





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

së Dytë Botërore në Himarë/Himara, si dhe gjatë, mbretëronte uria dhe varfëria. Banorët e Dhërmiut/Drimadesa dhe të fshatrave të tjerë nuk arrinin të siguronin as artikujt e domozdoshëm për të mbijetuar, p.sh. miell, sheqer, kafe, etj. (Nina 2004: 130). Administrata e Kombeve të Bashkuara për Ndihmë dhe Rehabilitim (United Nations Relief and Rehabilitation Administration – UNRRA), që e ndihmoi Shqipërinë me ushqime dhe mallra të tjerë (Jacques 1995: 426-427), ndihmoi gjithashtu edhe për ndërtimin e qendrës shëndetësore në Himarë/Himara (Nina 2004: 131). Nëse gjatë viteve 1924-1945 nataliteti u rrit, në dhjetëvjeçarin në vazhdim ra. Në atë kohë himarjotët me forcat e tyre në një nga lagjet e fshatit Kondraqa, d.m.th. Kallami, mbollën ullinj, limona, portokalle dhe mandarina. Rinovuan gjithashtu edhe plantacionet e ullirit që u shkatërruan gjatë Luftës së Dytë Botërore. Rrënjët e vjetra të agrumeve dhe të ullinjve i këmbyen me rrënjë kumbulle, shege dhe fiku.

Për të kryer këto punë të shumta e të vështira, punohej me orar të zgjatur, që nga mëngjesi deri natën vonë, vetëm me një pushim të vogël për të ngrënë atë pak ushqim të varfër. Për këtë arsye çdo vit, që nga fillimi i majit, familja jonë shpërngulej e gjitha nga fshati dhe vendosej në baçen e Kallëmit ku ngrinin një tendë me thupra e gjethe, si dhe krevate për të fjetur, sajuar me tela që thureshin mbi hunj. (Nina 2004: 132)

Fshatarët i shisnin prodhimet e tyre në Vlorë dhe në rrethinat e saj dhe për një gjysmë viti së bashku fituan rreth një milion lekë. Çdo fshatar fitoi për një gjysmë viti rreth pesë mijë lekë, që për atë kohë ishte një shumë relativisht e madhe. Me këtë fitim, p.sh. vëllezërit Duni ndërtuan shtëpinë pranë magazinës së familjes Nina në Kallami (Nina 2004: 135). Biografinë e familjes së tij Nina e mbyll me vitin 1955, vdekjen e gjyshit Foto, që vdiq dy vite para themelimit të kooperativës bujqësore të Dhërmiut/Drimadesit.

Përveç këtij përshkrimi, që bazohet në përvojat personale, redaktorët e faqes së internetit [www.himara.eu] e përmendin komunizmin vetëm në disa fjali ku përshkruhet kundërshtimi i banorëve vendas për zgjedhjen e Enver Hoxhës si kryetar shteti:

Në vitin 1945 banorët e Himarës e refuzuan pjesëmarrjen e tyre në plebishitin që do të konfirmonte regjimin e Enver Hoxhës. Shumë vendas u arrestuan. Personi që mbështeti lëvizjen, Andreas Dimas, u varros i gjallë. Regjimi vazhdoi, mbylli shkollën greke, e ashtuquajtura Akrokeravnia, dhe ua mori himarjotëve të drejtat e minoritarëve. (<http://himara.eu/index-en.html>, vizituar për herë të fundit në dhjetor 2007)

Heshtja mbi regjimin e komunizmit ka të bëjë vetëm me historiografinë kombëtare dhe lokale për krahinën e Himarës/Himara. Përndryshe për periudhën e komunizmit në Shqipëri mund të lexohet më shumë në veprat





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

e historiografëve bashkëkohorë (Pashko 1993, Kasoruhu 1996, Qesari 2000, Konomi 2001, Pepa 2003). Duket sikur koha e diktaturës së Enver Hoxhës që la pas shumë viktime, rrënoja dhe mbetje të tjera të diktaturës komuniste (bunkerë, stacione ushtarake, vila dhe pallate të komunistëve etj.), sot në shkrimet e historiografëve bashkëkohorë dhe në kujtimet e banorëve të krahinës së Himarës/Himara nuk është hapësirë e ngjarjeve të kontestueshme, por e historive të heshtura e të padëgjua, ose të palexuara. Ndoshta këto kujtime në jetën e përditshme të individëve janë të marginalizuara dhe nuk veprojnë si histori konfliktuale të së kaluarës së tyre.

### PËRMBLEDHJE

Ky kapitull zbulon mospërputhjet dhe konfliktet në interpretimin e së kaluarës së krahinës së Himarës/Himara. Ashtu si në shumë shtete të tjera ish-komuniste ose ish-socialiste (p.sh. shtetet e ish-Jugosllavisë, ish-Bashkimit Sovjetik, Rumanija etj.) edhe në Shqipëri po rishkruhet historia që gjatë periudhës së komunizmit favorizonte ideologjinë komuniste dhe përfaqësuesit e tyre. Për ta forcuar autoritetin e tij, dikatori komunist Enver Hoxha i jepte rëndësi dhe njëkohësisht rikrijonte vetëm disa ngjarje dhe rrethana të së kaluarës duke fajësuar ose fshirë të tjerat. Kështu mund të flitet për historitë mitike që krijojnë imazhin e një të kaluarë, të tashme dhe të ardhme të madhërishme. Sot me vendosjen e demokracisë, në vend të një historie mitike mund të diskutohet për shumë histori mitike (Schwandner-Sievers 2002).

Histori të ndryshme mitike shqiptare ngërthejnë në vetvete tre mite: mitin e të qenurit i pari, e homogjenitetit dhe të luftës së parreshtur për pavarësi (Malkolm 2004). Historia mitike e krahinës së Himarës/Himara është e shpërndarë në shumë versione që mitizojnë të kaluarën. Siç e vërtetojnë shkrimet e historiografëve të prezantuar këtu dhe të studiuesve të tjerë, interpretimet e tyre bazohen në interesat kombëtare, ose pro shqiptare, dhe në ato lokale. E kaluara e krahinës së Himarës/Himara, që deri para pak kohësh ishte pjesë e parëndësishme e historisë shqiptare, është bërë pjesë e bisedimeve dhe konflikteve të shumta mes historiografëve, politikanëve dhe vetë vendasve.

Po të ndjekim (Herzefeldin (1991) vendet dhe zërat që përcaktojnë Himarën/Himara janë të shumëllojshme. Emëruesi i tyre i përbashkët është vazhdimësia kulturore dhe rikrijimi i së kaluarës. Nga pikëpamja e zërave të shumtë, zëri i Nikolës dhe i Spiros kanë të njëjtën vlerë si dhe trajtesat e autorëve të botimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (2004).







## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

Njësoj vlen edhe për veprat e historiografëve kombëtarë si Memushaj (2003) dhe Frashëri (2005), për intelektualët vendas siç janë Rusha (2001), Jorgji (2006a, b, c), Koçi (2006) dhe të tjerë. Këto janë pikëpamje të ndryshme të së kaluarës së kësaj krahine dhe çdo pikëpamje prezantohet si legjitime dhe e “vërtetë”. Te dallimet përmbajtësore të gjithë përqipen ta përcaktojnë origjinën dhe përkatësinë e tyre ilire dhe epirote si themel i shtetit kombëtar; duket se e kuptojnë atë sikur të ketë ekzistuar “prej kohësh”.

Nga pikëpamja e bashkësisë lokale apo e studiuesve të përmendur historia nuk është e shumëllojshme dhe e shumëzëshme (Herzfeld) dhe nuk bazohet te mitet (Schwandner-Sievers). Për vendasit dhe historiografët historia shpalos “të vërtetën”. Prandaj është me rëndësi që në vend të historive të shumta dhe të shumëllojshme të gjurmohen dhe të prezantohen mënyrat se si individët i trajtojnë, i përshtatin, bisedojnë dhe debatojnë për të kaluarën e Himarës/Himara. Mënyrat e ndërtimit të hapësirës dhe kohës së kaluar zbulojnë parreshtur vendosjen e raporteve të forcës ku, sipas Ballinger-it (2003), qendra dhe periferia zhvendosen dhe këmbehen parreshtur. Kështu rindërtohen dhe rikrijohen “të vërtetat” mbi të kaluarën e Himarës/Himara. Raportet e forcës caktojnë parreshtur se cila “e vërtetë” do të mbizotërojë mbi tjetrën, njëkohësisht “e vërteta” mbizotëruese cakton raportet e forcës. Këto raporte përcaktojnë sfondin shoqëror dhe kulturor të rrëfyesve, historiografëve dhe kontekstit të gjerë shoqëror, politik dhe historik. Kështu p.sh. pas rënies së komunizmit dhe ndryshimeve të mëvonshme shoqërore, politike dhe ekonomike, Spiro dhe Nikola krijojnë dhe trajtojnë “të vërtetën e tyre historike” dhe lënë pas dore “të vërtetat historike” të Bixhilit (2004) dhe autorëve të tjerë të botimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Spiro dhe Nikola i konsiderojnë rrëfimet e tyre si të parëndësishme dhe “të pavërteta”. Në të njëjtën mënyrë Bixhili dhe autorë të tjerë krijojnë dhe trajtojnë “të vërtetën” e tyre për historinë e origjinës së popullatës. Ata kritikojnë hipotezat e vendasve që mendojnë se e kanë origjinën nga *Meghalihore*.

Raportet e forcës përvijëzojnë si dallimet ashtu dhe ngjashmëritë mes pikëpamjeve kombëtare dhe atyre lokale si dhe interpretimeve të së kaluarës. Nëse dallimet janë të dukshme te konfliktualiteti dhe kontestueshmëria e tyre të konceptuara nga pikëpamja lokale apo kombëtare, ngjashmëritë dalin në pah nga mënyra e ligjëritimit të tyre. Autorët me priirje kombëtare dhe lokale e përcaktojnë shtetin kombëtar dhe bashkësinë lokale si entitete të izoluara, sikur të mos jenë të lidhura dhe të ndërvarura ndërmjet tyre. Shumë studiues lokalë (Rusha 2001; Jorgji 2006a, b, c; dhe pjesërisht Nina 2004) e vënë theksin te imazhi i veçantisë





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

së vendasve të Himarës/Himara. Veçantinë e tyre e përcaktojnë në dallim nga vendet dhe njerëzit e tjerë në Shqipëri. Në të njëjtën mënyrë edhe studiuesit që mbështesin interesat kombëtare (Memushaj 2003, autorët e përmbledhjes së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë 2004, Bixhili 2004, Frashëri 2005), diskutojnë mbi shtetin kombëtar, apo Shqipërinë, si një entitet homogjen ku nuk ka vend për shumëllojshmëri dhe diversitet, ose për identitet dhe veçanti lokale të Himarës/Himara, pasi sipas tyre lokalizmi i tyre i përket kombit.

Lëvizjet dhe lidhjet mbi të cilat debatojnë studiuesit zbulojnë sërish faktin se njerëzit e krijojnë vetë hapësirën e tyre në raport me vendet dhe njerëzit e tjerë. Administrata të ndryshme, p.sh. osmane dhe kombëtare, vunë në zbatim ndarjen dhe kategorizimin në bazë të përkatësisë hapësinore dhe shoqërore të njerëzve. Pasojat e mospërputhjeve mes mënyrës osmane dhe kombëtare të organizimit të njerëzve dhe vendeve, kanë qenë tensionet politike dhe konfliktet territoriale, që janë shfaqur dhe zhdukur vazhdimisht dhe rizgjuar sërish (khs. Green 2005). Individët kategorizimet dhe mospërputhjet e praktikave të përditshme ndër shekuj, i kanë rikrijuar dhe ripërcaktuar në një kontekst të caktuar shoqëror, historik dhe politik.

Dallimet fetare, të vëna në jetë nga administrata osmane, atëherë nuk patën asnjë rol të rëndësishëm në praktikën e përditshme të banorëve të Shqipërisë së Jugut. Vetëm më vonë, në kohën e lëvizjeve kombëtare të fundit të shek. 19 dhe fillimit të shek. 20, dallimet fetare filluan të bëhen të rëndësishme dhe të dukshme, ngaqë ishin vendosur dhe pranuar si dallime që duheshin kapërcyer ose njësuar për bashkimin dhe unitetin e kombit shqiptar. Në përputhje me këtë shumë intelektualë shqiptarë në mërgim përhapën dhe vunë në përdorim gjuhën e shkruar shqipe në medie të ndryshme. Gjuha u bë gradualisht thelbi i identifikimit dhe homogjenizimit të kombësisë shqiptare. Ideja e homogjenitetit vazhdoi edhe në kohën e komunizmit, i cili përveç idesë së gjuhës dhe territorit të përbashkët, përhapri dhe vetëdijën mbi historinë e përbashkët. Mosmarrëveshjet dhe tensionet për shkak të kufirit shtetëror mes Shqipërisë dhe Greqisë u bënë temë e debateve të nxehta deri në vitin 1912, të cilat u shtypën më vonë me vendimin e Enver Hoxhës për ndalimin e kalimit të kufirit shtetëror dhe ndërprerjen e marrëdhënieve me shtetet fqinje.

Ideologjia komuniste u imponua dhe u forcua në organizimin hapësinor dhe në arkitekturë (arkitektura komuniste, p.sh. stacionet ushtarake, bunkeret, etj.), në rutinën e përditshme (puna në kooperativat bujqësore, aksionet e pionerëve, kufizimit të ushqimit dhe të mallrave etj.), me udhëtimet dhe shpërnguljet (ndalimi i kalimit të kufirit





## 2. HISTORI MOSPËRPUTHJESH

shtetëror, kufizimi i qarkullimit publik, ndalimi i përdorimit të mjeteve automobilistike personale, etj.) dhe me ndikimin nëpërmjet propagandës në jetën dhe praktikën e përditshme të banorëve të Shqipërisë.

Kundërshtimet dhe prirjet mbi kufirin shtetëror dhe dallimet mes njerëzve dhe vendeve u shfaqën sërisht pas rënies së komunizmit dhe ndryshimeve shoqërore, politike dhe ekonomike që pasuan. Por këtë herë, në një tjetër kuptim dhe kontekst shoqëror dhe politik në krahasim me të kaluarën. Në vend të idesë së homogjenitetit të shtetit kombëtar, individë të caktuar në vende të caktuara rikrijuan idenë e lokalizmit homogjen dhe "të ndryshëm".

Kapitulli i parë prezanton se si pikëpamjet dhe imazhet e paqëndrueshme, të ndryshueshme dhe të lëvizshme mbi fshatin, po edhe të lidhura mes tyre, krijojnë pozitën (ose "ku") e Dhërmiut/Drimadesit. Ky kapitull trajton debatet, bisedimet dhe mosmarrëveshjet e vazhdueshme mes historiografëve dhe intelektualëve të tjerë, që krijojnë të kaluarën, të tashmen dhe njëkohësisht të ardhmen (ose "kur") e Dhërmiut/Drimadesit duke e vendosur atë në kohë. Shumë pikëpamje të historiografëve dhe studiuesve të tjerë arrijnë të jenë konfliktuale, por të gjitha përshkruajnë lëvizjet e parreshtura dhe kontaktet mes njerëzve dhe vendeve që ndër shekuj iu nënshtruan ndarjeve të ndryshme administrative, dallimeve dhe kategorizimeve. Dallimet janë bazë për mënyrën se si njerëzit dhe vendet janë të vendosur në hierarkinë hapësinore, që është "rezultati i ushtrimit të vazhdueshëm të forcës" (Green 2005: 89). Forca, qoftë ajo politike, ekonomike dhe burokratike, ushtrohet nëpërmjet konfigurimeve të marrëdhënieve të lëvizshme hapësinore dhe të dallimeve.

Studiuesit që interpretojnë të kaluarën e Himarës/Himara bazuar në pikëpamjet kombëtare dhe lokaliste e riformojnë të kaluarën dhe të tashmen e Himarës/Himara dhe njëkohësisht hartojnë të ardhmen. Historiografia është vetëm njëra nga mediet që përcjell mënyrat e endërtimit të hapësirës në të cilën (ri)formohet fuqia dhe përcaktohet përkatësia e banorëve të Himarës/Himara. Mbështetësit ose ithtarët e pikëpamjes pro shqiptare i vendosin njerëzit dhe fshatin e Himarës/Himara në territorin shqiptar, kurse ithtarët e pikëpamjes lokaliste i përcaktojnë ata si lokalitet ose "diversitet" të pavarur, të veçantë dhe unik, të lidhur me Greqinë apo Bashkimin Evropian.





### 3.

---

## DETI DHE MALET<sup>76</sup>

»Karakter i ynë i ngjan vendit dhe klimës ku jetojmë. Nga njëra anë është i ftohtë dhe i egër si malet, nga ana tjetër është i butë dhe mikpritës si deti.« (Dimitris, nga shënimet në terren)

Sidomos në muajt e parë të qëndrimit tim në fshatin Dhërmi/Drimades edhe shumë fshatarë të tjerë e përshkruanin me të njëjtat fjalë si Dimitrisi karakterin e tyre dhe e lidhnin atë me vendlindjen. Ky identifikim i paqartë, një lloj krijimi i hartës së karakterit të banorëve të Dhërmiut/Drimadesit dhe fshatrave të tij është thelbësor për kuptimin e proceseve të krijimit të hapësirës.

Kapitulli i mëparshëm (*Histori mospërputhjes*), me prezantimin e pikëpamjeve dhe interesave të historiografëve lokalistë dhe kombëtarë, e vendos lexuesin në një kohë të caktuar të fshatit, duke shtruar pyetjen »kur«, kurse ky kapitull e çon atë nëpër rrugë dhe vende që vendasit e Dhërmiut/Drimadesit i thurin me rrëfimin e tregimeve, kujtimeve dhe në kontekstet e tyre biografike. Edhe pse në kontekstin e gjerë politiko-shoqëror dhe ekonomik rrëfimet gojore të vendasve duken më pak të dëgjua sesa ato historiografe, rrëfimet njësoj si historiografia tregojnë për rrënjosjen, ndarjen dhe përkatësinë e individëve. Për këtë antropologët duhet të tregohen të kujdesshëm se »historitë e kujt tregohen«, si dhe për faktin se këto histori »natyralizojnë« marrëdhënie të veçanta shoqërore (Bender 2001: 5).

Historitë që përshkruhen këtu janë njësoj siç i kanë treguar vetë vendasit e moshuar, të lindur në vitet 1926-1945. Të gjitha tregimet u shënuan, ndërsa rrëfeshin, në ditarin e terrenit dhe më vonë u plotësuan me informacione. Te analiza e tregimeve i kushtohet vëmendje karakterit të marrëdhënieve shoqërore, siç përvijohen në lëvizjet e njerëzve dhe në historitë e tyre, në rrjetin e tyre shoqëror dhe në lidhjet mes vendeve, duke krijuar lidhje dhe marrëdhënie hapësinore. Këtu lind pyetja se si dhe në

---

<sup>76</sup> Varianti i mëparshëm i pjesës së parë të kapitullit është botuar në *Traditiones* (2007a:159-174) me titullin Krijimi i hartës dhe vendosja e hapësirave në Dhërmi/Drimades në Shqipëri dhe Veriut.





### 3. DETI DHE MALET

çfarë mënyre kuptimet e ndryshme të hapësirës, që i lexojmë në tregimet e personave të veçantë, krijojnë pozitën e Dhërmiut/Drimades, duke iu përgjigjur pyetjes “ku”.

Analiza e historive mbështetet mbi “grupet lëvizëse mbizotëruese” që vendosen mes vendeve (Green 2005: 89). Bashkëbiseduesit e Sarah Green-it nga Kasidiaris në kufirin greko-shqiptar i kuptojnë dallimet mes “këtu” dhe “diku gjetskë” në bazë të dallimeve dhe ndarjeve sipas pozitës shoqërore dhe statusit të forcës. Ky ka të bëjë me forcën “e atribuimit të kuptimeve të ndryshme të vendeve”, me forcën “e mosmarrjes parasysh të disa vendeve” dhe me forcën e ndalimit të udhëtimeve nëpër, përmes dhe ndërmjet vendeve” (po aty). Procesi i vendosjes së këtyre forcave mbështetet në “forcat” politike, ekonomike dhe burokratike, përcakton dhe ndryshon “ku-në”, ose pozicionin e vendeve dhe të njerëzve (Green 2005: 216). Në histori ndodhin lëvizje, shpërngulje, udhëtime, ndarje dhe riorganizime njerëzish dhe vendesh. Duke marrë parasysh këto lloj lëvizjesh dhe ndarjesh hapësinore, individët u kanë krijuar vendeve pozicione të ndryshme. Pikërisht për këtë në analizën e shumëllojshmërisë së pozicioneve pyetja “ku” është më e rëndësishme se pyetja “kush” (Green 2005: 16).

Ashtu siç konstatoi Green në territorin e saj të studimeve, edhe në Dhërmi/Drimades “ku-ja”, apo pozicioni i fshatit, është i lidhur me mënyrën e udhëtimeve ose me mënyrën e kufizimeve të tyre, me distancën mes Shqipërisë dhe Greqisë, me estetikën e topografisë dhe të krahinës, me mënyrën e përcaktimit dhe kategorizimit të vendeve në shkrimet administrative, mënyra se si këto në krahina të ndryshme mund të shfaqen ose të zhduken (po aty). Për të gjurmuar format e ndryshme të marginalitetit dhe paqartësisë, Green pyet veten se “si krijohet pozicioni i vendit dhe se si ky pozicion, sipas një seri kriteresh, mund të jetë i njëjtë dhe njëkohësisht i ndryshëm” (po aty).

Në bazë të ngjashmërive të përmendura në dinamikën e udhëtimeve, shpërnguljeve dhe ndarjeve të njerëzve dhe vendeve mes Kasidiarisit dhe Dhërmiut/Drimadesit, që janë larg njëri-tjetrit për afërsisht 60 kilometra, janë interesante dallimet dhe ngjashmëritë mes pozitave të shumta të Dhërmiut/Drimadesit, se si pyetja “ku” përcakton hierarkinë hapësinore dhe se si hierarkia hapësinore cakton pozitën e fshatit. Kjo çështje thelbësore trajtohet në pjesën e dytë të këtij kapitulli, kurse në pjesën e parë prezantohet sfondi teorik për analizën e rrëfimeve të vendasve.





### 3. DETI DHE MALET TREGIME DHE RRËFIME

Për analizën e tregimeve dhe rrëfimeve merren parasysh mësimet e Tilley-it (1994) dhe Ingold-it (2000) dhe koncepti i operacioneve hapësinore i de Certeau-s (de Certeau 1984: 115-130). Operacionet hapësinore, siç janë rrëfimet e tregimeve dhe kujtimet, zbulojnë transformimin e parreshtur të vendeve në hapësira dhe anasjelltas të hapësirave në vende. Tregimet janë udhë hapësinore që ngërthejnë në vetvete lëvizje kohore dhe praktika hapësinore: “Çdo tregim është histori udhëtimi – praktikë hapësinore” (de Certeau 1984: 115). Këto praktika përfshijnë taktikat e përditshme, siç është p.sh. përdorimi i treguesve hapësinorë (“*Atje përtej* është Greqia. Prej andej mund të shohim Korfuzin dhe Thonuzin/Othonasin”), i emrave të vendeve (“*Jaliskari*, që do të thotë port ... Shpesh kalonin nga *Shën Pantaleoni*”), përcaktues kohorë “*kur* e mbylli shteti rrugën ... ishte uri e madhe në periudhën mes dy luftrave, madje edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore”, kujtimet (“*Dikur* ky ka qenë porti ku babai im ankoronte anijen”). Këto “aventura të rrëfyera” (de Certeau 1984: 116) krijojnë njëkohësisht “veprime gjeografike” (po aty), të cilat vendosin dhe organizojnë hapësirën duke e transformuar atë parreshtur në vende dhe këta të fundit përsëri në hapësira (de Certeau 1984: 118). Në këto procese hapësira është në transformim dhe ndryshim të parreshtur dhe nuk i ngjan kurrë hapësirës së mëparshme. Prandaj këtu mund të flasim për hapësira apo për procesin e krijimit të hapësirës (ang. *spatialising*).<sup>77</sup>

Biografitë e shkurtra të katër rrëfyesve krijojnë hartën e udhëve dhe të shpërnguljeve në vende të ndryshme të Shqipërisë dhe Greqisë, si dhe të kthimit apo të kthimeve të vazhdueshme në fshatin e vendlindjes Dhërmi/Drimades. Biografitë vazhdojnë me kujtimet e rrëfyesve për paraardhësit që na çojnë përtej detit apo maleve. Kur kujtojnë udhëtimet e të parëve të tyre dhe thurin tregimet mbi gjurmët e tyre, rrëfyesit rikrijojnë hapësirën e fshatit, përcaktojnë identitetin e tyre dhe krijojnë (ang. *generate*) kufijtë e përkatësisë së tyre.

#### Kujtime, krijimi i hartës së hapësirave dhe rindërtimi i tyre

Mes shek. 15 dhe 17 hartat gjeografike krijoreshin duke u bazuar në itinerare udhëtimesh (de Certeau 1984: 120-121). Sot me zhvillimin e lartë të teknologjisë elektronike (filmimet satelitore ajrore, aparaturat navigatore GPS), kartografëve nuk u duhet të udhëtojnë në vende dhe

<sup>77</sup> Më shumë për konceptin e procesit të krijimit të hapësirës (ang. *spatialising*) shiko Muršič (2006: 48-53).





### 3. DETI DHE MALET

krahina, pasi mund t'i hartojnë hartat e tyre edhe pa lëvizje "fizike". Me këtë hartografia moderne, veçanërisht ajo që krijon harta gjeografike dhe politike, e përjashton lëvizjen e njerëzve dhe imazhi që krijon buron vetëm nga strukturat e botës materiale (Ingold 2000: 234). Ingoldi flet për "iluzionin hartografik" (po aty) dhe mendon se hartat topografike bashkëkohore krijojnë një ndjesi statike dhe stabiliteti të rremë të vendit dhe të kufirit. Në këtë mënyrë hartografia bashkëkohore largohet nga jeta dhe nga vendi i banimit të individëve (ang. *dwelling*) (po aty).

Hartografia, që ka një strukturë të caktuar dhe e përjashton lëvizjen, është nocion i kundërt me atë të krijimit të hartave të hapësirave nga vetë njerëzit. Këto lloj hartash ilustrohen nga udhëtarët ose rrëfyesit e tregimeve që as nuk i japin formë atyre dhe as nuk i përdorin, por thjesht "i krijojnë" ato. Thelbi i krijimit të hartave të tilla është se krijimi i tyre është një proces i papërmbyllur. Nga ky aspekt rrëfimi i tregimeve është një proces i papërfunduar që të çon nëpër vende, bën dallimin e tyre dhe njëkohësisht i lidh ata duke vendosur në këtë mënyrë hapësirat.

Në gjuhën greke dhe në dialektin grek që flitet në Dhërmi/Drimades, fjala *istoria* do të thotë tregim dhe histori. *Istories* (sh.) të shumta për detin, bregdetin dhe fshatin flasin për të kaluarën dhe kujtimet e njerëzve. Kujtimet zbulojnë diçka që ka kaluar prej kohësh, kështu mund të themi se kujtimet zbulojnë "prezencën e mosprezencave të ndryshme" (de Certeau 1984: 108).

Njësoj si de Certeau edhe Tilley (1994) mendon se "kujtimet krijojnë parreshtur ndryshimin e vendit, që s'është asnjëherë i njëjti, me gjithë përpjekjen ideologjike dhe kujdesin për "stabilitet", apo për një palëvizshmëri perceptive dhe konjitive të vendit, për riprodhimin e një seri kuptimesh, prezantimesh dhe imazhesh mbizotëruese" (1994: 27-28). Ingoldi shton se kujtesa e hap rrugën me fjalë, të cilat nuk janë vetëm të prezantuara dhe të dhëna në formë gojore, por janë praktika kujtese të përfshira në perceptimin e ambientit (Ingold 2000: 148). Kujtesa është një proces në të cilin kujtimet lindin së bashku me udhët nëpër të cilat njerëzit kalojnë gjatë jetës së tyre (po aty). Këto rrugë nuk shtrohen vetëm nga njerëzit por edhe nga konteksti politiko-shoqëror dhe historik.

### TREGIMET PËR DETIN DHE MALET

#### Tregime për detin

Një mbrëmje herët, në janar, po qëndronim në tarracën e shtëpisë së saj me Frosinën, e lindur në vitin 1934 në Dhërmi/Drimades. Nuk kishte rrymë





### 3. DETI DHE MALET

elektrike dhe temperatura e jashtme ishte më e këndshme se ajo e dhomës. Me Frosinën po ngroheshim në rrezet e fundit të diellit dhe kundronim detin Jon, ishullin Korfuz dhe Thonuz/Othonas të mbuluar nga dritat, që lozonjare pulsonin nga larg. Me shikimin të drejtuar nga ishulli, Frosina tha:

Atje përtej (*eki pera*) është Greqia. Nga këtu (*apo edo*) mund të shohim Korfuzin dhe Thonuzin/Othonasin. Xhaxhai im dikur lundronte shpesh atje (*eki*). Kishte anijen e vet. Thonuzi/Othonasi nuk është ishull i madh dhe ka vetëm disa shtëpi. Xhaxhai bënte tregti në Korfuz dhe Itali. Shiste *valanidhi*<sup>78</sup> prej të cilit grekët prodhonin lëkurë artificiale që e përdornin për çanta dhe xhaketa. Përveç *valinidhit* njerëzit [banorët e Dhërmiut/Drimadesit] tregtonin edhe *kitro*. Kitro është një lloj i veçantë agrumi që sot është zhdukur. Xhaxhai shiste edhe vaj ulliri. Meqë ishte tregtar, kishte edhe dyqanin e tij në qendër të fshatit, në Shën Dimitri (*sto kendro, sto Agios Dimitris*) [emri i kishës]. Kjo ishte para kohës së Enverit (*ton kero tou Enver*). Kurse babai im ishte peshkatar. Peshkonte me dinamit, njësoj si peshkatari i famshëm Niko Dabo. A ke dëgjuar ndonjëherë për Niko Dabon? Shkrimtari Petro Marko, që është nga ky vend (*apo ton topos*), ka shkruar për Niko Dabon. Titulli i librit është Shpella e Piratëve. Niko Dabo ishte një peshkatar i guximshëm që e kishte humbur njërin sy nga peshkimi me dinamit. Njerëzit thonë se në kohën e Enverit, kur Partia [Partia Komuniste] ia mori tokën, Niko Dabo tha: "Merrni gjithçka! Më lini vetëm 100 metra det te Avrii, ku zë peshk," dhe tregoi nga deti ku kishte kaluar pjesën më të madhe të jetës së tij. Niko Dabo peshkoi tërë jetën.

Gjatë tregimit vëzhgonim detin dhe dritat në largësi. Kur perëndoi dielli, ajri u ftoh dhe Frosina më ftoi në shtëpinë gjysmë të rinovuar të trashëguar nga i ati. Ajo ishte njëra nga motrat e mbijetuara, pasi tre të tjerat kishin vdekur në fëmijëri. Prindërit e Frosinës ishin me origjinë nga Dhërmiu/Drimadesi. Në kohën e komunizmit kishin punuar në kooperativën bujqësore të fshatit. Në vitin 1954 Frosina u martua me një djalë nga fshati. Disa muaj pas martesës bënë kërkesë për transferim në Tiranë, ku burri i saj mësoi të punonte si mekanik. Ai gjeti një punë të përshtatshme, kurse Frosina zuri punë në një furrë buke. Ata kanë katër fëmijë, dy vajza dhe dy djem, tre janë të martuar. Njëri nga djemtë me gruan, që është nga Vlora, jeton në Tiranë. Djali tjetër me gruan, nga Tirana, jeton në Itali. Dy vajzat jetojnë në Greqi, njëra është e martuar me një vendas nga Dhërmiu/Drimadesi, kurse tjetra është beqare. Në vitin 1999 menjëherë pas rënies së komunizmit Frosina dhe burri i saj dolën në pension dhe u kthyen në fshatin e lindjes. Fshati ishte pothuajse i zbrazur, pasi shumica e fshatarëve kishin emigruar në Greqi. Pothuajse çdo vit Frosina me burrin shkojnë vizitojnë vajzat e tyre në Greqi, ku kalojnë festat

<sup>78</sup> Valanidhi ose valanidhia, konet e drurit *Quercus aegilops*.







### 3. DETI DHE MALET

e Krishtlindjes dhe të Vitit të Ri. Përveç kësaj vizitojnë shpesh edhe djalnin në Tiranë, ku kujdesen për nipërit dhe mbesat.

Historinë tjetër për detin dhe bregdetin e tregoi Pavlosi, i lindur në vitin 1938 në Dhërmi/Drimades. Sot është i ve dhe jeton në Tiranë. Në vitin 1958 bëri kërkesë për t'u transferuar në Tiranë për të studiuar gjeodezi. Pas mbarimit të studimeve u punësua në Tiranë dhe u martua me një vajzë nga Dhërmiu/Drimadesi. Për martesën u morrën vesh prindërit e tyre. Pavlosi dhe gruaja jetuan në Tiranë deri në vitin 1990, pastaj bashkë me djalnin dhe vajzën emigruan në Greqi. Në vitin 2001 u kthyen në Tiranë, kurse fëmijët e tyre, të martuar, qëndruan në Athinë. Me paratë e fituara dhe të kursyera në Athinë blenë shtëpi dhe hapën një dyqan mallrash me pakicë. Pas dy vitesh gruaja e Pavlosit vdiq. Verën, nga korriku në gusht, Pavlosi e kalon në Dhërmi/Drimades, ku me vëllain ndajnë shtëpinë e trashëguar nga ana e të atit. Të paktën një herë në vit, në muajt e dimrit, ai viziton fëmijët e tij dhe familjet e tyre në Athinë. Një pasdite të nxehtë gushti, të ulur në tarracën e një restoranti në bregdet me pamje nga deti, Pavlosi më pyeti:

A i shikon ata shkëmbinjtë atje (*eki*)? [*duke treguar nga shkëmbinjtë e mëdhenj larg që lidhnin bregdetin me detin*]. Ata shkëmbinjtë e mëdhenj që dalin nga deti? Aty ku janë çadrat dhe bari?

Pohova dhe e pyeta se si quhet shkëmbi. Pavlosi u përgjigj:

Jaliskari,<sup>79</sup> që do të thotë port. Dikur (*totes*) ai ishte port, aty gjyshi im mbante të ankoruar anijen e vet. Por sot shqiptarët (*i alvani*) kanë shkatërruar çdo gjë. Këta s'kanë aspak shije! Muço, Papajani, Duni dhe Zhupa ishin disa prej fiseve *soia* të pasur që ishin pronarë anijesh. Në Drimades nuk kishte shumë anije. Përafërsisht katër ose pesë. Ato ishin prej druri dhe të blera në Itali ose Greqi. Për shkak të portit në afërsi të bregdetit gjendeshin dhe magazinat. Në to fshatarët ruanin *valanidhi*, *kitro* dhe vaj ulliri. Për shkak të rrugës së thepisur nga bregu i detit për në fshat ishte tepër e rëndë të mbahej ngarkesa. Burrave u duhej ta ngarkonin në gomerë ose ta mbanin vetë. Në vend se me asfalt rruga buzë detit ishte e shtruar me gurë nga gratë e fshatit. Zakonisht gratë ishin ato që mblidhnin gurë për ndërtimin e shtëpive ose rrugëve. Gratë himariote janë të njohura për punën dhe karakterin e tyre të fortë. Ato punonin shumë. Kujdeseshin për familjet shumëanëtarëshe, shtëpinë, kopshtin, shkonin mbushnin ujë, lanin rrobat në përrua, mblidhnin dru për t'u ngrohur, gurë për ndërtime, etj. Edhe sot kujdesen faktikisht për çdo gjë. Vetëm se janë më të ngadalta, po plaken dhe janë të lodhura. Tërë kohën punojnë, ndërkohë që burrat ulen në hijen e vreshtave ose në

<sup>79</sup> Fjala greke *Jaliskari*, ose *Gialiskari*/Γαλισκάρη përbëhet nga dy fjalë: *γιαλός/gialos* – bregdet dhe *σκάρη/skari* – port.





### 3. DETI DHE MALET

kafene (*kafeneio*), ku luajnë me letra dhe pinë raki. Dikur në fshat ka pasur edhe disa peshkatarë. Kurse burrat e familjeve të pasura bënin tregti jashtë (*ihan kani emborio okso*) [shn. *tregtonin me vendet jashtë Shqipërisë së sotme*]. Për këtë jemi më të civilizuar se shqiptarët. Baballarët tanë kanë parë shumë vende të Greqisë, Italisë dhe gjetkë. Në krahasim me zonat veriore dhe lindore të Shqipërisë ne kemi qenë më të pasur (plusii). Më vonë në kohën e sistemit (*keru tou sistema*), kur qeveria i mbylli rrugët (*otan o kratos eklise to dromo*) u ndalua tregtia dhe u konfiskuan tokat.

Aghatula, e lindur në Dhërmi/Drimades në vitin 1944, në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare u regjistrua në shkollën pedagogjike në Elbasan. Pas katër vitesh u kthye në Dhërmi/Drimades, nga ku partia komuniste e transferoi në Himarë/Himara ku dha mësim për tre vjet në një shkollë të mesme. Në vitin 1966 u martua me një bashkëfshatar nga Dhërmiu/Drimades dhe së bashku u transferuan në Sarandë. Burri punonte si mekanik, kurse Aghatula jepte mësim në shkollë të mesme. Ajo lindi katër vajza. Në vitin 1993 familja u transferua në Greqi. Në fillim jetuan bashkë, më vonë, kur vajzat u martuan, ia lanë banesën njëres prej tyre dhe vetë u shpërngulën në vitin 2000 në një banesë të re. Tre vite më vonë u kthyen në Dhërmi/Drimades, ku me kursimet e Greqisë dhe pensionin e shtetit grek ndërjuan shtëpinë e tyre në tokën që dikur kishte qenë pronë e vjehërrit të Aghatulisë. Vajzat – burrat e të cilave i kanë prindërit himarjotë – jetojnë në Greqi dhe i vizitojnë prindërit vetëm për pak javë në muajt e verës. Kurse Aghatula me burrin i vizitojnë ato pothuajse çdo vit për Krishtlindje dhe për festat e Vitit të Ri. Në Greqi shkojnë gjithashtu kur duhet të zgjasin afatin e Letërnjoftimeve të Posaçme të Etnicitetit.<sup>80</sup> Në një nga vizitat e mia në shtëpinë e tyre Aghatula kujtonte:

Gratë e bregut njihen si punëtore dhe të kujdeshme. Veçanërisht mamatë tona punonin shumë. Kujdeseshin për shtëpinë, oborrin dhe ambientin rreth saj, ndërkohë që burrat rrinin ulur nëpër *kafeneiah* (*sh.*) ose zinin peshk. Atëherë këto vende i kishte kapluar varfëria. Peshku ishte i vetmi ushqim me vlerë që hanim. Mish hanim rrallë. Megjithatë kishim gjëra nga jashtë (*okso*). Këto i dërgonte xhaxhai im që kishte emigruar në Amerikë mes dy luftrave [mes Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore]. Më kujtohet që si dhuratë martesë i dërgoi hallës një vello (*barbuli*) të mrekullueshme. Më vonë e trashëgova unë. Ishte me të vërtetë e mrekullueshme! Në shtëpi kishim edhe disa mobilje që gjyshi im i kishte sjellë nga Greqia në kohën kur bënte tregti në ishujt grekë. Më kujtohen bufetë e rregulluara dhe të gjera, tryezat e bukës dhe karriget. Edhe disa shtëpi të tjera i kishin mobiljet nga jashtë. Edhe pse shumë herë ishim

80 Deri në vitin 2004 Letërnjoftimet e Posaçme të Etnicitetit vlenin pesë vjet, kurse pas vitit 2004 dhjetë.





### 3. DETI DHE MALET

të uritur, ishim të civilizuar. Edhe sot më kujtohet se sa keq u befasova kur, si praktikante e shkollës pedagogjike në Elbasan [vend në *Shqipërinë e Mesme*], gjatë praktikës qëndrova në një familje. U tmerrova kur mu desh të haja përtokë dhe ta merrja ushqimin nga e njëjta enë si anëtarët e tjerë të familjes. Nuk kishin pjata! Fjetëm në të njëjtën dhomë ku hëngrëm, në dyshekët që zonja e shtëpisë i shtroi përtokë. Shtretër nuk kishte. Atëherë e kuptova se çfarë varfërie ishte atje. Ne me të vërtetë ishim të varfër, por të paktën kishim mobilje dhe orendi të tjera me vlerë (*pramata*). Këto i kishim nga gjyshërit dhe baballarët tanë që bënëin tregti në Korfuz dhe Venecia.

#### Tregime për malet

Një pasdite vonë, në gusht, ishim ulur me Kaliopin në një kodër të gjelbëruar, disa metra larg banesës sime, ku Kaliopi shpesh kulloste dhinë e saj. Kaliopi është e lindur në vitin 1933 në Dhërmi/Drimades dhe malet i kujton kështu:

Po, po, mamaja ime shkonte shpesh atje, përtej, në vendet pas maleve (*ehi pai piso apo ta vuna*). Nganjëherë shkonte atje lart me bashkëfshataret, nganjëherë vetëm me motrën time. E di, dikur (*totes*) ... këtu ishte varfëri. Gratë shkonin atje [tregon me gishtin tregues drejt maleve] në vendet përtej maleve. Shpesh kalonin nga Shën Pantaleoni (*Ag. Panteleimon*) ... A e njeh Shën Pantaleonin? A ke qenë ndonjëherë atje (*eki*)?

Iu përgjigja se ende nuk e kisha vizituar kishën e Shën Pantaleonit, po kisha dëgjuar për të. Kaliopi vazhdoi:

Ah, e di ... Mamatë tona shkonin në vendet përtej maleve. Ngarkoheshin (*zhalomenes*) me artikuj të ndryshëm dhe i këmbenin ato me miell, qumësht, kos, djath dhe perime të stinës ... Kripën, ullinjë, vajin e ullirit, portokallet, veshjet dhe nganjëherë edhe pjesë mobiljesh që i kishin sjellë gjyshërit tanë nga jashtë i lidhnin me litar në kurriz dhe i çonin përtej malit, në shi, në borë, në të ftohtë ... Moti s'kishte rëndësi, uria atëherë ishte e madhe. Sidomos këtej nga ne, ku nuk ka mjaftë tokë pjellore që të rritet gruri. Për këtë atëherë hanim bukë misri pa maja. Ajo ishte shumë e fortë. Prandaj shpesh dëshironim bukë gruri dhe grurë që i gjenim përtej malit. Gjatë rrugës nëpër male gratë këndonin. Për ta patur më të lehtë. Sot shumica e këngëve janë harruar. Çfarë s'kanë hequr (*ti ihane traviksi*). Nganjëherë mamatë tona ktheheshin pa asnjë mall në shtëpi sepse ua vidhnin gjatë rrugës. Kudo ishte uri dhe njerëzit përtej maleve ua vidhnin ushqimet ... Sa të këqinj ishin njerëzit atje!

Kaliopi e ka kaluar të tërë jetën e saj në fshat. Në krahasim me bashkëmohataret e saja është martuar relativisht vonë. Kur ishte 28 vjeçe,





### 3. DETI DHE MALET

babai ra dakord për martesë me një burrë të ve, dhjetë vjet më të madh se ajo, që kishte katër fëmijë nga martesë e parë. Ishte vendas nga Dhërmiu/Drimadesi. Pas martesës Kaliopi lindi dy djem. Në kohën e komunizmit punoi bashkë me burrin në kooperativën bujqësore të Dhërmiut/Drimadesit. Tani është vejushe dhe jeton vetëm, djemtë janë martuar dhe jetojnë me familjet e tyre në Athinë. Djali më i madh është martuar me një bashkëfshatare, kurse gruaja e djalit të vogël është nga Himara/Himara. Meqë ishte e vetmuar, Kaliopi bleu një dhi që e kullot zakonisht në tokën që i takon *soit* të saj.

Histori të njëjtë si Kaliopi tregoi edhe Olga, e lindur më 1944 në Dhërmi/Drimades. Ishim në shtëpinë e prindërve të saj ku mamaja e saj e sëmurë po pushonte në shtrat. Olga filloi të kujtonte:

E di, sa herë që shoh mamanë nuk më besohet që është ende gjallë. Me gjithë ato që ka hequr. Familja jonë ka qenë jashtëzakonisht e varfër. Këtë shtëpi (*afto to spiti*) ku jetojmë e ka ndërtuar me duart dhe mundin e saj në vitin 1954. Shumicën e materialit të ndërtimit e kishte grumbulluar mamaja – gurë që i ngarkonte nga malet përreth. Gjatë ndërtimit babai ynë nuk ishte në shtëpi, pasi në vitin 1947 partia [Partia e Punës së Shqipërisë] e dërgoi në Jugosllavi. Atëherë (*totes*) e la mamanë vetëm me tre fëmijë – unë dhe dy motra. A e magjnon që kujdesej vetëm për vjehrrin, vjehrrën (*ta petherika tis*) dhe tre fëmijë? Më pas kur babai u kthye nga Jugosllavia, mamaja lindi edhe pesë fëmijë, nga të cilët njëri vdiq pak muaj pas lindjes. Atëherë këtu ishte uri. Për këtë shkonte shpesh me bashkëfshataret përtej maleve, në Vranisht dhe Trubaç në Labëri. Atje (*eki*) këmbente ullinj, kripë dhe nganjëherë veshje me grurë dhe ushqime të tjera. Ende më kujtohet se si na rrëfente tregime për njerëz që lypnin para dhe veshje. Mes tyre kishte dhe hajdutë. Nganjëherë gratë i vidhnin gjatë rrugës për në shtëpi. Shumë e trishtueshme ... Po, ishte uri e madhe mes dy luftrave dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në krahasim me tregimin e gjallë të Kaliopit, tregimi i Olgës për varfërinë e familjes së saj përshkruhet me trishtim dhe hidhërim. Olga u martua kur ishte ende adoleshente. Ishte 14 vjeçe kur babai ra dakord që ajo të martohej me një bashkëfshatar. Pak pas martesës bashkë me burrin bënë kërkesë për transferim në Tiranë. Aty Olga punoi në fabrikën e mobiljeve, kurse burri ishte hidraulik. Kur u bë 35 vjeçe e humbi atë në një aksident automobilistik. Sot jeton në Tiranë me djalin dhe familjen e tij. Për shkak të nënës së sëmurë vjen shpesh (të paktën tre herë në muaj) në fshat.

Një pasdite të nxehtë vere po bisedoja me Thodorin, të lindur më 1928 në Dhërmi/Drimades. Po qëndronim në tarracën e shtëpisë së re dhe po bisedonim për kishën e vogël të Shën Panteleonit që gjendet në majë të





### 3. DETI DHE MALET

malit Çika. Kur e pyeta a ishte ngjitur ndonjëherë deri te Shën Panteleoni filloi të kujtonte tregimin në vijim:

Dikur kullosja delet atje në male (*sta vuna eki*). Atëherë i dija të gjitha shtigjet që të çonin atje. Jam bari nga mosha 13-vjeçare. Njësoj si vëllai im. Vetëm në këtë mënyrë mund të fitonim bukën e gojës, pasi familja jonë ishte shumë e varfër. Unë isha dymbëdhjetë vjeç, kurse vëllai dhjetë kur na vdiq babai. Kështu qemë të detyruar ta fitonim bukën e gojës për të mbajtur frymën gjallë, pasi mamaja nuk ishte në gjendje të kujdesej për tre djemtë e saj. Më i madhi qëndroi në shtëpi, kurse unë dhe vëllai i vogël shkoni nga një shtëpi te tjetra. Punonim te familjet e pasura të fshatit si barinj. Babai ynë vdiq shumë i ri nga një sëmundje në mushkëri. Kur ishte djalosh ai kishte punuar në minierën e Lavrit, aty iu shkatërruan mushkëritë. Në Lavri njohu mamanë tonë dhe u martua me të. Mamaja jonë është greke. Në kohën kur në Lavri dhe më gjerë u përhap epidemia e gripit spanjoll, babai me familjen u shpërngul në Drimades. Meqë prindërit nuk kishin ende shtëpi në fshat, jetuam me xhaxhain, deri sa ndërtuam shtëpinë pranë shtëpisë ku kishte lindur babai. Kjo ishte rreth vitit 1937 apo 1938 ... Po ishte viti 1938, kur unë isha dhjetë vjeç. Tre vite më vonë babai vdiq dhe fillova të punoja si bari për të fituar para. Shërbeva te familja më e pasur e fshatit. Zotëria ishte mjek dhe e tërë familja e tij tregohej shumë e dashur dhe e kujdesshme me mua. Asnjëherë nuk pata uri. Ishin njerëz zemërmirë dhe të shkolluar. Kishin një shtëpi të madhe, atje poshtë, anës rrugës. Por në atë kohë rruga nuk ishte akoma e asfaltaruar si sot. Në dimër kullosja delet në buzë të detit, kurse në verë në male. Më kujtohet se në gusht kur në fshat ishte tmerrësisht nxehtë e kaloja natën pranë Shën Panteleonit. Atje lart ishte i vetmi vend i freskët në këto anë.

Në vitin 1946 Thodoris u martua me një vajzë nga fshati që ishte pak më e re se ai. Pas dasmës bëri shërbimin ushtarak në Elbasan. Pas një viti u kthye në fshat dhe bashkë me gruan bënë kërkesë për transferim në Vlorë. Aty zuri punë si mekanik dhe më vonë u ngrit në detyrë si shofer kamioni. Gruaja punonte si rrobaqepëse në një fabrikë shtetërore. Ata kanë tre fëmijë, dy vajza dhe një djalë. I fejuari i vajzës së madhe dhe e fejuara e djalit janë nga Vlora dhe janë ortodoksë, kurse vajza tjetër është e martuar me një bashkëfshatar. Në vitin 1994 Thodorisi dhe gruaja emigruan në Athinë ku jetuan me djalin, gruan e tij dhe nipat. Për të ndërtuar shtëpinë në Dhërmi/Drimades, pesë vite më vonë shitën banesën në Vlorë dhe filluan të ndërtojnë shtëpinë në fshat. Përveç parave nga shitja ata në ndërtimin e shtëpisë investuan edhe kursimet e pensionit bujqësor nga Greqia, si dhe kursimet e djalit i cili pas vdekjes së tyre do ta trashëgojë shtëpinë. Në vitin 2000 u kthyen në vendlindjen e tyre në Dhërmi/Drimades dhe u shpërngulën në shtëpinë e re.





### 3. DETI DHE MALET

Gjatë qëndrimit tim në Dhërmi/Drimades dëgjova vetëm tre tregime të vendasve që rrëfyen për kullotjen nëpër malet përreth. Nga kujtimet e vendasve del se në fshat nuk kishte shumë dele, edhe pse disa burime të dokumentuara nuk i konfirmojnë kujtimet e tyre. Vendasit e moshuar mendojnë se fshati i Dhërmiut/Drimadesit njihet më shumë për peshkim sesa për kullotje. Vetëm disa familje në fshat rrisnin dele, prandaj dhe nuk kishte shumë nevojë për barinj; këta vinin zakonisht nga familjet e varfra të fshatit ose nga Labëria, apo nga fshatrat e tjerë përreth. Kullotja filloi të zhvillohej në kohën e koooperativave bujqësore gjatë komunizmit. Përveç kullotjes, që ishte punë burrash, gjatë komunizmit u zhvillua edhe mbledhja e bimëve mjekësore dhe e bimëve të tjera, p.sh. *çaj mali* që mblidhej nga gratë e fshatit në malet përreth.

#### NGA VENDE NË HAPËSIRA: LËVIZJA DHE NDALIMI

Po ta mendojmë hapësirën si diçka që e lejon lëvizjen, atëherë vendi përjetohet si ndalim. Çdo ndalim gjatë lëvizjes e transformon vendndodhjen në vend. (Tuan 1997: 6)

Nga brendësitë e tregimeve për detin dhe malet del qartë se kujtimet e rrëfyesve përcaktohen nga vendndodhja e tyre. Kështu p.sh. Frosina dhe Aghatula, kur qëndrojnë në tarracën e shtëpisë së tyre dhe kundrojnë detin, si dhe Pavlosi i ulur në tarracën e restorantit buzë detit, rrëfejnë tregime për detin. Kaliopi që qëndron në kodër, Olga ulur në shtëpinë e të jëmës duke treguar për ndërtimin e shtëpisë me gurë të sjellë nga malet përreth, dhe në fund Thodoris, të cilin e pyes për kishën e vogël malore të Shën Panteleonit, rrëfejnë tregime për malet.

Në tregimet e tyre rrëfyesit përshkruajnë veprimet, lëvizjet dhe udhëtimet, p.sh. tregti, peshkim, ngarkim, këmbim, lundrim dhe ecje. Nëpërmjet tyre vendosin lidhjet mes vendeve të ndryshme dhe krijojnë hartën e udhëve të tyre. Nga ky këndvështrim tregimet ilustrojnë një sërë udhësh që lidhin Dhërmiun/Drimadesin me vende të ndryshme (Athinë, Lavrio, Elbasan, Vranisht, Trubaç, Labëri), me ishuj (Korfuz, Thonuz/Othonas) dhe shtete (SHBA, Greqi, Itali, Jugosllavi dhe Shqipëri). Me këto lidhje krijojnë hapësirën që shtrihet mes “vendeve përtej detit” dhe vendeve “përtej maleve”. Transformimi i vazhdueshëm i vendit dhe i hapësirës dhe anasjelltas është veçanërisht i rëndësishëm për analizën e tregimeve të prezantuara.

Tregimet “hapen” në vendin dhe vendndodhjen e rrëfyesve kur flasin. Kujtimet e tyre të çojnë në hapësira që shndërrohen në vende (ndalim) dhe kthehen përsëri në hapësira (lëvizje). Kështu p.sh. Frosina e





### 3. DETI DHE MALET

nis tregimin e saj në Greqi që e dallon si vend: “Atje përtej është Greqia.” Shenjën “atje përtej” e përcakton me dallimin “nga këtu”, që cilëson fshatin Dhërmi/Drimades: “Nga këtu mund të shikojmë Korfuzin dhe Thonuzin/Othonasin.” Në vazhdim të tregimit përshkruan lundruesen e xhaxhait që duke kaluar nga një vend “këtu” (Dhërmiu/Drimades) në tjetrin “atje” (Korfuzi dhe Thonuzi/Othonasi në Greqi) përvijon rrugën dhe krijon hapësirën. Kjo përshkruhet në këto fjali: “Atje përtej është Greqia. Nga këtu shihet Korfuzi dhe Thonuzi/Othonasi. Xhaxhai im dikur lundronte shpesh atje.” Në kujtimin për xhaxhain tregimi kthehet nga hapësira në vend, ose te ishulli Thonuz/Othonas: “Othonasi nuk është ishull i madh dhe ka vetëm disa shtëpi.” Më tej nga vendi, ose nga ishulli, kalon përsëri në hapësirë që këtë herë përvijohet nga rruga tregtare mes Dhërmiut/Drimades, Korfuzit dhe Italisë: “Xhaxhai bënte tregti me Korfuzin dhe Italinë.” Në përshkrimin e vargut të veprimeve, siç janë lundrimi, tregtimi, shitja dhe peshkimi që zhvillohen nëpërmjet detit dhe përcaktojnë hapësirën, e vendos atë në kohën para komunizmit, ose “para kohës së Enverit”. Kujtimet e Frosinës kalojnë gradualisht “në kohën e Enverit” ose në kohën e komunizmit (1945-1990) dhe të kolektivizimit të pronës tokësore, kur Partia e Punës së Shqipërisë kolektivizoi dhe shtetëzoi tokat private në Shqipëri. Frosina e ilustron marrjen e tokës private me përshkrimin e peshkatarit dhe “heroit lokal” Niko Dabo, që me kërkesën e tij “për 100 metra det te Avrili” e përcakton hapësirën detare si vendin ku ai peshkon: “Merrni gjithçka! Më lini vetëm 100 metra det te Avrili, ku zë peshk”.

Tregimi i Pavlosit fillon në një pozicion që ai e cilëson “ata shkëmbinjtë atje”. Në përcaktimin e pozicionit (“Ata shkëmbinjtë e mëdhenj që dalin prej detit?”), në emërtimin e tij (Jaliskari), në shpjegimin e emrit (“që do të thotë port”) dhe në fund duke e vendosur në të shkuarën (“dikur ky ishte port”), Pavlosi konfiguruar pozicionet që përcaktojnë vendin. Duke përmendur *soia-t* e pasur që i kishin të ankoruara anijet e tyre në Jaliskari, ai vazhdon me përcaktimin e vendit ose të fshatit. “Muço, Papajani, Duni dhe Zhupa ishin disa prej *soia-ve* të pasur që ishin pronarë anijesh. Në Drimades nuk kishte shumë anije. Përafërsisht katër a pesë.” Më pas me përshkrimin e anijeve “të blera dhe të sjellura nga Greqia dhe Italia”, e lidh fshatin portual Jaliskari me vendet përtej detit, pra me Greqinë dhe Italinë duke krijuar hapësirën. Pas kësaj Pavlosit i kujtohet rruga që çon nga bregu i detit në fshat. “Për shkak të rrugës së thepisur nga bregu i detit për në fshat ishte tepër e rëndë të mbahej ngarkesa.” Me aktivitetet e ndryshme (shtrimi i rrugës, mbatja e ngarkesës së mallrave të importuara) si dhe me përmendjen e rrugës që lidh bregun e detit me fshatin, Pavlosi krijon hartën e hapësirës së fshatit. “Në vend se me asfalt rruga buzë detit





### 3. DETI DHE MALET

ishte e shtruar me gurë nga gratë e fshatit. Zakonisht gratë ishin ato që mblihdnin gurë për ndërtimin e shtëpive ose rrugëve.” Me përshkrimin e grave punëtore dhe aktiviteteve të ndryshme të tyre (kujdesi për familjen, kopshtin, mbushja e ujit, larja e rrobave mbledhja e drurëve për ngrohje dhe i gurëve për ndërtim etj.) Pavlosi kalon në një vend të caktuar, në *kafeneia*. Këtu burrat e fshatit, në dallim nga gratë e tyre punëtore dhe të kujdesshme, rrinë ulur, pinë raki dhe luajnë me letra. Në pjesën e fundit të tregimit përmend peshkatarët (“Dikur në fshat kishte edhe disa peshkatarë.”) dhe tregtinë e burrave nga familjet e pasura (“Burrat e famijeve të pasura bënë tregti jashtë.”). Kështu ai kthehet në bregdet dhe në tregtinë me vendet përtej detit, që i vendos “jashtë”. Pavlosi bën dallim mes vendeve “jashtë”, pra përtej detit, dhe vendeve “brenda, në”, pra në fshat, dhe shton se nga kontaktet me Greqinë dhe Italinë vendasit janë “më të civilizuar” nga banorët e tjerë të Shqipërisë. Duke e dalluar Dhërmiun/Drimadesin nga vendet e tjera të Shqipërisë, Pavlosi e kupton “civilizimin” si zhvillim shoqëror dhe ekonomik. Tregimi i tij vazhdon me dallimin duke i përcaktuar banorët e Dhërmiut/Drimadesit si më të pasur nga ata të Veriut dhe të Lindjes së Shqipërisë. Njësoj si tregimi i Frosinës edhe ai i Pavlosit mbyllet me kohën e komunizmit, ose “në kohën e sistemit”, kur “shteti”, pra Partia e Punës së Shqipërisë e Enver Hoxhës, e ndaloi rreptësisht kalimin e kufirit shtetëror. Çdo lloj tentimi për ta kaluar kufirin ndëshkohej rëndë.

Me caktimin e kufirit të sotëm të Republikës së Shqipërisë në vitin 1913, rruga nëpër të cilën njerëzit e këtyre anëve kishin udhëtuar dhe tregtuar me shekuj të tërë u kufizua, kurse në kohën e komunizmit u bë e pakalueshme: “Më vonë në kohën e sistemit komunist, kur shteti e mbylli rrugën, na e ndaluan tregtinë dhe shpërnguljet dhe na i morrën tokat.”

Kur gjatë tregimit Kaliopi kujton nënën e saj, na çon “atje përtej në vendet përtej maleve”, në vendet ku nëna kishte ecur së bashku me gratë e fshatit. Në këtë mënyrë Kaliopi e pozicionon fshatin e saj duke e dalluar atë nga malet dhe nga “vendet përtej tyre”. Me ecjen e grave nga fshati nëpër male drejt vendeve përtej tyre, tregimi vizaton rrugën mes këtyre vendeve duke krijuar hapësirën. Kjo ilustron nga fjalja: “Po, mamaja ime shkonte shpesh atje përtej, në vendet përtej maleve.” Në vijim Kaliopi përmend varfërinë si shkakun kryesor të udhëtimeve përtej maleve dhe nga përshkrimi i hapësirës kthehet përsëri në vend, në Shën Pantoleon, që gjendet në mal dhe emërtohet sipas një shenjtorit: “E di, dikur ... këtu ka qenë uri e madhe. Gratë shkonin atje lart, në vëndet përtej maleve. Shpesh kalonin nga Shën Pantaleoni.” Nga Shën Pantaleoni tregimi vizaton rrugën përpara, deri “atje përtej”, d.m.th. në vendet përtej maleve. Në







### 3. DETI DHE MALET

përshkrimin e aktiviteteve, siç janë ngarkimi i artikujve ("Ato ngarkoheshin me ushqime) dhe këmbimi i tyre me ushqime ("që i këmbenin me miell, qumësht, kos, djath dhe perimet e stinës") forcohen rrugët që çonin nga fshati në vendet përtej maleve. Ky varg rrugësh dhe aktiviteteve krijon sërish hapësirën që kthehet përsëri në vend, pra në fshat. Ashtu si tregimi i Frosinës dhe i Pavlosit, edhe ai i Kaliopit në pjesën e fundit përshkruan fshatin, ose "vendet tona", që përshkak të tokës jopjellore gruri nuk rritet si në vendet përtej maleve, ku gratë e fshatit shkonin e merrnin: "Sidomos këtej nga ne, ku nuk ka mjaftë tokë pjellore që të rritet gruri ... Prandaj shpesh dëshironim bukë gruri dhe grurë që i gjenim përtej malit." Kaliopi e mbyll mendimin e saj duke i cilësuar si negative "vendet përtej maleve" ku jetojnë njerëzit e këqinj, që shpesh herë i plaçkisnin gratë gjatë rrugës për në fshat: "Nganjëherë mamatë tona ktheheshin pa asnjë mall në shtëpi sepse ua vidhnin gjatë rrugës. Kudo ishte uri dhe njerëzit përtej maleve i vidhnin ushqimet ... Sa të këqinj ishin njerëzit atje!"

Olga e rrëfen tregimin e saj në shtëpinë e prindërve gjatë bisedës sonë. Me përshkrimin e ndërtimit të shtëpisë, që në pjesën më të madhe ishte ndërtuar me punën dhe mundin e nënës së saj ("Kjo shtëpi... është ndërtuar me duart dhe mundin e saj"), Olga vizaton rrugën ndërmjet shtëpisë në fshat dhe maleve përreth ku e ëma kishte mbledhur gurët për ndërtimin e saj. Olga krijon hapësirën: "Shumicën e materialit të ndërtimit e kishte grumbulluar mamaja – gurë që i ngarkonte nga malet përreth". Në vijim përmend babain që në atë kohë mungonte, pasi Partia Komuniste e Shqipërisë në kohën e komunizmit e kishte dërguar në Jugosllavi. Duke kujtuar fëmijërinë, familjen e saj dhe urinë në fshat ajo e përcakton kështu hapësirën: "Gjatë ndërtimit babai ynë nuk ishte në shtëpi, pasi në vitin 1947 partia e dërgoi në Jugosllavi. Atëherë e la mamën vetëm me tre fëmijë ... Atëherë këtu ishte uri." Njësoj si Kaliopi edhe Olga shikon te uria arsyen për të cilën gratë shkonin në vendet përtej maleve. Ndryshe nga Kaliopi Olga e emërton vendin përtej maleve si Labëri dhe me këtë tregimi rivendoset në një vend të caktuar: "Atëherë këtu ishte uri. Për këtë ajo shkonte shpesh me bashkëfshataret përtej maleve, në Vranisht dhe Trubaç në Labëri. Atje bënte këmbimin e mallrave." Edhe Olga i përcakton vendet përtej maleve me këmbimin e mallrave që hajdutët ua vidhnin shpesh gjatë kthimit për në shtëpi. Ajo e vendos tregimin e saj në kohë, mes dy luftrave (1918 – 1939) dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939-1945).

Në kuadrin e interpretimit të tregimeve si praktika hapësimore, analiza e tregimeve dëshmon se si tregimet janë "gjeografi veprimesh": organizojnë hapësirën, e transformojnë atë parreshtur në vende ose vendndalime dhe këto të fundit i transformon përsëri në hapësira ose





### 3. DETI DHE MALET

lëvizje. Tregimet nuk ilustrojnë vetëm procesin e transformimit hapësinor, ato marrin pjesë aktive të ky transformim, pasi krijojnë dhe transformojnë pa rreshtur hapësira, vende, rrugë dhe kufinj.

Deti dhe malet përkufizohen si caqe që ndajnë dhe njëkohësisht kufizojnë dhe lidhin fshatin me vende të tjera në Amerikë, Greqi, Itali dhe Shqipëri. Kujtimet e rrëfyesve në udhëtimin e paraardhësve të tyre hartojnë hartat gjeografike shoqërore. Në to fshati është qendra, kurse vendet e tjera vendosen dhe krahasohen mes tyre në varësi të tij. Këto lloj (ri)vendosjesh hapësinore e përcaktojnë dhe i caktojnë vendin fshatit vazhdimisht duke krijuar pozicione të ndryshme të tij.


#### POZICIONET E DHËRMIUT/DRIMADESIT

Skica e mëposhtme (Skica 5) prezanton hapësirën sipas tregimit të Frosinës. Tregimi i saj nuk ka të bëjë me periudhën para komunizmit ose *prin to kero tou Enveri*, pasi Frosina u transferua në Tiranë në kohën e komunizmit dhe pas tij u kthye në fshatin e lindjes. Fshati pozicionohet në bazë të lidhjeve që ka me Italinë dhe Greqinë apo me ishujt grek Thonuz/Othonas dhe Korfuz. Hapësira që Frosina krijon me rrëfimin e saj përfshin fshatin, Greqinë dhe Italinë dhe përjashton Shqipërinë. Për shkak të ndalimit të marrëdhënieve tregtare dhe udhëtimeve përtej detit dhe për shkak të kolektivizimit të pronës tokësore pozicioni i fshatit në kohën e komunizmit konceptohej ndryshe. Përvojat e njerëzve dhe perceptimi i hapësirës nga ana e tyre atëherë kufizoheshin vetëm në Shqipëri. Duket se hapësira përcaktohet nga mungesa e marrëdhënieve dhe udhëtimet e fshatarëve në Greqi dhe Itali si dhe nga shtetëzimi i pronës tokësore. Ky lloj përcaktimi nuk ndryshon vetëm pozicionin e fshatit, por edhe pozicionin dhe përkatësinë e vetë vendasve që sipas tregimit të Frosinës nuk janë as grekë dhe as shqiptarë.





### 3. DETI DHE MALET



Skica 5: Rrugët dhe vendet siç përshkruhen në tregimin e Frosinës


Tregimi i Pavlosit (Skica 6) krijon një hartë hapësire disi më të shtrirë në krahasim me atë të Frosinës. Nëse hapësira e Frosinës përfshin ngushticën e detit, hapësira e Pavlosit përfshin edhe fshatin. Pavlosi e krijon hartën e hapësirës duke i vendosur lokalitetet në varësi të tre ndërrimeve kohore: para, gjatë dhe pas komunizmit. Tregimi fillon me kritikën e transformimit të portit në bar që është në pronësinë e “shqiptarëve”. Këtu ai bën dallim mes *alvani* dhe *horiani* apo vendasve. Në vazhdim tregimi vizaton hapësirën para kohës së komunizmit që nëpërmjet rrugëve detare shtrihet në vende të ndryshme në Greqi dhe Itali. Në raport me Dhërmiun/Drimadesin këto vende janë “jashtë” (*okso*), kurse fshati është “brenda, në” (*mesa*). Kur përshkruan mënyrën se si ngarkohen mallrat e importuara nëpërmjet rrugës së shtruar me gurë mes fshatit dhe bregdetit, Pavlosi vizaton hapësirën *mesa* duke e vendosur fshatin mes bregdetit dhe maleve përreth. Ai i cakton pozicione të ndryshme fshatit dhe i koncepton ato në një hierarki hapësinore, ku vendeve “jashtë” u atribuon fuqi ekonomike dhe shoqërore, kurse vendet “në Shqipëri” i lidh me jocivilizimin dhe varfërinë. Kur fshatin e vendos mes civilizimit dhe pasurisë “jashtë” dhe jocivilizimit dhe varfërisë “në Shqipëri”, ai krijon pozicionin “e ndërmjetëm” të fshatit duke e përcaktuar si të paqartë. Në përshkrimin e ndërlidhshmërisë së fshatit me Italinë dhe Greqinë dhe





### 3. DETI DHE MALET

lidhjes së fshatit me civilizimin dhe pasurinë, tregimi i Pavlosit përpiqet t'i kapërcejë paqartësitë dhe t'i caktojë fshatit një pozicion të fortë dhe të palëvizshëm. Nga njëra anë tregimi e ndan fshatin nga Shqipëria, kurse nga ana tjetër e kufizon atë me Greqinë dhe Italinë. Ky lloj konceptimi është në kundërshtim me atë të kohës së komunizmit kur pozicionin e fshatit nuk e caktonin kontaktet dhe rrugët përtej detit, por ndarjet dhe ndalimi i lundrimit, i tregtisë dhe i rrugëve të tyre.



Skica 6. Rrugët dhe vendet siç përshkruhen në tregimin e Pavlosit.


Rrugët në biografinë e Aghatulës (Skica 7) përfshijnë shumë vende, në të cilat ajo është shpërngulur gjatë jetës së saj. Në këtë rast pozicionin e fshatit e caktojnë marrëdhëniet tregtare të gjyshit me Korfuzin dhe Veneciën si dhe të xhaxhait në Amerikë (shiko skicën 7). Amerika, Korfuzi dhe Venecia janë "jashtë" (okso) dhe ashtu si në tregimin e Pavlosit këto vende përfaqësojnë civilizimin dhe pasurinë. Kur përshkruan varfërinë që mbizotëronte në fshat pas Luftës së Dytë Botërore, gjatë komunizmit, Aghatula e vendos Dhërmiun/Drimadesin në lidhje me Elbasanin, ku bënte praktikën pedagogjike. Edhe ajo i përcakton dhe i dallon pozicionet e fshatit duke marrë parasysh hierarkinë hapësinore; vendeve okso u atribuon fuqi ekonomike dhe shoqërore, kurse atyre "në Shqipëri"





### 3. DETI DHE MALET

dobësinë. Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me pozicionin ndërmjetës të fshatit mes pasurisë dhe varfërisë. Tregimet për detin përcaktojnë pozicionin e Dhërmiut/Drimadesit në lidhje me kontaktet e burrave të fshatit me vendet dhe njerëzit në Itali, Greqi ose Amerikë, kurse tregimet për malet flasin për marrëdhëniet që krijojnë gratë e fshatit me vendet dhe njerëzit “përtej” maleve.




Skica 7: Rrugët dhe vendet siç përshkruhen në tregimin e Aghatulës

Kaliopi (Skica 8) që e ka kaluar tërë jetën e saj në Dhërmi/Drimades e pozicionon fshatin në lidhje me udhëtimet e nënës së saj dhe fshatareve të tjera në kohën e varfërisë. Ajo e dallon fshatin nga vendet “përtej maleve”, ku janë “njerëzit e këqinj”. Edhe tregimi i saj mundohet ta përcaktojë pozicionin e fshatit nëpërmjet hierarkisë hapësinore, që këtë herë është më shumë e përcaktuar nga ana shoqërore sesa ekonomike. Kështu p.sh. njerëzit dhe vendet “përtej maleve”, edhe pse kanë grurë dhe ushqime, cilësohen negativisht, pasi fshataret gjatë kthimit për në shtëpi shpesh herë plaçkiteshin prej tyre.





### 3. DETI DHE MALET



Skica 8: Rrugët dhe vendet siç përshkruhen në tregimin e Kaliopit.

Olga (Skica 9), rrëfyesja tjetër disi më e re, që në kohën e komunizmit ishte transferuar në Tiranë, nga ku ende sot për shkak të prindërve të sëmurë kthehet shpesh në Dhërmi/Drimades, e vendos tregimin e saj për malet në hartë njësoj si Kaliopi. Olga e vendos Dhërmiun/Drimadesin në marrëdhëniet e fshatarëve me venolet “përtej” maleve (Trubaç, Vranisht dhe Labëri). Njësoj si Kaliopi edhe Olga i lidh ata me hajdutët. Marrëdhëniet e fshatit me vendet “përtej” maleve Olga i vendos në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore. Ndryshe nga Kaliopi, Olga në hartën e tregimit të saj vendos edhe Jugosllavinë, ku Partia e Punës së Shqipërisë e dërgoi babain e saj në kohën e komunizmit.





### 3. DETI DHE MALET




Skica 9: Rugët dhe vendet siç përshkruhen në tregimin e Olgës.

Skica e fundit (Skica 10) ilustron tregimin e Thodorit në kohën e adoleshencës së tij, kur punonte si bari dhe kulloste bagëtitë në kodra dhe në breg të detit. Tregimi ia cakton fshatit pozicionin e tij në lidhje me përvojat e kaluara në male dhe në begdet. Përveç kësaj në hartën e tregimit vendos edhe Lavrion dhe Greqinë, ku i ati gjatë kohës së punës me kontratë kishte njohur nënën e tij. Pas martesës për shkak të epidemisë së Gripit ata u shpërngulën në fshat.





### 3. DETI DHE MALET



Skica 10: Rrugët dhe vendet siç përshkruhen në tregimin e Thodorit.

Skicat ilustronë mënyrat me të cilat rrëfimi i tregimeve cakton vazhdimisht pozicionin e Dhërmiut/Drimadesit, duke iu përgjigjur pyetjes “ku”. Pozicionin e fshatit e caktojnë udhëtimet dhe shpërnguljet e prindërve të rrëfyeses/rrëfyesit, të gjyshërve dhe të të afërmeve të tjerë, si dhe kufizimi i udhëtimeve të tyre gjatë komunizmit, ndarjet gjeopolitike dhe së fundi edhe topografia e krahinës.

Skicat ilustronë drejtimit dhe rrugët nga kanë kaluar të parët e tyre nëpër vende të ndryshme me të cilat rrëfyesit krijojnë hapësirën e fshatit të tyre. Duke kërkuar dhe përcaktuar në mënyrë të vazhdueshme pozitën e tij, rrëfyesit caktojnë kufijtë që ndajnë fshatin nga vendet dhe njerëzit e tjerë. Ky proces konfigurim hierarkinë hapësinore që i jep vend të veçantë përkatësisë së rrëfyesëve/rrëfyesve, më pas ata e vendosin hapësirën në hartën gjeopolitike të shteteve nacionale. Imazhet grafike janë përpjekje për të vizatuar “optikën kartografike”, të krijuar nga rrëfimet.

### PËRMBLEDHJE

Deti nga njëra anë dhe malet nga ana tjetër e mbërthejnë fshatin mes tyre dhe e përcaktojnë atë si një hapësirë “të ndërmjetme” nga ku burojnë paqartësi. Duket sikur Dhërmiu/Drimades është një hapësirë që bashkon në vetvete të qenurit mashkull dhe femër, pasurinë dhe varfërinë, civilizimin dhe jocivilizimin. Këto dualitete përputhen me fjalinë e Dimitrisit







### 3. DETI DHE MALET

kur thotë se deti është mikpritës dhe i butë, kurse malet të ftohta dhe të egra. Ambiguitetet që lindin nga këto dualitete apo shumëllojshmëri pozicionesh janë ato që trazojnë pozicionin e Dhërmiut/Drimadesit.

Kur tregimet përshkruajnë ndarjet politike dhe ekonomike të vendeve dhe të banorëve të tyre, krijojnë dallime mes tyre. Në këtë proces rrëfyesit e tregimeve e vendosin fshatin dhe banorët e tij në hartën gjeopolitike të Evropës dhe botës.

Siç rrëfejnë tregimet dhe siç dëshmon historiografia (shiko kapitullin 2), në kohën para komunizmit banorët e Shqipërisë së Jugut, Epirit dhe ishullit të Korfuzit në Greqi tregtonin dhe udhëtonin në këto zona duke krijuar një hapësirë të përbashkët. Pas vitit 1945, pas ndalimit të kalimit të kufirit shtetëror shqiptar, rrugët dhe marrëdhëniet tregtare mes njerëzve u ndërprejnë. Kështu konceptimi i hapësirës filloi të ndryshojë gradualisht: ajo nuk krijohet më vetëm nga lëvizjet e kontrolluara dhe të planifikuara të njerëzve nëpër Shqipëri, por edhe nga ndalimi i udhëtimeve në Greqi, Itali dhe gjatë. Në praktikën e përditshme dhe në perceptimin e vendasve kufiri shtetëror mes Greqisë dhe Shqipërisë, që Pavlos e quan "postoblok", dallonte dhe ripërcaktonte "kush" dhe "çfarë" i përkiste shtetit shqiptar dhe se "kush" dhe "çfarë" i përkiste shtetit grek. Pas rënies së komunizmit, kur sipas këndvështrimit të grekëfolësve ortodoksë "postobloku" mes Shqipërisë dhe Greqisë u hap përsëri dhe nisi emigrimi masiv, kuptimi i kufirit shtetëror mes Shqipërisë dhe Greqisë ndryshoi përsëri. Këto ndryshime s'janë vetëm rezultat i dallimeve politike mes shteteve, por edhe të ekonomisë dhe të politikës globale, që sot janë të një rëndësie thelbësore në marrëdhëniet e forcave dhe të hierarkive mes vendeve të ndryshme: kështu disa vende dhe shtete gjeopolitikisht dhe ekonomikisht cilësohen si "Evropa", "Perëndimi" dhe "vende të zhvilluara", ndërsa vendet dhe shtetet e tjera cilësohen si "Ballkan", "Lindje", "jocivilizim" dhe "shtete në zhvillim".

Këto tregime ilustrojnë se si rrëfyesit e tregimeve në hierarkinë hegjemoniste, gjeopolitike dhe ekonomike të vendeve dhe shteteve i transformojnë dhe i ripërcaktojnë hierarkitë e tyre personale, që janë thelbësore për caktimin e pozicionit të Dhërmiut/Drimadesit. Mepërjashtim të asaj të Olgës dhe të Aghatulës, hartat e rrëfyesve të tjerë nuk përfshijnë emra vendesh në territorin e Shqipërisë. Mali i Vetëtimitës është kufiri mes vendeve "përtej maleve" (*piso*) dhe fshatit dhe mes vendeve para maleve (*brosta*) dhe fshatit. Në vend të vendeve në Shqipëri përmendin vende dhe shtete "jashtë" territorit shqiptar, pasi fshatin e lidhin me civilizimin dhe pasurinë; këto vende dhe shtete janë "jashtë" (*okso*) territorit shqiptar në krahasim me fshatin, që është "brenda, në" (*mesa*). Edhe ngushtica e detit





### 3. DETI DHE MALET

bëhet në këto tregime kufi mes fshatit dhe vendeve “jashtë”. Por në dallim me vargmalin, ajo përcaktohet poztivisht. Edhe ky përkshkrim e përforcon pozitën e paqartë të fshatit dhe duke e pozicionuar atë në një vend të ndërmjetëm. Duket sikur rrëfyesit mundohen ta zgjidhin këtë paqartësi të fshatit duke e zhvendosur pozicionin e tij në varësi të marrëdhënieve të tyre me vendet dhe njerëzit e tjerë.

Duke kujtuar rrugën e të parëve të tyre rrëfyesit rivendosin të kaluarën dhe transformojnë të tashmen, që përcakton në mënyrë të konsiderueshme përkatësinë e tyre në vend dhe në fshat. Kurse vendosja e vazhdueshme e hapësirave dhe lëvizja e pozicioneve për shkak të ndryshimeve shoqërore, kulturore dhe politike që dokumentohen sërish nga historia, numërimet e ndryshme të popullatës, çështjet e pakicave, konfliktet për tokën, ekonomia globale dhe ndarja gjeopolitike e botës bëhen sot akoma më shumë problematike, pasi çojnë në kundërshtime dhe mosmarrëveshje që trajtohen në kapitullin vijues.





4.

## BISEDIME PËR MBETURINAT<sup>81</sup>

Në kapitullin e mëparshëm nëpërmjet kujtimeve në rrugëtimin e të parëve dhe udhëtimeve të ndryshme u tregua se si vendasit krijojnë hapësirat në të cilat vendosin veten dhe fshatin e "tyre". Në këtë kapitull prezantohen mosmarrëveshjet për mbeturinat në bregdetin e Dhërmiut/Drimadesit: në këtë kontekst vendasit administrojnë dhe kontrollojnë mjetet e tyre, formojnë identitetin dhe përkatësinë e tyre. Nga njëra anë marrëdhëniet e fshatarëve me mbeturinat janë pasqyrim i marrëdhënieve të rastësishme historike, politike, ekonomike dhe shoqërore në fshat, rajon dhe brenda shtetit në përgjithësi. Në anën tjetër bisedimet për mbeturinat janë bërë pjesë e rëndësishme e procesit të (ri)ndërtimit të këtyre marrëdhënieve dhe të hapësirës sociale në përgjithësi.

Në pjesën e parë të këtij kapitulli prezantohen bisedimet me pronarët e objekteve turistike, para fillimit të sezonit veror që këtu nis në qershor. Ajo që më intereson te këto bisedime është fakti se si njerëzit e përjetojnë këtë vend dhe si e administrojnë atë. Në pjesën e dytë rradhiten tregimet e pronarëve që ofrojnë shërbime dhe objekte turistike, si dhe të vetë turistëve dhe punëtorëve sezonalë në bregdet, të cilët në bisedimet për mbeturinat krijojnë rregull në hapësirë dhe njëkohësisht vendosin se çfarë dhe kush është nga jashtë vendit dhe se çfarë dhe kush është vendas.

Rrëfimet e individëve të ndryshëm përfaqësojnë bisedimet e papërfunduara për atë se kush është përgjegjës për mbeturinat dhe kush për pastrimin e tyre. Kur njerëzit diskutojnë dhe zihen për mbeturinat ata krijojnë pozicione opozitare dhe e kalojnë parreshtur përgjegjësinë nga "shteti" te "bashkësia lokale" dhe anasjelltas, nga përgjegjësia kolektive te përgjegjësitë individuale dhe anasjelltas, dhe së fundi nga të huajt te vendasit dhe anasjelltas. Kategorizimet siç janë p.sh. "shteti" kundrejt "lokalitetit", përgjegjësia kolektive kundrejt përgjegjësisë individuale dhe ajo e vendasve kundrejt të huajve, janë komplekse dhe varen nga konteksti shoqëror dhe kulturor i secilit bashkëbisedues. Në vitet e fundit,

<sup>81</sup> Varianti i mëparshëm i pjesës së dytë të këtij kapitulli është botuar në revistën *Zëri i shoqatës slllovene të etnologjisë* me titullin "Mbeturinat si diçka jashtë vendit në Dhërmi/Drimades, Shqipëria e Jugut"





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

kur turizmi po zhvillohet më intensivisht dhe numri i shërbimeve turistike ose i ofertës turistike rriten gjithnjë e më shumë, kur ka gjithnjë e më shumë punëtorë sezonalë, emigrantë dhe turistë, pyetjet se kush apo çfarë është “i (e) pisët” dhe “i (e) pa rregulluar”, si dhe kush dhe çfarë është “i (e) pastër” dhe “i(e) rregulluar” (ose kush apo çfarë i “takon” fshatit dhe kush ose çfarë vjen nga jashtë) bëhen gjithnjë e më të rëndësishme.

Mary Douglas ka ilustruar në mënyrë të qartë (1996 [2002]) se kuptimi i papastërtisë është i kushtëzuar shoqërisht dhe kulturalisht dhe papastërtinë e përcakton si refuzim të rendit. Papastërtia është diçka që gjendet “jashtë” vendit, është “produkt anësor i rregullimit sistematik dhe i rradhitjes së gjërave, pasi rregullimi përfshin edhe hedhjen e elementeve të papërshtatshme” (Douglas 2002: 44).

Edhe në bregdetin e Dhërmiut/Drimadesit papastërtia dhe mbeturinat mund të perceptohen si produkt anësor i rregullimit shoqëror dhe hapësinor. Pra nuk bëhet fjalë për kategori joaktive, por për kategori produktive që rrezatojnë mospërputhjet shoqërore. Këto vijnë shpesh herë rastësisht, mbi të gjitha është interesante se si përvojat jetësore të bashkëbiseduesve përcaktojnë konceptime të ndryshme të pastërtisë dhe papastërtisë, vendase dhe të huaj. Pronarët e objekteve turistike dhe ofruesit e shërbimeve turistike, punëtorët sezonalë, emigrantët dhe turistët diskutojnë parreshtur se kush është përgjegjës për mbeturinat dhe se kush duhet ta pastrojë bregdetin. Në këto debate njerëzit shprehin pikëpamjet e tyre përsa i përket turizmit duke e ripërcaktuar kuptimin e bregdetit turistik. Nëse bregdeti turistik është burim i këtyre diskutimeve, vetë diskutimet ndërtojnë dhe rindërtojnë bregdetin, ku personat që pohojnë se janë nga Dhërmiu/Drimadesi fitojnë rastin ta konsolidojnë lokalizmin e tyre, përkatësinë dhe të qenurit vendas.

Gupta dhe Ferguson (2001: 13) theksojnë reciprocitetin e proceseve të formimit të vendeve, lokalitetit dhe identitetit, që janë të ndryshueshëm dhe konfliktual. Lokalizëm nuk do të thotë “rrënjosje” në një vend të caktuar, pasi ai krijohet vazhdimisht në marrëdhëniet e ndërsjella dhe nga dallimet mes njerëzve dhe vendeve. Kështu lokalizmi është pjesë përbërëse dhe formuese e procesit të ndryshimeve shoqërore; po kështu ndryshimet shoqërore p.sh. turizmi bregdetar në Dhërmi/Drimades, janë pjesë përbërëse dhe formuese e lokalizmit ose e të qenurit vendas dhe formojnë identitetin. Në bazë të arritjeve të Hallit, Gupta dhe Ferguson konstatojnë se “identiteti është pikë takimi – është pikë e një identifikimi të përkohshëm – që e cakton dhe e transformon një subjekt në mënyrë të tillë që t’i mundësojë atij të jetë operativ” (2001: 13).





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

Njerëzit në bregdetin e Dhërmiut/Drimadesit e formojnë dhe ripërcaktojnë identitetin duke u bazuar në lidhjet apo “takimet” e tyre me njerëzit e tjerë në bregdet, si dhe duke u bazuar në përvojat e tyre jetësore, në udhëtimet, shpërnguljet dhe kontaktet me njerëzit dhe vendet e tjera. Pronarët lokalë, të ardhurit, emigrantët dhe turistët përvijëzojnë kufijtë mes “nesh”, ata që i “takojnë” vendit dhe “të tjerëve”, “jashtë” tij. Takimi kufijve është pika e identifikimit të përkohshëm të tyre, që u mundëson veprim në vend. Krijimi i kufijve mes atyre që i “takojnë” vendit dhe “të tjerëve”, që janë “jashtë” tij, nuk bazohet vetëm në vetëdijen kolektive apo në identitetin imagjinar, po është edhe pasojë e dinamikës së marrëdhënieve të forcave dhe të pabarazisë. Për këtë nuk janë interesante vetëm marrëdhëniet e ndërsjella dhe dallimet mes njerëzve, po edhe dinamika e marrëdhënieve të forcave që konfigurohet mes tyre, duke vendosur caqe, dallime dhe njëkohësisht barazi mes njerëzve dhe vendeve.

#### TURIZMI NË DHËRMI/DRIMADES

Fillimet e zhvillimi të turizmit në këtë fshat nisin nga viti 1960, kur Partia Komuniste e Shqipërisë në bazë të shtetësimi të pronës private dhe të tokave i rinovoi dhe e ndryshoi funksionin e disa ndërtesave të vjetra në fshat, që dikur kishin shërbyer për magazinimin e *kitrës, valanidhit*,<sup>82</sup> vajit të ullirit dhe ullinjve. Kështu p.sh. një nga magazinat u shndërrua në objekt turistik, *Hotel Dhërmiu*; në një lëndinë pranë detit u ndërtua *Kampi i Punëtorëve*. Në breg të detit u ndërtua vila qeveritare e njohur si *vila tou Enveri*. Në hotel dhe në kamp pushonin anëtarët e Lidhjes Komuniste të Punëtorëve,<sup>83</sup> kurse vila qeveritare ishte projektuar për pushimet verore të elitës së atëhershme politike. Pas rënies së komunizmit, kolapsit të skemave investuese piramidale në vitin 1997 dhe krizës ekonomike që çoi në humbjen e tërësishme të kontrollit shtetëror, *Hotel Dhërmiu* u plaçkit nga bandat që në atë kohë pa rend ligjor iu sulën ndërtesave që kishin qenë në pronësi të Partisë së Punës dhe i shkatërruan ato. U ruajt vetëm vila qeveritare që sot, përveç *Hotel Dhërmiut* në rrënim e sipër, është ende në pronësinë e shtetit. Me kalimin e viteve toka ku dikur ishte kampi i punëtorëve iu shit një biznesmeni nga Shqipëria e Veriut, i cili ndërtoi aty një hotel që e emërtoi *Hotel Dhërmiu*. Edhe pse kampi i punëtorëve

<sup>82</sup> *Valanidhi* (nj.) ose *valanidhia* (sh.) – kone lisi (*Quercus aegilops*). *Kitro* – lloj agrumi i zhdukur.

<sup>83</sup> Këta ishin mbi të gjitha nëpunës zyrtarë, p.sh. mjekë, mësues dhe zyrtarë. Bujqit, që dikur kishin punuar në kooperativë apo në ferma shtetërore, nuk ishin anëtarë të kësaj organizate.






#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

ka falimentuar prej kohësh, emri i tij përmendet në bisedat e vendasve që kësaj pjese të bregdetit i thonë *Kampi*.

Disa vite pas rënies së komunizmit dhe në fillim të procesit të privatizimit të tokave (Ligji mbi tokat nr. 7501, 19. 7. 1991), ndërtesat shtetërore dhe tokat filluan t'u shiteshin personave që vinin nga vende të tjera të Shqipërisë. Pas vitit 1997, sidomos pas vitit 2000 kur krahina e Himarës/Himara u njoh zyrtarisht si bashki dhe kur u rinovua rruga magjistrale përmes qafës së Llogarasë, numri i turistëve dhe i shërbimeve turistike në Dhërmi/Drimades dhe në Himarë/Himara u rrit ndjeshëm. Pronarët që vinin nga vende të tjera ndërtuan nëntë ndërtesa: në to gjenden restorante, dhoma, bungalove, një diskotekë dhe një hotel i vogël. Përveç hotelit, të gjithë objektet e tjera gjenden në veri të përroit *Potami* (që do të thotë përrua) që përshkon linjën bregdetare të Dhërmiut/Drimadesit dhe derdhet në det. Vendasit kanë filluar t'i ndërtojnë objektet e turizmit pas vitit 2000 dhe këto kryesisht në jug të përroit. Ndër nëntë objektet e vendosura aty janë edhe restorante, motele të vogla, bungalove, restorant me ushqime të shpejta dhe klub nate. Ndër pronarët e objekteve turistike "vendase" mbizotërojnë të kthyerit nga mërgimi dhe emigrantët që gjatë vitit jetojnë në Greqi.



Skica 11: Objektet turistike në bregdetin e Dhërmiut/Drimadesit në vitin 2005. Ndërkohë që në anën veriore (të djathtas) gjenden objektet turistike të pronarëve që vijnë nga vende të tjera të Shqipërisë, në atë jugore (të majtas) gjenden objektet e pronarëve të lindur në Dhërmi/Drimades.

#### PARA SEZONIT TË VERËS

Një mëngjes herët në qershor po ecnim me Ariadnen, e lindur në vitin 1943 në Sarandë, në kopshtin e saj prapa restaurantit me ushqim të shpejtë që e drejton së bashku me burrin e saj Kostën dhe djalin Arqilenë. Për ta





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

mbrojtur kopshtin nga erozioni e kanë ngritur atë në një terren më të lartë dhe e kanë rrethuar me mur guri. Njësoj si vitet e shkuara edhe tani dheut të kopshtit i kanë shtuar dhe të ri që e kanë sjellur nga Vunoja dhe Himara/ Himara ku ende gjen tokë pjellore.

Ariadne më tregonte me krenari qepët dhe domatet e mëdha, ende të papjekura, që i kishim mbjellur së bashku në fillim të prillit. “A të kujtohet se sa shpejt i mbollëm, ngaqë Kosta po nxitonte për në fshat ku e prisnin punë urgjente,” tha ajo dhe shkuli një kokë qepe dhe ma tregoi me krenari duke shtuar se munda ynë nuk kishte shkuar kot. Në të njëjtin çast u përkul edhe njëherë dhe filloi të shkulte barishtet e këqia dhe të nxirrte nga dheu guralecat. “Gurë, gurë, vetëm gurë kemi këtu.” Kur iu përgjigja se me gjithë gurët të mbjellat janë rritur mirë, ajo mu përgjigj disi e irituar: “Sigurisht që janë rritur mirë, por sikur unë me Kostën të mos sillnim çdo pranverë dhe të ri, të mos hiqnim gurët dhe të mos blinim thasë me pleh kimik te Sulo,<sup>84</sup> kopshti nuk do të kishte prodhuar kaq shumë.” Më tej shtoi se me të vërtetë këtë vit të mbjellat kanë prodhuar shumë dhe se domatet, qepët, hudhurat, trangujt, kungujt dhe patatet që rriten në kopsht mjaftojnë për ofertën e tyre në restorantin veror me ushqim të shpejtë, ku përveç sanduiçave përgatisin edhe suvlaki, shishqebab, sallatë sezonale dhe patate të pjekura.

Ariadne me lëvizje të shkathta dhe të shpejta vazhdonte të shkulte barishtet e këqia dhe të hiqte gurët që i hidhte jashtë murit rrethues, prapa së cilit shtrihet një sipërfaqe me bimë të gjelbërta dhe ullinj të mbjellë në periudhën e kooperativave bujqësore (1957–1990). Gjatë pastrimit të kopshtit vazhdonte të tregonte se bashkë me Kostën kishin investuar shumë punë në kopsht. “Shikoji duart!” tha, i hapi dhe më tregoi duart e vrazhda ngjyrë kafe në të kuqe nga argjila. Pastaj më tregoi garzën e lidhur në nyjen e gishtit tregues të dorës së djathtë dhe shtoi se nga i ftohti i ishte bërë plagë. Nga puna e vazhdueshme me ujë të ftohtë, nga detergjentët dhe puna në kopsht plaga nuk po i shërohet. “Shiko, a të duken duar mësueseje këto,” më pyeti.

Pa prituri përgjigje, filloi të tregonte me një frymë historinë e kushëririt të Kostës, Andreës, që kishte hedhur në kopshtin e tyre shishe qelqi. Para disa viteve (2003) Andrea kishte ndërtuar në tokën e Kostës një bar dhe

<sup>84</sup> “Sulo është shkurtimi i mbiemrit Sulejman. Ai është shitës fruta-perimesh, vjen nga Mallakastra, qytezë në veri të Vlorës. Gjatë viteve 2004 dhe 2005 çdo të mërkurë dhe të premte v sillte fruta dhe perime restoranteve në Llogara dhe në fshatrat e Himarës/Himara. Shiste gjithashtu edhe mallra të tjera (miell, sheqer, qirinj, shkrepse, uthull, vaj luledielli, lulemine, karamelle, biskota, spageti, makarona, letër higjienike, peceta), me raste edhe enë kuzhine dhe gota, në pranverë edhe pleh kimik zakonisht të pakëtuat në thasë të endur plastikë prej 50 kilogramësh.





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

një klub nate që iu desh t'i prishte pas kthimit të Kostës dhe Ariadnës nga Greqia. Pyetjes sime se si e kishte pritur Andrea prishjen e barit dhe të klubit të natës, Ariadna iu përgjigj me inat se nuk kishte zgjedhje tjetër, pasi ishte shumë e qartë se toka nuk ishte e tij. Të dy me Kostën kishin punuar shumë dhe ishin munduar tepër derisa i hoqën të gjitha xhamat e shisheve të thyera dhe i hodhën jashtë fshatit. "Nuk e di se ku i hodhëm shishet," iu përgjigj ajo me ashpërsi pyetjes sime se ku i patën depozituar shishet. "Te njëra prej kthesave, ndoshta. Ka të ngjarë mes Drimadesit dhe Vunosë ... ku e di." Ariadne vazhdoi të kritikojë nëpunësit e komunës që duhej të kujdeseshin prej kohësh për heqjen e mbeturinave nga bregu. Kanë vendosur disa kazana për mbeturina në fshat, por janë tepër pak dhe janë të vegjël për t'u mjaftuar nevojave të fshatit. Ariadne u ankua se nuk i beson planit të nëpunësve të komunës që gjatë muajve të verës premtojnë heqjen sistematike të mbeturinave. Në këtë periudhë bregdeti është plot me turistë që lënë pas sasi të mëdha mbeturinash. "Premtojnë, por nuk bëjnë gjë ... Kjo është Shqipëria! Vetëm gënjeshtria! Një ditë kështu, një ditë ashtu" (*Afto einai Alvania. Monoha pseumata. Mia mera etsi ali mera anapoda*). Më pas gati u pre me një copë xhami që e gjeti brenda në tokë, gjë që provokoi përsëri shfryrje inati dhe indinjim ndaj nëpunësve të komunës dhe kushëririt të Kostës. "Sa njerëz të pistë janë këta," dhe vazhdoi të tregonte për përtacinë e kushëririt, lakminë dhe mëndjemadhësinë e tij. Vërshimin e fjalëve zemëruese të Ariadnes e ndërpreu djali dyvjeçar i Fluturës që na vizitoi në kopsht.

Nëna e Dimitrit Flutura dhe babai Lolo ishin ulur me vajzën e tyre dhjetëvjeçare në pjesën e përparme të restorantit dhe po bisedonin me Kostën. Flutura, e lindur në vitin 1969 në Vlorë, është nga një familje ortodokse. Edhe pse burri i saj është nga Dhërmiu/Drimadesi, Flutura e flet dhe e kupton pak dialektin lokal grek. Ajo ka ardhur në fshat në vitin 1998, ku jeton me Lolon dhe dy fëmijët në shtëpinë që është pronë e vëllait të madh të Lolos. Ky, ashtu si dhe vëllezërit dhe motrat e tjera të Lolos në vitin 1990 emigroi në Greqi. Flutura është mësuese në shkollë fillore, kurse Lolo për arsye shëndetësore nuk punon. Babai i Lolos është i lindur në Janinë, në Greqi, nga ku emigroi në Dhërmi/Drimades në kohën e gripit spanjoll. Në bazë të vendlindjes së babait, në vitin 2004 Lolo aplikoi për pasaportën greke. Ai dhe fëmijët kanë pasaporta greke, kurse Flutura shqiptare. Në njërin nga takimet e mia të para me Lolon dhe Fluturën, Lolo më tregoi pa e pyetur pasaportën e tij, siku të donte të konfirmonte shtetësinë greke, dhe vuri në dukje me shpoti se Flutura është shqiptare, kurse ai dhe fëmijët grekë. Shakaja e tij nuk kishte të bënte me shtetësinë e përzier të familjes së tij, por me vlerën e shtetësisë, ku shtetësia shqiptare vlente më pak se ajo greke.







#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

Ardhja e papritur e Dimitrit e ndali vërshimin e fjalëve të Ariadnës. E përshëndeti me butësi dhe e pyeti për prindërit. Dimitrisi i vogël që nuk dinte ende të fliste mirë tregoi me gisht nga mami dhe babi, që ishin ulur në pjesën e përparme të restorantit. Ariadne i hodhi jashtë gardhit barishtet që mbante në dorë, lau duart dhe më ftoi t'i bashkoheshim prindërve të Dimitrisit. E mori Dimitrisin në krahë, dolëm në pjesën e përparme të restorantit dhe u ulëm me Fluturën dhe Lolon që po bisedonin me Kostën ndërkohë që ai po lante tarracën me një gyp plastik për ujë. Ariadne u ul pranë Fluturës, kurse Dimitrisi me motrën shkuan të luanin në anën tjetër të restorantit. Për të mos penguar bisedën e Lolos me Koston, Ariadne e pyeti me zë të ulët Fluturën se si ndihej. Vazhdoi menjëherë ta pyeste për numrin e turistëve të "ana e të huajve" (*kseni meria*), në veri të restorantit të tyre dhe përroit *Potami*. Flutura iu përgjigj se edhe atje s'ka pothuajse turistë dhe shtoi se Romano (pronari i lokalit në veri të bregdetit) kishte pritur disa turistë javën e kaluar. Ariadne iu përgjigj se këtë e dinte dhe komentoi se *kseni meria*, ku shumica e objekteve turistike janë në pronësi të të ardhurve, ka gjithnjë e më shumë vizitorë sesa pronarët "lokalë" ose "vendas" (*meria tou horiani*) në jug të përroit *Potami*. Sipas mendimit të Ariadnës arsyeja kryesore e pakësimit të vizitorëve është oferta më tërheqëse dhe më e gjerë turistike në anën veriore të bregdetit, pasi atje gjenden kryesisht hotelet dhe motelet më të mëdha.

Ndërsa Ariadne po nervozohet përsëri për gjendjen në bregdet, Dimitrisi i vogël vrapoi te Flutura dhe duke mbajtur dorën në prapanicë u mundua t'i thoshte diçka asaj. Vështrimi i ëmbël prej nëne i Fluturës ndryshoi pasi Dimitrisi i vogël gjatë lojës me të motrën kishte bërë nevojën në pantallona. Flutura me qejf të prishur filloi të ankohej se kishte harruar të merrte pantallona rezervë për Dimitrisin dhe e luti Kostën që të hidhte pak ujë në këmbët e Dimitrit dhe në dysheme. Kur Kosta po e lante Dimitrisin i tha me butësi se herën tjetër duhet të vijë t'i thotë mamit para se ta bëjë nevojën dhe jo pasi ta bëjë atë. Flutura e zhveshi me kujdes Dimitrisin, i mblodhi me shkathtësi pantallonat e mbushura me nevojë dhe bashkë me Dimitrisin në krahë shkoi buzë detit, ku mendonte t'i lante mirë atë dhe pantallonat. Sofija e vogël që po qëndronte e heshtur pranë nesh dhe po ndiqte çdo gjë, më kapi për dore dhe më luti të shkoja me të. Mezi priste të lahej në det.

Plazhi me guralecë, që shtrihet 30 metra më poshtë restorantit, ishte pothuajse i zbratur. Përveç disa fëmijëve që luanin me zë të lartë në largësi, aty ishin edhe dy familje me fëmijë. Prindërit po pushonin në çadra, kurse fëmijët po laheshin në det. Disa metra larg tyre Sofia shtroi peshqirin e saj, kurse Flutura u nis drejt detit me Dimitrin në krahë për ta larë atë. Kur





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

njëra nga gratë që rrinte nën çadër e kuptoi qëllimin e Fluturës, i tha asaj në shqip: “A nuk shihni që këtu ka fëmijë! Nuk do të donim të laheshim në mut!” Flutura u skuq pak dhe pa fjalë me Dimitrin në krahë u largua nga familjet. Gruaja që ishte nervozuar pak më parë me Fluturën u kthye nga i shoqi dhe po komentonte e skandalizuar veprimin e Fluturës.

Ndërkohë Sofia e hoqi fustanin dhe mu lut ta shoqëroja në det. Meqë nuk dinte ende të notonte, kishte frikë të hynte vetëm në det. Flutura dhe Dimitrisi u kthyen pas pak. Dimitri hyri në det me ne, kurse Flutura u kthye në restorant, pasi nuk i kishte marrë rrobat e banjës me vete dhe nuk e duronte diellin e nxehtë. Kur unë Dimitri dhe Sofia po laheshim në ujë të cekët, na u bashkuan edhe disa fëmijë të tjerë që po luanin gjithashtu në det. Prindërit e tyre dëgjuan që flisja greqisht me një theks tjetër dhe gruaja që më parë ishte nervozuar me Fluturën më pyeti se nga jam. Përgjigjia se jam nga Sllovenia shkaktoi tek ata interes dhe më ftuan të ulesha te çadra e tyre. Gjatë bisedës më thanë se të katërt janë të lindur në Dhërmi/Drimades. Kur ishin ende të vegjël prindërit e tyre u transferuan në Vlorë, ku gjetën dhe punë. Kiços, i lindur më 1969, tha:

Në Drimades vijmë çdo vit. Jemi prej këtej dhe e duam këtë vend. Këtu jetojnë prindërit tanë që i vizitojmë shpesh – me aq sa mundemi. Na vjen keq që vitet e fundit nga që jemi tepër të ngarkuar me punë kemi pak pushime dhe i vizitojmë prindërit vetëm në verë dhe nganjëherë gjatë *Pashkëve*. Fëmijët tanë këtu argëtohen shumë, tërë ditën e kalojnë në natyrë, ku vrapojnë lirshëm rreth e rrotull. Kjo në Athinë është e pamundur pasi Athina është qytet i madh plot me tym dhe erë të keqe. Gjithnjë lahemi nga kjo anë e plazhit ku vijnë kryesisht vendasit. Në anën tjetër vijnë kryesisht të huajt dhe unë asnjëherë s’jam ndier mirë atje. Në verë këtu është diçka me të vërtetë e veçantë, takon pothuajse të gjithë fshatarët, madje dhe ata që jetojnë në mërgim në Greqi. Gjatë vitit punojmë shumë dhe nuk kemi kohë të takohemi. Pikërisht kjo është arsyeja pse kthehemi në Drimades dhe gjatë verës vijmë te ky plazh. Mëkat që shqiptarët po e ndotin atë gjithnjë e më shumë. Hedhin plehra kudo. Drimades ka plazhin më të mirë të këtyre anëve dhe është një turp i vërtetë që shqiptarët e ndotin. Sillen si derra. E pe atë shqiptaren se si i lau pantallonat e fëmijës plot me nevojë në det! Fare afër fëmijëve tanë! Sa e shpifur!

I kujtova se gruaja që lau Dimitrin është e martuar me një vendas dhe Kiços vazhdoi:

Po, po ... Ku kemi ardhur! Natyrisht, shumë vendas janë martuar jashtë [*jashtë fshatit*]. Kjo është për të ardhur keq pasi këtu jetojnë gjithnjë e më shumë “turq”. Edhe pak dhe do t’ua kalojnë vendasve (*horiani*). Shteti (*o kratos*) po përqiqet ta bëjë këtë vend shqiptar. Por ky vend është grek,





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

edhe toponimet janë greke. Ndoshta e di emrin e atij plazhit të bukur dhe të madh që duket nga Llogaraja? Quhet *Meghalihora*. Po emrin e vendit para *Meghalihorës* e di? *Grammata* dhe pas saj *Meghalihora*. Dhe pas *Meghalihorës* *Jaliskari*.

Vangjeli që ishte ulur afër Kiços dhe po dëgjonte bisedën tonë kundërshtoi:

Nuk është ashtu! Në fillim është *Grammata*, pastaj *Meghalihora*, *Voroskopo*, *Kondratsa*, *Jaliskari* dhe atje poshtë [duke treguar me gisht drejt bregut në jug] në largësi është *Alevra*.

Kur i pyeta Kiçon dhe Vangjelin për kuptimin e këtyre emrave mu përgjigjën se këto i dinë prindërit e tyre, kurse ata i kanë harruar. Për harresën ia vënë fajin komunizmit që sipas mendimit të tyre ka përhapur një ideologji të rremë duke indoktrinuar banorët e Shqipërisë, sidomos brezat e lindur pas vitit 1945. Ndërkohë që Kiços dhe Vangjeli po ziheshin për toponimet, gratë e tyre filluan të mblidhnin gjërat që kishin me vete. Ishte kohë dreke dhe të dyja familjet u nisën për në fshat ku i priste dreka te prindërit e Kiços dhe Vangjelisit. Pasi gratë mblodhën peshqirët, dyshekët e plazhit, lodrat e fëmijëve dhe ushqimet, njëra prej tyre harroi disa mbeturina që i kishin lënë gjatë paradites, kurse tjetra i mblodhi, i futi në qese, u kthye nga unë dhe tha: "Ne i mblehim gjithnjë mbeturinat sepse e duam fshatin tonë."

#### Identifikimi dhe përkatësia

Emri i vendit buron nga përvojat e njerëzve (Tilley 1994: 15). Këto së bashku me kuptimet e vendeve janë të ndryshme, pasi varen nga përjetimi personal, kolektiv, rajonal etj. i hapësirës (Tilley 1994: 17). Vendasit e moshuar (të lindur mes viteve 1926 dhe 1945) e përjetojnë bregdetin nëpërmjet përjetimeve personale dhe kolektive të hapësirës që lidhen me kujtimet e paraardhësve dhe udhëtimeve të këtyre nëpër Shqipëri, Greqi, Evropë dhe botë. Ndryshe e përjetojnë hapësirën brezat e rinj, të lindur pas vitit 1950. Përvojat e tyre bregdetare bazohen si në përfitimin e konomik, p.sh. fitimet nga oferta turistike, ashtu dhe nga përfitimi personal, p.sh. vizitat te prindërit e tyre dhe kalimi i kohës së lirë. Përvojat e brezit të ri janë pjesërisht të lidhura me përkatësinë e tyre kolektive të cilën, sipas shembullit të Kiços dhe Vangjelit, e vendosin dhe e lidhin me lokalizmin. Kështu fshati bregdetar ndërthet në vetvete kuptime të ndryshme, të ndryshme nga brezat – e rinj dhe të vjetër – dhe nga vetëpërcaktimi i individëve.





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

Për Kostën dhe Ariadnën bregdeti ka kuptim ekonomik, pasi për ta është burim të ardhurash. Kurse Flutura dhe Lolo e konsiderojnë bregdetin si vendin e tyre, ku ata kalojnë kohën e lirë dhe ruajnë marrëdhëniet sociale. Edhe për vendasit emigrantë Këço dhe Vangjelis dhe gratë e tyre bregdeti është vendi i kontakteve sociale dhe i kalimit të kohës së lirë. Njëkohësisht fshati është vendi ku jetojnë prindërit e tyre dhe ku ata kthehen çdo vit. Pra përjetimin e vendit e përcaktojnë njëkohësisht udhëtimet dhe shpërnguljet e individëve, biografite e tyre personale, administrimi i mjeteve (p.sh. toka), objektivat dhe dëshirat e tyre.

Kur njerëzit jetojnë në një vend u duket se ai është pjesë e tyre. Përvoja e vendit është e rëndësishme në formimin e identitetit të individit (Tilley 1994: 18). Kur Ariadne flet për punën e saj në kopsht, vë në dukje kujdesin dhe zellin e saj kundrejt pakujdesit dhe neglizhencës së kushëririt të Kostës që në kopshtin e tyre kishte hedhur shishet e qelqit. Me këtë ajo flet për identitetin e saj. Si dëshmi e punës së saj të zellshme Ariadne tregon duart e rrudhura dhe të vrara nga puna, që sipas mendimit të saj nuk i shkojnë përshtat nivelit të saj arsimor ose pozicionit të saj social. Në kohën e komunizmit Ariadne ishte mësuese, ky profesion i kishte sjellur asaj privilegje në atë kohë. Në monologun për punën e saj dhe në kritikën që i bën kushëririt të Kostës ajo e cakton përkatësinë e saj në fshatin bregdetar. Ndryshe nga Kosto, Ariadne është nga Saranda. Pas martesës u transferuan në Përmet, nga ku pak vite pas rënies së komunizmit emigruan në Greqi. Në vitin 2003 u kthye në Shqipëri, ku së bashku me burrin dhe djalin Arqilenë u vendosën në Dhërmi/Drimads, vendlindja e burrit, ku Kosta kishte trashëguar shtëpinë e babait. Më vonë Kosta dhe Arqileja ndërjuan në bregun e fshatit një restorant me ushqim të shpejtë që sot është burim kryesor fitimi. Meqë Ariadne nuk është vendase, nuk ka kujtime nga fshati, prandaj përkatësinë e saj dhe fshatin i përcakton në bazë të punës së saj dhe kujdesit për kopshtin dhe restorantin. Kur ajo përshkruan sjelljen e papërshtatshme në lidhje me mbeturinat, bën dallime mes vetes dhe të tjerëve. Sipas saj kryesia vendore është neglizhuese, e pakujdesshme dhe e papërgjegjshme kur bëhet fjalë për heqjen e mbeturinave nga bregdeti. Përveç kryesisë vendore ajo kritikon edhe elitën politike dhe qëndrimin e saj ndaj fshatarëve që e përshkruan me këtë fjali: “Kjo është Shqipëria! Vetëm gënjeshtër! Një ditë kështu, tjetrën ashtu.” Me këtë fjali Ariadne është më shumë kritike ndaj qeverisë së shtetit shqiptar që e sheh si sinonim të jostabilitetit dhe të pabesueshmërisë. Duke mbivendosur dallimet (p.sh. “shtetin”, kryesinë lokale ose kushëririn e Kostës) mes vetes dhe “të tjerëve” Ariadne e cakton dhe e shpreh vazhdimisht identitetin e saj si dhe përkatësinë në fshat. Kjo lloj dinamike përputhet me procesin





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

e identifikimit, që paraqet në mënyrë të qartë lidhjen e ndërsjelltë të vendit dhe fuqisë (Gupta dhe Ferguson 2001: 14). Organizimi hapësinor i shërbimeve turistike është për Ariadnën pikënisje për riprodhimin e dallimeve hapësinore: mes “anës së të huajve” (*kseni meria*), ku shumica e pronarëve vijnë nga vendet e tjera të Shqipërisë, dhe “anës së vendasve” (*meria tou horiani*) ku qëndrojnë vendasit dhe ajo vetë, Kosta dhe kushëriri i tij. Kur Ariadne vë në dukje natyrën e saj punëtore, ajo e cilëson faktikisht kushëririn e Kostës si të pakujdesshëm dhe të papërgjegjshëm ndaj pastërtisë; në këtë mënyrë ajo e vendos atë “jashtë” vendit, kurse kur bën dallimin mes dy anëve bregdetare të “të huajve” dhe të “vendasve” e vendos atë përsëri “në” vend. Pra identifikimi është proces dinamik dhe i ndryshueshëm i dallimeve dhe ndarjeve që mund të përcaktohen në hapësirë. Identifikimet e lëvizshme, jostatike e bëjnë të lëvizshme edhe hapësirën që përcaktohet nga dallimet mes anës bregdetare të “të huajve” dhe asaj të “vendasve”.

I njëjti kontestualitet dhe relativitet hapësinor vihet re edhe te kritika e gruas së Kiços kur kritikon e skandalizuar veprimin e Fluturës. E inatosur me Fluturën që donte të lante në det pantallonat me nevojë të Dimitrisit, pikërisht aty ku po laheshin edhe fëmijët e saj, e konsideron veprimin e saj si papastërti. Edhe Koço e krahason veprimin e Fluturës me mospërgjegjësinë e “shqiptarëve”, për të cilët mendon se e ndotin ambientin. Sipas Kiços dhe gruas së tij “shqiptarët” janë përgjegjës për të gjithë papastërtinë dhe ndotjen dhe i vendosin ata (shqiptarët) “jashtë” vendit, aty ku qëndron dhe papastërtia. Në këtë mënyrë Kiço e vendos papastërtinë brenda kornizës kombëtare dhe në përputhje me këtë cakton kufijtë. Edhe pse së bashku me gruan jetojnë si emigrantë në Greqi, në sfondin e ndarjes mes “shqiptarëve” dhe “vetes”, ata vetëpërcaktohen se janë “nga” vendi; ata identifikohen me bregdetin dhe fshatin, nga ku janë dhe prindërit dhe të afërmit e tyre.

#### Manipulimi me shtetësinë

Caktimi hapësinor dhe dallime të njejta identifikuese mund të vihen re edhe në tregimin e Lolos. Kur ai tallet me shtetësinë shqiptare të Fluturës, e kupton atë në përputhje me ideologjinë e shtetit kombëtar duke vendosur hierarkinë e shtetësi: shtetësia shqiptare vlen më pak se ajo greke. Nga njëra anë rikrijon ligjërimin hegjemonist për “shqiptarët” ose “*Alvanos*”, ashtu siç përhapet nga mediet, qarqet ekonomike dhe politike në Greqi,<sup>85</sup>

<sup>85</sup> Më shumë për qëndrimin negativ dhe ligjërimet stereotipe në mediet greke shiko Kretsi 2002, de Rapper 2002, Mai in Schwandner-Sievers 2003.





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

kurse në anën tjetër ironia e tij dhe ndërrimi i shtetësive pas rënies së komunizmit ilustrojnë manipulimin me shtetësinë në kuadrin e rregullave burokratike dhe politikës ndërkombëtare.

Mendësinë e Lolos mund ta interpretojmë nëpërmjet definicionit të poetikës sociale të Herzfeldit (*social poetics*), që do të thotë se “në marrëdhëniet e përditshme normat ripërsëriten dhe përcaktohen nëpërmjet transformimit të konventave sociale” (Herzfeld 2005: 37). Tallja e Lolos tregon se si individët e prodhojnë dhe e menaxhojnë në mënyrë individuale kuptimin e shtetësisë, të vendosur në ideologjinë shtetërore. Në ndërveprimet e mekanizmave politike, burokratike dhe ekonomike shqiptare me ato shtetërore greke, Lolo e trajton shtetësinë si diçka që i sjell përfitim.<sup>86</sup> Nga kjo rrjedh se kuptimi i shtetësisë nuk është diçka statike dhe e vendosur paraprakisht, por është dinamik dhe i ndryshueshëm. Edhe pse dinamik, qëndrimi i Lolos ndaj shtetësisë lundron në ujërat e ideologjisë shtetërore. Nëse do ta interpretonim rindërtimin që i bën Lolo shtetësisë greke dhe shqiptare me konceptin e krijimtarisë së Herzfeldit, do të dilte se shembulli i Lolos e dëshmon pjesërisht këtë krijimtari. Është e vërtetë se Lolo e trajton shtetësinë si diçka që i sjell dobi (kalime pa limit të kufirit mes Shqipërisë dhe Greqisë, arsim falas për fëmijët, sigurim social dhe shëndetësor në Greqi), por nuk e bën atë në mënyrë krijuese. Ai e “jeton” shtetësinë e tij dhe në praktikën jetësore nuk e ndryshon atë në mënyrë krijuese, pavarësisht se çfarë mendon për të; lëviz ende në kornizat e politikës ndërkombëtare dhe në to gjen mënyrën se si shtetësia t’i sjellë përfitime.

Në veprën e saj *Shkrime nga Ballkani Green* (2005: 124) diskuton mbi cinizmin dhe ideologjinë e shtetit kombëtar në Pogoni dhe konstaton se individët e riprodhojnë ideologjinë shtetërore jo për të kundërshtuar cinizmin, por për shkak të tij. Kur kontradiktat dhe konfliktet në jetën e përditshme janë të parregulluara, sipas mendimit të Greenit poetika e Herzfeldit shpesh nuk mjafton që me të të shpjegohen ndryshimet e qëndrimit të individit ndaj shtetit. Ideologjia shtetërore – “përcaktuese” dhe “legaliste” – depërton nëpërmjet “kthetrave” politike, burokratike dhe ekonomike. Ironia e Lolos qëndron në mënyrën se si ai riprodhon shtetësinë dhe ideologjinë shtetërore në përgjithësi.

Kuptimi hegjonik i “shtetit” (*kratos*) del në pah edhe nga dallimi që bën Kiço mes *horiani*, që janë *apo ton topos*, “nga” vendi, dhe *kseni* që janë “jashtë” vendit. Sipas fjalëve të Kiços martesat duhet të lidhen vetëm mes vendasve, pra atyre që janë “nga” vendi. Martesat jashtë vendit apo fshatit sipas Kiços sjellin rrezik që fshati të bëhet “shqiptar”. Përveç kësaj

<sup>86</sup> Si shtetas grek dhe si bujk i regjistruar në Greqi, Lolo do të marrë pension në përputhje me sistemin e sigurimit OGA.





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

shpreh shqetësimin se në të ardhmen fshati do të popullohet gjithnjë e më shumë me shqiptarë, që i quan me përbuzje *turq*. Ai e konsideron shtetin si autoritet me rëndësi dhe me fuqi që dëshiron ta bëjë Dhërmiun/Dirmadesin një fshat “shqiptar”. Ashtu si dhe Lolo e njëson shtetësinë me kombësinë dhe të dyja i përcakton si mekanizma të rëndësishëm në procesin e formimit të identitetit të individit. Kur identitetin e përcakton në raport me kombësinë, e shikon atë sikur të kishte ekzistuar “prej kohësh”, madje edhe para lindjes së shteteve kombëtare në shek. e 19. Kìços e konsolidon kombësinë e tij si diçka “natyrore” në përputhje me ideologjinë shtetërore.

Në mënyrë të njëjtë rendit emrat grekë të ishujve dhe plazheve ranore në fshat dhe rreth tij. Duket sikur nëpërmjet emërtimeve e përcakton bregdetin si grek. Kur Vangjelisi e plotëson atë duke shtuar emra të tjerë dhe duke e korrigjuar me ndryshimin e renditjes së emrave, del në pah moskoherenca në rrëfimin e tij. Gjithsesi, të dy rindërtojnë imazhin e bregdetit në përputhje me identitetin e tyre që është i ngujuar në ideologjinë e shtetit kombëtar.

#### SEZONI VEROR

Në muajt verorë jeta e përditshme në fshat ndryshon krejtësisht, sidomos në fillim të gushtit kur për shkak të pushimeve kolektive në Greqi dhe Itali (1 deri 25 gusht) në fshat kthehet shumica e vendasve që jetojnë në emigracion. Gjatë kësaj kohe në rrugë dhe në kalimet kufitare Kakavia dhe Konispol krijohen pritje me orë të tëra. Shumica e vendasve që jetojnë në Greqi kthehen në Dhërmi/Drimades ku kalojnë pushimet dhe festojnë Fjetjen e Shën Mërisë ose Pashkët e Vogla (*Panajia* ose *Mikri Pashka*, më 15 gusht). Pronarët e restoranteve dhe bareve përpiqen të fitojnë sa më shumë gjatë kësaj kohe, pasi fitimi veror (10. – 15.000 Euro për pronarë) përbën shpesh fitimin vjetor që ata e përdorin për shpenzimet e përditshme dhe për investime – ndërtime të shtëpive të reja, rinovime dhe përmirësime të objekteve të tyre turistike.

Shumë emigrantë – turistë, prindërit e të cilëve janë nga Dhërmiu/Drimades, në verë e bllokojnë anën juglindore të përroit *Potami*, nga ku shtrihet një plazh i gjerë me guraleca. Me emigrantët përzihen edhe turistët nga Evropa dhe vende të tjera të Shqipërisë. Shumica e turistëve nga Shqipëria dhe gjatë përqëndrohen kryesisht në gjijtë e vegjël në anën veriperëndimore të përroit. Me rritjen e numrit të njerëzve në fshat dhe me mungesën e shërbimeve komunale gjatë sezonit turistik rritet shumë sasia e mbeturinave dhe e deponive të mbeturinave rreth





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

rrugëve, shtegjeve, lëndinave dhe livadheve<sup>87</sup>. Kështu që nuk është çudi që mbeturinat të jenë objekt bisedimesh dhe mosmarrëveshesh mes pronarëve, emigrantëve dhe turistëve që takohen në bregdetin e fshatit.

##### Debate dhe bisedime për mbeturinat

Gjatë diktaturës komuniste aksionet e pastrimit që organizoheshin zakonisht me iniciativën e Partisë së Punës kontribuonin tek ideja e untetit dhe homogjenitetit të shtetasve dhe edukimit të përgjegjësishë për ambientin e përbashkët. Qëllimi ishte nxitja e individëve ose e shtetasve për të bashkëpunuar dhe kontribuar për mbajtjen pastër të mjedisit, për të “mirën e përbashkët” të “shtetit” të tyre. Pas rënies së komunizmit u hoq dorë edhe nga aksionet e pastrimit, kurse për shkak të krizës së përgjithshme ekonomike (Sjöberg 1992) u hoq dorë edhe nga kujdesi për heqjen sistematike të mbeturinave. Me lirimin e kufijve dhe liberalizimin e marrëdhënieve ekonomike në tregun shqiptar po shihen gjithnjë e më shumë materiale jo të degradueshme (plastikë, teneqe, bateri et.). Organizatat amerikane, si p.sh. USAID, Banka Botërore dhe organizata të tjera jofitimprurëse kanë filluar të tërheqin vëmendjen mbi problematikën e mbeturinave: zgjidhjet e propozuara janë vendgrumbullimet e mbeturinave dhe funksionimi i shërbimeve komunale që bëjnë pastrimin sistematik të mbeturinave dhe të mjedisit rrethues. Kështu në vitin 2005 Banka Botërore financoi pastrimin e bregdetit në bashkitë e Vlorës, Sarandës dhe Himarës/Himara (shiko *Albanian Coastal Zone Development and Cleanup Program*). Në maj 2005, një muaj para zgjedhjeve qeveritare (3 korrik 2005), bashkia e Himarës/Himara me ndihmën financiare të Bankës Botërore vendosi kazanë për mbeturina në qendër të fshatit, ku kalon dhe rruga e bregdetit. Katër kazanë i vendosi në brendësi të fshatit. Përveç kësaj gjatë sezonit turistik (nga qershori në gusht) ka vënë në funksion edhe shërbimin komunal për heqjen e mbeturinave. Bashkia bleu për këtë qëllim edhe një kamion dhe punësoi disa punëtorë sezonalë që gjatë ditës mbledhin mbeturinat përgjatë bregut dhe i hedhin në vendgrumbullimin pranë fshatit fqinj Vuno. Me gjithë këto ndryshime nuk e kanë zgjidhur këtë problematikë, përkundrazi, mbeturinat janë bërë objekt debatesh dhe mosmarrëveshjes mes turistëve dhe pronarëve të lokaleve turistike.

87 Në Dhërmi/Drimades kazanët e mbeturinave gjenden kryesisht pranë shtëpive, anash rrugicave dhe rrugëve, në parcelat e pandërtuara, në lëndina dhe livadhe. Tre deri katër herë në vit fshatarët i djejin mbeturinat dhe fshati mbulohet nga tymi i zi dhe era e keqe sikur të digjej plastikë, apo kanaçe, apo material i pareciklueshëm. Edhe në bregun e detit kazanët e mbeturinave gjenden në të njëjtat vende si në fshat.







#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

Kush i hedh mbeturinat dhe kush është përgjegjës për ngarkimin e bregdetit me mbeturina? Kush do të duhej të kujdesej për heqjen e tyre? Kjo është konfliktuale si për shumicën e vendasve, ashtu edhe për turistët. Disa pronarë të objekteve turistike mendojnë se për zgjidhjen e problemit të mbeturinave është përgjegjëse vetëm bashkia, që është e papërgjegjshme dhe nuk kujdeset për heqjen sistematike të tyre.

Një pasdite gushti po bisedoja me Athinën, lindur më 1948 në Tiranë. Burri i Athinës është vendas nga Dhërmiu/Drimadesi. Ata janë njohur në Tiranë gjatë studimeve. Aty jetuan deri në vitin 1990 kur emigruan bashkë me fëmijët në Athinë ku jetuan për dhjetë vjetë. Athina ishte amvisë, kurse Andrea punëtor fizik. Në vitin 2000 u kthyen në Shqipëri dhe u shpërngulën në shtëpinë e babait të Andreas në Dhërmi/Drimades. Një vit më vonë Andrea hapi një hotel të vogël në breg të detit. Përsa i përket problematikës së mbeturinave Athina tha këto:

Edhe vitet e shkuara bashkia e Himarës/Himara është ndihmuar nga shteti për t'u kujdesur për grumbullimin dhe heqjen sistematike të mbeturinave. Por megjithatë s'bëri asgjë. Këtë vit, nga ankesat dhe protestat e shumta të vendasve ka organizuar shërbimin komunal që çdo ditë mbledh mbeturinat para hoteleve dhe restoranteve në bregdet. Me që vite më parë nuk funksiononte shërbimi komunal, burrit tim i duhej t'i hiqte vetë ato. Çdo mëngjes ai merrte qese të zeza të mëdha plot me mbeturina dhe i çonte në rrethinat e fshatit. E ku t'i hidhte? Edhe për rrugën me zhavorr që të çon te hoteli ynë na është dashur të kujdesemi vetë dhe të investojmë paratë tona. Mund ta imagjinosh se si ishte rruga deri te hoteli ynë! Faktikisht s'kishte asgjë. Vetëm gropa dhe shkëmbinj. Kalimi me makinë ishte i pamundur. Na u desh të merrnim punëtorë që ta rrfshonin me makineri rrugën. Puna e tyre na kushtoi shtrenjtë, po çfarë të bënim? Kemi qeni prej vendasve të parë që kemi nisur me ofertë turistike në këtë pjesë të bregdetit. Prandaj të gjitha shpenzimet e rrugës i mbuluam ne. Sot shpenzime të tilla i ndajmë mes fqinjëve. Kur është e mundur, kuptohet. E kush do të na ndihmojë, po s'e ndihmuam vetë veten, ne vendasit (*horiani*). Te shteti nuk mbështetemi dot. Edhe bashkia në Himarë duhet një herë t'i qartësojë gjërat me zilinë e vet, pasi Drimades po bëhet konkurent i rrezikshëm dhe ndoshta pikërisht për këtë na krijojnë vështirësi të tilla. Kështu për shembull vitin e kaluar, në kulmin e sezonit na e ndërprejnë rrymën elektrike gjoja nga ngarkesa e tepërt. Përveç kësaj nuk donin t'i hiqnin mbeturinat, pasi, siç deklaruan, ky lloj shërbimi ishte shumë i shtrenjtë për bashkinë. Vetëm tani, pas protestës së pronarëve kundër injorancës së tyre, bashkia ka filluar të na ndihmojë.

Arqileja, prindërit e të cilit janë të lindur në Dhërmi/Drimades, është si ata pronar i një restoranti në breg të detit. Rreth përgjegjësisë për mbeturinat foli disi ndryshe. Arqileja është i lindur në vitin 1970 në Korçë,





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

ku prindërit e tij ishin shpërngulur në vitet gjashtëdhjetë. Në vitin 1990 emigroi në Greqi ku punoi për disa vite si punëtor fizik në Athinë, më vonë vendosi të studiojë për turizëm dhe biznes. Pas mbarimit të studimeve u punësua në një agjenci turistike në Athinë. Në vitin 2000 u kthye në Dhërmi/Drimades.

Meqë Himara është zonë problematike, politika e shtetit nuk do të investojë për përmirësimin e infrastrukturës së saj. Kështu rruga magjistrale është e mbuluar nga gropat dhe në të kanë mbetur vetëm arna asfalti. Kemi vështirësi me rrymën elektrike dhe me mbledhjen e plehrave. Përveç kësaj nuk kemi shërbim të përshtatshëm mjekësor dhe turistëve nuk mund t'u ofrojmë siguri. Problem tjetër është edhe transporti i pasigurt publik dhe mungesa e sigurisë në rrugë, gjë që vlen për të gjithë vendin. Pra ka shumë arsye pse nuk mund t'ua rekomandojmë turistëve fshatin tonë. Me rëndësi është se bashkia e Himarës nuk merr kurrë nga buxheti i shtetit mjete të mjaftueshme për t'i investuar në zhvillimin e infrastrukturës, mjeksisë dhe përmirësimin e ofertës turistike. Shumat që na jep shteti nuk na mjaftojnë që të përballemi me të gjitha vështirësitë njëkohësisht. Kështu që nisma për zgjidhjen e problemeve dhe zhvillimin e krahinës na mbetet neve, vendasve, dhe varet prej punës dhe pjesëmarrjes sonë. Më mirë bashkëpunoj me një fqinj të vështirë sesa t'ia lë shtetit të ma marrë tokën. Shpresoj të vijmë kohë të mira, pasi na kanë ofruar ndihmë disa organizata ndërkombëtare. Për shembull në vitin 2008 Banka Botërore ka si objektiv të zbatojë një projekt pilot për rinovimin e shtëpive të vjetra në Drimades. Këtë lloj ndihme nuk mund ta presim nga shteti që nuk na do sepse jemi grekë. Me këtë kurrësesi nuk pajtohemi.

Fjoralba, e lindur në vitin 1970 në Berat, në verën e vitit 2005 punonte në restorantin që së bashku me burrin e kishin marrë me qira. Para kësaj kishte drejtuar një restorant në Berat që për shkak të të ardhurave të ulta e kishte mbyllur. Më vonë vendosën të dy me burrin që ta provonin edhe njëherë fatin e tyre në Dhërmi/Drimades:

Sa çudi më duket këtu! Jam në Shqipëri dhe e ndiej veten si refugjate. Nuk e kuptoj çfarë nuk shkon te këta njerëz, tërë kohën flasim greqisht. Përveç kësaj dëgjojnë vetëm muzikë greke dhe turistëve u ofrojnë vetëm ushqim grek, siç janë sallata greke dhe *tzatziki*. Është e tmerrshme dhe e turpshme që nuk janë në gjëndje t'u ofrojnë turistëve ushqime tradicionale shqiptare. Për shembull, kur disa turistë izraelianë donin të provonin diçka tipike të këtyre anëve nuk munda t'u ofroj asgjë, pasi pronari i këtij lokali nuk dëshiron të gatuj ushqim tradicional shqiptar. E ndjeva veten ngushtë kur turistët më pyetën nëse kuzhina shqiptare dhe ajo grek ngjajnë. Natyrisht që jo! Por këtu njerëzit duan çdo gjë që është greke. Këtu njerëzit janë me të vërtetë të çuditshëm, sillen sikur të jenë shumë të rëndësishëm. Sidomos meshkujt që s'punojnë fare, si





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

ai burri në barin tonë për shembull [tregon me kokë drejt një burri të ulur në bar]. Fle tërë kohën dhe kur vijnë mysafirët duhet t'u shërbej unë me pije. Ama e kam vendosur të mos e mbështes më dembelizmin e tij. Këta meshkuj [burrat e fshatit] dinë vetëm të rrinë ulur, të pijnë cigare dhe raki, ndërkohë që grave të tyre u del kurrizi nga puna. Këtë s'e kuptoj dot! Nëse nuk duan të punojnë, përse hapin biznese të tilla? Me të vërtetë, nuk e kuptoj karakterin e tyre të çuditshëm dhe të paqytetëruar. Fshatarë! Përveç kësaj, janë edhe shumë të pisët. A e ke parë ku i hedhin plehrat? Nëpër shkurre, përtej rrugës. Si derrat! Po të isha turiste, nuk do të haja kurrë në këtë restorant. Më vjen neveri të ha pranë dikujt që hedh plehrat përtokë. Me të vërtetë më vjen keq që kam ardhur këtu! S'e ndiej veten mirë dhe mezi pres të mbarojë sezoni dhe të largohem nga ky vend.

Gjatë qëndrimit tim në Dhërmi/Drimades kam takuar edhe turistë nga vende të ndryshme evropiane. Përveç grupit të turistëve nga Izraeli, që kaluan në fshat dy ditë, takova një turist nga Gjermania, dy nga Hungaria, gjashtë nga Anglia dhe dy nga Franca. Çiftin nga Franca e njoha në fshat kur po kërkonin kishën e Shën Mërisë që përmendet në guidën turistike që e kishin blerë në një librarë në Vlorë.<sup>88</sup> Ata kënaqen me udhëtimet e tyre në Evropë, ky është hobi i tyre. Për Shqipërinë u tregoi një shok që kishte punuar për një organizatë joqeveritare në Tiranë. Burri tha:

Më pëlqen bregdeti jugor i Shqipërisë, sidomos fshati i Himarës. Bashkë me gruan kemi vizituar edhe Sarandën, por nuk u kënaqëm edhe aq shumë si këtu. Këtu ka më shumë gjelbërim dhe më pak hotele të mëdhenj dhe restorante si në Sarandë. Këtu mund të bësh gjëra të ndryshme. Mund të shkosh në plazh dhe të kënaqesh duke notuar, të shëtisësh përgjatë plazhit me guralecë apo të ngjitesh në fshat dhe të shikosh shtëpitë dhe kishat e vjetra të mrekullueshme, disa prej të cilave kanë afreske të vjetra mahnitëse. E vetmja gjë që s'na pëlqen në këtë vend janë mbeturinat. Vendasit janë mospërfillës ndaj mbeturinave dhe i hedhin kudo. E pabesueshme! [qesh]

Një grup të rinjsh, dy vajza dhe tre djem, kishte mendim tjetër ndaj mbeturinave në krahasim me bashkëbiseduesit e tjerë. Këta janë të lindur në Greqi, kurse prindërit e tyre janë të lindur në Dhërmi/Drimades. Njëra nga vajzat e shpjegoi mendimin e saj për këtë çështje me këto fjalë:

Me të vërtetë kënaqemi kur vizitojmë fshatin e lindjes së prindërve tanë, ku jetojnë edhe gjyshërit. Na vjen keq që s'mund të qëndrojmë më shumë se njëzet e pesë ditë në vit, e duam fshatin tonë. Drimadesi ka një plazh të mrekullueshëm dhe një det unik. Por vitet e fundit këtu ka gjithnjë e më

<sup>88</sup> Guida turistike *Vlora, rrugë, ofertë turistike, plazhe, male, shpella, misteret e tregimeve, njerëzit dhe kuzhina tradicionale*, redaktuar nga Renato Novelli, është botuar nga organizata italiane UNOPS-PASARP. Botimi ka dalë në shqip, italisht dhe anglisht.





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

shumë *Alvani*. Nuk jemi mësuar me këtë, pasi për shumë kohë në plazh vijnë vetëm *horiani*. Tani ka gjithnjë e më shumë shqiptarë. Shikoj! [duke treguar një grup djemsh të rinj të ulur pranë nesh]

##### Mbeturinat si diçka jashtë vendit

Në bisedimet dhe negociimet se kush është fajtor për mbeturinat dhe se kush do të duhej të kujdesej për bregdetin e pastër, bashkëbiseduesit (ri) krijojnë parreshtur hapësirën e fshatit. Në përputhje me rezultatet e Mary Douglasit, edhe në Dhërmi/Drimades mbeturinat janë pjesë e rregullimit shoqëror dhe hapësinor si dhe e sistemimit. Kuptimet e mbeturinave dhe papastërtisë bazohen në refuzimin e “elementeve të papërshtatshme”, me të cilat përcaktojnë njëkohësisht vetveten dhe “gjërat jashtë vendit”. Nëse nga njëra anë mbeturinat etiketojnë atë çka është “e papërshtatshme” dhe “jashtë” vendit, në anën tjetër etiketojnë çka është “e përshtatshme” dhe “brenda” vendit. Debatet e nxehta për papastërtinë dhe mbeturinat që u ndezën në bregdetin e fshatit verën e 2005, njësoj si tregimi i Kiços dhe Ariadnës, ilustronjë kuptimet e të qenurit “jashtë” dhe “nga” vendi, të ndryshueshëm dhe të caktueshëm me kontekstin shoqëror dhe kulturor të bashkëbiseduesve.

Bazuar në përvojat e kaluara dhe jetën në Greqi, Athina, e lindur në Tiranë dhe e martuar me një vendas nga Dhërmiu/Drimades, bën dallim mes “vendasve” dhe “shtetit” duke përforcuar kuptimin e lokalizmit ose të autoktonisë. Në përshkrimin e ndërtimit të rrugës, që mundësoi qasjen në hotel, Athina vë në dukje dhe përcakton përkatësinë e saj në fshat dhe bregdet. Dallime mes “vendasve” dhe “shtetit” bën edhe Arqileja, nëpunës në bashkinë e Himarës/Himara, që pas disa vitesh jetese në Greqi është kthyer në fshatin e prindërve. Ashtu si Athina edhe Arqileja nuk ka jetuar më parë në fshat ku sot është pronar restoranti. Si ish-student për turizëm dhe ish-agjent turistik në Greqi vë theksin në “mungesën e zhvillimit” të infrastrukturës, në të cilën shikon një prej burimeve kryesore të zhvillimit të turizmit në fshat. “Shtetit” ose elitës politike i vë faj për mungesën e përgjegjësisë në kujdesin për infrastrukturën dhe mbledhjen e plehrave. Është interesante se këtë e sqaron me angazhimin e vendasve për vendin e tyre dhe me mospajtimin e elitës politike me faktin që ata janë “grekë”. Punëtorja sezonale Fjoralba nga Berati e ndriçon problemin e mbeturinave nga një këndvështrim tjetër. Ajo ka ardhur në Dhërmi/Drimades në sezonin e verës, për një fitim më të mirë. Këtu ajo takohet me pronarët jomikpritës të lokaleve që në bisedat e përditshme përdorin greqishten që ajo s’e kupton. Për shkak të përvojave negative Fjoralba





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

ankohet për përdorimin e gjuhës greke nga vendasit dhe kritikon ofertën e papërshtatshme kulinare, pasi pronarët vendas të lokaleve u ofrojnë turistëve vetëm ushqim grek dhe dëgjojnë vetëm muzikë greke. Ajo i cilëson “vendasit” negativisht, i konsideron fshatarë dhe njerëz “jashtë” vendit. Turistët nga Franca, që vijnë nga një ambjent i ndryshëm kulturor dhe shoqëror në krahasim me bashkëbiseduesit e tjerë, nuk bëjnë dallime të tilla. Për ta bregdeti i fshatit është thjesht një prej stacioneve të udhëtimit të tyre në Shqipërinë e Jugut. Duke lavdëruar fshatin dhe bregdetin e tij mendojnë se arsyeja e papastërtisë së bregdetit qëndron te pakujdesja e vendasve: mbeturinat e dëmtojnë imazhin e fshatit dhe janë diçka “jashtë” fshatit. Dhe së fundi grupi i të rinjve që jetojnë në Greqi dhe i kalojnë pushimet në bregdetin e fshatit ia kalon (mos)përgjegjësinë për mbeturinat shqiptarëve “të zinj” dhe të “pisët”. Duke u bazuar në jetën e tyre në Greqi, ku janë të bombarduar me stereotipe dhe stigmatizime të përhapura nga mediet greke (khs. Kretsi 2002; de Rapper 2002; Mai dhe Schwander-Sievers 2003) ndaj emigrantëve shqiptarë, grupi i të rinjve bën dallime mes “vendasve” dhe “shqiptarëve”.

Siç vëren dhe Appadurai, rrëfimet e bashkëbiseduesve tregojnë se si termi “vendas” është një arritje relacionale që vendoset gjithmonë në rrjetën e tërësisë së marrëdhënieve dhe përfshihet në procesin e prodhimit social. Kështu sipas mendimit të Athinës, gruaja e pronarit të hotelit që është vendas, “lokalizmi” ose “autoktonia” përcaktohen në kundërshtim me nëpunësit e bashkisë. Sipas Arqilesë, nëpunës bashkie dhe pronar lokal, “lokalizmi” ose “autoktonia” janë të menduara në raport dhe njëkohësisht në kundërshtim me “shtetin” dhe elitën politike në pushtet. Ndërsa rrjeti social i Fjoralbës nga Berati, ku kanë lindur edhe prindërit e saj, ndryshon nga ai i Athinës dhe Arqilesë. Me këtë mund të shpjegoj dhe qëndrimin refuzues që ajo ka ndaj “vendasve”. Kurse çifti nga Franca vjen nga një ambjent krejtësisht tjetër: prandaj ata nuk i vendosin “vendasit” në nivel lokalist apo rajonal, po ti krahasojmë me Athinën, Arqilenë dhe Fjoralbën. Ata i vendosin “vendasit” brenda kornizës kombëtare, si shqiptarë. Po ashtu grupi i emigrantëve të rinj edhe pse vjen nga një tjetër rrjet social, e vendos “lokalizmin” dhe “autoktoninë” në nivel kombëtar. Ai i njëson ato me të qenurit grekë dhe jo me atë shqiptarë. Shembujt e prezantuar këtu ilustrojnë faktin se si kuptimet “vendas”, “lokalizëm” dhe “autoktoni” nuk janë kategori statike, por janë në ndryshim të vazhdueshëm dhe varen nga rrjetet e marrëdhënieve shoqërore që thuren prej individëve.

Debatet dhe bisedimet rreth papastërtisë dhe mbeturinave ilustrojnë faktin se sa komplekse dhe të rastësishme janë kategoritë e mikpritisit ose të “vendasit” dhe mysafirit ose “turistit”, si dhe dallimet mes tyre që





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

kanë qenë objekt diskutimesh në fillimet e zhvillimit të antropologjisë së turizmit (Cohen 1974, Wahab 1975, Smith 1989: 4, Crandall 1980). Ndryshe nga vepra *Mikpritës dhe mysafirë* (Smith 1989: 4), ku radhiten lloje të ndryshme turizmi dhe kategoritë e mikpritësve dhe mysafirëve që lidhen me ta, zënkat dhe negociatat mbi mbeturinat dëshmojnë se kuptimet e mikpritësit dhe mysafirit nuk janë statike dhe të kundërta, por të lëvizshme, plotësuese dhe varen nga konteksti shoqëror dhe kulturor. Ashtu siç ka konstatuar Selwyn<sup>89</sup> (1996: 8) në zbulimet e tij etnografike në Maltë, edhe rezultatet e Dhërmiut/Drimadesit ilustrjnë faktin se sa kalimtare dhe të lira janë dallimet mes përcaktimit të mikpritësit ose të "vendasit" dhe mysafirit ose "turistit" (shiko edhe Kenna 1993). Tregimet e prezantuara tregojnë se në të dyja kategoritë, "vendas" dhe "turist", bëhet fjalë për deklarata retorike që shprehin pozitën e bashkëbiseduesit në rrjetin e marrëdhënieve shoqërore. Kështu p.sh. grupi i të rinjve emigrantë i konsideron turistët si "vendas" në krahasim me "turistët shqiptarë" për të cilët presupozon se janë të pistë dhe nga "jashtë" vendit. Turistët nga Franca e kategorizojnë ndryshe termin "vendas", i cili për ta përfshin emigrantët e rinj, turistët, turistët e tjerë nga Shqipëria dhe Kosova, punonjësit turistikë dhe pronarët e restoranteve, bareve dhe hoteleve të vogla. Pikërisht këtyre ua vënë përgjegjësinë për ndotjen e bregdetit.

Papastërtia dhe mbeturinat kanë historinë e tyre. Dhërmiu/Drimadesi, ashtu si dhe vendet e tjera në Shqipëri, ka qenë ndër shekuj pjesë përbërëse e ndarjeve të ndryshme administrative dhe politike të njerëzve dhe vendeve. Dallimet mes "neve" dhe "të tjerëve" nëpërmjet administratave politike, që i kategorizonin në mënyra të ndryshme vendet dhe njerëzit, u bënë gradualisht pjesë e jetës së përditshme të njerëzve. Pasojë e mospërputhjeve mes mënyrës së kategorizimit osman dhe kombëtar kanë qenë mosmarrëveshjet që sot shfaqen në përpjekjet e banorëve të Dhërmiut/Drimadesit për të afirmuar lokalizmin dhe përkatësinë e tyre në fshat. Nga bisedimet del qartë se lokalizmi dhe "autoktonia" vendosen në raport me kuptimet e tjetrit, "të huajt". Emigrantët nga Dhërmiu/Drimadesi e konsiderojnë veten "vendas" nga bregdeti, ku kthehen çdo vit për të kaluar pushimet. Edhe vendasit që jetojnë prej kohësh në fshat i shikojnë ata si pjesë përbërëse të bregdetit, kurse "të huajt", "shqiptarët", sipas tyre nuk i përkasin bregdetit.

89 Në hyrjen e përmbledhjes me titull *Imazhi i turistit. Mitet dhe ndërtimi i miteve në turizëm* Selwyn përmend faktin se si debatet mbi plehrat dhe mbeturinat në qytetin turistik të Valetës në Maltë kanë një rëndësi thelbësore për ndërtimin e identitetit të banorëve. Në kundërshtim me të dhënat etnografike nga Dhërmiu/Drimadesi, shembulli i Selwyn-it tregon se si Fondacioni për Studime Ndërkombëtare e ka vlerësuar pakujdesinë në hedhjen e mbeturinave si pjesë të së ashtuquajturës "kulturë autentike malteze" (Selwyn 1996: 31).





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

Përveç kategorizimeve të përmendura, kuptimet e papastërtisë dhe mbeturinave në bregun e fshatit përfshijnë edhe mosmarrëveshjet mes përgjegjësisë individuale dhe kolektive si dhe përgjegjësisë së “shtetit” dhe “bashkësisë lokale”. Mosmarrëveshjet mes përgjegjësisë individuale dhe kolektive përcaktohen me procesin e tranzicionit: nga përgjegjësia kolektive për mjedisin e pastër, e përhapur në kohën e komunizmit, deri te përgjegjësia individuale që filloi të përhapej me afirmimin e parimeve demokratike. Aksionet kolektive të pastrimit (p.sh. pastrimi i rrugicave, rrugëve mes qendrave të qyteteve, fshatrave etj.), që zbatoheshin nga Partia e Punës, bazoheshin në nxitjen dhe përhapjen e idesë së unitetit dhe homogjenitetit të shtetasve të Shqipërisë dhe krijuan ndjenjën e lidhjes dhe përgjegjësisë për lagjen ku jetohej dhe për shtetin. Aksionet e pastrimit ishin një nga mjetet e aparatit të shtetit (Althusser 1980 [1977]), me të cilat Partia e Punës përhapu idenë e ndërgjegjes kombëtare dhe të unitetit. Nga njëra anë këto ide bazoheshin në unitetin e shtetasve dhe të territorit shtetëror, dhe në tjetrën parashikonin edhe dallimet mes tyre. Pas rënies së komunizmit dhe vendosjes së demokracisë për disa persona ideologjia e hegjemonisë së unitetit kombëtar dhe e barazisë vazhdoi të krijohej dhe të transmetohej në përfytyrimet dhe praktikat e përditshme, kurse për disa të tjerë u vu në diskutim. Kështu p.sh. Athina dhe Arqileja kritikojnë shtetin e “pakujdesshëm” që nuk kujdeset për mbledhjen dhe pastrimin e mbeturinave dhe i kundërvënë atij përgjegjësinë individuale në pastrimin e bregdetit. Ata nuk presin mbështetje financiare nga “shteti” dhe zgjidhjen e problemit e shikojnë te bashëpunimi i vendasve dhe te ndihmat e mundëshme të organizatave ndërkombëtare, p.sh. Banka Botërore.

Përveç te ato që u tha më lart, bashkëbiseduesit e vënë theksin edhe te mosmarrëveshjet mes “shtetit” dhe “bashkësisë lokale”. Tregimet e tyre që burojnë nga kontekste të ndryshme shoqërore dhe kulturore, tregojnë se si e krijojnë dhe e kuptojnë unitetin dhe homogjenitetin sipas mënyrës së tyre të konceptimit të “shtetit” dhe “bashkësisë lokale”. Kur flasin për to i trajtojnë si entitete të veçanta, të përcaktuara me gjuhën, territorin, traditat dhe zakonet e njerëzve që jetojnë në këto tërësi – “në shtet” ose në “bashkësi lokale”. Fjoralba duke kritikuar e nervozuar vendasit, përdorimin e gjuhës greke, ofertën e ushqimit grek dhe dëgjimin e muzikës greke, flet për kuptimin e “të qenurit shqiptar” si entitet homogjen. Në të njëjtën mënyrë si Fjoralba e kupton “të qenurit shqiptar” Arqileja dhe grupi i të rinjve emigrantë. Ata i përcaktojnë “lokalizmin” dhe “autoktoninë” si entitete homogjene. Të dy bashkëbiseduesit, Fjoralba dhe Arqileja, me pikëpamjet dhe përfytyrimet e tyre në lidhje me mbeturinat në bregdet,





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

krijojnë dhe përçojnë idetë mbi unitetin dhe homogjenitetin e banorëve, të cilët i përcakton si “shqiptarë” ose “vendas”.

Zënkat, bisedimet për mbeturinat dhe mënyra e pastrimit të tyre lidhen me marrëdhëniet dhe kontaktet mes individëve. Këto përbëjnë kornizën e dallimeve që janë burim mosmarrëveshjes mes vendasve, të kthyerve nga emigracioni, emigrantëve, punëtorëve sezonalë, turistëve shqiptarë dhe të huaj. Dallimet dhe ndarjet shoqërore janë paralele me dallimet hapësinore, pasi si dallimet shoqërore ashtu dhe ato hapësinore i japin kuptim bregdetit turistik në Dhërmi/Drimades. Bregdeti përbëhet nga pjesa veriperëndimore dhe ajo juglindore që i ndan përroi *Potami*. Duket sikur pjesa veriperëndimore, ku janë përqëndruar më shumë pronarët e objekteve turistike dhe turistë nga vendet e tjera të Shqipërisë dhe Evropës, e lidh bregdetin dhe njerëzit me Shqipërinë. Pjesa juglindore e bregdetit, ku gjenden kryesisht pronarët vendas dhe emigrantët të lindur në Dhërmi/Drimades, dhe disa turistë nga Evropa është më e lidhur me Greqinë. Ndarje të njëjta të hapësirës vihen re edhe te përcaktimet se kush është “jashtë” dhe kush është “nga” vendi, ose kush është i huaj, që s’i takon fshatit dhe kush është vendas, që i takon fshatit.

#### PËRMBLEDHJE

Debatet dhe bisedimet për mbeturinat dhe heqjen e tyre bazohen te ndërveprimet e individëve, me të cilat krijohen ndarje dhe dallime, që nganjëherë shkaktojnë mospajtime mes vendasve, emigrantëve, punëtorëve sezonalë, turistëve shqiptarë dhe të huaj. Këto ndarje shoqërore lindin paralelisht me ato hapësinore. Të dyja këto mënyra ndarjesh përcaktojnë kuptimin e bregdetit turistik në Dhërmi/Drimades, të ndarë në pjesën veriore dhe jugore. Pjesa veriore është e prirur drejt Shqipërisë dhe këtu gjenden kryesisht pronarë të shërbimeve turistike nga Shqipëria dhe nga jashtë, kurse pjesa jugore është me prirje nga Greqia dhe është qendër e pronarëve vendas dhe emigrantëve. Kjo ndarje shumëfishohet në përcaktimin se kush është “jashtë” vendit dhe kush “nga” vendi, se kush është i huaj dhe nuk i takon bregdetit dhe kush është vendas dhe i përket bregdetit të Dhërmiut/Drimadesit.

Rikonfigurimi i parreshtur hapësinor dhe lokalist i bregdetit të Dhërmiut/Drimades tregon se kategoritë “vend turistik”, “turizëm”, “turist”, “vendas” dhe “lokalizëm” ose “autoktoni” nuk janë të përcaktuara me saktësi dhe s’janë të pandryshueshme, por janë relacionale. Në çdo kontekst historik, politik, ekonomik, shoqëror, kulturor dhe të rastësishëm individët formojnë botkuptimet e tyre dhe rikonfigurojnë marrëdhëniet







#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

me njëri-tjetrin. Vendasit, turistët, emigrantët dhe të tjerët – në zënkat e tyre për (mos)përgjegjësinë për mbeturinat – caktojnë kush është “nga” ose “brenda” vendit dhe kush është “jashtë” tij. Në përputhje me argumentin e prezantuar në hyrje, bregdeti i fshatit është zonë ku mbeturinat (ri) përcaktojnë kuptimin e turizmit, e përkufizojnë bregdetin dhe fshatin si vend turistik ku individët, te të cilët mbizotërojnë emigrantët e kthyer dhe ata që ende jetojnë jashtë shtetit, kthehen rregullisht në Dhërmi/ Drimades për të kaluar pushimet, për të kërkuar dhe gjetur përkatësinë dhe lokalizmin e tyre.

Njësoj si rrëfimet e tregimeve që përshkruajnë udhëtimet e të parëve përtej detit dhe nëpër male (shiko kapitullin 3), edhe bisedimet dhe mosmarrëveshjet e vazhdueshme në lidhje me mbeturinat dhe heqjen e tyre tregojnë se cila është pozita e fshatit në hierarkinë hapësinore dhe se si rikonfigurohet kjo hierarki në lidhje me pozitën e fshatit. Ndarjet janë fenomen i hershëm: përgjatë shekujve në jetën e njerëzve dhe të fshatit kanë ndikuar ndarje të ndryshme administrative, politike dhe ekonomike të njerëzve dhe vendeve. Njerëzit në praktikë e tyre jetësore dhe në kuadrin e normave burokratike i kanë riprodhuar ndarjet e së kaluarës. Pas rënies së komunizmit, kur kufiri shqiptaro-grek u bë përsëri i kalueshëm dhe filloi emigracioni masiv, ndarjet dhe dallimet nuk u bazuan më në dallimet nacionale, por edhe në ato ekonomike dhe të infrastrukturës mes të dyja shteteve. Dallimet filluan të shfaqeshin në praktikë jetësore dhe përvojat individuale që popullojnë të dyja anët ndërkuftare, si shqiptare dhe greke. Green (2005: 228) ka konstatuar se gjatë kohës që Shqipëria ishte komuniste dhe Greqia jo, kjo e dyta ishte në mënyrë të pakundërshtueshme për banorët e zonave kufitare të të dyja shteteve më “perëndimore”. Lidhja e “modernizimit”, “perëndimit” dhe kapitalizmit që krijojnë në mënyrë të pakundërshtueshme “tjetrin”, çon në bindjen “e përgjithshme” të banorëve të zonës ndërkuftare se Greqia është “më moderne” se Shqipëria.

Dallimet mes Greqisë “moderne” dhe Shqipërisë “së pazhvilluar” dalin në pah edhe në zënkat dhe bisedimet për mbeturinat e bregdetit të fshatit. Në bazë të këtyre dallimeve pronarët e shërbimeve turistike, emigrantët, punëtorët sezonalë dhe turistët e tjerë vendosin hierarkinë hapësinore që e rikonfiguron vazhdimisht Dhërmiun/Drimadesin dhe formon identifikimin e individëve. Shembulli i Lolos dhe i Fluturës është ilustrim shumë i gjallë i faktit se si jetohej dhe përcaktohet hierarkia hapësinore në lidhjet martesore mes bashkëshortëve me shtetësi të ndryshme. Nëse në jetën e përditshme të Lolos dhe Fluturës shtetësia nuk ka asnjë kuptim (përveç nivelit retorik të shprehur nga cinizmi i Lolos), ajo





#### 4. BISEDIME PËR MBETURINAT

bëhet e rëndësishme kur Flutura me Lolon dhe fëmijët dëshiron të kalojë kufirin dhe të vizitojë të afërmit e vet dhe të Losos në Greqi. Në çastin kur ajo kalon kufirin bëhet subjekt (ose pjesë) i kontrollit shtetëror ose më mirë i atij politik. Në këtë mënyrë politika e shtetit shpreh fuqinë e vet duke vënë në pah dallimet, duke i ndarë dhe emërtuar njerëzit për të kontrolluar udhëtimet e tyre në botë.





## PËRFUNDIM

Për detyrat etnografike dhe krahasuese është karakteristikë kompleksiteti. Këtu antropologët dëshirojnë të tregojnë përshtjellimin e fenomeneve shoqërore dhe kulturore, edhe pse për ta konfirmuar atë duhet ta thjeshtojnë aq sa të bëhet i dukshëm. Duket se objekti i përshkrimit - të treguarit se sa të ngatërruara janë lidhjet mes elementeve- rëndohet nga vetë përshkrimi. (Strathern 2005: xiii)

Ky punim u përpoq të ndriçonte kompleksitetin si karakteristikë e ndërtimit të vazhdueshëm të hapësirës në fshatin Dhërmi/Drimades në Shqipërinë e Jugut. Vrojtimi i hollësishëm i fshatit dhe i jetës brenda tij tregon se sa të shumëllojshme, shumështrësore dhe të përshtjelluara janë kuptimet në lidhje me përcaktimet hapësinore. Këto kuptime nuk varen vetëm nga periudhat historike dhe politike, marrëdhëniet shoqërore dhe vetpërcaktimet individuale në rrjetet e tyre. Erozioni i tokës, topografia e "larmishme", të dhënat e paqarta demografike, variantet e shumta të emrave, historiografitë konfliktuale, kujtimet e shprehura dhe të ndrydhura të njerëzve, praktikat e përditshme lëvizjet e shpeshta dhe shpërnguljet në mënyrat nga më të ndryshmet krijojnë hartën hapësinore të fshatit si dhe kuptime komplekse dhe të paqarta. Vendasit, historiografët, gjeomorfologët, juristët dhe politikanët mundohen sipas mënyrave të tyre të zbardhin kompleksitetin, t'i konkretizojnë paqartësitë dhe t'i përcaktojnë si "fakte" njëkuptimshe. Kjo lloj "e vërtete e njësuar" bëhet menjëherë e diskutueshme dhe ky entitet i fortë në pamje të parë hidhet poshtë nga një tjetër entitet i fortë në pamje të parë. Nëse shprehemi sipas Wolfit, pikërisht kjo bën që entitetet të "vërtiten" rreth boshtit të tyre dhe njëkohësisht ta shtyjnë njëri-tjetrin si topa të fortë bilardoje (Wolf 1997:5).

Ky punim tregon se sa janë të ndryshueshme, kontestuale dhe të rastësishme kuptimet e nocioneve të tilla si "vendas" (*horiani*) dhe i huaj (*ksenos*), "grek" dhe "shqiptar"; "jashtë" (*okso*) dhe "brenda, në" (*mesa*), "para" dhe "prapa" (*pisos*), "nga" vendi (*apo to topos*) dhe "jashtë" vendit. Ajo që perceptohet dhe përjetohet si vendase, pas një çasti në një kontekst tjetër bëhet e huaj. Dhe anasjelltas, kuptohet. Çfarë është greke bëhet shqiptare dhe ajo që është shqiptare bëhet greke. Çfarë është "nga" vendi mund të jetë edhe "jashtë" tij. Deklaratat e banorëve të fshatit dhe të emigrantëve të kthyer tregojnë se si kuptimet e fshatit që lindin në jetën e përditshme,





## PËRFUNDIM

në përjetimet dhe bisedimet e njerëzve nga Dhërmiu/Drimadesi, janë të shumëzëshme.

Këtë shumëllojshmëri kuptimesh e zbulojnë tregimet e njerëzve të prezantuara në kapitullin e parë. Ato tregojnë se si ka ndryshuar shtrirja e krahinës së Himarës/Himara nëpër shekuj, se si janë gjithnjë të ndryshueshëm emrat e fshatrave dhe të njerëzve, cilat gjuhë kanë folur dhe si janë (kanë qenë) ndërthurur ato me njëra-tjetrën, tregojnë për kishat dhe praktikat fetare, për mënyrat e kundërta të numërimit dhe të kategorizimit të banorëve dhe se sa është dinamik të konceptuarit e farefisit dhe përfshirja e mospërfshirja e pjesëtarëve në të. Tregimet, njësoj si kujtimet e të moshuarve krijojnë hartën e pozicioneve të ndryshme të fshatit që janë gjithmonë të ngjuara në procesin e lindjes së tyre, që dalin jashtë kornizave të kategorive statike dhe të përmbyllura që pozitave të ndryshme të fshatit mundohen t'i imponojnë forca të ndryshme politike, ekonomike, madje dhe njerëz.

Që ndryshueshmëria e paparashikueshme të mund të shihet si një konstante historike, kapitulli i dytë i dedikohet prezantimit të së shkuarës së fshatit siç interpretohet në historiografinë ose historiografisë bashkëkohore. Imazhet e së kaluarës në Shqipërinë postkomuniste ripërcaktohen në procesin e (ri)shkrimit të historisë. Paqartësia e emrave të përveçëm dhe të vendeve, dilemat mbi çështjet e minoritetit, përkatësia e fshatarëve dhe pozita e fshatit në praktikën historiografe bëhen pjesë e njëmendësisë dhe subjekt i afirmimit të një pikëpamjeje të vetme për të kaluarën që të arrihen qëllimet e së tashmes. Rishikimi i historiografisë moderne (sidomos pas vitit 2000) që mbështet pikëpamjet pro shqiptare, pro greke ose prolokale, zbulon mënyrën me të cilën historiografët mundohen ta vendosin fshatin në hartën historike dhe gjeopolitike të shteteve kombëtare. Mënyra e tyre e ligjërimit nxjerr në pah se ata i kuptojnë shtetet kombëtare si entitete të qarta dhe të ndryshueshme, që ekzistojnë prej kohësh dhe i ndajnë njerëzit sipas gjuhës, territorit dhe përkatësisë kombëtare.

Numrat e lëvizshëm, vetëdedikimet dhe emrat e fshatrave e gjejnë unitetin dhe veçantinë e tyre në kategoritë kombëtare që hynë në jetën dhe në përvojat e njerëzve me vendosjen e diktaturës komuniste. Gardhi i lartë elektrik i vendosur përgjatë kalimeve kufitare atëherë shënonte dukshëm kufirin shtetëror jo vetëm në hartën politike të Evropës, por edhe në jetën e përditshme të njerëzve në Shqipëri që në zonën kufitare cilësoheshin si shqiptarë. Kufiri ishte "rrugë" që kalonte përmes tyre duke i ndarë në dy pjesë. Lëvizjet dhe udhëtimet që kalonin përmes tij në shekujt e kaluar u ndërpre në krejtësisht në vitin 1945. E megjithatë shpërnguljet





## PËRFUNDIM

dhe udhëtimet e njerëzve nuk morën fund; ndryshoi vetëm drejtimi i tyre që në kohën e komunizmit drejtohej në brendësi të shtetit.

Ndërtimi i hapësirës dhe vendit është pjesë e një procesi të vazhdueshëm dhe të pakthyesëm. Njerëzit nga Dhërmiu/Drimadesi me lëvizjet dhe shpërnguljet, rrëfimin e tregimeve, me kujtimet, si dhe me menaxhimin dhe manipulimin e mjeteve, p.sh. tokën dhe mbeturinat, krijojnë hapësirën dhe njëkohësisht bëhen pjesë e saj. Biografite e njerëzve zbardhin itineraret e pasura të shpërnguljeve dhe lëvizjeve përmes vendeve të ndryshme dhe brenda tyre në Shqipëri, Greqi dhe gjetkë. Lëvizjet dhe shpërnguljet e rrëfyesve të tregimeve në një farë mënyre përsërisin lëvizjet dhe shpërnguljet e paraardhësve të tyre. Në kujtimet e tyre, që sipas Ingold-it (2000), "krijohen së bashku me fjalët dhe gdhenden në perceptimet individuale për mjedisin", njerëzit i krijojnë vazhdimisht emrat e mjedisit dhe kujtimet e tyre. Mjedisi rrethues është "bota që ekziston dhe ka kuptim në lidhje me mua [*me individin*], për këtë dhe është krijuar dhe ndryshon së bashku me mua dhe rreth meje" (Ingold 2000: 20). Tregimet zbardhin pikëpamjet e rrëfyesve për mjedisin si dhe për veten e tyre në kuadrin e këtij mjedisi. Ato bazohen në lidhjet mes mjedisit dhe individëve dhe prej tyre zhvillohet më tej.

Sipas de Certeau-së (1984) Ingold-i konstaton se rrëfyesi kur rrëfen tregimin krijon hartën e procesit të krijimit të tij. Ky proces ilustron tregimet e fshatarëve të moshuar. Që kontinuiteti dhe pakthyesmëria e procesit të jenë të qarta, tregimet në fillim janë të analizuar në bazë të hipotezës së de Certeau-së mbi transformimet e parreshtuara të vendeve në hapësira dhe anasjelltas. Në vazhdim procesi i lindjes dhe ndërtimit të vendeve dhe hapësirave është i menduar me ndihmën e konceptit të hierarkisë hapësinore siç e ka përcaktuar Sarah Green (2005). Vëmendja përqëndrohet në lidhjen mes hierarkisë hapësinore dhe pozitës së një vendi të caktuar. Ilustrimet grafike të tregimeve të zgjedhura tregohen në mënyrë të tillë që të ilustronjë hartat e shumëllojshme të vendeve të tjera, të pozicioneve të tyre në hapësirë dhe kohë. Ato flasin për variantet e ndryshme të këtyre pozicioneve që janë të lëvizshëm dhe të ndryshueshëm në kontekste të ndryshme socio-kulturale. Lëvizshmëria tregon se si ndarjet mes njerëzve dhe kufijve të vendeve janë kalimtare dhe të eliminueshme. Lëvizshmëria dhe ndryshueshmëria e tyre i atribuohet si ndarjeve që njerëzit në kujtimet dhe tregimet e tyre i bëjnë krahinës, ashtu edhe kufirit shtetëror që e ndan Shqipërinë nga Greqia, Italia, SHBA dhe Jugosllavia. Kur rrëfyesit përshkruajnë malet e kufizojnë hapësirën ndërmjet maleve, ose Shqipërisë dhe fshatit, ndërsa kur përshkruajnë detin e vendosin kufirin mes fshatit dhe detit. Me këtë





## PËRFUNDIM

konceptimin nacional të ndasive dhe kufijve e mbështesin me konceptet hapësinore dhe anasjelltas.

Ilustrimi i gërshetimit të hapësirës dhe vendit në lidhje me konceptimin hegjemonist të shteteve nacionale përqëndrohet te brezi i ri; këta janë pronarët e shërbimeve turistike, emigrantët dhe turistët, që frekuentojnë bregdetin e Dhërmiut/Drimadesit. Ndarjet shoqërore dhe hapësinore konkretizohen edhe në problematikat praktike ditore, konkretisht në lidhje me mbeturinat. Kur njerëzit ia kalojnë përgjegjësinë për ndotjen e bregdetit fqinjit, "shqiptarëve", "vendasve", bashkësisë lokale, bashkisë dhe në fund shtetit kombëtar, krijojnë njëkohësisht kufizime shoqërore dhe hapësinore. Gjatë këtij procesi ata vendosin rregull dhe brenda tij vendosin aktivitetin e tyre. Mosmarrëveshjet, mospërputhjet dhe kontradiktat që janë produkt dhe prodhues të dallimeve mes "nesh" dhe "atyre" janë pjesë e marrëdhënieve të forcës, ku çdo individ mundohet të afirmojë të kuptuarit dhe të përjetuarit e vendit dhe caktimin e pozicionit të fshatit. Gjatë këtij procesi përvijëzohet hierarkia hapësinore që kontribuon në formimin e identitetit të individëve, të vendosur në fshat ose të përjashtuar prej tij.

Kompleksiteti ose fragmentarizmi i marrëdhënieve të forcës ndërmjet individëve në bregdet del në pah nëpërmjet dy perspektivave të lidhura mes tyre: me mikro- dhe makronivelin. Kështu p.sh. emigranti Kiços, i lindur në Dhërmi/Drimades, e krijon rendin brenda mikronivelit duke bërë dallim mes vetes "si vendas" (*horianos*) dhe "shqiptarëve" (*alvanos*). Këtu ai thekson përgjegjësinë individuale dhe pjesërisht edhe lokale për papastërtinë në bregdet dhe në fshat. Në dallimin mes "shqiptarëve" dhe *horianëve* Kiço e vendos identitetin e tij në fshatin bregdetar, e përcakton veten si vendas, më afër të "qenurit grek" sesa të "qenurit shqiptar". Në procesin e autoidentifikimit ai përcakton edhe bregdetin dhe fshatin. Me toponimet që ai mendon se janë me burim grek, e vendos fshatin në hartën gjeopolitike të shteteve nacionale. Të kuptuarit e hapësirës dhe vendit nga Kiços është nga njëra anë i lidhur me biografinë e tij, kurse nga ana tjetër ai riprodhohet duke u bazuar te forcat dhe fuqitë politike, ekonomike dhe administrative që formojnë botëkuptimin ndaj botës.

Sipas deklaratave dhe tregimeve të fshatarëve të moshuar dhe atyre të brezave të rinj, që jetojnë në mërgim, si dhe të pronarëve të shërbimeve turistike duket sikur kuptimet e fshatit dhe të pozicionit të tij – ose "ku" gjendet fshati- ripërcaktohen në praktikat e individëve dhe në mënyrën se si ata e përjetojnë kufirin shtetëror mes Shqipërisë dhe Greqisë. Fshatarët e moshuar e ripërcaktojnë pozicionin e fshatit në lidhje me "postbllokun" dhe ndalimin e kalimeve nëpër kufirin shtetëror, kurse brezi i ri në lidhje





## PËRFUNDIM

me rihapjen e kufirit shtetëror mes Shqipërisë dhe Greqisë, migracionit masiv që vijoi pas kësaj, dhe rrethanat e ndryshme ekonomike dhe politike në Shqipërinë postkomuniste.

### TREGIMET E HESHTURA TË KOMUNIZMIT

Historiografia e zonës së Himarës/Himara në periudhën e komunizmit (kapitulli i dytë), përmbajtjet e tregimeve të fshatarëve të moshuar që përshkruajnë rrugëtimet e të parëve të tyre (kapitulli i tretë) dhe së fundi bisedimet dhe debatet për mbeturinat në bregdetin e fshatit (kapitulli i katërt) krijojnë përshtypjen e mungesës dhe të shpërfilljes së tregimeve të kohës së komunizmit. Por vëzhgimi i hollësishëm mes rreshtave të veçantë të teksteve të burimeve gojore dhe të shkruara zbardh vitalitetin dhe ndikimin e fshehur të komunizmit: komunizmi ka qenë dhe është ende veprues pikërisht për shkak të mungesës fiktive. Ideologjia e komunizmit e krijon “në heshtje” hartën krahinore dhe rrëfen historinë e saj me objekte të dukshme ose me mbetjet e kohës së vet: bunkerët kërpudha, ndërtesa dhe hotele të shkatërruara (p.sh. Hotel Dhërmiu), plantacionet e agrumeve dhe ullinjtë të lëna pas dore, shkrimet e zbehura komuniste “*Pionerët e Enverit*” në muret e disa ndërtesave. Tregimet e hidhura që përshkruajnë komunizmin dhe dëshmojnë për të kaluarën janë të mbuluara dhe të fshehura në sfond. Për to mund të dëgjosh në disa nga deklaratat e burrit të Lefterisë dhe të disa grave të moshuara: “Edhe Enver Hoxha na thoshte se nuk i interesonte politika dhe na pyeste se si jetonim, çfarë pinim dhe hanim. Kurse në fund na çoi të tërëve në burg!” Ndikimi i komunizmit rrezaton edhe nga zënkat për mbeturinat, veçanërisht kur përgjegjësia bëhet një herë kolektive dhe pastaj individuale, si dhe te tregimi i Anastasit për mungesën e modernizimit dhe moszhvillimit të fshatit për të cilën ia vë fajin së kaluarës komuniste.

Mungesa e tregimeve të kohës së komunizmit tregon se si koha e izolimit dhe represionit është ende e gjallë, sidomos te fshatarët e moshuar. Fuqia e “autoritetit” komunist që mishërohej në figurën e Enver Hoxhës dhe regullonte fshehurazi rutinat e përditshme të individëve (ndalimi i lëvizjes jashtë kufijve shtetërorë dhe kontrolli i lëvizjes brenda tyre, kolektivizimi i tokës, uniteti kombëtar, njësimi i individëve etj.) ka lënë gjurmë edhe në idetë dhe normativat e partisë politike kryesore në vend. Edhe pse fuqia e saj ndikon deri në një farë mase edhe në praktikatat e përditshme individuale, sot del në pah në një mënyrë disi tjetër në krahasim me të kaluarën. E përditshmja e fshatarëve shoqërohet nga dobësimet e vazhdueshme të fuqisë së rrymës elektrike dhe të ujit, nga





## PËRFUNDIM

migracioni masiv në Greqi, Itali dhe gjetkë, nga problematika minoritare dhe rajonalizmi (lokalizmi ose autoktonia), denacionalizimi dhe privatizimi i pjesëve të bregdetit që janë premtues për zhvillimin e turizmit, etj. Kanë kaluar më shumë se dhjetë vjet nga shëmbja e komunizmit dhe globalizimi (ose glocalizimi) që pasoi menjëherë pas tij është i dukshëm kryesisht në qytetet e mëdha (p.sh. Tirana dhe Durrësi), e megjithatë duket sikur ruhen ende disa faktorë karakteristikë të sistemit të kaluar, p.sh. kontrolli shtetëror, mangësia, pasiguria ekonomike dhe mosbesimi në elitën politike ose në të ashtuquajturin “shtet” (*to kratos*). Efektet dhe ndikimi i fuqisë politike që nga forca e vetme e despotit është riklasifikuar në fuqi të shumta të partive politike kryesore, janë ruajtur në jetën dhe përvojat e njerëzve. Në vend se nga një person dhe nga një zë, forca aplikohet nga shumë zëra që fshatarët u kontribuojnë autoritetin dhe fuqinë. Pikërisht kjo krijon ndjesinë se pavarësisht nga ndryshimi radikal i sistemit nga komunizmi në demokraci, gjërat nuk kanë ndryshuar rrënjësisht. “Syri” ose “sytë” e kontrollit të politikës, ekonomisë dhe burokracisë sipas mendimit të fshatarëve të moshuar qëndrojnë ende “atje lart” (apo apano/nga lart), ku sipas tyre gjendet elita politike në pushtet. Këta “sy panoptikë”, nëse do të përdorja shprehjen e Foucault-it, ende ekzistojnë dhe në një farë mënyre ende “spiunojnë” jetën e përditshme të fshatarëve.

Sistemi ka ndryshuar, disa njerëz janë shpërngulur jashtë, të tjerë kanë ardhur në fshat. Kurse forcat që ndajnë dhe kategorizojnë njerëzit dhe vendet ende ekzistojnë. Kështu banorët e Dhërmiut/Drimadesit kanë ndjenjën e imponimit të vazhdueshëm të interesave të ndryshme që influencojnë jetën e tyre të përditshme. Kjo është sot me sa duket njëra nga arsytet e mungesës së tregimeve nga periudha e komunizmit. Në fund të fundit këtë e kam përjetuar vetë, pasi “sytë” e mi, të paktën në muajt e parë të punës në terren, qenë ndoshta për shumë njerëz sytë e “shtetit” ose të ndonjë organizate ndërkombëtare.

## KONFLIKTUALË APO TË (NDËR)LIDHUR?

Procesi i rindërtimit jo të qëndrueshëm të hapësirës dhe vendit në Dhërmi/Drimades, nga njëra anë krijon dallime dhe konflikte, nga ana tjetër nxjerr në pah ngjashmëritë dhe marrëdhëniet e ndërsjella. Disa prej studiuesve proceset e ndërtimeve jo të qëndrueshme, të parregulluara dhe fragmentare të hapësirave dhe vendeve i kanë cilësuar si pashmangshmërisht konfliktuale dhe problematike. Siç del edhe nga gjurmimet në Dhërmi/Drimades kuptimet e hapësirave dhe vendeve nuk janë vetëm konfliktuale por edhe të paqarta.







## PËRFUNDIM

Te paqartësitë kuptimet e hapësirave lëvizin dhe ndryshojnë vazhdimisht në varësi të kontekstit dhe të individëve që përfshihen në të. Për konfliktualitetin mund të flitet vetëm atëherë kur fuqitë politike, ekonomike dhe shoqërore përpriqen t'i kategorizojnë paqartësitë dhe t'i përcaktojnë si entitete "të qarta" dhe "të qëndrueshme". Ndërtimi jo i qëndrueshëm i hapësirës dhe i vendit nuk është patjetër arsye për kuptime mospërputhëse të hapësirës dhe vendit. Po kështu mospërputhjet kuptimore dhe mosmarrëveshjet nuk janë të palëvizshme apo të caktuara paraprakisht, siç propozojnë studiueset e përmendura. Më shumë se për konfliktualitetin e hapësirave (për të cilin flasin këta autorë) është më me vend të flitet për hapësira mosmarrëveshesh dhe mospërputhesh. Hapësirat dhe vendet nuk janë konfliktuale vetëvetiu, por janë gjithmonë konfliktuale për shkak të dikujt dhe në lidhje me dikë, ndërkohë që për dikë tjetër janë krejtësisht të pranueshëm për t'u jetuar dhe përjetuar.

Mospërputhjet dhe mosmarrëveshjet që krijojnë dhe përcaktojnë hapësirat, vendet dhe njerëzit, janë pjesë e procesit të krijimit, që përveç ndarjeve dhe dallimeve, zbulon edhe lidhjen mes njerëzve dhe vendeve. Njerëzit i ndërtojnë dhe u japin kuptim hapësirave dhe vendeve në lidhje të ndërsjellë me hapësirat, vendet dhe njerëzit e tjerë. Lëvizjet dhe udhëtimet e vazhdueshme të fshatarëve nga e kaluara deri sot flasin për fshatin dhe njëkohësisht e ndajnë atë nga hapësirat dhe vendet e tjera në anën tjetër të detit dhe maleve në Shqipëri, Greqi, Itali dhe SHBA.

Mosmarrëveshja dhe lidhja mes hapësirave dhe vendeve në Dhërmi/Drimades mbështeten në tre kontekste kryesore. I pari ka të bëjë me lëvizjet dhe shpërnguljet e njerëzve përmes vendeve, i dyti ka të bëjë me ndarjen dhe dallimin mes njerëzve dhe vendeve, kurse i treti ka të bëjë me marrëdhëniet e forcave që i konfigurjnë dhe vendosin vendet dhe njerëzit. Për banorët e Dhërmiut/Drimadesit lëvizjet, udhëtimet dhe shpërnguljet janë diçka konstante, ka ndryshuar vetëm drejtimi, dendësia, dinamika dhe mënyra. Te këto lloj ndryshimesh, përveç zhvillimit teknologjik dhe ekonomik, kanë ndikuar edhe ndarjet administrative, politike, ekonomike dhe shoqërore të njerëzve dhe vendeve në kuadrin e të cilave lëvizin marrëdhëniet e forcave. Këto të fundit krijojnë hartën e hapësirave dhe vendeve në të cilat individët e ndiejnë veten si në shtëpi ose si të huaj dhe në to formojnë identitetin e tyre. Sipas Lefebver-it (1974), de Certeau-së (1984), Ingold-it (1993 dhe 2000), Gupt-it dhe Ferguson-it (1997), që kanë menduar për procesin e ndërtimit të hapësirës dhe vendit, hapësira dhe vendi janë gjithmonë në qendër: qendrat dhe periferitë i ndërrojnë vazhdimisht pozicionet e tyre duke u transformuar vazhdimisht. Bota sot në thelb është fraktale (Appadurai 1996: 46), gjë që do të thotë se





## PËRFUNDIM

nuk i përshtatet modelit të Euklidit me kufijtë, strukturat dhe rregullat e “rregullsisë” së botës. Në vend të kësaj fragmentet e parregulluara rrjedhin dhe përzihen nga qendra në periferi duke i ndryshuar pa rreshtur pozicionet e tyre (khs. Green).

Vendosja e kufirit shtetëror në vitin 1913 filloi të ndikojë në praktikat jetësore të përditshme pas 32 vitesh, kur u ndal kalimi i tij. Koha e komunizmit pati shumë pasoja te banorët e Dhërmiut/Drimadesit: forca e udhëheqjes autarkike dhe e politikës kombëtare i ndryshoi drejtimet e lëvizjeve nga përtej kufirit brenda tij, pra duke ndryshuar dinamikën e tyre. Lëvizjet e vendasve, ose moslëvizjet nuk bazoheshin në marrëdhëniet ekonomike, por në politikën homogjenizuese dhe të unitetit të popullit shqiptar. Pas vitit 1990, pas rihapjes së kufijve, lëvizjet dhe shpërnguljet përtej kufirit shqiptaro-grek u ringjallën. Drejtimi dhe dinamika ndryshuan përsëri me emigracionin masiv, sidomos nga fshatrat me popullatë grekëfolëse. Ndërkombtarizmi, globalizimi dhe rajonalizmi që mbështetet dhe përshpejtohet nga modeli mbishtetëror (p.sh. Bashkimi Evropian), janë bërë pjesë e ndërtimit të hapësirës dhe vendit edhe në fshatin Dhërmi/Drimades. Kur emigrantët i ruajnë lidhjet me fshatin e lindjes dhe kur kthehen aty vazhdimisht, i japin gjithmonë kuptim të ri pozicionit të tij në hartën shoqërore. Ky pozicion caktohet me hierarkinë hapësimore që i jep përparësi aspektit ekonomik dhe ndikimit: kështu “të qenurit grek” lidhet me modernizmin, kurse “të qenurit shqiptar” me modernizimin (me gjithë përpjekjet ende s’mund të flitet për modernizëm) (khs. Green 2005: 230).

Nietzsche (1884) shkroi para 124 vjetësh fjalinë: “Zoti ka vdekur”; kjo shënoi ndryshim radikal mes strukturave klasike, ligjshmërisë dhe proceseve të krijimit. Në këto procese forcat dhe marrëdhëniet e forcave nuk janë më të vendosura dhe të rregulluara sipas principit të qendrave të forta dhe periferive, por sipas parimit të fraktaleve. Kjo dikton marrëdhëniet e forcave dhe rikonfiguron hierarkinë hapësimore nëpër fshatra, vende dhe qytete të Shqipërisë, Evropës dhe botës duke theksuar gjithnjë e më shumë efektet ekonomike dhe të kapitalit, dhe gjithnjë e më pak logjikën e shteteve kombëtare.

Konceptet “ku” dhe “kush” varen nga konteksti historik, politik dhe ekonomik; koha postkomuniste, ndryshimet shoqërore dhe ekonomike si dhe emigracioni masiv kanë ndikuar shumë në rikrijimin e ndjesisë individuale të “vatrës”, të përkatësisë, lokalizmit ose autoktonisë dhe vendosjen në fshat. Nga njëra anë individët përballeshin me dallimet ideologjike (khs. *horianos vs. ksenos*) duke manipuluar me to, nga ana tjetër në tregimet dhe deklaratat përsërisin dhe krijojnë ndarjet hapësimore






## PËRFUNDIM

(khs. deti vs. malet). Në proceset e riprodhimit të këtyre ndarjeve sot ndikojnë ekonomia globale, zhvillimi i teknologjisë informative dhe ideologjia gjeopolitike dhe ekonomike e “mbishtetit”. Me këto ndryshime vendasit nuk vetëpërcaktohen më me përkatësinë kombëtare – si grekë ose si shqiptarë- por me identitetet rajonale që i vendosin në hapësirën e Bashkimit Evropian, pasi ky i jep përparësi rajonalizmeve duke i vendosur para nacionalizmit (khs. Harvie 1994; Green 2005: 19). Kështu shumë vendas nga Himara/Himara dhe Dhërmiu/Drimadesi e vendosin përkatësinë e tyre në krahinën e Himarës/Himara si një vend i pavarur, i veçantë dhe i dukshëm në hartën gjeopolitike të Bashkimit Evropian (khs. [www.himara.eu](http://www.himara.eu)).



# SHTOJCA

Shtojca 1




Lagjet e Dhërmiut/Drimadesit





# SHTOJCA

## Shtojca 3



Rruga Via Egnatia.





## BIBLIOGRAFIA

- Albanian Coastal Zone Development and Cleanup Program. Environment and Social Safeguards Framework (Phase I). April 20th 2005. Republic of Albania. Ministry of Territorial Adjustment and Tourism, [http://www-ds.worldbank.org/servlet/WDSContentServer/WDSP/IB/2005/05/19/000011823\\_20050519133519/Rendered/PDF/E11410rev0ICZMCP1ESSF1final.pdf](http://www-ds.worldbank.org/servlet/WDSContentServer/WDSP/IB/2005/05/19/000011823_20050519133519/Rendered/PDF/E11410rev0ICZMCP1ESSF1final.pdf) (zadnjič obiskano 27.7.2007).
- Albanian Association of Municipalities. 2001. Local Government in Albania. Tirana: Albanian Association of Municipalities.
- Althusser, Louis. 1980 [1977]. Ideologija in ideološki aparati države (opombe k raziskavi). Përkth. Skušek-Močnik Zoja in Slavoj Žižek. Ljubljana: Cankarjeva Založba.
- Anderson, Benedict. 1995 [1983]. Imagined Communities. Reflections on the Origin and Spread of Nationalism. London and New York: Verso.
- Appadurai, Arjun. 1996. Modernity at Large. Cultural Dimensions of Globalization. Minneapolis, London: University of Minnesota Press.
- Backer, Berit. 2003. Behind Stone Walls. Changing Household Organisation Among the Albanians of Kosova. Tiranë: Dukagjini Balkan Book, Peja.
- Ballinger, Pamela. 2003. History in Exile. Memory and Identity at the Borders of the Balkans. Princeton: Princeton University Press.
- Barleti, Martin. 1967. Historia e Jetës dhe Veprave të Skënderbeut. Prev. Stefan Prifti. Tiranë.
- Barth, Fredrik (bot.). 1970 [1969]. Ethnic Groups and Boundaries. The Social Organisation of Culture Difference. London: George Allen & Unwin.
- Bender, Barbara and Margot Winer (bot.). 2001. Contested Landscapes. Movement, Exile and Place. Oxford and New York: Berg Publishers.
- Bender, Barbara. 2001. Introduction. Në: Bender, Barbara and Margot Winer (bot.), Contested Landscapes. Movement, Exile and Place. Oxford and New York: Berg Publishers.
- Berishaj, Nikollë. 1989. Albansko-slovenski in slovensko-albanski slovar. Fjalor Shqip-Sillovenisht dhe Sillovenisht-Shqip. Ljubljana: Cankarjeva založba.
- Berishaj, Martin. 2004. Skrita moç bese. Ženske v imaginariju albanskega tradicionalizma. Dodatek Skenderbegov Kanon. Ljubljana: Založba ZRC SAZU.
- Bërxfholi, Arqile. 2004. Organizimi Administrativo-Tokësore i Bregut pas Vitit 1913 e Deri sot. Në: Nasi, Lefter, Kristaq Prifti, *et.al.* (bot.), Himara në Shekuj. Tiranë: Akademia e Shkencave Shqipërisë.
- Bërxfholi, Arqile. 2005. Minoritetet në Shqipëri. Tiranë: Këshillit Shkencor të Qendrës së Studimeve Gjeografike në Akademinë e Shkencave, Tiranë.
- Bixhili, Foto. 2004. Jipet e Iperit. Himariotët. Tiranë: Botimet Toena.





## BIBLIOGRAFIA

- Bjelić, Dušan I. dhe Obrad Savić (bot.). 2002. *Balkan as Metaphor. Between Globalization and Fragmentation*. Cambridge, Massachusetts: The MIT Press.
- Blumi, Isa. 2002. *The Role of Education in the Formation of Albanian Identity and its Myths*. Në: Schwandner-Sievers, Stephanie in Bernd J. Fischer (bot.), *Albanian Identities. Myth and History*. London: Hurst & Company.
- Bollano, Theodhori *et.al.* 2006. *Problemi i Pronës dhe Opsionet e Zgjidhjes së këtij Problemi Madhor si Potencial për Zhvillimin Ekonomik të Zonës*. Në: *Punimet e Konferencës Pan-Himariote 2005. Ndërtimi i së Ardhmes së Himarës*. Tiranë: Shtëpisë Botuese FLESH.
- Bollano Priamo. 2007. *Himara – Potencialet Ekonomike dhe Sfidat e Zhvillimit*. Tiranë.
- Bos in UNPO Mission. 1994. *Mission Report on the Situation of the Greek Minority in Albania. Unrepresented Nations and Peoples Organisation*.
- Brookfield, Harold C. 1969. *On the Environment as Perceived*. *Progress in Geography*, 1: 53-80.
- du Boulay, Juliet. 1991. *Cosmos and Gender in Village Greece*. Në: Loizos, Peter in Evthymios Papataxiarchis (bot.), *Contested Identities: Gender and Kinship in Modern Greece*. Princeton: Princeton University Press.
- Byron, Lord George Gordon. 1891. *The Poems and Dramas of Lord Byron*. 2 Vol. Chicago: Belford-Clarke Co.
- Campbell, John K. 1964. *Honour, Family and Patronage: a Study of Instrututions and Moral Values in a Greek Mountain Community*. Oxford: Clarendon Press.
- Cancik Hubert dhe Helmuth Schneider (bot.). 1997. *Der Neue Pauly Enzyklopädie der Antike*. Band 2. Stuttgart: Verlag J.B. Metzler.
- Ceka, Neritan. 2005. *The Illyrians. To the Albanians*. Tirana: Migjeni.
- de Certeau, Michael. 1984. *The Practice of Everyday Life*. Berkeley: University of California Press.
- CIA Factbook. 2007. *Albania*, <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/al.html> (27. 10.2007).
- Clayer, Nathalie. 2003. *God in the »Land of the Mercedes«*. *The Religious Communities in Albania Since 1990*. Në: von Peter Jordan idr. (bot.), *Österreichische Osthefte, Sonderband 17, Albanien, Herausgegeben*. Wien: Peter Lang.
- Clayer, Nathalie. 2006. *L'albanisation de la Zone Frontière Albano-Grecque et ses Aléas dans l'entre-deux-Guerres*. A Paraître dans les Actes du Colloque »Frontières«, Athènes, Septembre.
- Cohen, Erik. 1974. *Who is a Tourist?* *Sociological Review*, 22 (4): 527-553.
- Cohen, Anthony P. 1994. *Self Consciousness. An Alternative Anthropology of Identity*. London and New York: Routledge.
- Cosgrove, Denis. 1984. *Social Formation and Symbolic Landscape*. Totowa: Barnes and Noble.
- Crandall, R. 1980. *Motivations for Leisure*. *Journal of Leisure Research*, 12 (1): 45-54.
- Cowan, Jane K. 1991. *Going Out for Coffee? Contesting the Grounds of Gendered Pleasures in Everyday Sociability*. Në: Loizos, Peter and Evthymios Papataxiarchis





## BIBLIOGRAFIA

- (bot.), *Contested Identities. Gender and Kinship in Modern Greece*. Princeton: Princeton University Press.
- Cungu, Azeta in Johan F.M Swinnen. 1999. Albania's Radical Agrarian Reform. *Economic Development and Cultural Change*, 47(3): 605-19.
- Çakali, Pollo, Leonidha Papa idr. 2006. Problemi (et) Prone në Bregdet dhe Opsionet e Zgjidhjes së Këproblemi Madhor Parë si Potenciali Kryesor për Zhvillimin të Zones. Në: Nasi, Lefter, Kristaq Prifti, idr. (bot.), *Himara në Shekuj*. Tiranë: Akademia e Shkencave Shqipërisë.
- Çami, Muin. 2004. *Himara në 1912-1914 (Vështrimi Historik)*. Në: Nasi, Lefter, Kristaq Prifti, idr. (bot.), *Himara në Shekuj*. Tiranë: Akademia e Shkencave Shqipërisë.
- Danforth, Loring. 1995. *The Macedonian Conflict. Ethnic Nationalism in a Transnational World*. Princeton: Princeton University Press.
- Dede, Kosta. 1978. *Drimades tis Himaras*. Athens.
- Dedej, Zamir. 2002. *National Report on Marine and Coastal Biodiversity*. Republic of Albania Tirana, March 2002, [http://nfp-eionet.eu.int:8180/convention/other\\_conv/1075458781](http://nfp-eionet.eu.int:8180/convention/other_conv/1075458781) (Zadnjë obiskano 20.10.2007).
- Demographic Atlas of Albania*. 2003. *Atlas of Albania*. Tirana: Verlag and Shtypshkronja Ilar.
- Derhemi, Eda. 2003. *New Albanian Immigrants in Thessaloniki, Greece: Processes of Economic and Social Incorporation*. *Journal of Ethnic and Migration Studies*, 29 (6): 1015-1032.
- De Soto, Hermine. 2000. *Contested Landscapes: Reconstructing Environment and Memory in Postsocialist Saxony-Anhalt*. Në: Berdahl, Daphne, Matti Bunzl in Martha Lampland (bot.), *Altering States. Ethnographies of Transition in Eastern Europe and the Former Soviet Union*. Ann Arbor: The University of Michigan Press.
- Douglas, M. 2002 [1966]. *Purity and danger*. London: Routledge.
- Dubisch, Jill. 1991. *Gender, Kinship, and Religion: »Reconstructing« the Anthropology of Greece*. Në: Loizos, Peter in Evthymios Papataxiarchis (bot.), *Contested Identities. Gender and Kinship in Modern Greece*. Princeton: Princeton University Press.
- Duijzings, Ger. 2002. *Religion and the Politics of »Albanianism«: Naim Frashëri's Bektashi Writings*. Në: Schwandner-Sievers, Stephanie in Fischer, Bernd J. (bot.), *Albanian Identities. Myth and Hystory*. London: Hurst & Company.
- Duka, Ferit. 2004. *Aspekte Social-Ekonomike dhe Demografike të Himarës Gjatë Sundimit Osman (shek. XV-XVI)*. Në: Nasi, Lefter, Kristaq Prifti, idr. (bot.), *Himara në Shekuj*. Tiranë: Akademia e Shkencave Shqipërisë.
- Durham, M. Edit. 1909. *High Albania*. London: Edward Arnold.
- Durham, M. Edit. 1928. *Some Tribal Origins, Laws and Customs of the Balkans*. London: George Allen and Unwin.
- Durkheim, Émile. 1976 [1915]. *The Elementary Forms of the Religious Life*. Trans J. W, Swain, 2nd ed. London: Allen and Unwin.
- Elezi, Ismet. 2006. *Kanuni i Labërisë*. Tiranë: Botimet Toena.
- Elsie, Robert. 2001. *A Dictionary of Albanian Religion, Mythology, and Folk Culture*. London: Hurst & Company.







## BIBLIOGRAFIA

- Eriksen, Thomas Hylland. 1993. *Ethnicity and Nationalism. Anthropological Perspectives*. London: Pluto Press.
- Evans-Pritchard, E. E. 1940. *The Nuer. A Description of the Modes of Livelihood and Political Institutions of a Nilotic People*. Oxford: Clarendon.
- Fagan, Brian M. *et.al.* (bot.). 1996. *The Oxford Companion to Archaeology*. Oxford: Oxford University Press.
- Feld, Steven dhe Keith H. Basso (bot.). 1996. *Senses of Place*. Santa Fe: School of American Research Press.
- Ferguson, Charles A. 1959. Diglossia. *Journal of the Linguistic Circle of New York*. First Report Submitted by the Republic of Albania, Under Article 25, Paragraph 1, of the Council of Europe. Framework Convention for the Protection of the National Minorities, 2001. [http://www.mfa.gov.al/english/pdf\\_files/Raporti%20i%20Pare%20\(ang\).pdf](http://www.mfa.gov.al/english/pdf_files/Raporti%20i%20Pare%20(ang).pdf) (Zadnjič obiskano, 27. 7.2007).
- Fjalor i Shqipësisë së Sotme. 1980. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë.
- Foucault, Michel. 1975. *Discipline and Punish. The Birth of the Prison*. New York: Vintage.
- Foucault, Michel. 1980. *Power/Knowledge. Selected Interviews and Other Writings, 1972-1977*. Në: Colin Gordon (bot.). New York: Pantheon.
- Frashëri, Kristo. 2004. Himara në Burimet Dokumentare Historike. *Korrieri* 3. 12, fq. 13-15; 4. 12., fq. 14-15; 7. 12., fq. 18-19; 8. 12., fq. 17.
- Frashëri, Kristo. 2005. Himara dhe Përkatësia Ethnike e Himarjotëve. Bisedë me Historianët Grekë. Tiranë: Botimet Toena.
- Gingrich, Andre. 1998. *Frontier Myths of Orientalism: The Muslim World in Public and Popular Cultures of Central Europe*. Në: Baskar, Bojan in Borut Brumen (bot.), MESS: Mediterranean Ethnological Summer School, 2. Ljubljana: Institut za multikulturne raziskave.
- Gjokopulli, Marko in Leonidha Prifti. 2006. *Arsimi në Himarë: Shkolla dhe Gjendja e Saj. Detyrat për të Ardhmen*. Në: Punimet e konferencës Pan-Himariote 2005. Ndërtimi i së ardhmes së Himarës. Tiranë: Shtëpisë Botuese FLESH.
- Gjokopulli, Marko. 2007. *Shkolla »Gjikë Bixhili«- Dhërmi –Historiku*. Tiranë.
- Gjipali, Ilir. 2004. *Kërkime Arkeologjike në Bregdetin Jonian*. V: Nasi, Prifti, *et.al.* (bot.), Himara në shekuj. Tiranë: Akademia e Shkencave.
- Glenny, Misha. 2000 [1999]. *The Balkans 1804-1999. Nationalism, War and the Great Powers*. London: Grant Books
- Glytsos, Nicholas P. 1995. *Problems and Policies Regarding the Socio-economic Integration of Returnees and Foreign Workers in Greece*. *International Migration*, 33 (2): 155-76.
- Gold, John R. 1980. *An Introduction to Behavioural Geography*. Oxford: Oxford University Press.
- Gould, Peter in Rodney White. 1974. *Mental Maps*. England: Penguin Books.
- Grameno, Mihael. 1925. *Kryengritja Shqiptarë*. Vlorë.
- Green, Sarah F. 2005. *Notes from the Balkans. Locating Marginality and Ambiguity on the Greek-Albanian Border*. Princeton: Princeton University Press.





## BIBLIOGRAFIA

- Gregorič Bon, Nataša. 2007a. Kartiranje in vzpostavljanje prostorov v Dermiju/ Drimadesu v južni Albaniji. *Traditiones*, 36 (2): 159–174.
- Gregorič Bon, Nataša. 2007b. Smeti kot stvari zunaj kraja v Dermiju/Drimadesu, južna Albanija. *Glasnik Slovenskega etnološkega društva* 47 (3-4): 17–26.
- Grillo, Ralph. 1996. *Language and Linguistic. Nē: Barnard Alan in Jonathan Spencer (bot.)*, Encyclopedia of Social and Cultural Anthropology. London: Routledge.
- Grosjean François. 1982. *Life with two Languages: An Introduction to Bilingualism*. Cambridge, MA: Harvard University Press.
- Gupta, Akhil dhe James Ferguson (bot.). 2001 [1997]. *Culture, Power and Place. Explorations in Critical Anthropology*. Durham and London: Duke University Press.
- Gupta, Akhil. 2001 [1997]. *The Song of the Nonaligned World: Transnational Identities and the Reinscription of Space in Late Capitalism*. Nē: Gupta, Akhil in James Ferguson (bot.), *Culture, Power and Place. Explorations in Critical Anthropology*. Durham and London: Duke University Press.
- Hagedorn, Konrad. 2002. *The Political Economy and Institutional Evolution of Privatisation and Restructuring of Agricultural Land in Central and Eastern Europe*. Paper presented to the Regional Conference on Land Issues in Central and Eastern Europe and the CIS, Budapest, Hungary, 3-6.4., 2002.
- Hammond, N.G.L. 1967. *Epirus. The Geography, the Ancient Remains, the History and the Topography of Epirus and Adjacent Areas*. Oxford: Clarendon Press.
- Hammond, N.G.L. in H.H. Schullard (bot.). 1976 [1970]. *The Oxford Classical Dictionary*. Second Edition. Oxford: Clarendon Press.
- Hamers, Josiane F. in Michael A. Blanc. 1989. *Bilinguality and Bilingualism*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Harding, A.F. 2000. *European Societies of the Bronze Age*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Harvey, David. 1973. *Social Justice and the City*. London: Arnold.
- Harvie, Christopher. 1994. *The Rise of Regional Europe*. London: Routledge.
- Hasluck, Margaret. 1954. *The Unwritten Law of Albania*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Hatziantoniou, Kosta. 2002. *Himara, to Aparto Kastro tou Helenismou*. Athina.
- Hatziprokopiou, Panos. 2003. *Albanian Immigrants in Thessaloniki, Greece: Process of Economic and Social Incorporation*. *Journal of Ethnic and Migration Studies*, 29 (6): 1033-1059.
- Heidegger Martin. 1977. *Building Dwelling Thinking*. Nē: Krell D.F. (bot.), *Basic Writings*. New York: Harper and Row.
- Henry, Rosita. 1994. *Kuranda at War: Contested Space and the Politics of the Market Place*. *Australian Journal of Anthropology*, 5 (3): 294-305.
- Herzfeld, Michael. 1982. *Ours Once More. Folklore, Ideology, and the Making of Modern Greece*. Austin: University of Texas Press.
- Herzfeld, Michael. 1985. *The Poetic of Manhood. Contest and Identity in a Cretan Mountain Village*. Princeton: Princeton University Press.
- Herzfeld, Michael. 1991. *A Place in History. Social and Monumental Time in a Cretan Town*. Princeton: Princeton University Press.





## BIBLIOGRAFIA

- Herzfeld, Michael. 2005. *Cultural Intimacy. Social Poetics in the Nation-State*. New York: Routledge.
- Hirsch, Eric in Michael O'Hanlon. 1995. *The Anthropology of Landscape. Perspectives on Place and Space*. Oxford: Clarendon Press.
- Hirschon, Renée. 1983. Women the Aged and Religious Activity: Oppositions and Complementarity in an Urban Locality. Në: Allen, P. in L. Mackrakis (bot.), *Women and Men in Greece*. *Journal of Modern Greek Studies*, 1 (1) 113-129.
- Hirschon, Renée. 1998 [1989]. *Heirs of the Greek Catastrophe. The Social Life of Asia Minor Refugees in Piraeus*. New York: Berghahn Books.
- Hobhouse, John Cam. 1813. *A Journey Through Albania and Other Provinces of Turkey in Europe and Asia Constantinople during the years 1809 and 1810*. London: James Cawthorn.
- Hobsbawm, Eric in Terrence Ranger. 2001 [1983]. *The Invention of Tradition*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Hysa, Ramazan. 2005. *Albanian – English – Albanian Dictionary*. Tiranë: EDFA.
- Ingold, Tim. 1993. The Temporality of the Landscape. *World Archaeology. Conceptions of Time in Ancient Society*, 25 (2): 153-174.
- Ingold, Tim. 1996. *Social Relations, Human Ecology and the Evolution of Culture: An Exploration of Concepts and Definitions*. Në: Lock, Andrew and Charles R. Peters (bot.), *Handbook of Human Symbolic Evolution*. Oxford: Clarendon Press.
- Ingold, Tim. 2000. *The Perception of the Environment. Essays in Livelihood, Dwelling and Skill*. London and New York: Routledge.
- INSTAT (2004). *Albania Census Atlas 2001*. Tiranë: Instituti i statistikës.
- Iossifides, Marina A. 1991. Sisters in Christ: Metaphors of Kinship Among Greek Nuns. V: Loizos, Peter in Evthymios Papataxiarchis (bot.), *Contested Identities. Gender and Kinship in Modern Greece*. Princeton: Princeton University Press.
- Jacques, Edwin E. 1995 [1908]. *The Albanians. An Ethnic History from Prehistoric Times to the Present*. North Carolina and London: McFarland & Company, Inc. Publishers Jefferson.
- Jezernik, Božidar. 1998. Dežela, kjer gre vse narobe. *Prispevki k etnologiji Balkana*. Ljubljana: Znanstveno in publicistično središče, zbirka Sophia 2/98.
- Jorgji, Kristaq V. 2006a. The Himariotes Discuss on Himara. *ABC Daily*, april 1, str. 4-6.
- Jorgji, Kristaq V. 2006b. How the Himariotes see Himara. *ABC Daily*, april 2, str. 18.
- Jorgji, Kristaq V. 2006c. A Review of Mr. Frashëri's Paper on Himara: »Conversation with the Greek Historians«, <http://www.himara.eu/articles/004-en.html> (28.10.2007).
- Just, Roger. 1991. The Limits of Kinship. Në: Loizos, Peter in Evthymios Papataxiarchis (bot.), *Contested Identities. Gender and Kinship in Modern Greece*. Princeton: Princeton University Press.
- Kabo, Mevlan. 2004. *Veçori Gjeografike të Trevës së Himarës*. Në: Nasi, Lefter, Kristaq Prifti, idr. (bot.), *Himara në Shekuj*. Tiranë: Akademia e Shkencave Shqipërisë.
- Kalčić, Špela. 2006. *Oblačilne prakse in procesi redefinicije identitete v slovenskih muslimanskih skupnostih po razpadu Jugoslavije*. Doktorska disertacija. Ljubljana: Univerza v Ljubljani.





## BIBLIOGRAFIA

- Kasoruh, Amik. 1996. Një Ankh Gjysmëshekullor. Shqipëria e Enver Hoxhës. Tiranë: Çabej.
- Keena, Margaret E. 1993. Return Migrants and Tourism Development: An Example from Cyclades. *Journal of Modern Greek Studies*, 11 (1): 75-96.
- Knežević Hočevar, Duška. 1999. Družbena razmejevanja v Dolini Zgornje Kolpe. Domačinska zarnišlanja nacije in lokalitete. Ljubljana: Založba ZRC.
- Koçi, Jano. 2006. Himara (Kaonia). Arkeologji-Histori-Kulturë-Himara sot. Tiranë: Shtëpia botuese Gent Grafik.
- Koka, Viron. 2004. Pretendimet Greke Ndaj Shqipërisë së Jugut dhe Himarës (Vitet '20-'30 të Shek. XX). Në: Nasi, Lefter, Kristaq Prifti, idr. (bot.), Himara në Shekuj. Tiranë: Akademia e Shkencave Shqipërisë.
- Kondis Basil and Eleftheria Manda. 1994. The Greek Minority in Albania. A Documentary Record (1921-1993). Thessaloniki: Institute for Balkan Studies.
- Konomi, Vasil. 2001. Greqia – Shqipëria dhe Emigranti. Tiranë: GEER.
- Korkuti, Muzafër. 2004. Vendbanimet e Fortifikuara Paraqytetare në Bregdetin e Jonit. Në: Nasi, Lefter, Kristaq Prifti, idr. (bot.), Himara në Shekuj. Tiranë: Akademia e Shkencave Shqipërisë.
- Kretsi, Georgia. 2002. »Shkelqen« oder »Giannis«? Namenwechsel und Identitätsstrategien Zwischen Heimatkultur und Migration. Në: K. Kaser, P. Pichler in S. Schwandner-Sievers (bot.), Die Weite Welt und das Dorf. Albanische Emigration am Ende des 20. Jahrhunderts. Wien: Böhlau.
- Leake, Martin. 1967. Travels in Northern Greece. Volume I. Amsterdam: Adolf M. Hakkert Publisher.
- Lear, Edward. 1988 [1851]. *Journal of a Landscape Painter in Greece and Albania*. Introduction by Steven Runciman. London: Century.
- Lefebvre, Henri. 1991[1974]. *The Production of Space*. Translated by Donald Nicholson-Smith. Oxford: Blackwell.
- Lovell, Nadia (bot.). 1998. *Locality and Belonging*. London: Routledge.
- Low, Setha M. in Denise Lawrence- Zúñiga (bot.). 2003. *The Anthropology of Space and Place. Locating Culture*. Oxford: Blackwell Publishing.
- Lowenthal, David. 1961. Geography, Experience, and Imagination: Towards a Geographic Epistemology. *Annals of the Association of American Geographers*, 51: 241 -260.
- Lubonja, Fatos. 2002. Between the Glory of a Virtual World and the Misery of a Real World. Në: Schwandner-Sievers, Stephanie in Bernd J. Fischer (bot.), *Albanian Identities. Myth and History*. London: Hurst & Company.
- Mai, Nicola dhe Stephanie Schwandner-Sievers. 2003. Albanian Migrations and New Transnationalisms. *Journal of Ethnic and Migration Studies*, 29 (6): 939-948.
- Malcom, Noel. 2002. Myths of Albanian National Identity: Some Key Elements, as Expressed in the Works of Albanian Writers in America in the Early Twentieth Century. Në: Schwandner-Sievers, Stephanie in Bernd J. Fischer (bot.), *Albanian Identities. Myth and History*. London: Hurst & Company.
- Malltezi, Luan. 2004. Himara dhe Qëndresa Kundërosmane në Shek. XV. Në: Nasi, Lefter, Kristaq Prifti, idr. (bot.), Himara në Shekuj. Tiranë: Akademia e Shkencave Shqipërisë.





## BIBLIOGRAFIA

- Marko, Petro. 1998. Shpella e Pirateve. Tiranë: Shtëpia Botuese »Mësonjtorja«.
- Marko, Stavri. 2006. Disa Sugjerime për Rritjen e Efektivitetit të Marketimit të Rajonit të Himarës nga Ana e Bashkisë së Himarës. Në: Punimet e Konferencës Pan-Himariote 2005. Ndërtimi i së Ardhmes së Himarës. Tiranë: Shtëpisë Botuese FLESH.
- Mazower, Mark. 2000. The Balkans. From the End the Byzantium to the Present day. London: Phoenix Press.
- Mauss, Marcel in Henri Beuchat. 1979 [1904]. Seasonal Variations of the Eskimo, prev. James J. Fox. London: Routledge & Kegan Paul.
- Memushaj, Rami. 2003. Himara në Dritë e të dë Nave Historike, Gjuhësire dhe Ethnologjike. Tiranë: Botimet Toena.
- Minorities: The Present and the Future. 2003. Report of AHRG on the Situation of Minorities in Albania. Tiranë: Botimet »Kanun«.
- Modern Albanian Dictionary, 1980. Tiranë: Albanian Academy of Science.
- Morgan, Lewis Henry. 1881. Houses and House-Life of the American Aborigines. Washington, DC: Government Printing Office.
- Muršič, Rajko. 2006. Nova paradigma antropologije prostora. Prostorjenje in človeška tvornost. Glasnik Slovenskega etnološkega društva 46 (3, 4): 48–54.
- Nasi, Lefter, Kristaq Prifti, *et.al.* (bot.). 2004. Himara në Shekuj. Tiranë: Akademia e Shkencave Shqipërisë.
- Navaro-Yashin, Yael. 2002. Faces of the State. Secularism and Public Life in Turkey. Princeton: Princeton University Press.
- Nietzsche, Friedrich. 1991 [1884]. Volja do moči. Poskus prevrednotenja vseh vrednot. Transl. Janko Moder. Ljubljana: Slovenska Matica.
- Nina, Foto. 2004. Drimades. Athina.
- Norris, David A. 1999. In the Wake of the Balkan Myth: Question of Identity and Modernity. Basingstoke, UK: St. Martin's Press.
- Osmani, Shaban idr. 2003. Leximi 4. Tiranë: Shtëpia Botuese e librit shkollor.
- Oxford Greek Dictionary. 1997. Oxford Greek Minidictionary. Oxford: Oxford University Press.
- Pano, Niko idr. 2006. Rehabilitimin Ambjentat dhe Platforma për një Zhvillim të Qëndrueshem Socialo-Ekonomik të Hapesirës Bregdetare të Spile-Himarë (Deti Jon). Në: Punimet e konferencës Pan-Himariote 2005. Ndërtimi i së ardhmes së Himarës. Tiranë: Shtëpisë Botuese FLESH.
- Papadakis, B.P. 1958. Histoire Diplomatique de la Question Nord-Epirote (1912-1957). Athens: J. Alevropoulos.
- Papailias, Penelope. 2003. "Money of Kurbet is Money of Blood". The making of a "Hero" of Migration at the Greek-Albanian Border. Journal of Ethnic and Migration Studies, 29 (6): 1059-1078.
- Pashko, Gramoz. 1993. Obstacles to Economic Reform in Albania. Europe-Asia Studies, 45(5): 907-921.
- Pepa, Pjetër. 2003. The Criminal File of Albania's Communist Dictator. Transl. Vangjel Morcka. Tiranë: UEGEN.
- Peristiany, John G. 1965. Honour and Shame: The Values of the Mediterranean Society. London: Weidenfeld and Nicholson.





## BIBLIOGRAFIA

- Petrović, Tanja. 2006. Ne tu, ne tam. Srbi v Beli Krajini in njihova jezikovna ideologija v procesu zamenjave jezika. Ljubljana: ZRC SAZU.
- Pettifier, James. 2001. The Greek Minority in Albania. In the Aftermath of Communism. Surrey: Conflict Studies Research Centre.
- Pollo, Stefanaq in Arben Puto. 1981. The History of Albania from Its Origins to the Present. London: Routledge and Kegan Paul.
- Pouqueville, F. C. H. L. 1825. Histoire de la Régénération de la Grèce. 3 eds. 3 Vols. Brixelles: Imprimerie d'Auguste Wahlen.
- Prendi, F. 1982. The Prehistory of Albania. Cambridge Ancient History III (1): 187-237.
- Prifti, Kristaq. 2004. Kontributi i Populsisë së Himarës në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare të Periudhës së Rilindjes (Shek. XIX-1912). Në: Nasi, Lefter, Kristaq Prifti, et.al. (bot.), Himara në Shekuj. Tiranë: Akademia e Shkencave Shqipërisë.
- Qesari, Vasil. 2000. Post-Scriptum për Diktaturen. France: Laurent Monfort.
- de Rapper, Gilles. 2002. »Culture« and the Reinvention of Myth in a Border Area. Në: Schwandner-Sievers, Stephanie in Bernd J. Fischer (bot.), Albanian Identities. Myth and History. London: Hurst & Company.
- de Rapper, Gilles in Pierre Sintès. 2006. Composer Avec le Risque : La Frontière Sud de l'albanie Entre Politique des Etats et Solidarités Locales. Revue D'études Comparatives Est-Ouest, 37 (2): 6-37.
- Relph, Edward. 1976. Place and Placelessness. London: Pion Limited.
- Riza, Emin. 2004. Banesat Popullore në Kalanë e Himarës. Në: Nasi, Lefter, Kristaq Prifti, et.al. (bot.), Himara në Shekuj. Tiranë: Akademia e Shkencave Shqipërisë.
- Rusha, Spiro. 2001. Himara ne Stuhitë e Shekujve. Tiranë: Shtëpia Botuese »ARBRI«.
- Schwandner-Sievers, Stephanie dhe Bernd J. Fischer (bot.). 2002. Albanian Identities. Myth and History. London: Hurst & Company.
- Schwandner-Sievers, Stephanie. 2005. Times Past: References for the Construction of Local Order in Present—Day Albania. Në: Todorova, Maria (bot.), Balkan Identities. Nation and Memory. London: Hurst & Company.
- Seremetakis, Nadia C. 1991. The Last Word. Women, Death, and Divination in Inner Mani. Chicago: The University of Chicago Press.
- Seymour-Smith, Charlotte. 1986. Macmillian Dictionary of Anthropology. London: Basingstoke.
- Selwyn, Tom (bot.). 1996. The Tourist Image: Myths and Mythmaking in Tourism. London: Wiley.
- Sinani, Shaban. 2004. Himara: Identiteti i Bashkësisë dhe Ethnotipi. V: Nasi, Prifti, et.al. (bot.), Himara në shekuj. Tiranë: Akademia e Shkencave.
- Sjöberg, Örjan. 1992. Underurbanisation and the Zero Urban Growth Hypothesis: Diverted Migration in Albania. Geografiska Annaler. Series B, Human Geography, 74 (2): 3-19.
- Smith, Valene L. (bot.). 1989 [1977]. Hosts and Guests. The Anthropology of Tourism. Philadelphia: University of Pennsylvania Press.
- Sotiri, Natasha. 2001. E Folmja dhe Toponimia e Qeparoit. Konica: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë.





## BIBLIOGRAFIA

- Sotiri, Natasha. 2004. E Folmja e Himarës. Në: Nasi, Lefter, Kristaq Prifti, *et.al.* (bot.), Himara në Shekuj. Tiranë: Akademia e Shkencave Shqipërisë.
- Spiru, Llambro. 1965. I Himara. Athina.
- Stewart Pamela J. dhe Andrew J. Strathern. 2003. Landscape, Memory and History. Anthropological Perspectives. London: Pluto Press.
- Strathern, Marilyn. 2005 [1991]. Partial Connections. Savage, Md.: Rowman & Littlefield.
- Šašel Kos, Marjeta. 2005. Appian and Illyricum. (Situla, 43). Ljubljana: Narodni muzej Slovenije.
- Škaljić, Abdulah. 1966. Turcizmi u Srpskohrvatskom jeziku. Sarajevo: "Svjetlost" Izdavačko preudozeće.
- Škiljan, Dubravko. 2002. Govor nacije. Jezik, nacija, Hrvati. Zagreb: Golden Marketing.
- Šumi, Irena. 2000. Kultura, etničnost, mejnost. Konstrukcije različnosti v antropološki presoji. Ljubljana: Založba ZRC SAZU.
- Thëngjilli, Petrika. 2004. Aspekte të Përpyjekjeve të Himarijotëve për Liri (Shek. XVI-XVIII). V: Nasi, Lefter, Kristaq Prifti, *et.al.* (bot.), Himara në Shekuj. Tiranë: Akademia e Shkencave Shqipërisë.
- Tilley, Christopher. 1994. A Phenomenology of Landscape. Places, Paths and Monuments. Oxford: Berg.
- Todorova, Maria. 1997. Imagining the Balkans. New York: Oxford University Press.
- Todorova, Maria (bot.). 2004. Balkan Identities. Nation and Memory. London: Hurst & Company.
- Triandafyllidou, Anna in Mariangela Veikou. 2002. The Hierarchy of Greekness. Ethnic and National Identity Considerations in Greek Immigration Policy. *Ethnicities*, 2 (2): 189-208.
- Tsitselikis, Konstantinos. 2003. Citizenship in Greece. Present Challenges for future changes. Dual citizenship, Governance and education, Administrative Secretariat of the Minority Groups Research Centre (KEMO), [http://209.85.129.104/search?q=cache:FrOy9S7Oi8AJ:www.antigone.gr/project\\_deliverables/Citizenship\\_in\\_Greece\\_\\_\\_Present\\_challenges\\_for\\_future\\_changes.doc.+76.+Tsitselikis,+Konstantinos+\(2003\).+Citizenship+in+Greece&hl=sl&ct=clnk&cd=2&gl=si&client=firefox-a](http://209.85.129.104/search?q=cache:FrOy9S7Oi8AJ:www.antigone.gr/project_deliverables/Citizenship_in_Greece___Present_challenges_for_future_changes.doc.+76.+Tsitselikis,+Konstantinos+(2003).+Citizenship+in+Greece&hl=sl&ct=clnk&cd=2&gl=si&client=firefox-a) (Zadnjič obiskano 20.10.2007).
- Tuan, Yi-Fu. 1974. Topophilia. A Study of Environmental Perspective of Experience. Minneapolis: University of Minnesota Press.
- Tuan, Yi-Fu. 1977. Space and Place. The Perspective of Experience. Minneapolis: University of Minnesota Press.
- United Nations Development Programme Global Environment Facility. 1999. Conservation of Wetland and Coastal Ecosystems in the Mediterranean Region. Tirana: Ministry of Health and Environment and the Committee for Environmental Protection.
- Vickers, Miranda. 2001. The Albanians. A Modern History. London: I.B. Tauris.
- Voje, Ignacij. 2006. Turški dokumentarni viri. Ljubljana: Oddelek za zgodovino Filozofske Fakultete v Ljubljani.





- Vullnetari, Julie. 2007. Albanian Migration and Development: State of the Art Review. IMISCOE Working Paper, št. 18, September.
- Wagner, Roy. 1991. The Fractal Person. Në: Strathern Marilyn in Maurice Godelier (bot.), Big Men and Great Men: Personifications of Power in Melanesia. Cambridge: Cambridge University Press.
- Wahab, Salah. 1975. Tourism Management. London: Tourism International Press.
- Winniffrith, T.J. 2002. Badlands – Borderlands. A History of Northern Epirus/Southern Albania. London: Duckworth.
- de Waal, Clarissa. 1996. Decollectivisation and Total Scarcity in High Albania. Në: Abrahams, Ray (bot.), After Socialism. Land Reform and Rural Social Change in Eastern Europe. Oxford: Berghahn Books.
- de Waal, Clarissa. 2005. Albania Today. A Portrait of Post-Communist Turbulence. London and New York: I. B. Tauris and Company.
- Whitaker, Ian. 1976. Familial Roles in the Extended Patrilineal Kin-group in Northern Albania. Në: Peristiany, John G. (bot.), Mediterranean Family Structures. Cambridge: Cambridge University Press.
- Whitaker, Ian. 1981. "A Sack for Carrying Things": The Traditional Role of Women in Northern Albanian Society. Anthropological Quarterly, 54:146-156.
- WHO, <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs211/en/> (1.6.2007).
- Wolf, Eric. 1997 [1982]. Europe and the People without History. Berkeley and Los Angeles: University of California Press.
- Zamputi, Njac dhe Selami Pulaha (bot.). 1990. Dokumente te Shekujve XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë Vellimi IV (1975-1699). Tiranë: Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë.
- Zdruli, Pandi idr. 2004. Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities.

